



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Факултет за јазици, култури и комуникација
Faculty of Languages, Cultures and Communication

STUDIMET E DOKTORATËS - CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA:

ÇËSHTJE ETNOLINGUISTIKE DHE PEDAGOGJIKE TË ABETAREVE SHQIPE NË KOSOVË

KANDIDATI:

Ma. sc. Valentina Nimonaj-Hoti

MENTORI:

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Tetovë, Prill 2020

PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	6
Abstract.....	7
Disa fjalë për autoren.....	9
HYRJA	11
Objekti i studimit.....	11
Metodologjia e punës	13
I. HISTORIKU I ABETAREVE SHQIPE	16
1. AUTORËT E ABETAREVE SHQIPE	17
1.1. Abetaret e Naum Veqilharxhit	17
1.2. Abetaret e Konstandin Kristoforidhit.....	20
1.3. Abetarja e Daut Boriçit.....	21
1.4. Abetaret shqipe para Kongresit të Manastirit	22
1.5. Abetaret shqipe pas Kongresit të Manastirit.....	24
2. ABETARET NË SHQIPËRI (1945-2012).....	27
3. ABETARET SHQIPE NË MAQEDONI.....	33
4. ABETARET SHQIPE NË KOSOVË 1945 - 2012	34
4.1. Abetaret shqipe para Kongresit të Drejtshkimit.....	35
4.1.1. KËNDIMI im i parë e vitit 1945.....	36
4.1.2. Abetare për të rritur e vitit 1946.....	37
4.1.3. Abetare për klasën e parë të shkollës fillore e vitit 1947	38
4.1.4. Abetare për të rritur e vitit 1948.....	39
4.1.5. Abetare për klasën e parë të shkollave fillore e vitit 1951	40
4.1.6. ABETARJA, 1955	41
4.1.7. ABETARJA, 1966	42
4.1.8. ABETARJA, 1967	43
4.1.9. ABETARJA, 1972	44
4.2. Abetaret shqipe në Kosovë pas Kongresit të Drejtshkimit të gjuhës shqipe.....	46
4.2.1. ABETARJA, 1977	47
4.2.2. ABETARJA, 1982	48

4.2.3. ABETARJA, 2003	49
4.2.4. ABETARJA, 2008	51
4.2.5. ABETARJA, 2012	52
II. AUTORËT E ABETAREVE SHQIPE NË KOSOVË.....	54
1. REXHEP SHPENDI.....	55
2. MEHMET GJEVORI (1912-2007)	56
3. KOLË XHUMARI (1912-2006).....	57
4. STATHI KOSTARI	59
5. SHEFQET VELIU.....	60
6. MEHMEDALI HOXHA (1924-1991)	61
1. RAMIZ HOXHA.....	61
8. JUSUF SHUSHKA	62
9. QAMIL BATALLI (1936-2009).....	63
10. ISLAM KRASNIQI.....	65
11. AGIM DEVA (1948 - 2009)	66
12. MIMOZA ÇANO- GJOKUTAJ.....	67
13. SHEZAI RROKAJ.....	68
III. STRUKTURA E ABETAREVE	70
1. Paraabetarja pjesë e programit të abetares nga viti 1945-2012	70
2. Paraabetarja pjesë e Abetares	73
3. Paraabetarja, libër i veçantë	78
4. Paraabetarja, pjesë e librit të Abetares dhe librit Abetare Pune.....	80
5. Abetarja e mirëfilltë dhe struktura e orës mësimore	83
IV. METODAT E MËSIMIT TË LEXIMIT DHE SHKRIMIT NË ABETARET SHQIPE NË KOSOVË	90
1. Metodatat sintetike.....	91
1.1. Metoda e leximit rrokje për rrokje	91
1.2. Metoda e tingujve natyralë.....	92
1.3. Metoda fonografike	93
1.4. Metoda fonetike	93
2. Metoda analitike	94
2.1. Metoda e fjalive normale.....	94
2.2. Metoda e fjalës normale.....	95
2.3. Metoda e rrokjeve normale.....	96
3. Metoda globale.....	97

4.	Metoda analitike-sintetike.....	98
5.	Format e mësimi të shkronjave në abetare.....	99
5.1.	Forma monografike.....	99
5.2.	Forma e mësimi grup të shkronjave	103
6.	Forma komplekse.....	105
V.	ONOMASTIKA E ABETAREVE SHQIPE NË KOSOVË	106
1.	Emrat e krijuar nga një fjalë e shqipes.....	107
1.1.	Frekuenca e emrave nga fjalë shqipe në abetare	114
1.2.	Emrat ilirë në abetaret shqipe në Kosovë.....	115
1.3.	Emra të vjetër katolikë në abetaret shqipe në Kosovë	117
2.	Emrat sllav.....	119
3.	Emrat Oriental.....	120
4.	Emra të dalë nga ndonjë emër tjetër.....	124
4.1.	Antroponimet e dala nga emra të vendeve.....	124
4.2.	Emra, trajta të dala vetëm nga pjesa e parë e emrit	125
4.3.	Emra, trajta të dala nga pjesa fundore e emrit.....	126
4.4.	Emra me shkurtime cunime të ndryshme në abetare.	126
5.	Emra të dalë nga toponime.....	127
5.1.	Emra të dalë nga Oronimet.....	127
5.2.	Emra të dalë nga Hidronimet.....	127
5.3.	Emra të dalë nga Patronimet	128
5.4.	Emra të dalë nga Toponimet.....	128
5.5.	Emra të dalë nga emrat e vendbanimeve.....	128
5.6.	Emra të dalë nga Etnonimet	129
5.7.	Emra të dalë nga emrat përkëdhelës.....	130
5.8.	Emra që shprehin dëshirë	130
VI.	ANALIZA DIALEKTORE E ABETAREVE	134
1.	Analizë fonologjike në abetaret deri në vitin 1972.....	136
1.1.	Metafonia.....	137
1.2.	Rënia e tingujve.....	138
	Afereza	138
	Sinkopa.....	138
	Apokopa	139
1.3.	Kalimi i tingullit /ë/ në /a/.....	140

1.4. Kalimi i bashkëtingëllores /h/ në /f/	142
1.5. Rotacizmi.....	142
1.6. Alternimi i bashkëtingëlloreve /mb>m, nd>n, ng>k/	143
1.7. Asimilimi i grupeve të zanoreve / ue, ye, ie/	144
1.8. Mbaresat: /shin/, /ue/, /vet/, /uem/ dhe /er/.....	147
Mbaresa: /shin/	147
Mbaresa: /ue/	147
Mbaresa: /vet/	147
Mbaresa: /uem/	148
Mbaresa: /er/	148
1.9. Ndryshim i kuptimit	148
2. Vështrime etnolinguistike	151
1.1. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse,	151
1.2. Pasqyrimi i fjalëve të urta	152
VII. ABETARET DHE EDUKIMI MORAL	153
1. Edukimi për jetë në familje	157
2. Edukimi kombëtar	159
3. Edukimi për punën	163
4. Edukimi për dashuri ndaj shkollës	165
5. Edukimi human	168
6. Edukimi ndërkombëtar	171
7. Njohja e moralit	172
8. Premtimet	174
9. Bujaria	174
10. Morali	175
1. Mjetet e edukimit moral	175
1.1. Këshilla	176
1.2. Modeli	177
1.3. Gara	179
1.4. Denimi	179
2. Llojet e edukimit	179
PËRFUNDIMI	181
CONCLUSION.....	186
BIBLIOGRAFIA.....	191

Abstrakt

Në këtë punim të disertacionit të doktoraturës me titull “Çështje etnolinguistike dhe pedagogjike të abetareve shqipe në Kosovë”, kemi për qëllim të paraqesim një studim sa më të thellë dhe të plotë mbi abetaret në Kosovë. Rëndësia e këtij punimi është pikërisht tek të dhënat gjuhësore dhe pedagogjik për të gjitha abetaret pas Luftës së Dytë Botërore. Fakte të cilat kanë munguar deri me sot në veprimtarin botuese në Kosovë.

Hulumtimi është bërë në të gjitha abetaret e botuara nga vitit 1945- 2012, në Kosovë. Kjo do të thotë se analiza fillon nga abetarja e parë e vitit 1945, deri te abetarja e fundit mbarëkombetare e vitit 2012, që aktualisht përdoret në shkollat tona për nxënësit e klasës së parë. Për t’i paraqitur në mënyrë sa më të plotë abetaret, duke u mbështetur edhe në ndryshimet shoqërore, gjuhësore, historike, politike dhe arsimore që i përcakton ato, shfrytëzuam metodën përshkruese, metodën krahasuese dhe atë historike.

Studimin e kemi përqendruar në fushën e gjuhësi dhe pedagogjisë. Ku brenda pedagogjisë përfshihet disiplina e historisë së arsimit shqiptar, pikërisht duke analizuar problemet nga kjo fushë si: Paraqitja kronologjike e të gjitha abetareve shqipe. Ky historik është paraqitur edhe si e veçantë prej viteve 1945 e deri sot, për abetaret në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë.

Fokus i këtij studimi është edhe qasja metodike duke i shqyrtuar të gjitha metodat dhe format me të cilat janë hartuar abetaret. Pastaj, struktura e ndërtimit të abetareve si: paraabetarja, abetarja, struktura e orës mësimore në abetare. Analizohet dhe ndikimi edukativ i abetares, me theks të veçantë, komponentja e edukimit moral.

Onomastika është një çështje tjetër në këtë studim sepse emrat në abetare përbëjnë një fushë të rëndësishme e interesante për hulumtim. Analizohen me theks të veçantë antroponimet apo emrat vetanak (personal). Në grupin e antroponimeve përfshihen këto lloje të emrave të njerëzve si: emrat nga një fjalë shqipe, emrat ilirë, emrat katolikë, emrat sllavë, emrat oriental, antroponimet e dala nga emra të vendeve, emra trajta të dala nga

pjesa e parë dhe e fundit e emrit dhe emra shkurtime, cungime të ndryshme, pa lënë anash edhe oronimet, hidronimet, patronimet, etnonimet etj.

Një tematikë tjetër gjuhësore është dhe analiza dialektore e abetareve, ku analizohen shumë çështje dialektore të abetareve.

Pastaj studimi ofron të dhënat për jetën dhe veprimtarinë e autorëve të abetareve të cilët ishin edhe mësues, shkrimtarë, hartues, redaktorë, metodistë dhe gjuhëtar. Pra, kështu vihen në pah ndryshimet e abetareve ndër vite në vazhden e arritjeve nga dy shkencat si gjuha dhe pedagogjia.

Fjalët çelës: abetare, paraabetare, gjuha, etnolinguistika, dialektologjia, onomastike, metodika, edukimi.

Abstract

In this paper of the doctoral dissertation titled "Ethnolinguistic and pedagogical subjects of Albanian ABC-Books in Kosovo" we aim to present a deeper and comprehensive study of ABC-Books in Kosovo. The significance of this paper is precisely in the linguistic and pedagogical data for all ABC-Books after World War II. Facts that have been missing to date in publishing activities in Kosovo.

The research was done in all ABC-Books published from 1945 to 2012 in Kosovo. This means that the analysis starts from the first ABC-Book of 1945 to the last nationwide ABC-Book of 2012, currently used in our schools for first grade students. To present the ABC-Books as fully as possible, relying on the social, linguistic, historical, political, and educational changes that determined them, we used the descriptive, comparative and historical method.

We have focused our research in the field of linguistics and pedagogy. Where pedagogy includes the discipline of the history of Albanian education, precisely by analyzing problems in this field such as: Chronological presentation of all Albanian ABC-Books. This history is also presented as a special one from 1945 until today, for ABC-Books in Albania, Macedonia and Kosovo.

The focus of this study is also on the methodical approach by examining all the methods and forms by which ABC-Books are designed. Then the structure of construction of ABC-Books such as: Pre ABC-Book, ABC-Book and the structure of lessons in the ABC-Book. The educational impact of the ABC-Book is also analyzed, with a particular emphasis on the moral education component.

Onomastics is another subject in this study, because names in ABC-Books constitute an important and interesting area for research. Special emphasis is given to anthroponymy or personal names. The group of anthroponymy includes these types of people's names such as: names from an Albanian word, Illyrian names, Catholic names, Slavic names, Oriental names, anthroponymy derived from names of places, names and forms deriving from the first and last part of the name and different truncation name abbreviations, without excluding the oronyms, hydronyms, patronymics, etchings, etc.

Another linguistic theme is the dialectical analysis of ABC-Books, where many dialectical issues of ABC-Books are analyzed.

The study then provides information on the lives and activities of the authors of the ABC-Books who were also teachers, writers, drafters, editors, methodists and linguists. This is how the ABC-Books change over the years in line with the achievements of the two sciences such as language and pedagogy.

Keywords: ABC-Book, Pre ABC-Book, language, ethnolinguistics, dialectology, onomastics, methodology, education.

Disa fjalë për autoren

Valentina Nimonaj-Hoti u lind më 12.03.1981 në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesmen i përfundoi në vendlindje. Studimet themelore universitare i përfundoi në Departamentin e Pedagogjisë, Fakultetit Filozofik, Universitetit të Prishtinës, mori titullin Profesor i pedagogjisë. Në të njëjtin fakultet i përfundoi edhe studimet pasuniversitare-Master, në programin: Pedagogji e përgjithshme (drejtimi shkencor) dhe e mori titullin: Master i shkencave të pedagogjisë.

Në vitin 2014/2015 i regjistroi studimet e doktoraturës në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe, Tetovë.

Nga viti 2008 ka filluar punën asistente në Departamentin e Pedagogjisë, Fakulteti Filozofik. Aktualisht punon në të njëjtin Departament, por në Fakultetin e Edukimit.

Në vitin 2014 / 2015, ka ligjëruar në Fakultetin e Edukimit, në Gjakovë, në programin për Avancim e Kualifikimin e Mësimdhënësve (AKM).

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë & Alled, është trajnere për shkollat Profesionale. Për përfshirjen e komponentes pedagogjike dhe didaktike në shkollat profesionale, ka mbajtur trajnim me mësimdhënës të shkollave profesionale, nga këto komuna: Deçani, Peja dhe Rahoveci.

Në vitin 2016 është trajnuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë & USAIDI si trajnerë për identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për përmirësim të shkathtësive të leximit.

Në vitin 2017 ka qenë pjesë e trajnimit për Metodën e përziera (mikse) në hulumtim, organizuar nga Universiteti i Indianas dhe Universiteti i Prishtinës.

Nga viti 2019 është trajnere për ngritjen e kapaciteteve në arsimin fillor-Mësimdhënia me nxënësin në qendër, të organizuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë & GIZ.

Për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, në vitin 2019, ka ndjekur trajnimin me temë: Mësimdhënia në arsimin e lartë dhe trajnimin, Planifikimi dhe zbatimi (implementimi) i mësimdhënies në arsimin e lartë. Si hulumtues ka marrë pjesë në disa konferenca si:

- Java e shkencës 2013, “Abetaret shqipe në Kosovë 1945-1948”, Prishtinë.

- Java e shkencës 2014, “Krahasimi i abetares mbarëkombëtare me abetaren e vitit 2008”, Prishtinë.
- Konferencë shkencore ndërkombëtare. “Demokracia në Evropën Juglindore”2014, “Analizë pedagogjike e abetares mbarëkombëtare”, Tetovë.
- Sfidat e studimeve albanologjike në fillim të shek. XXI, “Zhvillimi i germave të shtypit dhe atyre tëshkrimit në abetaret e Ramiz Hoxhës”, Tetovë.
- Konferencë Mbarëshqiptare “130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe-vatër e arsimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, 2017, “Mësimi i leximit dhe shkrimit në abetaret e Qamil Batallit” Korçë.
- European Conference on social and behavioral sciences, 2018, “Struktura e abetareve shqipe” Prizren.
- The Art and Science of Teaching: A conference on pedagogy and research in Education”, 2019, “Onomastics of Albanian abc-books in Kosovo” Prishtinë.

Publikimet shkencore:

- Titulli i punimit, Analizë pedagogjike abetares mbarëkombëtare”, Emri i revistës, “Diskutimi”, viti III. nr.11.Maj 2014.
- Titulli i punimit, “Onomastics of albanian ABC-books in Kosovo”, Revista, European Journal of Foreign Language Teaching, Volume 4. Issue 1. 2019.
- Titulli i punimit, Teaching reading and writing to first grade students from 1982-2000, Revista, European Journal of Foreign Language Teaching, Volume 4. Issue 3. 2019.

Publikimet tjera:

- “Abetaret shqipe në Kosovë 1945 -2012”, Prishtinë, 2014.
- “Pedagogjizimi, kjo polifoni edukative”, Bashkautore, Prishtinë, 2018.
- Bashkautore/kontribuese (Edukim), (zërat në fushën e edukimit). Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.2018 / I, II /

HYRJJA

Objekti i studimit

Studimi i çështjeve etnolinguistike e pedagogjike të abetareve shqipe në Kosovë, paraqet një hulumtim mjaft interesant dhe të rëndësishëm. Njohja e librit të parë të nxënësve të klasës parë në Kosovë është pjesë e historisë së shkollës shqipe në Kosovë dhe historisë së përgjithshme të popullit.

Njohja me aspektet etnolinguistike dhe pedagogjike të abetareve kanë rëndësi: gjuhësore, pedagogjike, praktike dhe për historinë e arsimit shqiptar. Studimi e këtij teksti shkollor nga vitit 1945 e deri sot, paraqet fakte të dhëna, informacione për të gjithë punonjësit shkencor, arsimdashësit, mësimdhënësit dhe hartuesit e abetareve.

Të dhëna që mund t'i ndihmojnë hartuesve dhe projektuesve të politikave arsimore për klasën e parë, që ta njohin të kaluarën dhe ta ndërtojnë të ardhmen pa përsëritur lëshimet që kanë pasur këto tekste për 65 vite. Abetaret gjatë historisë së tyre kanë pasur shumë vështirësi të cilat janë lidhur me shumë rrethana dhe faktorë nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1999.

Gjatë studimit shohim se abetaret i ka përcjell gjendja e vështirë politike, që nënkupton një kontroll dhe censurë mbi këto libra dhe përpjekja për bartjen e ideologjive politike duke filluar nga çasti kur fëmijët ose dhe të rriturit fillojnë ta shohin dritën e parë të mësimin të leximit shkrimit fillestar. Shihet një tendencë e brumosjes së teksteve, me përmbajtje të tilla, parulla politike, me emra vendesh, njerëzish varësisht sipas qëllimeve e idealeve të tjerëve që i kontrollonin dhe ndikonin mbi këto tekste.

Ndërsa duke i përcjellë në mënyrë kronologjike të gjitha çështjet etnolinguistike dhe pedagogjike të abetareve për të gjitha këto vite, ne pasqyrojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë historinë e arsimit të shkollës shqipe, librit shqip në Kosovë dhe njohim personalitetet e hartuesve të abetareve nga vitit 1945-2012.

Studimi i këtyre librave ka rëndësi edhe gjuhësore për arsye sepse janë studiuar çështjet etnolinguistike, si: onomastike dhe dialektike të abetareve. Ky punim mund të ju shërbej gjuhëtareve si referim për studime të shumta gjuhësore gjë mund të bëhen në te ardhmen. Kurse rëndësia praktike përkon në atë që punonjësit shkencor, hartuesit e abetareve, metodistët të shohin variante të ndryshme të zbatimit të metodave, formave, njohjen e

përmbajtjeve e qëllimeve të këtyre përmbajtjeve, e shumë të dhëna të hollësishme për njohjen të këtyre librave përmes të analizës që ju ofron punimi.

Mbi të gjitha, rëndësia e këtij punimi qëndron në lindjen dhe rritjen e motivimit të studiuesve të fushave të ndryshme për t'i marrë si objekt hulumtimi, që sot do të jenë një njohje, ndihmës ndërsa në të ardhmen testamente që duhet ruajtur. Lexuesit nga përmbajtja e këtij punimi mund të marrin të dhëna, fakte, informacione për çështje të ndryshme të cilat do t'i shtjellojmë në pika të shkurtra sikurse mund t'i gjejmë në përmbajtje.

Kapitulli i parë, ofron të dhëna mbi historikun e abetareve shqipe në përgjithësi, duke filluar nga tri abetaret e para të N. Vixhilharxhit, K. Kristoforidhit dhe D. Boriqit, pastaj punimi vazhdon me abetaret para dhe pas Kongresit të Manastirit. Njohja me abetaret në Shqipëri nga vitit 1945-2012, pastaj në Maqedoni, abetaret shqipe në Kosovë duke i ndare në abetare para dhe pas Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Kapitulli i dytë, përmban të dhëna për jetën, veprën, kontributin e pashoqë të hartuesve të abetareve shqipe, duke filluar nga abetarja e parë dhe deri të abetarja mbarëkombëtare. Kapitulli i tretë, ka të bëjë me strukturën e abetareve. Ku përfshihen paraabetaret në të gjitha abetaret shqipe si periudha përgatitore. Të cilat mund t'i gjejmë si pjesë e abetares, si libra të veçantë dhe si pjesë e abetares dhe abetare punës. Dhe punimi ka përmbajtje për abetaren e mirëfilltë dhe strukturën e orëve mësimore nëpër abetare.

Kapitulli i katërt, përfshin çështje nga metodika e mësimit të leximit dhe shkrimit fillestar. Më konkretisht shikohen metodat që janë zbatuar, qofshin ato sintetike, analitike, globale dhe analitike-sintetike. Pastaj fokusi bie te format e mësimit të tingujve, shkronjave si: Forma monografike, forma e mësimit grup i shkronjave dhe forma komplekse.

Kapitulli i pestë, shqyrton çështjet e onomastikës së abetareve në Kosovë. Në këtë kapitull mund të marrim të dhëna për emrat e ndryshëm si: Emrat e krijuar nga një fjalë shqipe, frekuenca e emrave nga një fjalë shqipe, emrat ilirë në abetaret shqipe në Kosovë, emrat e vjetër katolikë në abetaret shqipe në Kosovë, emrat sllavë, emrat oriental, antroponimet e dala nga emra të vendeve, emra, trajta të dala vetëm nga pjesa e parë e emrit, emra, trajta të dala vetëm nga pjesa fundore e emrit, emra që shprehin dëshirë, oronimet, hidronimet, patronimet, emrat e vendeve, emrat e vendbanimeve, emrat e etnonimeve, emrat përkëdhelës.

Kapitulli gjashtë, ka të bëjë me analizën dialektor të abetareve, Analiza fonologjike e abetareve të botuara para Kongresit Drejtshkrimor të gjuhës shqipe. Metafonia, Rënia e tingujve, Afereza, Sinkopa, Apokopa, Kalimi i tingullit /ë/ në /a/, Kalimi i bashkëtingëllore /h/ në /f/, Rotacizmi, Alternimi i bashkëtingëlloreve /mb>m, nd>n, ng>k/, Asimilimi i grupeve të zanoreve/ue, ye, ie/, mbaresat/shin/, mbaresat /ue/, mbaresat/vet/, mbaresat /uem/, mbaresat /er/, ndryshimi i kuptimit, vështrime etnolinguistike. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse, Pasqyrimi i fjalëve të urta.

Kapitulli i shtatë, tregon ndikimet edukative nëpër abetare, me fokus edukimi moral të brezave të rinj përmes përmbajtje nëpër abetare si: Edukimi për jetë në familje, edukimi kombëtar, edukimi për punë, edukimi për dashuri ndaj shkollës, edukimi njerëzor (human), edukimi ndërkombëtar (internacional), njohja e moralit, premtimet, bujaria, mjetet e edukimit moral, këshilla, modeli, gara, dënimi, llojet e edukimit.

Kapitulli i dhjetë, ka përfundimin dhe literaturën.

Shpresojmë që ky punim ta plotësoj fushën e studimit mbi tekstet shkollore dhe ofroj studiuesve të tjerë një themel mbi të cilin ata do të bëjnë hulumtime të shumta, nga fushat e tyre dhe të kemi një pasqyrë me të plotë për të gjitha abetaret nga vitit 1945-2012.

Metodologjia e punës

Hulumtimi është bërë në të gjitha abetaret e botuara më Kosovë nga viti 1945-2012. Pra, duke realizuar studimin nga abetarja e parë shqipe në Kosovë e vitit 1945 e deri te abetarja e fundit mbarëkombëtare e vitit 2012, që aktualisht përdoret në shkollat tona për nxënësit e klasës parë.

Ky hulumtim cilësor është realizuar në mënyra të ndryshme dhe me disa metoda. Vetitë e përgjithshme që i karakterizojnë shumicën e hulumtimeve cilësore sipas Bogdan-it dhe Biklen-it (2007) janë:

1. Të dhënat cilësore mbledhen në formë të fjalëve ose vizatimeve e jo si numra,
2. Në hulumtime cilësore hulumtuesi ka tendencë për t'i analizuar të dhënat në mënyrë induktive (Vula, 2016).

Për t'i paraqitur në mënyrë sa më të plotë çështjet etnolinguistike dhe pedagogjike në abetare, duke u mbështetur edhe në ndryshimet shoqërore, historike, politike dhe arsimore, që i përcaktuan në shumë raste edhe përmbajtjet në abetare, shfrytëzuam metodën përshkruese, metodën krahasuese dhe historike në një periudhë prej 73 viteve të botimit të këtyre abetareve. Në një hulumtim të tillë është e pamundur t'i shmangem metodës përshkruese, sepse për ta dokumentuar një fakt nëpër abetare, qoftë etnolinguistike (si onomastika apo dialektologjia) apo pedagogjike është dashur ta përshkruajmë çështjen e studimit siç është në abetare, duke e shoqëruar përshkrimin dhe me atë se çfarë gjejmë në dokumentet tjera shoqëruese.

Hulumtimet përshkruese (deskriptive) dhe historike, fokus kanë kushtet dhe ngjarjet e së kaluarës dhe ato të të tashmes, qëllimi i tyre është përshkrimi dhe interpretimi, burim i të dhënave janë informatorët, dokumentet, objektet, mbledhja e të dhënave bëhet me vëzhgim dhe analizim, analiza e të dhënave bëhet gojarisht (verbalisht) dhe shpesh e shoqëruar me statistika (Mertler&Charles, 2005, p.276).

Ndërsa metoda krahasuese zë vend të rëndësishme në këtë studim “Metoda krahasuese nënkupton konstatimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis dukurive...midis etapave të ndryshme të zhvillimit historik, midis kategorive dhe shkollave të mendimit” (Sokoli, 2008). Pasiqë edhe studimi është gjuhësor dhe historik i abetareve, atëherë dalim te pohimet se të gjitha studimet historike dhe të kësaj natyre si studimi ynë krahasojnë. Krahasimi ka përfshirë gjetjen e ngjashmërive dhe dallimeve nga një abetare në tjetrën të botuar më parë

ose më vonë dhe ndryshimet brenda abetareve i kemi krahasuar duke u mbështet edhe në dyshimet mes periudhave, rrethanave, planeve programeve mësimore, ngjarjeve me peshë gjuhësore e historike.

Qasja historike bazohet në përfaqësimin dhe interpretimin e shënimeve, punimeve dhe burimeve të tjera të informatave lidhur me njerëzit, dukuritë ose praktikrat (Honcock & Algozzine, 2017). Gjithnjë duke i analizuar abetaret dhe dokumentet e ndryshme. Studimet historike zakonisht paraqesin një përshkrim të evoluimit të ngjarjeve, programeve, në rastin tonë, të abetareve me kalimin e kohës.

I. HISTORIKU I ABETAREVE SHQIPE

Historia e popullit tonë në përgjithësi është një histori luftërash, përpjekjes për liri e çlirim. Robërimet shumë shekullore të shqiptarëve janë përcjellur me shumë gjak për t'i shpëtuar asimilimit, për të ruajtur gjuhën, traditat dhe zakonet. Këtë fat të trisht e ka pasur edhe gjuha shqipe si një gjuhë e lashtë, por me alfabet të ri. E cila deri në vitin 1908 u shkrua me alfabete të gjuhëve të huaja. Shkollat, abetaret dhe tekstet në gjuhën shqipe luftoheshin më shumë se çkado tjetër nga autoritetet e huaja si greke, turke, sllave.

Historia e zhvillimit të arsimit kombëtar shqiptar përfshin tërësinë e veprimtarive dhe të arritjeve në fushën e arsimit, si arritje kulmore për kohën dhe rrethanat ishte hartimi i abetareve të para. Këto abetaret janë vepra monumentale në historinë e arsimit. Abetaret gjatë historisë kanë kaluar një rrugë të vështirë, rrugë kjo e cila ka lënë gjurmë në historinë e shkollës, arsimit dhe kulturës shqiptare. Abetaret janë tekste që kanë zënë vend të rëndësishme në hapësirën e arsimit shqiptar, për shkak të vlerave edukativo-arsimore, gjuhësore, risive didaktike, metodike dhe mjeshtërinë së shtjellimit të përmbajtjeve që do t'i mësojnë nxënësit. "Por, ja që shekulli i 19-të, ky shekull i dritave, zgjon dhe midis shqiptarëve një burrë të ndezur nga dashuria për kombin e vetë dhe për ndriçimin e tij dhe harton abetaren e parë shqipe" (Domi, 1976). Shkollat shqipe bashkë me abetare ishin mjete më i fortë për ta luftuar shkollën e huaj. Mund të thuhet se të rrallë janë popujt që kanë një histori të dhimbshme të shkollës dhe abetares sa populli ynë. Histori të këtillë ka edhe abetarja e parë shqipe e njohur deri më sot "Evetari".

"Që atëherë e deri sot janë shtypur më se 150 abetare në trevat shqiptare dhe jashtë tyre si në Bukuresht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Vjenë, Napoli, Selanik, Athinë, Paris, Milano, Bari, Worçester, Laipçig, Konstancë, Aleksandri të Egjiptit etj" (Osmani&Kazazi, 2000). Abetaret e botuara nuk janë përdorur vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe në të gjitha trevat ku jetonin shqiptarët. Roli i tyre ka qenë shumë i madh sepse fëmijët dhe të rriturit shqiptarë duke mësuar shkrim-lexim u vetëdijësuan për vlerat e gjuhës shqipe, për historinë e popullit shqiptar, u ndërgjegjësuan për çështjen e nëpërkëmbur kombëtare.

Armiqtë që ishin kundër kombit ishin edhe kundër abetares dhe arsimit shqip, prandaj ky libër edhe u vu në listën e botimeve të ndaluara për shumë vjet. Përpjekja dhe lufta për ta mbrojtur këtë libër të parë ishte më e fortë se dëshirat e pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Etja për dije që kishte populli shqiptar mund të realizohet me

mbijetesën e abetares, nevoja dhe dëshira për të ishte aq e madhe sa i mbijetoi çdo dhune që ushtrohej mbi të gjithë ata që merreshin me përgatitjen, botimin dhe shpërndarjen e abetareve. Abetarja ishte arma më e fuqishme për të shkëputur arsimin shqip nga varësia e arsimimit në gjuhë të huaja.

Autorët e abetareve shqipe, ishin pedagogë, mësues, shkrimtarë, metodist, luftëtarë, shkenctarë dhe veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare. Disa nga këta iluministë ishin: Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Daut Boriçi, Sami Frashëri, Anastas Kullurioti, Ndre Mjedra, Luigj Gurakuqi, Parashqevi Qeriazi, Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani, Kolë Xhumari, Ramiz Hoxha, Xhevat Gega, Qamil Batalli, Mehmet Gjevori etj. Disa prej autorëve ranë dëshmorë për të mbijetuar gjuha shqipe.

1. AUTORËT E ABETAREVE SHQIPE

1.1. Abetaret e Naum Viqilharxhit

Naum Panajot Bredhi i cili është i njohur si Naum Veqilharxhi, është ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare është hartuesi i abetares së parë shqipe dhe dëshmor i shkollës shqipe. Naum Veqilharxhi ka lindur më 17 dhjetor 1797, në Vithkuq të Korçës. Veprimtaria e tij ka shtrirje politike, gjuhësore, pedagogjike dhe arsimore. Veqilharxhi përbën plejadën e atdhetarëve tanë që dhanë kontribut të shkëlqyer në fushën e historisë së shkollës, të tekstologjisë, të gjuhës dhe të shkrimit shqip dhe mendimit pedagogjik. Ai është autor i disa veprave dhe dokumenteve të rëndësishme për arsimin dhe pedagogjinë kombëtare. Disa nga veprat e tij janë:

1. Alfabeti, 1824/25
2. Fort i shkurtër e i përdorshëm Ëvetar Shqip, Mot/I pare, (Bukuresht,1844).
3. Fare i ri Ëvetar Shqip për djem nismëtorë, Mot/I dytë, (Bukuresht,1845) etj.

“Pa dyshim që, më 1824, Veqilharxhi vihet në një plan më të përparuar se Meksi dhe Gjirokastriti, posa kërkonte për shqipen një alfabet të veçantë dhe braktiste alfabetin grek. Një alfabet i veçantë për shqipen donte të thoshte një element bashkimi për të gjithë shqiptarët e përçarë nga tri fe të ndryshme” (Shuteriqi, 1976). “33 tinguj të ndryshëm ka

gjuha shqipe dhe zotria e tij formoi po aq shenja ose shkronja për të. Në Shqipëri, gjetja e Naumit u prit me ngrohtësi dhe gëzim që s'pritej, aq sa një numër i madh i shqiptarëve filluan ta shkruaj gjuhën e tyre me shkronjat e formuara prej tij" (Domi, 1976).

N. Veqilharxhi është hartuesi i abetares së parë të shqipes. Ishte një nismë që deri në vitin 1844, nuk e kishte marrë asnjë atdhetar (patriot) shqiptar, kur nuk kishte një alfabet të vetëm të gjuhës shqipe e as shkollë në gjuhën shqipe. Abetari i parë i botuar në vitin 1844 më titullin "Fort i shkurtër e i përdorshëm evetar shqip për çdo secilin që do të mësonjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip" (Osmani, 1999). Ai është libërth i vogël, N. Veqilharxhi në parathënien e botimit të vitit 1845 shkruan ,... mos i vështroni të vogëlmit e ti, koha do t'i dëftojë të mathtë e të rendit (= rëndësisë) së ti" (Osmani, 1999). Ky libër shënon një ngjarje të rëndësishme në historinë e teksteve të shkollës shqipe. Kjo abetare ka tetë faqe, "midis ballinës dhe fletës së parë të Evetarit gjendet një fletë e veçantë e cila në rekto është plotësisht e bardhë, pa kurrfarë shkrimi, ndërsa në faqen e saj, versc, gjendet portreti i gravuar i N. Veqilharxhit, përfundi të cilit me alfabetin e tij, gjenden të shkruara këto fjalë: Naum P. Veqilharxhi pjell mbë 1797 mbë 6 të dheqembrit."(Koliqi,1989).

Në faqet e tjera, në vija të përgjithshme janë këto përmbajtje: në fletën e parë është një strofë e një poezie në shqip me titull: "Epa retë mosuarit frik' e perëndisë". Autori dëshiron t'i bëjë të vetëdijshëm nxënësit e abetares së tij se çdo gjë në fillim është e vështirë, por me punë bëhet e lehtë.

"Çdo e nisur q'është e rëndë,
s'ka njeri që nuk e di,
por kushdo që do të vihet
Si shpëton gjëset ati" (Koliqi, 1989).

Në fletën e dytë rekto dhe verso është alfabeti i hartuar nga autori, në fillim shkronjat e vogla të shkrimit, me shpjegimet në alfabetin grek, pastaj shkronjat e mëdha të shkrimit. Kurse te faqja çift e fletës gjinden dy shenjat grafike të mëdha të shtypit për të gjitha shkronjat e alfabetit.

"Midis tyre shkruan disa aforizma me vlerë edukative, si: "Mos shëko lëvozhgënë, por vështro palcën", "Mos lësho gjuhen të te enjë përpara mendjes", "Dora e shtrënguar sbën

gjësen të vyerë”, “Në fund të faqes fillojnë shpjegimet e alfabetit të tij në greqishte, që vazhdojnë edhe në fletën e tretë.” (Bevapi, 1996).

Në “Ëvetar”, përveç mësimin të tingujve/shkronjave dhe leximit e shkrimit, ka edhe ndikim edukativ përmes sentencave morale edukative, që kanë si qëllim eliminimin e shprehive të këqija si: gënjeshtres, paturpësisë, përtacisë, koprracisë, etj.

Në fletën e katër recto jepen këto aforizma pedagogjike: “Përtesi është rëndje e dheut”, “Kush flet shumë, s’flet të vërteta”, “Kush gënjen njëherë, s’besohet tjetër herë”, “I mari njihet nga të qeshurit shumë”, “Bëj mirë të gjesh mirë”, “Kush duron trashëgon”, “Mos kesh turp të mësosh atë që s’di”, “Më mirë i vdekur se i turpëruar”, “As e mira, as e liga s’beten pa shpërlzer” etj. Në fletën e katërt verso jepen disa porosi për të vegjlit (Koliqi, 1989).

Abetarja e dytë e Veqilharxhit është e vitit 1845, e botuar në Bukuresht me titull “Fare i ri Ëvetar Shqip për djem nismëtorë nxjerë e dhenëmbë dritë tani herën e parë, për djem të vegjël me një të zgjedhur me disa gjë të mirash e të fitimëshme”. Ky botim ndryshon nga i pari si nga vëllimi, ashtu edhe nga përmbajtja. Kjo abetare ndahet në tri pjesë: Pjesa hyrëse (dedikimi, parathënia etj.), Abetarja e mirëfilltë (shkronjat, rrokjet, fjalitë etj.) dhe Libri i leximit (17 pjesë leximi të zgjedhura, të përkthyer dhe të përshtatura nga Dhjata e Vjetër). Pas parathënies N. Veqilharxhi i mbarështroi 33 shkronjat e mëdha të alfabetit të tij. Po në të njëjtën faqe pasojnë shkronjat e vogla të shtypit, 33 shkronjat e alfabetit të tij janë radhitur kështu: a , ë, e, l, o, u, y. V, b, g, j, dh, d, th, z, k, q, ll, l, m, n, nj, p, r, s, sh, t, f, h, h, c, ç, (xh), x”. (Koliqi, 1989). Në hartimin e kësaj abetare autori merr për bazë metodën e rrokjeve normale. Fillon me mësimin e shkronjave (tingujve), vazhdon me lidhjen e tyre në rrokje, me fjalë të ndara në rrokje e me fjali dhe përfundon me copat e leximit. Së pari vijnë shkronjat e shtypit, pastaj ato të shkrimit. Kjo ishte abetare bashkëkohore për kohën. (Koliqi, 2002).

Nga fleta e dhjetë deri te e trembëdhjeta, N. Veqilharxhi për të ushtruar djalëria të lexuarit, kjo pjesë e abetares është e njëjtë sikurse te abetaret e ditëve të sotit, ku një pjesë i takon përforcimit të leximit dhe shkrimit. Por, e bukura e gjithë kësaj është se pjesët tekstuale jepen në fjalë të urta e porosi të ndryshme, me karakter edukativ. Përmbajtja e teksteve letrare të dhëna në Ëvetari (1845), janë një burim i freskët frymëzimi e një brumë i shëndetshëm për edukimin e dashurisë për kombin dhe për të qenit shqiptar. Në to

“...tingëllon fuqishëm porosia e Naumit për dashurinë ndaj atdheut, gatishmëria e tij për flijimin e jetës për të mirën e atdheut.

Në fletën e trembëdhjetë, autori vazhdon me shkronjat e shkrimit, së pari i paraqet shkronjat e vogla e pastaj Ëvet e mëdha.

“Ëvetar (1844) është shumë më i vogël, ka vetëm tetë faqe, Ëvetari (1845), ka pesëdhjetë faqe. N.Veqilharxhi preferon që shkronjat e shkrimit të mësohen ndaras nga shkronjat e shtypit. Këtu duhet shtuar se në Ëvetarin (1844) mësimi i shkronjave të shkrimit i paraprinë mësimin të shkronjave të shtypit, ndërsa në Ëvetarin (1845) së pari mësohen shkronjat e shtypit e pastaj ato të shkrimit” (Koliq, 1989).

Abetaren e vitit 1844, populli e priti me gëzim dhe shpresë të madhe. U shtyp në numër të vogël ekzemplarësh dhe u përhap vetëm në Korçë, Përmet dhe Berat. Ndërkaq, abetarja e vitit 1845 u shtyp në numër më të madh ekzemplarësh, por nuk dihet se në cilat treva u përhap, supozohet se një numër syresh u dogjën bashkë me shtëpinë e Veqilharxhit në Stamboll (Koliqi, 2002). “Patrikana i mbledhi të gjitha abetaret e shpërndara nëpër qarqet shqiptare dhe i dogji kurse aurorin e mallkoi si tradhtar kishe. Veprimtaria e tij atdhetare ishte shkaku që qarqet reaksionare greke t’ia shkurtojnë jetën, ta helmojnë atë” (Cituar nga Koliqi, 2002).

1.2. Abetaret e Konstandin Kristoforidhit

Konstandin Kristoforidhi lindi më 1827 në Elbasan. Kristoforidhi ishte “Mësues i Popullit, rilindas i shquar, “babai i gjuhës shqipe”, shkencëtar, leksikograf, poliglot dhe pedagog, ka merita të veçanta për arsimin, kulturën dhe shkencën kombëtare shqiptare”, (Koliqi, 2002). Kristoforidhi është pasardhësi i N. Veqilharxhit. Pas shumë polemikash del e vërteta se abetaret e Kristoforidhit janë botuar rreth 23 vjet pas atyre të N. Veqilharxhit. “Kristoforidhi i hulumtoi dialektet e shqipes dhe u përpoq për përpunimin e afrimit të tyre drejt një gjuhe kombëtare të njësuar, prandaj hartoi dhe dy abetare shqipe (njërën toskërisht, tjetrën gegërisht), 1. “Abetar shqip”, gegërisht (1867) dhe 2. “Alfavitari shqip”, toskërisht (1868) (Koliqi, 2002).

Këto dy abetare i botoi në Konstandinopojë. Abetaren gegërisht e ka hartuar me alfabetin latin, kurse atë toskërisht me alfabetin grek. Teksti hapet me alfabetin, duke dhënë shkronjat e shtypit, të mëdha e të vogla, të ilustruara me shembuj konkretë. Brenda faqeve 2-5 janë vendosur tingujt e të folurit, lidhjet e tyre në fjalë. Sipas Kristoforidhit “tashti për tashti pak rëndësi kanë shkronjat, shenjat dhe alfabeti. Unë dua, dëshiroj që gjuha ime të shkruhet, sidoqoftë, mjaft që të shkruhet...” (Koliqi, 2002).

“Ai u jep të vegjëlvë të kuptojnë se gjuha përbëhet nga tingujt, rrokjet, fjalët, fjalitë, ku nëpërmjet shembujve të dhënë synon të zhvillojë tek ata drejtshqiptimin fillestar. Në faqen 6-7 jepen shenjat e pikësimit, numrat, numërorët, si dhe disa njohuri të thjeshta praktike për ndarjen e kohës, përshëndetjet, etj.” (Bevapi,1996).

“Gjithashtu, këto abetare në krahasim me ato të Naum Veqilharxhit, shënojnë ngritje cilësore profesionale, si nga përmbajtja, ashtu dhe nga metodologjia e hartimit të tyre” (Koliqi, 2002).

Po ashtu, vend të rëndësishëm zënë edhe proverbat edhe copat e leximit, që përshkruhen me karakter kombëtar, frymë patriotike dhe kriter shkencor.

“Vjersha e mirënjohur e R. L. Stivensonit, e përshtatur mjaft mirë prej K. Kristoforidhit “Ylli lart në qiell”, është krijim i frymëzuar për fëmijët.” (Bevapi,1996). Kjo është poezia më jetëgjatë në abetare. Atë e gjejmë në të gjitha abetaret e Q. Batallit nga viti 1982- 2007 dhe në abetaren mbarëkombëtare.

1.3. Abetarja e Daut Boriçit

Daut Boriçi lindi në Shkodër me 1825. Është klerik, intelektual, edukator, pedagog, atdhetar, kryetar i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën. Daut Boriçi ishte edhe hartues i njëres ndër tri abetaret e para shqipe.

Daut Boriçi e botoi abetaren e gjuhës shqipe në vitet '60 të shekullit të kaluar, në Stamboll, të litografuar, duke e ndjerë nevojën që kishte shqipja për një vepër të tillë, kur në Shqipërinë e Jugut ishte përhapur “Evetari” i Naum Veqilharxhit, ndërsa në Shqipërinë e Mesme, do të përhapej abetari i Konstandin Kristoforidhit (Osmani, 1999). Kjo abetare ka 34 faqe dhe është e hartuar me alfabetin arab, por me disa ndryshime sipas natyrës së gjuhës shqipe. “Ai shkruan: “Tue qenë shqiptarët të mësuem me alfabetin arab që përdorej

prej myslimanëve, nuk e pash nevojën me krijue forma të tjera për alfabetin e shqipes, prandaj në hartimin e tij mora për bazë alfabetin arab, por bana disa ndryshime si e do natyra e posaçme e shqipes” (Osmani,1999).

Abetarja fillon me paraqitjen e alfabetit arab për gjuhën shqipe. “Alfabeti i tij përbëhet nga 37 shkronja dhe jepet brenda faqeve 2-9. Nga ky alfabet, 28 shkronja janë të alfabetit arab, 2 i ka marrë nga osmanishtja dhe për të plotësuar nevojat e gjuhës sonë, ka krijuar 7 shkronja vetë për c, rr, zh, g, ng, gj, nd. Ndërsa në faqet 10-22 autori vendos fjalë me dy, tre, katër e pesë tinguj; nga faqet 23-25 jepen disa rregulla mbi bashkimin e shkronjave, theksin, shenjat e pikësimit. Pjesa tjetër, faqet 26-34, përmban fjali të thjeshta me dy, tre a më shumë fjalë...Ai ka ndjekur metodën rrokjesore në përpilimin e saj” (Bevapi,1996).

Në rrethanat e një censure të rreptë, të përndjekjeve dhe reprezaljeve, nuk ishte një punë e lehtë dhe pa pasoja, të botojë një abetare të tillë. Për këtë arsye autori nuk ka shënuar as emrin as vendin e botimit.

1.4. Abetaret shqipe para Kongresit të Manastirit

Duke ju referuar të dhënave në librin e Kujtim Bevapit, “Mendimi pedagogjik mbi abetaret shqipe”, në vitin 1879 Hasan Tahsini shpërndau një abetare të tij shqip botuar me alfabetin arab. Është folur për një abetare të Panajot Kupitorit, në vitin 1879. Në vitin 1877, autori Vasil Dhimitër Ruso boton abetaren me titull “Pellazgjika shqip, palla allfavitar me i thika dhe me thrishqefthika ta msiona dhe nkena se shum përpara do ta bëjna Bukureshtion, 1877,104 faqe”.

Abetarja e vitit 1879 është “Abetarja e Stambollit” me 136 faqe. Ishte vepër e përbashkët e intelektualëve të Rilindjes sonë kombëtare: Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos dhe Koto Hoxhit.

Anastas Kullurioti botoi një abetare “Abavatar arbëror pas përgjluhës Arbërore si flitetë nd’Elladhe, përqëruarë dhe përndrejurë e me gërma të ra her’e parë nd’Elladhë. N’Athn, “Zëri i Arbërisë”, 1882, 164 faqe.

Në vitin 1886, Sami Frashëri botoi abetaren shqipe “Abetare e gjuhës shqipe” prej S.H.F. Bukuresht, shtypur prej shoqërisë “Drita” 1886, 82 faqe.

Pastaj abetarja shqipe e Jovan Tërovës, shtypur prej Shoqërisë së mësimi shqipe “Drita” Bukuresht, 1887, 56 faqe.

Abetare e gjuhës shqipe prej Gaspër Benusit Shkodranit. Ndër shtypshkronjët të Shoqëris “Dituria” në “Bukuresht”. 1890, 72 faqe.

Abeçedari i Jeronim De Radës në vitin 1896 ishte broshurë 8 faqesh me titull “Abeqedario della lingua Albanese, Approvate ed adottato dal Congresso Nazionale unit Corigliano Calabro” 1896, 8 faqe.

Abetarja e shoqërisë “Bashkimi” në vitin 1899, botoi një abetare me titull “Abetari i citum prej shëcniet t’Bashkimit t’gluhës shtype” pa vd., pa vt., 32 faqe dhe 2 faqe pa numëruar.

Revista “Albania” e Brukselit boton një abetare në vitin 1899 dhe e titullon “Abetar e gjuhës shqipe”, Bruxellës, “Përlindia e Shqipëtarve”, 65 faqe.

Abetarja e Zymit, të cilës i mungon autorësia dhe viti i botimit. Rreth autorësisë, vitit dhe vendit të botimit ekzistojnë shumë dilema e polemika. Nëse pranohet autorësia e Dedë Pasit, atëherë abetarja nuk është shtypur në Zym, por në Shkodër dhe nuk i takon vitit të botimit 1900, por është më e hershme, para vitit 1889 ose të paktën më 1899. Ndërsa si pikë takimi me Zymin ka atë se ajo është përdorur në këto treva për mësimin e gjuhës shqipe.

Abetarja e Said Najdenit (Hoxhë Voka) (1900) titullohet “Abetare e gjuhës shqip. Ndë të folë gegënisht, Sofje, shtyp Shqipe “Mbrothtësia” K. P. Luarasi, 1900, 16 faqe. Pastaj katër vite më vonë Ndre Mjeda është autori i abetares me radhë “Këndime për shkollë të para Shqipënisë”, viti 1904. Kjo abetare ka pasur edhe dy ribotime të tjera, ndërsa botimi i tretë është përpiluar me alfabetin e përbashkët, vendosur në Kongresin e Manastirit të vitit 1908. Për ta vazhduar rrugën e hartimit të abetaresve një vit më vonë, Luigj Gurakuqi, botoi dy abetare njëra pas tjetrës. Abetarja e parë botohet në Napoli të Italisë më 1905, Abetari për mësoitore filltare t’Shqypnies. Libri i parë. Napoli. Edit.”Toccosalviotti”, 1905, 83 faqe. Abetaren tjetër Gurakuqi e botoi në Bukuresht: “Abetar i vogël shqyp mas abevet t’Bashkimit e t’Stambollit me tre tregime n’tdydialektet. Prej Lek Grudës, Bukuresht, “N. Voici”, “M. Voda” 1906, 27 faqe.

Të gjitha këto abetare ishin të hartuara para Kongresit të Manastirit me alfabete të ndryshme.

1.5. Abetaret shqipe pas Kongresit të Manastirit

Pas Kongresit kombëtar të alfabetit të gjuhës shqipe, filloi një epokë e re në historinë e abetareve. Ato pas vitit 1908 u hartuan me alfabetin që e miratoi Kongresi i Manastirit. Kështu, duke i dhënë hov luftës së shqiptarëve për shkolla dhe shkrim shqip.

Parashqevi Qiriazi, lindi më 2 qershor 1880, në Manastir. Mësuese e Popullit, intelektuale e shquar dhe veprimtare e arsimit të gruas. Delegates e Kongresit të Manastirit, fill pas Kongresit boton abetaren e saj, "Abetare për shkollat e para, shtypur prej shoqërisë Botonjëse "Literature", Manastir, "Bashkim i Kombit", 1909, 32 faqe. Ky tekst ka dy ribotime, në Manastir 1911 dhe në Uorçester, 1915. Kjo abetare është teksti i parë i shkruar me alfabetin e Manastirit dhe teksti i parë, autor i të cilit është një femër shqiptare.

Në këtë periudhë boton abetare edhe Nikolla Lake. Abetaren e botoi në dy pjesë: "Stervitjetore për nxënësit shqiptarë, cop e parë abetare. Paris. "Rue Vineusen ", 1909, 36 faqe, ndërsa vazhdimin e saj "Stervitjetore për nxënësit, shqiptarë, cop e dytë. Me shumë fytyra, Abetare, Paris, 1913.

Për ta penguar hapjen e shkollave dhe shkrimit shqip u ngrit propaganda xhonturke, duke kërkuar shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja arabe. Gjatë periudhës 1909-1910, u botuan abetare me alfabetin arabo-turk. "Rexhep Voka, ishte mbrojtës i programit politik të xhonturqve. Në këtë kuadër, mbrojti qëndrimin e xhonturqve për alfabetin e shqipes me shkronja arabe. Në vitin 1910, sajoi alfabet të shqipes me shkronja arabe, të plotësuar me shkronja të tjera që nuk kishte arabishtja. Për mësimin e këtij alfabeti, Voka hartoi një abetare, "Abeja shqip", botuar në Stamboll më 1910, në 10.000 kopje" (Koliqi, 2002). Pastaj, me këtë alfabet është edhe abetarja e hartuar nga Mulla Shaban Idrizi: "Elifba shqip. Istanbul, 1327/1909;/ 6 faqe. Gjatë viteve 1910-1911, qarkulluan disa abetare me alfabetin arab, si ajo e Arif Hiqmet e klubit" Mahfel.

Një formë tjetër e abetareve në historinë e këtij libri janë në trajtën e një flete fluturuese, që ishin mjaft praktike për atë kohë, paloseshin dhe shumë shpejtë shkonin në destinacionin e duhur. E tillë është "Abeceja shqype", pa autor, pa vit botimi dhe pa shtypshkronjë, ku është botuar. Kjo fletë fluturuese është gjetur brenda të përkohshmes "Shkupi", që tregon se është shtypur në atë shtypshkronjë, ku shtypej kjo gazetë dhe abetarja shpërndahej bashkë me gazetën. Vit i botimit i kësaj abetareje fluturuese merret viti 1911 sepse numri i parë i gazetës " Shkupi" doli në atë vit.

Po në të njëjtin vit, Simon Shuteriqi është autori i një abetareje shqipe të botuar në Manastir, më 1911: "Abetarja shqip. Rrjeshtuar në gjuhë të përbashkëte prej Simon Shuteriqi n'Elbasan, Manastir. Shtyp. Tregtarë Ndërkombëtarë", 1911, 64 faqe. Abetarja ka gjithsej 23 mësimet të cilat vihen në funksion të përvetësimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Mësimi i leximit dhe shkrimit bëhet me metodën sintetiko-analitike. Niset nga fjala, shkëputet prej saj kurse tingulli më pas i bashkon në rrokje.

Ky vit përshkruhet edhe me abetaren e Dhimitër Paparistos me titull "Abetare për shkollat fillore meshkujsh e femrash në l'igjerorjë t'Elbasanit me pak ndryshime", Shqypj' e parë. Editor: Lef Nosi. Elbasan, Manastir, Shtyp. "Tregtare Ndërkombëtare", 1911, 86 faqe. Kjo abetare ka tri botime, në vitin 1911, 1919 dhe 1920.

Pasojnë abetaret e botuara në vitet e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Abetarja e vitit 1912 është për nxënësit shqiptarë që mësonin në shkolla të huaja dhe mësimi jepej italisht. Ajo titullohet "Abetari për fmit qi msojmë shqip-italisht/ IIsilla mbario per i bambini che studiano Albaneye-Italiano. Për mësimoret e Shqipëries. Për la acuole d'Albania. Milano, Edit. "A. Vallardi" 1912". Po ashtu edhe "Abetari i vogël shqyp. Shkodër, Shtyp. "Nikaj" 1912, 32 faqe". Pastaj "Abetari i gjuhës shqipe, Athinë, 1912, 62 faqe.

Në vitin 1914, autori Isuf Agjah-Korça hartoi një abetare shqipe "Abetare", Korçë, Shtyp "Korça", 1914, me 14 faqe. Botimi tjetër është "Abetari për msoitore fillestar t' Shqypniis", Shkodër, Shtyp." Nikaj", 1914, 112 faqe.

Pastaj vjen me radhë abetarja e arbëreshit Marko La Pianes me titull "Abetar shqyp-italisht me vështrime mbi shqyrtimin dhe orthographien", Pjesa e parë, Albania-B.Officina. Tipografica Italiana, 1917, 61 faqe.

Në vitin 1918, Viskë Pula, boton një abetare: "Abetare për shkollat fillore". Korçë. Shtyp. Lib. "Korça" Koti-Xoxe, 1918, 20 faqe.

Thoma Papapano në vitin 1919 botoi në Vlorë abetare shqipe, që titullohej " Shkëndilat e para. Abetar e shtimi i ti", Vlorë. Shtyp. Italjane, 1919, 64 faqe.

Po në të njëjtin vit botohet abetarja e Shefqet Daiut me titull "Abetare e re për shkolla fillore t'ulta djemsh e vajzash" prej Sh.D. Elbasan. Shtyp" Elbasan", 1919, 40 faqe.

Një vit më vonë botohet abetarja e Mati Logorecit në vitin 1920. "Abetar", Vlorë. Shtyp. G. Diretores. 92 faqe, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit.

Po në këtë vit u botua “Abetare për shkollën fillestare të Shqipnisë mas metodës analitiko-sintetike të shkrimit e të këndimit, me fotografi të fatosit krutanë”, Shkodër, “Zoja e papërlyme”, 1920, 112 faqe.

Abetarja u mbështet në programin që përshtati Gaspër Beltoja, të botuar në Shkodër më 1919. Pastaj vjen abetarja e Jani Mingës “Abetare Kombëtare Shqip. E rrieshtueme pas parimit të pedagogjisë e psikologjisë...Pjes’ e B. Këndimore viti A Shkolluer”, Vlorë. Shtyp. “Vlorë”. 1920; 32 faqe.

Gjatë viteve 1920-1930, janë hartuar edhe disa abetare si: “Abetare arabisht për shkollat e Shqipërisë”, (Botimi i Ministrisë së Arsimit), Tiranë, 1921, 24 faqe. “Abetare për shkollat fillore të Shqipnis”, Shkodër, 1921.

Pastaj teksti i A. Xhuvanit “Abetare për shkollat fillore të Shqipnis”, kthyer në toskërisht prej P. Progonit Verlag Carl Honegën, Vienë, 1922. Kjo abetare pati një përhapje mjaft të gjerë dhe u ribotua në vitet 1931, 1932, 1933, 1934, 1935, 1936, 1937, 1938. Pas abetares së A. Xhuvanit vijnë edhe këto abetare në këto vite si: 1922, 1923 dhe 1927.

Hasan Tahsini është një nga figurat e shquara të Rilindjes kombëtare. Si dijetar me përgatitje poliedrike është autor i një abetare shqipe. Abetarja është botuar në Shkodër 1929, me titull “Abetari arabisht prej Hasan Tahsinit” (Bevapi,1996).

Kjo kronologji e abetareve shqipe nga viti 1844 e deri në vitin 1938 është marrë nga studiuesi Kujtim Bevapi, në librin e tij për abetaret shqipe që titullohet “Mendimi pedagogjik mbi abetaret shqipe”, në librin e Shefik Osmanit dhe Njazi Kazazit “Abetaret shqipe dhe trejtorja e tyre historiko-pedagogjike” dhe Hajrullah Koliqi “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”.

2. ABETARET NË SHQIPËRI (1945-2012)

Të gjitha abetaret që janë botuar në Shqipëri nga periudha e lartpërmendur janë marrë nga Bibliografite Kombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë, Libri shqip, botim I i Bibliotekës Kombëtare, Tiranë. Një pjesë e tyre janë gjetur edhe në skedarët e Bibliotekës Kombëtare të Tiranës, poashtu dhe në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe të librit “Trajektorja historiko-pedagogjike e abetareve shqipe”.

Nga këto burime të shfrytëzuara, shohim se kemi një numër të madh të abetareve pa autorë të cilat përfshijnë periudhën prej vitit 1945-1958. Gjatë viteve prej 1945-2016, janë botuar disa lloje të abetareve si:

- Abetare për nxënësit e klasës parë,
- Abetare për të rritur,
- Abetare për të rritur (gegërisht),
- Abetare për të rritur (toskërisht),
- Abetare për shkolla fillore të mbrëmjes,
- Abetare për fëmijët që nuk dëgjojnë,
- Abetare për ciklin e ulët të shkollës pa shkëputje nga puna.

Nga kjo mund të vijmë në përfundim se autorë të ndryshëm janë përpjekur të botojnë abetare për fëmijë, të rritur, të punësuar, për fëmijë që nuk dëgjojnë dhe në toskërisht e gegërisht, pra, shihet një tendencë për gjithëpërfshirje në mësimin e lexim-shkrimit. Nga të gjitha abetaret e botuara në Shqipëri vërejmë se Kolë Xhumari, zë një vend meritore në historinë e këtij kapitulli duke qenë autorë dhe bashkautor i abetareve si:

- Abetaren e Kolë Xhumarit dhe Qefsere Xhixha e hasim nga vitit 1977-1991,
- Abetaren e Kolë Xhumarit, Anton Lakuriqi dhe Gani Bardhi, e hasim të botuar në vitin 1971 dhe të ribotuar deri në vitin 1976 (Osmani&Kazazi, 2000).

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të profesionistëve dhe gjuhëtarëve të ndryshëm, ndër autorët më të spikatur që më së gjati qëndroi në “tregun” e shkrim-leximit është Kolë Xhumari i cili me të drejtë mund të vlerësohet si veterani i Abetares Shqipe. Të

shtojmë se Kolë Xhumari është autor ose bashkëautor i parë i abetares që nga viti 1945 deri në vitin 2004. (Rama, 2013). Për abetaret e botuara në Shqipëri, vitet e botimit dhe autorët, shiko tabelën nr.1.

Abetaret në Shqipëri 1945-2012

Nr.	Titulli	Autorët	Vendi, Shtëpia botuese	Viti
1.	Abetare për të rritur	Anonim	Tiranë: “Mbrothësia”	1945
2.	Këndimi im i parë	Anonim	Tiranë: “Gjekë”	1945
3.	Abetare për të rritur	Anonim	Tiranë: “ Mbrothësia”	1946
4.	Abetare: [gegënisht]	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1946
5.	Abetare: [toskërisht]	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1946
6.	Abetare për të rritur	Anonim	Tiranë: Stabilimenti	1946
7.	Abetare	Anonim	Tiranë	1946
8.	Abetare-për të rritun.	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1947
9.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë	1947
10.	Abetare për të rriture toskërisht	Anonim	Tiranë	1948
11.	Abetare gegënisht	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1949
12.	Abetare për të rritun: gegënisht	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1950
13.	Abetare për të rritun: toskërisht	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1950
14.	Abetare për të rritun: gegënisht (botimi II)	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1951
15.	Abetare	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1951
16.	Abetare	Anonim	Tiranë: Ministria e Arsimit	1952
17.	Abetare		Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1954
18.	Abetare		Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1955
19.	Abetare	Anonim	Tiranë	1956

20.	Abetare		Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1957
21.	Abetare		Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës	1958
22.	Abetare	K. Xhumari & A. Duhaxhiu	Tiranë: Ministria e Ars. dhe kultu	1958
23.	Abetare	Kolë Xhumari & Ahmet Duhaxhiu	Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës.	1959
24.	Abetare	Kolë Xhumari	Libri shkollor	1959
25.	Abetare	Kolë Xhumari	Libri shkollor	1960
26.	Abetare	Kolë Xhumari & Ahmet Duhaxhiu	Tiranë: "M. Duri"	1961
27.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1963
28.	Abetare për fëmijët që nuk dëgjojnë	Bedrie Kurizi & Kolë Xhumari	Tiranë	1963
29.	Abetare: për shk. fill. të mbrëmjes	Jorgji Bekteshi & Hysen Kola	Tiranë: Drejtoria e Botimeve Shkollore.	1964
30.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1964
31.	Abetare: për shk. Fill të mbrëmjes	J. Bekteshi, H. Kola	Tiranë: Drejtoria e Botimeve Shkollore.	1965
32.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1965
33.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1966
34.	Abetare: për të rritur	J. Bekteshi, H. Kola	Tiranë: Instituti i Studimeve dhe Botimeve Shkollore.	1966
35.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1967
36.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1968
37.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1969
38.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1970
39.	Abetare	K. Xhumari, G. Bedhia & A. Lakuriqi	"Libri shkollor"	1971
40.	Abetare (botimi II)	K. Xhumari, G. Bedhia	"Libri shkollor"	1972

		&A. Lakuriqi		
41.	Abetare (Për ciklin e ulët të shkollës pa shkëputje nga puna)	Gani Bardhia	Tiranë	1972
42.	Abetare	K. Xhumari, G.Bedhia &A. Lakuriqi	“Libri shkollor”	1973
43.	Abetare	K. Xhumari, G.Bedhia &A. Lakuriqi	“Libri shkollor”	1974
44.	Abetare	K. Xhumari, G.Bedhia &A. Lakuriqi	“Libri shkollor”	1975
45.	Abetare	K. Xhumari, G.Bedhia &A. Lakuriqi	“Libri shkollor”	1976
46.	Abetare për nxënësit që nuk dëgjojnë	Bedrie Tare	“Libri shkollor”	1976
47.	Abetare	G. Bedhija	Tiranë: SHBLSH.	1972
48.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1977
49.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1978/ 1979
50.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1980
51.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1981
52.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1982
53.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1983
54.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1984
55.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: “Libri shkollor”	1985

56.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: "Libri shkollor"	1986
57.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: "Libri shkollor"	1987
58.	Abetare	Kolë Xhumari	"Libri shkollor"	1988
59.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLU.	1989
60.	Abetare e gjuhësë shqip	Anastas Dodi		1988
61.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: SHBLSH.	1990
62.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: SHBLSH.	1991
63.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: SHBLSH.	1992
64.	Abetare	Kolë Xhumari & Qefsere Xhixha	Tiranë: SHBLSH.	1993
65.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë/ SHBLSH. Ribotim	1995
66.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH, Ribotim	1998
67.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH, Ribotim	1999
68.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH.	2000
69.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH. Botim për eksperimentim	2001
70.	Abetare shkronje pas shkronj	Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj	Tiranë: SHBLSH.	2001
71.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH. Ribot	2002
72.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH. Ribot	2003
73..	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH e re.	2004
74.	Abetare shkronje pas shkronje	Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj	Tiranë: Morava.	2004
75.	Abetare shkronje pas shkronje	Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj	Tiranë: Morava.	2006

76.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH. Ribot	2006
77.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH e Re.	2007
78.	Abetare shkronje pas shkronje	Mimoza Gjokutaj&Shezai Rrokaj	Tiranë: Morava. Bot.i 4-t	2007
79.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH e Re.	2008
80.	Abetare/ shkronje pas shkronje	Mimoza Gjokutaj&Shezai Rrokaj	Tiranë	2008
81.	Abetare	Kolë Xhumari	Tiranë: SHBLSH e Re.	2009
82.	Abetare: hap pas hapi	Bahri Beci	Tiranë: Mediaprint.	2011
83.	Abetare mbarëkombëtare	M, Gjokutaj., Sh, Rrokaj., I, Krasniqi & S, Kumnova	Pegi & Dukagjini	2012

3. ABETARET SHQIPE NË MAQEDONI

Sikurse Shqipëria e Kosova edhe shqiptarët e Maqedonisë janë përballur me problematika të shumta në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e shkollave shqipe dhe ngritjes së cilësisë së tyre. Ndër problemet më të theksuara që e vështirësonin funksionimin e edukimit dhe arsimit shqip ishin: mungesa e objekteve shkollore, mungesa e kuadrit arsimor dhe e teksteve shkollore etj. Kur flasim për tekstet shkollore, kemi parasysh edhe librin e abetares ku nxënësit do të mësonin lexim-shkrimin shqip. Duke parë një shqetësim të tillë i cili kërkonte nevojë urgjente për hartimin e teksteve dhe përmirësimin e gjendjes, i pari e filloi intelektual dhe pedagogu Abdyllaqim Dogani si një figurë e shquar e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar. Dogani ishte autor i gjashtë abetaresve, një abetare osmanisht, tri abetare turqisht dhe i dy abetaresve shqipe, një të alfabetit arab dhe tjetra të alfabetit latin. Manastirit “Abetare, Shkup, 1946” (Koliqi, 2012). Për disa nga abetaresve në Maqedoni shiko tablën. nr.2.

Abetaret në Maqedoni 1946-2004

Nr.	Titulli	Autori	Vendi	Viti
1.	Abetare	Abdyllaqim Dogani	Shkup	1946
2.	Abetare	Abdi Haxhiu, Sami Lamçe & Zyhdi Kajanaku	Shkup	1948
3.	Abetare	Abdi Haxhiu, Sami Lamçe & Zyhdi Kajanaku	Shkup	1949
4.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	1969
5.	Abetare / Zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës/	Xhevat Gega	Shkup	1969
6.	Abetare / Zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës/	Xhevat Gega	Shkup	1979
7.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	1988
8.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	1991
9.	Abetare	Avzi Mustafa & Feriz Mjaku	Shkup	2002
10.	Abetare	Qamil Xheladini & Neat Hajrullau	Shkup	2003
11.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	2004

4. ABETARET SHQIPE NË KOSOVË 1945 - 2012

Lufta e Dytë Botërore Kosovën e la në gjendje të vështirë ekonomike, politike po ashtu edhe arsimore. Në Kosovë nuk kishte shkolla të mesme as shkolla fillore tetëklasëshe, vetëm katërklasëshe. Lufta shkatërroi pothuajse tërësisht vendin tonë, duke përfshirë edhe ata pak tempuj të dijes që ishin.

Gjendja e shkollave ishte kjo, “prej 344 objekteve të shkollave fillore sa kanë ekzistuar në Kosovë, gjatë luftës janë shkatërruar 26 shkolla dhe janë dëmtuar 150 sosh. Mbi 90% e popullatës së Kosovës ishte analfabete. Përafërsisht gjendje e njëjtë ishte në të gjitha trojet shqiptare, madje edhe në Shqipëri. Në prag të Çlirimit të Atdheut (Shqipërisë, B. Sh), mbi 80% e popullsisë ishte analfabete, ndërsa te femrat ky tregues arrinte deri në 90%” (Shatri, 2006).

Kemi parasysh faktin, se në vitet 1941-1945, në Kosovë (në të gjitha viset shqiptare në ish-Jugosllavi), si mësues ose kontribues të arsimit shqip erdhën vullnetarisht me qindra shkodran e veprimtarë të tjerë nga viset tjera të Shqipërisë dhe nga Toskëria e sidomos elbasanas (afro 150), të cilët derdhën nektarin e tyre gjuhësor tek gonxhet e luleve shkollare kosovare , që ishin aq të etshëm për shkollën e mësimin shqipes (Vehapi, 2010).

Problemet në atë kohe ishin të shumta si: analfabetizmi, organizimi i punës, hapja e shkollave, mungesa e objekteve shkollore, renovimi i atyre që ishin shkatërruar nga lufta, mungesa e kuadrit arsimor, hartimi dhe botimi i teksteve shkollore.

Për t'i vënë hapat e parë për një luftë shpirtërore ndaj atij rregullimi shtetëror, Kosova në vitet e pasluftës hapi frontin dhe i shpalli luftë analfabetizmit përmes kurseve për analfabetë. Organizimi i kurseve për arsimin e të rriturve dhe për mësimin e shkrimit dhe të leximit ka dhënë rezultate të mira dhe ka ndikuar në ngritjen e nivelit të përgjithshëm arsimor dhe kulturor. Në anën tjetër luftoi për hapjen e shkollave fillore në ato mjedise që nuk ka pasur fare në mungesë të lokaleve shkollore, mësimi mbahej në shtëpi private, organizata prodhuese, bujqësore, kazerma ushtarake, etj.

Dhe, një prej përpjekjeve tjera shumë të rëndësishme arsimore kishte të bënte me hartimin e teksteve shkollore për këto shkolla që po hapeshin, e sidomos duke pasur parasysh që këto shkolla duhej të fillonin nga mësimi i lexim-shkrimit të gjuhës shqipe. Pra, duhej të hartohej libri i parë shkollor për nxënësit e klasës së parë për fëmijë të moshës 6 ose 7 vjeçare “Abetarja” dhe libri për mësimin e lexim-shkrimit për të rriturit analfabet “Abetarja për të rritur”.

Kështu që, të gjitha abetaret shqipe në Kosovë nga viti 1945-2012, do t’i ndajmë në dy grupe, si:

- a) Abetaret shqipe para Kongresit të Drejtshkrimit,
- b) Abetaret shqipe pas Kongresit të Drejtshkrimit.

4.1. Abetaret shqipe para Kongresit të Drejtshkrimit

Puna rreth ortografisë së gjuhës shqipe, që nga Kongresi i Elbasanit (1909), përkatësisht nga Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkruara të vendosura prej Komisionit Letrar Shqipe, Shkodër (1917), në vazhdimësi në periudhën ndërmjet dy luftave botërore si gjuhë zyrtare në Shqipëri, shërbente elbasanishtja me disa përmirësime, që do me thënë mbizotëronte gegënishtja bazuar kryesisht në rregullat drejtshkrimore të hartuara nga ajo Komisioni, të cilat i miratoi dhe Kongresi i Lushnjës (1920) dhe në njëfarë mënyre patën përligjen e organeve shtetërore të kohës (1917, 1923, 1928, 1935, 1940). Më vonë, natyrisht ka pasur diskutime për plotësime e përmirësime të standardit, me trajta të toskërishtes. Ndërsa Rregullat nga Komisioni Letrar e Shkodrës, paksa të zgjeruara e të përpunuara ishin në fuqi, faktikisht, në Shqipëri deri në vitet '40-a e në vazhdimësi edhe pse u sulmuan më 1948, u reduktuan në vitin 1952 dhe mbetën pa fuqi më 1956, por ligjërisht u mënjanuan në vitin 1974. Ndërsa tek ne në Kosovë zbatoheshin deri në vitin 1968 (Veselaj, 2015).

Pra, historia e gjuhës letrare shqipe është disiplinë shkencore e gjuhësisë shqiptare e formuar pas Luftës II Botërore. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt) të 1967-s dhe konkluzat e Konsullatës Gjuhësore të Prishtinës (1968). Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), zyrtarisht caktoi një gjuhë të vetme letrare kombëtare për të gjithë shqiptarët.

Abetaret shqipe në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe janë:

- a) “KËNDIMI im i parë” e vitit 1945,
- b) “Abetare për të rritur” e vitit 1946,
- c) “Abetare për klasën e parë të shkollës fillore” e vitit 1947
- d) “Abetare për të rritur” e vitit 1948,
- e) “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” e vitit 1951,
- f) “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” e vitit 1955,
- g) “Abetare – zhvillimi veçmas i germave të shtypit e të dorës” e vitit 1966 ,
- h) “Abetare – zhvillimi paralel i germave të shtypit e të dorës” e vitit 1967 dhe
- i) “Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit dhe të dorës” e viti 1972.

4.1.1. KËNDIMI im i parë e vitit 1945



Abetarja e parë shqipe që mësuan nxënësit e klasës së parë në Kosovë është “KËNDIMI im i parë” e vitit 1945. “Këta ekzemplarë të abetares në Kosovë e ka sjellë Mehmet Gjevori, Stathi Kostari dhe Sami Raça”. (Shatri, 2006). “Ky është teksti i parë shkollor që është shtypur në shtypshkronjën “Luarasi- Prizren-Tiranë” (Shatri, 2006), në të cilin nuk figuron emri i autorit. Ky tekst ka 80 faqe, tirazh 20.000 kopje.

Pjesa e parë e abetares fillon nga faqja 3 deri në faqen 25 ku mësohen vetëm shenjat grafike të mëdha të shtypit, kurse në pjesën e dytë nga faqja 26 deri në fund të abetares në faqe 80, mësohen edhe shenjat grafike të vogla të shtypit. Në përmbajtjen e këtyre faqeve, shihet se nxënësit kanë mësuar leximin dhe shkrimin vetëm me shkronja të shtypit (Nimonaj, 2011).

Faqja e parë fillon me tri fjalë, “Mama”, “Nina”, “Nana”, dhe në fund të fletës e ka të veçuar tingullin/shkronjën A. Pastaj, abetarja vazhdon menjëherë me tekste të përbëra nga disa fjali. Pikënisje për njohjen e tingujve/shkronjave është fjala dhe fjalia.

Abetarja përbëhet nga 60 tekste, 12 poezi, 9 gjëgjëza dhe 2 dialogë. Kjo abetare bëri kthesë në historinë e arsimit fillor në Kosovë në vitin shkollor 1945/46.

4.1.2. Abetare për të rritur e vitit 1946



Libri i parë për analfabetët titullohet “ABETARE për të rritur”. Autorë janë: Mehmet Gjevori, Salih Kolgeci, Ibrahim Riza, Rexhep Shpendi. Teksti u shtyp në shtypshkronjën “Progres” të Prizrenit. Kjo është abetarja e parë e botuar në Kosovë në vitin 1946, me 58 faqe dhe tirazh 50.000 kopje (Nimonaj, 2014).

Abetarja përbëhet nga pjesa kryesore prej faqes 4–29 dhe është abetare e mirëfilltë. Pjesa e dytë e abetares me njësi mësimore për përforcimin e shkathtësisë së leximit e shkrimit vazhdon nga faqja 30-58. Në këtë pjesë të abetares paraqiten nga tre tinguj/shkronja në një faqe. Në faqen e parë janë shenjat grafike të mëdha të shtypit, kurse në faqen e dytë mësohen tri shenjat grafike të vogla të shtypit, me fjalë dhe fjali të njëjta në dy faqet. Faqet 28 dhe 29 e rrumbullakojnë mësimin e të gjithë tingujve/shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe me të gjitha shenjat grafike. Në faqen 29 paraqiten shkronjat e dorës, me kujdes të veçantë në bukurshkrim dhe numrat nga një deri te dhjetëshi, të shkruar me vija në formë të ornamentit. Nga faqja 30-58, abetarja përbëhet nga 27 pjesë tekstuale dhe 2 poezi.

Mehmet Gjevori ne librine tij “Kujtime e shënime” e përshkruan kështu këtë ngajre të rëndësishme për shkollën dhe arsimin shqip në Kosovë; “nuk mund të pa përmendur e kujtuar, kujdesin, gëzimin e papërshkruar dhe punën e zellshme të të gjithë punonjësve grafik të shtypshkronjës, të cilët nuk kursyen as gjumin e natës ato ditë, vetëm e vetëm që ajo të dilte sa më parë nga shtypi e t’u shpërndahej në teren ndjekësve të kurseve anembanë Kosovës (Gjevori,1998).


4.1.3. Abetare për klasën e parë të shkollës fillore e vitit 1947



Në vitin 1947 botohet “Abetare për klasën e parë të shkollës fillore”. Hartues të abetares janë: M. Gjevori, J. Gjino, S. Kostari, botues Drejtorati Arsimor për Kosovë e Metohi - Komisioni Pedagogjik, “Jugoshtampa” - Beograd, 100 faqe dhe tirazh 50.000 kopje. Para se të botohej kjo Abetare, Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë kërkoi që i tërë teksti i abetares sonë në dorëshkrim, të përkthehet serbokroatisht dhe t’i dergohej për shqyrtim e miratim, para se të botohej. Për këtë çështje, Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, formoi një komision të posaçëm pedagogës-metodistësh për vlerësim. Kjo abetare është botuar edhe në vitin 1948 me 50.000 kopje dhe më 1950 me 15.000 kopje. Kjo abetare hyri në përdorim në vitin 1946/47, “në të gjitha shkollat shqip të Kosovës, Kosovës Lindore si dhe në ato të Malit të Zi” (Gjevori, 1998).

Sipas përmbajtjes së shtjelluar, ajo ndahet në tri pjesë. Pjesa hyrëse, që ka për qëllim të përgatit e përshtat nxënësit për jetën në shkollë. Pjesa e dytë, është abetarja e mirëfilltë, ku mësohen tingujt/shkronjat, lexim-shkrimi. Nxënësit kanë mësuar të lexojnë në mënyrë globale fjalët, fjalitë dhe tekstet, deri në fund të kësaj pjese. Faqja 42 dhe 43 e përmbyllin këtë pjesë me alfabetin e gjuhës shqipe. Tek alfabeti nxënësit për herë të parë i shohin shenjat grafike të vogla të shtypit, ku secili tingull/shkronjë paraqitet me nga një ilustrim frymori apo gjësendi që i konkretizon. Ndërsa pjesa e tretë, ka të bëjë me përforcimin e leximit e shkrimit të gjuhës shqipe (Nimonaj, 2014).

4.1.4. Abetare për të rritur e vitit 1948



Në vitin 1948, Mehmet Gjevori bashkë me Shevqet Veliun, Stathi Kostarin dhe Talat Paçarizin hartuan një abetare të re shqipe për të rritur me titull “Abetare për të rritur”, e cila u botua në shtypshkronjën “Dituria”, Beograd, 110 faqe me 100.000 kopje. Kjo abetare është botuar edhe në vitin 1950, me tirazh 60.000 kopje.

“Abetarja për të rritur” ka 108 faqe. Nga faqja 5 fillon mësimi i tingujve/shkronjave. Abetarja nis me tingullin/shkronjën O, o ku brenda një flete gjendet një shkronjë me të gjitha shenjat grafike të saj (e madhja dhe e vogla e shtypit paralel me ato të shkrimit). Përvetësimin i tingullit/shkronjës shoqërohet edhe me pjesë tekstuale të përbëra nga rrokje, fjalë dhe fjali, të shkruara me shkronja të shtypit, mirëpo ka edhe shkronja/tinguj, rrokje, fjalë dhe fjali të shkruara me shkronja të dorës në të njëjtën faqe. Nga faqja 5-39 mësohen tingujt/shkronjat, ndërsa duke filluar nga faqja 40 deri 93 pason pjesa për përforcimin e leximit dhe shkrimit (Nimonja, 2004). Pastaj në faqet 94, 95, ka pak gramatikë, për të vazhduar me faqet 96 deri 108 me matematikë.

4.1.5. Abetare për klasën e parë të shkollave fillore e vitit 1951

Në vitin 1951 është botuar abetarja për nxënësit e klasës së parë me titull “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore”, autorë të së cilës janë intelektualët dhe mësuesit e parë në Kosovë: Mehmet Gjevori e Stathi Kostari. Abetarja botohet në shtypshkronjën “Mustafa Bakia”, Prishtinë, 116 faqe me tirazh 6.000 kopje. Kjo abetare botohet edhe në vitin 1954 me tirazh 15.000 kopje.

Abetarja përbëhet nga tri pjesë si: Pjesa e parë është përgatitore, e dyta abetarja e mirëfilltë dhe pjesa e tretë periudha për ushtrimin e leximit dhe shkrimit. Periudha përgatitore është pjesa që ndikon në zhvillimin e aftësive folëse, dëgjuese dhe shkruese si dhe ambientimin e nxënësve në shkollë. Pjesa e dytë fillon nga faqja 16 deri në faqen 86. Secili tingull/shkronjë shtrihet në dy faqe të abetares. Në faqen e parë përpunohen shenjat grafike të shtypit. Në faqen tjetër nën ilustrim, janë të veçuara katër shenjat grafike, ndërsa të dorës janë të konkretizuara se si shkruhen në vijat e fletores. Pastaj ka shkronja, fjalë, fjali e tekstet me shkronja të shkrimit. Në të njëjtën mënyrë mësohen të gjitha shkronjat në këtë abetare.

Pjesa e tretë fillon nga faqja 87 deri 116, ku nxënësit zhvillojnë dhe përparojnë shkathtësinë e leximit dhe shkrimit, me tregime, poezi, përralla, etj. Gjithë trangu i abetares është i përbërë nga shtatëdhjetë e katër tekste dhe katërmëdhjetë poezi.

4.1.6. ABETARJA, 1955



Në vitin 1955 në Kosovë u botua në shtypshkronjën “Mustafa Bakia” një abetare tjetër me titullin “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore”, me 133 faqe dhe tirazh 50.000 kopje autorë të së cilës ishin Mehmet Gjevori dhe Jusuf Shushka.


Kjo abetare e Mehmet Gjevorit dhe Jusuf Shushkës është ribotuar edhe pesë herë të tjera, si: në vitin 1958 me tirazh 50.000 kopje, në vitin 1960 me tirazh 40.000 kopje, në vitin 1962 me tirazh 70.000 kopje, në vitin 1964 me tirazh 25.000 kopje edhe botimi i gjashtë në vitin 1965 me tirazh 35.000 kopje.

Abetarja ka 133 faqe. Nga natyra e përmbajtjeve të shtjelluara ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë deri në faqen 17 është hyrëse. Pjesa e dytë fillon nga faqja 18 deri në faqen 90 dhe është abetare e mirëfilltë. Këtu është përpunimi i tingujve/shkronjave të shoqëruara me tekste dhe ilustrime. Në këtë abetare, leximi dhe shkrimi mësohen njëkohësisht, pra

tingulli/shkronja, mësohen paralelisht me të gjitha shenjat grafike. Në faqen 90 e ka alfabetin me të gjitha shenjat grafike të konkretizuar me ilustrime.

Pjesa e tretë e përforcimit të leximit e shkrimit fillon nga faqja 91 deri 133. Kjo pjesë përbëhet nga tetëmbëdhjetë poezi, njëzet e një tregime dhe dy përralla.

4.1.7. ABETARJA, 1966



Ramiz Hoxha është autor i cili ka botuar dy variante të abetareve shqipe: e para Abetare (zhvillimi veçmas i germave të shtypit e të shkrimit) dhe Abetaren (zhvillimi paralel i germave të shtypit e të shkrimit). Abetarja e vitit 1966 ka përpunimin veçmas të germave të shtypit e të shkrimit dhe tirazhi i saj është 40.000 kopje, ndërsa ajo e vitit 1967 titullohet “ABETARE”-zhvillimi paralel i germave të shtypit e të shkrimit” dhe botohet me tirazh 50.000 kopje.


Abetarja e vitit 1966 titullohet “ABETARE” zhvillimi veçmas i germave të shtypit e të shkrimit” dhe tirazhi i saj është 30.000 kopje.

Kjo abetare ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë është hyrja, pjesa e dytë abetarja e mirëfilltë për mësimin e leximit-shkrimit dhe pjesa e tretë që ka për qëllim përforcimin dhe shtrihet vetëm në katër faqe. Pjesa e parë është hyrëse prej faqes 5 deri në faqe 17. Në këtë

pjesë abetarja ka ilustrime të ndryshme që kontribuojnë në përgatitjen e fëmijës për jetën në shkollë kurse faqja e fundit e pjesës hyrëse ka të bëjë me elementet e shkronjave.

Pjesa e dytë është abetare e mirëfilltë, që lidhet me fitimin e shprehive thelbësore të teknikës së shkrim-leximit. Kjo është një abetare që mundëson mësimin veçmas të germave të shtypit e të dorës, prandaj ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë nga faqja 18 deri 55 ka mësimin e tingujve/shkronjave vetëm me dy shenjat grafike të shtypit. Kurse në pjesën tjetër, prej faqes 56 deri 110, përpunohen dy shenjat e tjera grafike të shkrimit për secilin tingull/shkronjë, ku mësohet shkrimi, por në këtë pjesë ka edhe përforsim të leximit. Pjesa e tretë fillon nga faqja 111 e deri 115.

4.1.8. ABETARJA, 1967



Abetarja e vitit 1967 titullohet “ABETARE-zhvillimi paralel i germave të shtypit e të shkrimit”, me tirazh 50.000 kopje. Kurse, në vitin 1970, autori botoi dy abetare alternative dhe atë me zhvillim veçmas të germave të shtypit e të shkrimit, me tirazh 20.000 kopje dhe tjetrën me përpunim paralel të shkronjave të shtypit e të shkrimit me tirazh 50.000 kopje. “Në vitin shkollor 1970/71, mësohej në dy abetare, për fshat dhe për qytet. Germat në abetaret për fshat mësoheshin paralel, d.m.th. e shtypit paralel me atë të shkrimit...”(Dragusha,1974). Viti i fundit i botimit të këtyre abetareve të Ramiz Hoxhës

është viti 1972 me titull “ABETARE-zhvillimi paralel i germave të shtypit dhe të shkrimit”, me tirazh 60.000 kopje.

Abetarja e vitit 1967, ndahet në tri pjesë: pjesa hyrëse, abetarja e mirëfilltë dhe pjesa e tretë që ka të bëjë me përfundimin e leximit dhe shkrimit. Pjesa e parë është hyrja e abetares, prej faqes 5 deri në faqe 18 dhe është e njëjtë me abetaren paraprake. Pjesa e dytë ka të bëjë me fitimin e shprehive elementare paralelisht të leximit dhe shkrimit. Kjo pjesë fillon nga faqja 18 deri në faqen 91. Në këtë abetare të gjithë tingujt/shkronjat me një ecuri të njëjtë mësohen në dy fletë me dy pjesë tekstuale. Në fletën e parë është i veçuar tingulli me ngjyrë të kuqe dhe i konkretizuar me ilustrim. Afër dhe nën ilustrim është fjala normale e cila fillon ose e ka në mes tingullin që mësohet me tekst me shkronja të shtypit. Ndërsa faqja tjetër i ka të veçuara shkronjat e shtypit me ngjyrë të zezë, si dhe shenjat grafike të shkrimit me ngjyrë të kuqe të konkretizuara në mënyrën si shkruhet në vijat e fletores dhe teksti i shkruar me shkronja të shkrimit.

4.1.9. ABETARJA, 1972



ABETARE-Metoda (zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të shkrimit), me autorë Kolë Xhumari, Gani Bardhi, Anton Lakuriqi, 1972. Kjo abetare u dorëzua në shtyp në shtator 1971 dhe doli nga shtypi në maj 1972 (Xhumari, Bardhi & Lakuriqi, 1972). Abetarja ka 96 faqe dhe

ndahet në pjesën përgatitore dhe abetaren e mirëfilltë. Pjesa e parë, përgatitore fillon nga faqja 5-20. Kjo është abetaret që u kushton shumë rëndësi elementeve të shkronjave. Përkushtohet dhe te formimi i nocioneve duke filluar nga fjalia e përbërë nga dy fjalë si p.sh. “zogu këndon”, në fjali me tri fjalë “Bujku punon arën”, pastaj ushtrime për ta ndryshuar fjalën duke ndryshuar tingullin si “ura, ora”; “rosa, kosa”, etj. Më tutje vazhdojnë ushtrimet për rrokje, duke filluar nga fjalët njërrrokëshe deri te ato katërrrokësh si p.sh ve, mollë, çekiçi dhe trëndafili. Pas njohjes së rrokjeve fillon nocioni për tingullin prapë përmes ilustrimeve duke pyetur nxënësit: Si bënë sharra? Duke filluar nga faqja 6-9, ka paraqitje skematike të gjërave të ndryshme që kanë për detyrë t’i vizatojnë fëmijët.

Pjesa e dytë është një nga abetaret që përpunimin e tingujve/shkronjave e bën në mënyrë më komplekse sesa abetaret tjera dhe ka disa mënyra se si përpunohen shkronjat të ndara në grupe. Në grupin e parë mësohen shkronjat në një orë me tri shenjat grafike, dy të shtypit dhe të voglën e shkrimit.

Grupi i dytë në orën e parë paraqiten tri shenjat grafike sikurse për shkronjat paraprake, kurse orën pasuese ka ushtrime për tri shenjat grafike të këtyre shkronjave. Grupi i tretë, në orën e parë përpunohen tri shenjat grafike të tingullit/shkronjës, në orën tjetër ka ushtrime vetëm për këto shenja grafike të shkronjave të mësuara, por shoqërohen dhe me mësimin e shenjave grafike të mëdha të shkrimit për shkronjat e mësuara më parë. Në grupin e katërt mësohen katër shenjat grafike të shkronjës për një orë për të gjitha shkronjat tjera.

Në Komisinë Letrare Shqipe të Shkodrës më 1916-17, në këtë ngjarje të rëndësishme lindi për herë të parë në historinë e popullit shqiptar gjuha e standardizuar shqipe, e normëzuar mbi bazën e elbasanishtes. Duhet të përmendim se ky variant letrar është përdorur pas Luftës II Botërore edhe në Kosovë dhe Maqedoni si normë e vetme e folur dhe e shkruar e gjuhës letrare shqipe, gjer në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), por gjithashtu, ka pasur një bazë pak më të gjerë dhe përfshinte elemente gjuhësore edhe të të folmeve të tjera të gegërishtes (sidomos të kosovarëve dhe të dibranasve etj.) (Doli, 2015).


4.2. Abetaret shqipe në Kosovë pas Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Një ngjarje shumë e rëndësishme për shkencën, arsimin dhe kulturën shqiptare ka qenë Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që është mbajtur në Tiranë më 1972. Në këtë forum të lartë gjithëkombëtar është miratuar gjuha letrare e bashkuar (unisuar) dhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Gjuha letrare kombëtare (gjuha standarde) është forma më e përsosur e gjuhës e cila shërben për komunikim të përgjithshëm të pjestarëve të një kombi në të gjitha fushat e veprimtarisë. Ky komunikim i përgjithshëm përhapet më së lehti përmes komunikimeve publicistike e informative dhe arsimore-edukative dhe shkencore. Përhapja e gjuhës standarde bëhet shumë shpejtë në trajta të shkruara të gjuhës shqipe se sa në trajta të folura. Këtë dukuri e shohim dhe te abetaret pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ku vërehet menjëherë jetësimi i gjuhës standarde në këto abetare si:

- a) “Abetare” e vitit 1977,
- b) “Abetare” e vitit 1982,
- c) “Abetare” e vitit 2003,
- d) “Abetare” e vitit 2008 dhe
- e) “Abetare” e vitit 2012.

Tani, gjuha letrare kombëtare/gjuha e standartizuar është forma më e përhapur e gjuhës së shkruar, duke filluar dhe nga libri i parë shkollorë, ku nxënësit mësojnë leximin-shkrimin e drejtë të fjalëve, fjalive dhe pasurojnë fjalorin me fjalë e shprehje të bukura shqipe.

4.2.1. ABETARJA, 1977




Pesë viteve pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, kemi abetaren e Mehmedali Hoxhës, me titullin “Abetare”, botuar në vitin 1977 me tirazh 50.000 kopje. Kjo abetare është botuar edhe katër herë të tjera deri në vitin 1982. Botimi i dytë në 1978 me tirazh 50.000 kopje, botimi i tretë në vitin 1979 me tirazh 30.000 kopje, botimi i katërt 1980 me tirazh 40.000 kopje dhe botimi i pestë në vitin 1981 me tirazh 2000 kopje (Ramaj, 1985).

Abetarja ka 96 faqe. Shikuar nga natyra e përmbajtjes së shtjelluar, ajo ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë është hyrëse, ka ushtrime për zhvillimin e shkathësive komunikuese, po ashtu bëhet përpjekje që në këtë pjesë të formohen nocionet për fjalinë e përbërë nga dy dhe tri fjalë, pastaj fjalën e përbërë nga dy, tri dhe katër rrokje, gjithnjë duke u mbështetur në ilustrime.

Pjesa e dytë është abetare e mirëfilltë: përpunimi i tingujve/shkronjave, shoqëruar dhe me tekste, ilustrime e ushtrime përkatëse. Tingujt/shkronjat mësohen të kombinuara, në disa raste në një orë mësimore me tri shenjat grafike, një grup tjetër me katër shenjat e kështu me rradhë.

Pjesa e tretë, fillon prej faqes 92-96 ku ka ushtrimet për përparimin dhe përsosjen e mëtejshme të leximit e të shkrimit (Nimonaj, 2014).

4.2.2. ABETARJA, 1982



1982

1987

Nga viti 1982 deri në vitin 2007 kanë vepruar abetaret e Qamil Batallit. Nga viti 1982-1986 është ribotuar e njëjta abetare. Prej vitit 1987 del një botim tjetër me shumë pak ndryshime nga abetarja paraprake e vitit 1982. Pra, abetarja e vitit 1982 ka jetuar në duart e fatosave deri në vitin 2002.

Abetarja e vitit 1982, ka 95 faqe. Kjo abetare ndahet në dy pjesë. Pjesa hyrëse, pra, periudha përgatitore dhe pjesa e dytë abetarja e mirëfilltë apo periudha e mësimit të tingujve/shkronjave dhe të leximit e shkrimit. Kjo pjesë i përkushtohet përshtatjes së nxënësve dhe identifikimit të nivelit të njojurive. Autori ka bërë përpjekje që të bëjë njohjen e nocioneve për fjalinë, fjalën, rrokjen dhe tingullin. Nga fjalia e përbërë nga dy fjalë, tek ajo me tri fjalë për të kaluar te fjala me dy, tri dhe katër rrokje e pastaj te tingulli. Pjesa e dytë, e përpunimit të tinguit/shkronjës, ku ndahen në tri grupe, në fillim të abetares një shkronjë me një shenjë grafike, më pas me dy shenja grafike dhe nga faqja 54 një shkronjë me të gjitha shenjat grafike. Për Abetaren e vitit 1982 mund të konkludojmë :

- Abetarja mundëson mësimdhënie më mësuesin në qendër,
- Abetarja ka shumë pak ushtrime me tinguj, rrokje, fjalë dhe fjali,

- Abetarja nuk kërkon nga nxënësit t'i bëjnë këto veprime: të krahasojnë, manipulojnë, zgjedhin enigma, prejnë me gërshërë, ngjesin, modelojnë, zbukurojnë dhe plotësojnë pjesë që kërkon vizatimi,
- Nuk ofrojnë mësim të diferencuar, përmbajtja vlen njëjtë për të gjithë nxënësit,
- Zbatimi i metodës analitiko-sintetike është shumë sipërfaqësore,
- Abetarja ka shkronja me ngjashmëri grafike dhe mësohen afër njëra tjetrës,
- Në abetare në fillim është punuar me shkronjat që kanë strukturë grafike më të thjeshtë,
- Leximi dhe shkrimi vetëm me tingujt dhe shkronjat e mësuara, ju ka përshtatur fëmijëve të atyre viteve që shumë pak kanë qenë pjesë e edukimit parashkollor.

4.2.3. ABETARJA, 2003



2003

2007

Abetarja e vitit 2003, për klasën e parë të shkollës fillore është botimi i parë i një abetare cila ndryshon nga abetarja e vitit 1982, e autorit dhe poetit për fëmijë Qamil Batalli e cila ribotohet deri në vitin 2007. Abetarja ka 86 faqe. Kjo abetare ndahet në dy pjesë: në paraabetare dhe në abetaren e mirëfilltë.

Pjesa e parë, fillon nga faqja 3 deri në faqen 5. Kjo pjesë fillon me ditën e parë të shkollës me “Fëmijët e abetares” dhe me ilustrimin “Klasa jonë”, që ka për qëllim përshtatjen me mjedis shkollor.


Pjesa e dytë, fillon nga faqja 6. Në faqen 6 është përpunimi i tingullit/shkronjës “A, a”, pra, vetëm dy shenjat grafike të shtypit dhe pjesa tekstuale “Ani, Ana e nëna”. Tinguj/shkronjat tjera përpunohen brenda një ore me të gjitha shenjat grafik. Në këtë abetare, nuk ka tekste vetëm me shkronjat e zhvilluara, por brenda tekstit ka edhe shkronja të pamësuara më parë. Këtë dukuri nuk e hasim vetëm në fillim, por deri në fund të abetares. Pra, leximi bazohet në intuitë dhe procesin e perceptimit. Në kuadër të metodës mikse përfshihen edhe metoda analitiko-sintetike, metoda e fjalëve normale, metoda globale, metoda e fjalive normale dhe metoda e tingujve natyralë.

Zbatimi i metodës së përzier (mikse), si kombinim metodash, krijon hapësirë për një zhvillim dhe përsosje të mëtejme jo vetëm në krijimin e teksteve të reja, por edhe në përvetësimin më të lehtë të tyre. Ndërsa për Abetaren e dytë të Qamil Batallit mund të themi:

- Kanë një ecure didaktike të orës që kalon kryesisht nëpër hapat e metodës analitiko-sintetike,
- Nxënësi është aktiv gjatë gjithë orës mësimore dhe është në qendër,
- Kërkon që nxënësit të kenë përgatitje parashkollore,
- Ka periudhë përgatitore më të gjatë dhe më gjithëpërfshirëse,
- Abetarja i kushton rëndësi bukurshkrimit.

Shohim se Abetaret e Qamili Batallit për dy dekada e gjysmë me radhë i kanë mësuar nxënësit në Kosovë të lexojnë e të shkruajnë gjuhën shqipe. Kemi Abetaren e parë të Qamil Batallit e cila është përdorur nga viti 1982 deri 2002, e cila i ka shoqëruar shkollaret në periudhën më të errët të arsimit në Kosovë. Gjatë këtyre viteve në arsimin dhe shkollën shqipe kanë ndodhur, përjashtimi dhe mbyllja e institucioneve arsimore, uzurpimi i të gjitha hapësirave të dedikuara për arsim, organizimi i mësimin në shtëpi-shkolla etj. Serbia ndryshoi edhe ligjin për të gjitha nivelet e arsimit, duke i kaluar pa përjashtim kompetencat në organet e pushtetit serb. Rrethanat politike, arsimore, sociale, mbyllja e shtypshkronjave, pamundësia financiare, janë determinues që kjo abetare të mbetet njëra nga abetaret më jetë gjatë në historinë e abetareve në Kosovë.

4.2.4. ABETARJA, 2008




Abetarja e vitit 2008 është abetarja e parafundit në Kosovë. Autorët e abetares janë dy pedagogë dhe intelektualë të shquar, Agim Deva dhe Islam Krasniqi. Është e vetmja abetare shqipe në Kosovë, e cila përveç tekstit bazë Abetarja, ka një pako shoqëruese. Në këtë abetare pako nxënësit e klasës së parë kanë: paraabetaren, abetaren, fletoren e punës, dy fletore diktimi, një shkronjëtole individuale, një abetare rrotulluese, një abetare dëgjimore/auditive/CD-në, tabelën magnetografike dhe librin e mësuesit. Abetarja ka 88 faqe. Abetarja ka dy pjesë, periudhën përgatitore dhe abetaren e mirëfilltë.

Periudha e përgatitjes për mësimin e leximit dhe të shkrimit në abetare, e veçanta e kësaj abetareje është se në pakon e saj gjendet paraabetarja, broshurë e ndarë nga abetarja e mirëfilltë.

Abetarja e mirëfilltë, nga faqja 4 fillon mësimi i tingujve/shkronjave. Secilit tingull/shkronjë i janë kushtuar dy faqe. Ora mësimore për përpunimin e tingujve/shkronjave ka tri pjesë: pjesën hyrëse, kryesore dhe përfundimtare. Tingujt/shkronjat që mësohen janë të veçuara në një hapësirë të madhe perceptive, të ngjyrosura me vija ngjyrash, pozitash e formash të ndryshme. Në fillim të orës paraqiten dy shenjat grafike të shtypit dhe në fund të orës shenjat grafike të dorës të konkretizuara se si shkruhen në fletore me vija të ngushta. Së pari fillohet me përpunimin e tingullit, në mënyrë analitike. Nga poezia, tregimi ose nga

përshkrimi i ilustrimit veçohet për analizë një fjali, nga fjalia veçohet për analizë fjala, pastaj fjala ndahet në rrokje ose edhe nga fjala veçohet tingulli dhe mësohet shqiptimi i drejtë i tij.

4.2.5. ABETARJA, 2012



Abetarja e vitit 2012 është guri i parë në rrugën e unifikimit të teksteve shkollore. Autorët e abetares janë dy pedagogë nga Shqipëria: Dr. Mimoza Gjakutaj (Çano), Dr. Shezair Rrokaj dhe nga Kosova, pedagogu Dr. Islam Krasniqi dhe mësuesja Saranda Pozhegu. Botimin e lejoi Ministria e Arsimit dhe e Shkencës së Shqipërisë dhe Ministra e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës.

Abetarja mbarëkombëtare, përveç abetares bazë ka: Abetaren e punës dhe librin për mësuesin/en. Abetarja është strukturuar në tri pjesë: paraabetarja, abetarja dhe pasabetarja.

Paraabetarja në abetare, fillon nga faqja 7 deri 20. Kurse abetarja e mirëfilltë fillon nga faqja 21 deri 97. Në abetare tingujt/shkronjat janë paraparë të mësohen për pesë orë. Mësimi i alfabetit është ndarë në gjashtë grupe me nga gjashtë tinguj/shkronja. Ora fillon përmes një bisede mësues-nxënës lidhur me ilustrimet e ndryshme në abetare të cilat kanë në fillim, në mes apo në fund tingullin/shkronjën që do të mësohet. Leximi bëhet në mënyrë globale i përcjellë me kutiza ku duhet të plotësohet fjala me tingullin/shkronjën që mungon, e cila përpunohet.

Nga faqja 100 fillon pjesa për përforcimin e leximit dhe shkrimit deri në faqen 119. Në këtë pjesë nxënësit nuk janë vetëm lexues të thjeshtë, por nga ta kërkohet të jenë aktivë gjatë gjithë orës. Teksti shtron një mori kërkesash si: lexo, recito, mëso përmendësh, luaj role, bashkëbisedo, diskuto, jep këshilla, gjej veprimet, shkruaj, krijo, vizato, ngjyros, plotëso, gjej ngjashmëritë dhe dallimet, ndaj në rrokje fjalët, nënvizo rrokjen e fundit, njohja e ndjenjave, imagjino, fjalorthi dhe mësimi i shenjave të pikësimit.

Arritje e madhe kombëtare konsiderohet standardizimi i gjuhës shqipe në vitin 1972, ku gjithçka e shkruar duhet të hartohet sipas këtij standardi. Në vitin 2012, arrijmë te unifikimi i tekstit shkollor, siç është abetarja mbarëkombëtare Kosovë-Shqipëri.

Abetarja erdhi duke u përsosur dhe duke u përshtatur vazhdimisht me gjuhën standarde dhe me metodat më të reja të mësimi të shkrim-leximit. Me përmbajtjen e tyre, ato gjithnjë kanë shërbyer jo vetëm si mjete për t'i aftësuar nxënësit për të lexuar dhe shkruar gjuhën shqipe, por edhe si mjete të fuqishme edukimi. Me paraqitjen e tyre figurative ato kanë shërbyer edhe si mjete të fuqishme për edukimin etik, estetik dhe artistik të fëmijëve në këtë etapë të parë të shkollimit të tyre.

II. AUTORËT E ABETAREVE SHQIPE NË KOSOVË

Autorët e abetareve shqipe kanë dhënë kontribute të veçanta edhe për historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar dhe janë metodistët e parë origjinalë në mjeshtrinë e mësimdhënies. Gjatë hulumtimeve tona kemi spikatur faktin se i madhë është numri i mësuesve e shkrimtarëve që kontribuan dhe punuan me entuziazëm e përkushtim për abetaret e gjuhës shqipe, librat shqip, për luftën kundër analfabetizmit, ngritjen kulturore të masës, për hapjen e shkollave shqipe edhe në zonat më të thella dhe ngritjen e nivelit shkencor e profesional. Autorë e abetareve shqipe në Kosovë, i takojnë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore të cilët kryesisht ishin mësues shqiptarë në RSFJ. Një numër i tyre ishin mësues të ardhur nga Shqipëria me kërkesën e Ministrit të Arsimit, Ernerst Koliqit. Këta mësues punuan me shumë përkushtim ku fillimisht hartuan abetaret shqipe, pastaj punuan si inspektor të arsimit, si redaktor, kryeredaktor e shumë funksioneve tjera duke u përpjekur për mëkëmbjen e shkollës shqipe edhe përkundër rrethanave të pushteti jugosllav të asaj kohe. Në një situatë të tillë e rrethuar me regjimin e Jugosllavisë autorët e abetareve shqipe i njihnin shumë mirë proceset shkollore të asaj kohe sepse edhe vet kishin qenë nxënës të sistemit shkollor të RSFJ deri në vitin 1999 ku vazhdimisht bënë punë të cilat natyrshëm i kontribonin egzistencës së shkollës shqipe si dhe zhvillim të përmbajtjeve dhe proceseve mësimore shqipe.

Abetaret shqipe kishin një rrugëtim shumë të gjatë ku fillimisht kishin autor nga Shqipëria për të vazhduar pastaj bashkëpunimin me gjuhëtar dhe mësues nga Kosova me një mision të përbashkët kurorëzimin e Abetares Mbarëkombëtare me autorë nga dy shtetet, Kosovë dhe Shqipëri.

Përmes këtij punimi do të paraqesim disa nga kontributdhënësit më të çmuar në historinë e botimit të abetareve shqipe në Kosovë, ku secili prej tyre ka dhënë kontribut të veçantë në fushën e hartimit të këtij teksti shkollor.

1. REXHEP SHPENDI

Në fshatin Bujan të komunës së Bajram Currit në vitin 1910 ka lindur Rexhp Shpendi i cili më vonë do të vlerësohej si patriot dhe mësues i pasionuar si dhe mësues i popullit.

Rexhep Shpendi rrjedh nga një familje malësore, arsimdashëse dhe patriotike e cila i'a dinte vlerën shkollimit dhe me shumë mund arriti ta shkolloi birin e tij. Rexhepi pas përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm në fshatin Kolgecaj, sot Bajram Curri, vazhdoi studimet në Normalen e Elbasanit për të fituar titullin mësues për shkollat fillore.

Në rrethet e Kukësit punoi si mësues afro një dekadë duke kontribuar në edukimin patriotik, ngritjen e vazhdueshme të nivelit të mësimdhënies, mundësinë e rritjes së numrit të fëmijëve në shkolla si dhe në konsolidimin e punës së shkollat egjistuese. Mësuesi Rexhep Shpendi vazhdimisht u angazhua edhe për hapjen e shkollave të reja, paisjen e nxënësve me tekste shkollore, materiale didaktike dhe rregullimin e infrastrukturës së shkollave.

Në kohën kur Shqipëria u pushtua nga Italia, mësuesi Rexhep në shenjë revolte dhe paknaqësie organizoi një grup fshatarësh të armatosur për tu nisur drejt Durrësit të cilët kishin qëllim bashkimin me forcat e rezistencës për të mbrojtur vendin. Krahas këtij kontributi Rexhet Shpendi nuk nguroi të shfaqte dashurinë e tij që ndjente për ngritjen e arsimit në Kosovë dhe dëshirën për ti shërbyer këtij mësoni. Këtë rrugëtim e filloi në vitin 1941 fillimisht në Prishtinë, pastaj në Shtime dhe Pejë ku në vitin 1944 i bashkohet batalionit partizano- kosovar në luftë kundër fashizmit.

Aktivitetin profesional Rexhep Shpendi e realizoi edhe si drejtor i Normales së Gjakovës dhe inspektor i arsimit. Gjithashtu u angazhua edhe në organizimin e disa seminareve pedagogjike dhe kurseve arsimore të cilat vazhdimisht synonin të përmirësonin procesin e mësimdhënies. Intelektuali Rexhep Shpendi kontriboi edhe në hartimin e disa teksteve shkollore në të cilat ishte bashkëautor si:

- Abetare për të rritur, autorët: Mehmet Gjevori, Sali Kolgeci, Rexhep Shpendi, Ibrahim Riza, botuesi-Këshilli Popullor për Kosovë e Metohi- Drejtorati Arsimor-shtypshkronja e shtetit – Prizren, 1946 (Ramaj,1985).

Duhet theksuar se puna e tij është vlerësuar nga shumë kritikë me ç'rast ka marrë titullin e lartë nderi me urdhërin "Naim Frashëri", pastaj titullin "Mësues i Merituar", ndërkaq pas vdekjes është dekoruar me titullin "Mësues i Popullit" ndërsa Këshilli i Komunës së Bujanit dhe rrethit Bajram Curri e shpalli atë "Qytetar Nderi i Komunës Bujan".

2. MEHMET GJEVORI (1912-2007)

Veprimtari i devotshëm i arsimit kosovar, mësuesi, inspektori dhe pedagogu i njohur Mehmet Gjevori lindi në qytetin e bukur të Elbasanit me 01.VI.1912, ku shkollimin fillor e mbaroi në Elbasan ndërkaq atë të mesëm e përfundoi në shkollën teknike shqiptaro-amerikane (drejtimin e mësuesisë) në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve në periudhën 1933-1940 punoi si mësues dhe edukator në Internatin e Matit në qytetin e Burrelit. Një vit më vonë me 1941 Mehmet Gjevori ishte njëri ndër intelektualët e parë shqiptarë që i'u përgjigj apelit të Ministrit të Arsimit, prof. Ernest Koliqit për të vazhduar punën e mësuesit në Kosovë ku qëllim kryesor kishte hapjen e shkollave të para shqipe.

Në Kosovë Mehmet Gjevori fillimisht u angazhua si drejtor në SHF. "Abdyl Frashëri" në Prizren e pastaj aktivitetin e tij intelektual e ushtroi si arsimtar në Shkollën Normale të Gjakovës si një dritare e re e dijes në Kosovë.

Pas çlirimit të vendit nga okupatori e deri në tetor të vitit 1950 ka shërbyer si inspektor i shkollave shqipe të Krahinës, ku në të njëjtën kohë ushtronte edhe detyrën e anëtarit të ish Komisionit Pedagogjik pranë ish Drejtoratit për Arsim e Kulturë të Këshillit Popullor Krahinor. Në kuadër të këtij komisioni merrej me përpilimin, përshtatjen dhe përkthimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe.

Mehmet Gjevori gjithashtu gjatë kësaj periudhe menjëherë pas themelimit të shtëpisë së parë botuese ka mbikëqyrë punën mësimore-edukative në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme. Një pjesë tjetër të angazhimit të tij e ka orientuar edhe në organizimin e kurseve pedagogjike kundër analfabetizmit. Nga viti 1950 Mehmet Gjevori shërbeu si redaktor dhe më vonë edhe kryeredaktor në Shtëpinë Botuese "Mustafa Bakia", si dhe kryeredaktor i revistes shkollore "Pionieri". Si një intelektual dhe vizionar i arsimit shqip ai konsiderohet si njeriu që vuri bazat e arsimit shqip në Kosovë, jo vetëm me abetaret që i hartoi por edhe duke u bërë autor i shumë teksteve të tjera shkollore të cilat e pasuronin mësimdhënien kosovare.

Për punën e tij u nderua me shumë çmime, mirënjohje e dekorata të cilat e plotësuan profilin e tij e ndër të shumtët ishte edhe nderimi me urdhërin “Naim Frashëri” të klasit të parë në vitin 1994 të dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z.Sali Berisha ndërkaq në vitin 2003 u dekorua me “Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit” nga ish presidenti i Kosovës, tashmë i ndjerë Ibrahim Rugova.

Krijimtaria profesionale e Mehmet Gjevorit është shumë dimensionale duke e bërë autorë të shumë abetareve, librave të leximit, metodikave për mësimin e lexim-shkrimin në klasë.

Abetaret e Mehmet Gjevorit janë:

- Abetare për të rritur, botues- Këshilli Popullor për Kosovë e Metohi, Prizren, 1946, botimi i II 1948, botimi i III 1950.
- Abetare për klasën e parë të shkollës fillore, “Jugoshtampa”, Beograd, 1947.
- Abetare për të rritur, “Dituria”, Beograd, 1948.
- Abetare për klasën e parë të shkollave fillore, “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1951, botimi i II 1954.
- Abetare për klasën e parë të shkollave fillore, “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1955, e cila është ribotuar e përmirësuar disa herë dhe e njëjta është përdorur në shkollat tona 10 vjet rresht, deri në vitin 1966.
- Abetare, 1974.

Mehmet Gjevori krahas hartimit të abetareve, ishte autor edhe i shumë teksteve të tjera shkollore si:

- Gjeografia për klasën e III,
- Vjersha për shkollën fillore,
- Libër leximi për kl e II dhe III,
- Përkthyes i shumë teksteve tjera si: libër leximi klasa e I dhe III, aritmetike klasa I dhe II, etj

3. KOLË XHUMARI (1912-2006)

Profesori i shkronjave shqipe, babai i abetares dhe pedagogu i shquar shqiptar Kolë Xhumari lindi në Kavajë nga një familje e thjeshtë arsimdashëse dhe atdhetare. Babai i tij Pal Xhumari punoi si mësues duke u vlerësuar si “mësues i Popullit”. Arsimin fillor dhe të

mesëm e përfundoi në vendlindje ndërkaq në vitin 1931 i përfundoi studimet në Shkollën e Normales në qytetin e Elbasanit. Menjëherë pas përfundimit të Normales, emërohet mësues në Peqin e më pas në Durrës dhe Tiranë. Gjatë jetës së tij ka punuar si drejtor shkolle, metodist në Kabinetin Pedagogjik të Tiranës dhe në Institutin e Prefeksionimit të Mësuesve në Tiranë, pastaj edhe në Ministrinë e Arsimit dhe në Institutin e Studimeve Pedagogjike.

Mësuesi Kolë Xhumari ishte ndër të parët mësues që përdori metodën globale e njohur si njëra ndër metodat më të avansuara edhe gjatë ditëve të sotme në mësimin e abetares qysh në vitin 1937 ku punonte si mësues në shkollën “Hoxha Tasini”. Nga viti 1945 deri në vitin shkollor 2000/2001 punoi intensivisht në hartimin e abetareve. Abetaren e parë (1945) e punoi sipas metodës globale, për të vazhduar me metodën e fjalëve normale, pastaj me metodën analitike-sintetike (1962) dhe pas një eksperimentimi disavjeçar, në vitin 1994, botoi Abetaren punuar me metodën mikëse të shoqëruar edhe me fletore pune dhe të modeluar (Koliqi, 2012).

Pedagogu Kolë Xhumari gjatë punës së tij hartoi shumë tekste, metodika, doracakë metodik si dhe shumë artikuj shkencorë-profesionalë të cilët u botuan në revista dhe gazeta si: “Shkolla kombëtare”, “Arsimi popullor”, “Revista pedagogjike” etj. Krijimtaria profesionale e Kolë Xhumarit ishte gjithnjë prezente në proceset mësimore të cilat i kontribonin mësimin të lexim-shkrimit në Shqipëri si:

- “Abetare”, nga viti 1945 deri në vitin shkollor 2000/01,
- “ Abetare për fëmijët që nuk shohin” (bashkëautor, 1963),
- “Abetare për fëmijët që nuk dëgjojnë” (bashkëautor, 1963),
- “Fletore pune për abetaren”(1979-2001),
- “Libri i mësuesit për abetaren e re” (1984).

Profesionistët e mësimdhënies shqiptare, Kolë Xhumarin e vlerësojnë si mjeshtri i abetareve shqipe i cili vazhdimisht punoi në kërkim të metodave dhe formave të reja të mësimdhënies të cilat gjithnjë e më shumë rritnin efektshmërinë e mësimin të lexim-shkrimit.

4. STATHI KOSTARI

Në listën e kontributdhënësve shqiptar të cilët njihen si autorë të abetareve dhe veprimtarë të shkollave shqipe në Kosovë veçohet edhe emri i intelektualit Stathi Kostari i lindur në qytetin e Gjirokastrës. Kostari krijimtarinë e tij profesionale fillimisht e ka realizuar në Kosovë duke qenë njëri ndër 200 mësuesit që erdhën për të punuar aty. Ai ishte anëtar i përhershëm i Komisionit Pedagogjik duke dhënë kontributin e tij edhe në planifikimin dhe organizimin e kurseve të ndryshme pedagogjike përgjatë periudhës 1945-1949 kundër analfabetizmit si dhe shumë aktivitete të tjera të cilat natyrshëm i kontribonin mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor në Kosovë.

Stathi Kostari ishte bashkëautor i Abetares së botuar në vitin 1947, ku pastaj dorëshkrimin e kësaj Abetare me kërkesën e Ministrisë së Arsimit në Republikën e Serbisë e përktheu edhe në gjuhën serbokroate ku nga kjo ministri kërkohej shqyrtimi i miratimit para se e njehta të botohej në gjuhën shqipe. Veprimtaria e mësuesit Kostari është mjaftë e gjërë e cila në vete ngërthen një mori librash e ndër to më të favorizuara janë:

- Abetare për klasën e parë të shkollave fillore.

Autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, Jani Gjini. Drejtorati Arsimor për Kosovë e Metohi-Komisioni Pedagogjik, "Jugoshtampa", Beograd, 1947.

- Abetare për klasën e parë të shkollave fillore (botimi i dytë).

Autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, Jani Gjino. Drejtorati i Arsimit për Kosovë e Metohi-Komisioni Pedagogjik, Ndërmarrje tekstesh dhe mjetësh mësimore të RPS "Znanje", (Dituria), Beograd, 1948, botimi i tretë, 1950.

- Abetare për të rritur,

autorë: Mehmet Gjevori, Shefqet Veliu, Stathi Kostari, Talat Paçarizi, Drejtorati i Arsimit për Kosovë e Metohi, Komisioni Pedagogjik. "Dituria", 1948

- Abetare për klasën e parë të shkollës fillore,

autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, "Mustafa Bakija", Prishtinë, 1951.

- Abetare për klasën e parë të shkollës fillore,

autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari "Mustafa Bakija" Prishtinë, 1954.

- Gjeografi për klasën e III të shkollave fillore, autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, Jani Gjini, Drejtorati Arsimor për Kosovë e Metohi, Komisioni Pedagogjik, "Jugoshtampa", Beograd, 1947.

- Vjersha për shkolla fillore e paragjimnaze,

autorë: Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, Shefqet Veliu, Drejtorati i Arsimit, Komisioni Pedagogjik, Prishtinë, 1947.

Puna e Stathi Kostarit nuk mbaron vetëm me titujt e lartpërmendur sepse angazhimi i tij është vlerësuar nga kritika edhe për botimin e broshurës me titull "Udhëzime për mësimin e lexim-shkrimit për klasën e I të shkollave fillore, ku bashkëautor pati edhe veprimtarin Mehmet Gjevorin, ndërkaq botimin e tij e mundësoi Këshilli i Arsimit për Kulturë i Krahinës Autonome të Kosovës në Prishtinë 1952 (Gjevori, 1998). Duhet theksuar se autori në fjalë ka punuar edhe në hartimin e disa teksteve tjera shkollore si Gjeografia, 1947, Libër Leximi 1948, Histori për klasën e III dhe IV, 1952 dhe disa tekste të tjera.

5. SHEFQET VELIU

Njëri nga instruktorët e parë të shkollave shqipe në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore ishte veprimtari, mësuesi, autori i abetares dhe anëtari i Komisionit Pedagogjik, Shefqet Veliu i cili punën e tij fillimisht e bëri në qarkun e Graçanices dhe më vonë si mësimdhënës i kursit pedagogjik përgjatë vitit 1947 në qytetin e Prizrenit.

Intelektuali Shefqet Veliu në krijimtarinë e tij krijuese mbahet mend si autorë i shumë librave shkollore dhe bashkëautor në shumë tekste të tjera shkollore. Disa prej tyre janë:

- Abetare për të rritur, bashkëautor, Drejtorati i Arsimit për Kosovë e Metohi, Komisioni Pedagogjik, "Ditura", Beograd, 1948.
- Libër leximi për klasën e III të shkollës fillore, Biligrad, "Ditunija", 1948, 1966, 1968, 1970.
- Libër leximi për klasën e II të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, 1966, 1968, 1970, 1972, 1973.
- Libër leximi për klasën e I të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, 1963, 1983, 1969, 1972.

- Libër leximi për klasën e IV të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, 1983.
- Aritmetik , klasa e II, (bashkëautor) 1972,
- Përkthyes: Dituri natyre dhe shoqërie, 1972 etj.

6. MEHMEDALI HOXHA (1924-1991)

Shkrimtari për fëmijë Mehmedali Hoxha lindi në fshatin Radolishtë të Strugës ndërkaq vdiq në Shkup. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Shkup. Në fillim punoi si mësues, pastaj në redaksinë “Flaka e Vëllazërimit” gazetar dhe redaktor. Në vazhdimsi të punës së tij krijuese nga viti 1953, kur përherë të parë doli revista për fëmijë “Fatosi”, Mehmedali Hoxhen e gjejmë si kryeredaktor të saj derisa u pensionua. Gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht në vitin 1952 botoi një përmbledhja vjershash për fëmijë duke u bërë ndër autorët e parë që u prezantua para fëmijëve me vjerasha për fëmijë (Hasani,2003).

Ndër veprat e tij më të njohura janë:

- “Vjersha” 1952,
- “ Te kroni” 1960,
- “ Kur fryn era” 1962,
- “Atje mbi kodrina”1974,
- “ Ditët tona” 1979.

Si dhe abetarja e tij e titulluar:

- “Abetare” botuar në vitin 1977, Ribotuar 1978, 1979, 1980, 1981.

1. RAMIZ HOXHA

Profesori i gjuhës dhe letërsisë shqipe Ramiz Hoxha lindi në fshatin Kolgecaj, sot Bajram Curri me 01.VIII, 1927 në një familje fshatare punëtore. Pas përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm në vitin 1941 shpëngulet në Gjakovë ku në periudhën 1946/1947 përfundon mësimet në Normalen e Gjakovës dhe menjëherë emërohet si profesor në Gjimnazin e Ulët të Istogut ndërkaq në periudhën 1946/1947 kryen funksionin e drejtorit të shkollës. Periudha ndërmjet viteve 1949/1953 e gjen si student në grupin e albanoligjisë pranë FF të Universitetit të Beogradit ku në vitin 1957 përfundon provimin profesional pranë këtij Universiteti. Pas diplomimit shërben për një vit shkollor (1953/54) si profesor në Gjimnazin

Real të Gjakovës ndërkaq në po të njejtin vit për tre muaj punoi si profesor i gjuhës shqipe pranë Gjimnazit të Mitrovicës së Titos, ku në mungesë të kuadrit, e transformojnë për profesor të Gjimnazit të Prishtinës ku dhe aty punoi deri në vitin 1962.

Profesor Ramiz Hoxha shkëlqeu edhe në profesionin e gazetarit dhe redaktorit e më pas edhe si kryeredaktor në revisten “Shëndeti” e cila asokohe botohej në Prishtinë. Vitet 1969-1972 profesorin Ramiz e gjejnë në krye të detyrës si redaktor i Entit të Teksteve dhe Mjeteve mësimore të KSA të Kosovës.

Në fushën e shkrimeve ishte shumë aktiv duke u bërë autorë i disa teksteve shkollore, lektyrave shkollore dhe abetareve si:

- Abetare për klasën e parë të shkollës fillore, zhvillimi veçmas i germave të shtypit dhe të dorës, ETEMM I KSAK, Prishtinë, 1966; Bt.II I përmirësuar -1967; Rb-1968, Botimi III 1970;
- Abetare –zhvillimi paralel i shkronjave të dorës dhe të shtypit, ETEMM I KSAK, Prishtinë, 1969, Rb-1972.

8. JUSUF SHUSHKA

Të shumtë janë intelektualët shqiptar të cilët një jetë të tërë ja kanë kushtuar ngritjes së arsimit shqip, e njëri ndër ta është edhe profesori i SHLP në Prishtinë, mësuesi dhe pedagogu Jusuf Shushka i lindur me 9 shkurt 1928 në Kraishtë të Lipjanit. Profesor Shushka rridhte nga një familje me ekonomi të vogël kryesisht në bujqësi dhe në shumë raste edhe e vobektë. Mësimet e para i ndoqi në vendlindje për të vazhduar pastaj në gjimnazin e Prizrenit në vitin 1946 e më pas edhe si student i Normales së Gjakovës. Sukseset e tij në studime u dalluan shumë herët sepse u vlerësua si njëri nga 29 maturantët që në afatin e parë të rregullt (të qershorit të vitit 1948) i’u shtrua të gjitha provimeve të pjekurisë, duke fituar maturën me sukses të përgjithshëm. Falë sukseseve të tij fitoi të drejtën që të përzgjedhet nga autoritetet mësimore, në mesin e 15 maturantëve të posadipomuar për studime në Beograd. Në vitin 1948 u regjistrua në degën e pedagogjisë pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beligradit. Pas përfundimit të studimeve punoi si mësues në fshatin Kraishtë të Komunës së Lipjanit ndërkaq në vitin 1952, emërohet mësimsdhënës i

Normales së Gjakovës dhe më vonë kur shkolla transferohet në Prishtinë, Jusufi kaloi atje dhe shërbeu gjer më 1960.

Jusuf Shushka punoi edhe si Kryeshef i Seksionit për Arsim e Kulturë të KK të Prishtinës, Kryetar i Dhomës së veprimtarive shoqërore, drejtor i Entit Krahinor për Përparimin e Arsimit, profesor i Akademis Pedagogjike (Lleshi, 1987).

Krahas këtyre angazhimeve profesor Shushka është edhe autorë i dy librave të leximit dhe i një abetareje si:

- Abetare për klasën e parë të shkollave fillore (në bashkëautorësi me Mehmet Gjevorin), Botuar nga Shtëpia Botuese “Mustafa Bakia”, Prishtinë, 1955.

Kjo abetare është ribotuar edhe gjashtë herë të tjera si: në vitin 1958, Rb- 1960, Rb- 1962, Rb- 1964 dhe Rb- 1965, (Nimonaj, 2014).

- Metodika e mësimit të lexim-shkrimit në klasën I të shkollës fillore, Mehmet Gjevori, Jusuf Shushka, “M. Bakija” 1955.

Profesor Shushka gjithashtu ka punuar edhe si përkthyes ku përkthimet e tij më mira konsiderohen:

- Dituri natyre dhe shoqërie për klasën II , 1965;
- Psikologjia pedagogjike, 1964 (Ramaj, 1985).

9. QAMIL BATALLI (1936-2009)

Një emër tjetër i njohur për kontributin e tij në fushën e arsimit dhe pedagogjisë arsimore padyshim se rradhitet edhe mësuesi, gazetari, shkrimtari për fëmijë dhe pedagogu Qamil Batalli i lindur në Prishtinë në vitin 1936. Shkollimin fillor dhe të mesëm e përfundoi në Prishtinë, për të vazhduar studimet universitare në degën e Pedagogjisë në Universitetin e Beogradit. Pas përfundimit të studimeve është angazhuar si mësues e pastaj edhe si arsimtarë në fshatrat Begracë, Kaçanik i Vjetër, Dedllar, Pleshinë dhe së fundi në Prishtinë ndërsa nga viti 1959 punoi gazetar e më vonë redaktor në Radio Prishtinë, në emisionet për fëmijë.

Dëshira për fjalën e shkruar ishte e vazhdueshme ku krijimet e para letrare i botoi më 1954 në gazetën “Rilindja” dhe revistën “Pionieri”. Shkrimtari Qamil Batalli falë kontributit

të tij krijues, mbetet poet dhe shkrimtar shumë i dashur për fëmijë, kryesisht në gjinin letrare prozë për fëmijë, e herë pas here dhe poezi (Hasani,2003).

Puna e tij krijuese është vlerësuar shumë, duke lënë gjurmë në historinë e arsimit në Kosovë të cilën e pasuron edhe përmes botimit të disa abetareve të botuara në mes periudhës 1982/2012 duke mundësuar që shkronjat shqipe përmes këtyre abetareve të mësojnë afro 30 gjenerata në vendin tonë.

Krijimtaria letrare e Qamil Batallit përbën një opus të gjërë krijues të mbushur me laramani temash dhe të trajtuara sipas botës e imagjinatës fëmijërore. Ndër më të pëlqyerat konsiderohen të jenë:

- “Buzëqeshjet”,
- “Agimet e kaltra”,
- “Tregime të zgjedhura”,
- “Mësuesja dallandyshe,
- “Ditari i kaltër” etj.

Ndërsa abetaret e Qamil Batallit janë:

- “Abetarja” viti 1982, Rb-1983, Rb-1984, Rb-1985, Rb-1986,
- “Abetarja” viti 1987, kjo abetare është ribotuar deri në vitin 2002,
- “Abetarja” viti 2003, ribotim deri në vitin 200

10. ISLAM KRASNIQI

Njëri ndër metodistët e leximit dhe shkrimit fillestar në Kosovë ishte mësuesi dhe pedagogu Islam Krasniqi i lindur në Drenicë me 15.XII.1942. Shkollimin fillestar e përfundoi në vendlindje ndërkaq studimet i përfundoi në Normalen e Prishtinës në vitin 1963 për të vazhduar pastaj në Fakultetin Filozofik, në Degën Pedagogji pranë Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1977 magjistroi në shkencat pedagogjike në Universitetin e Zagrebit ndërsa në vitin 1985, doktoroi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik.

Angazhimin e tij në mësimdhënie e filloi si mësues në shkollën fillore “Emin Duraku” në fshatin Arllat të Drenicës, ndërkaq nga viti 1967-1972 punoi edhe në regjione të tjera si mësimdhënës siq ishte Shkolla Normale në Ferizaj, Shkolla Normale në Prishtinë, pastaj në Gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, në Gjimnazin “Skenderbeu” në Glllogoc të Drenicës e gjetiu. Profesionin e profesorit universitar e filloi në vitin 1972, pranë Fakultetit Filozofik, në Departamentin e Pedagogjisë ku më vonë është angazhuar edhe si bashkëpunëtorë profesional i jashtëm në disa fakultete të tjera

Profesor Krasniqi gjatë jetës së tij profesionale ka kryer edhe shumë detyra të tjera me përgjegjësi shoqërore e shkencore brenda Universitetit të Prishtinës ku për një kohë të gjatë ishte anëtarë i Komisionit Vlerësues në Entin e Teksteve dhe Mjeteve mësimore të Kosovës. Pedagogu dhe intelektual i Islam Krasniqi ishte pjesëmarrës në shumë kumtesa e referate të dala nga konferenca e simposiume të ndryshme shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Krijimtaria profesionale e tij përfshinë rreth 60 punime profesionale e shkencore të botuara në gazeta dhe revista kulturore, shkencore dhe pedagogjike.

Krasniqi është dhe autor i shumë teksteve shkollore e universitare dhe monografive studimore si dhe bashkëautor i disa abetareve si:

- Abetare, Agim Deva, Islam Krasniqi, Dukagjini, 2008,
- Paraabetare, Agim Deva, Islam Krasniqi, Dukagjini, 2008,
- Fletore pune për mësimin e shkronjave dhe leximit e shkrimit sipas Abetarës, Agim Deva, Islam Krasniqi, Dukagjini, 2008,
- Libri i mësuesit, Ndihmës metodik për punën me abetare, Agim Deva, Islam Krasniqi, Dukagjini, 2008.

- Abetare e ndryshuar dhe plotësuar, Agim Deva, Islam Krasniqi, Dukagjini, 2009, 2010 dhe 2011.
- Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë, Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi-Tiranë dhe Dukagjini, Pejë, 2012.
- Abetare pune e përbashkët Shqipëri-Kosovë, Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi-Tiranë dhe Dukagjini- Pejë, 2012.
- Tekst i mësuesit, Ndhmës metodik për mësimin e gjuhës amtare në klasën e parë të shkollës fillore, Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi-Tiranë dhe Dukagjini, Pejë, 2012.
- Abetare e përbashkët Shqipëri, Kosovë (e plotësuar në frymën e sygjërimeve të mësuesve nga terreni), Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi,Tiranë dhe Dukagjini, Pejë, 2013.
- Abetare pune e përbashkët Shqipëri-Kosovë (e ribotuar me plotësime e ndryshime sipas sygjërimeve të mësuesve nga terreni), Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi-Tiranë dhe Dukagjini, Pejë, 2013.
- Tekst i mësuesit, Ndhmës metodik për mësimin e gjuhës amtare në klasën e parë të shkollës fillore (i ribotuar dhe me plotësime sipas sugjërimeve të mësuesve nga terreni), Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova, Pegi-Tiranë dhe Dukagjini, Pejë, 2013.

11. AGIM DEVA (1948 - 2009)

Karvanit të gjatë të intelektualëve kosovar të cilët i kanë kontribuar arsimit shqip në Kosovë padyshim që i bashkohet edhe shkrimtari, gjuhëtari dhe poeti për fëmijë Agim Deva i lindur në Beograd në vitin 1948. Profilin e tij arsimor e ka plotësuar duke përfunduar studimet në Fakultetin Filozofik, për të vazhduar pastaj studimet postdiplomike në katedren e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe në fund doktoratën në fushën e letërsisë për fëmijë. Viti 1973 e gjen në krye të detyrës si profesor ordiner në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës.

Punoi edhe si gazetar në “ Zërin e Rinisë”, e më vonë ishte kryeredaktor i parë i “ Gazetës së Pionerëve”. Pasioni i tij për letërsi u vërejt shumë heret madje që nga mosha 10

vjeçare kishte filluar shkrimet e para të cilat dita ditës shtoheshin dhe bëheshin më artistike. Poeti Agim Deva ishte themelues i OJQ-së “Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë” ku përmes kësaj shoqate organizoi rreth 730 aktivitete dhe manifestime të ndryshme letrare në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë Lindore dhe gjetiu. Krijimtaria letrare e Agim Deves përfshinë rreth 70 vëllime të shkruara të cilat ngërthejnë në vete proza, poezi, antologji, monografi, kritika, libra me karakter ambiental, libër leximi për klasën e IV fillore, libra ilustrativë për fëmijët e moshave parashkollore dhe recensione të ndryshme. Poeti Agim Deva falë fjalës së tij të shkruar në mënyrë artistike bëri që poezitë e tij të përkthehen edhe në gjuhë të ndryshme si në gjuhën angleze, arabe, turke, italiane, ruse, serbokroate e shumëgjuhë të tjera të cilat pasuronin letërsinë për fëmijë në botë.

Ndonëse gjatë gjithë këtij punimi kemi trajtuar intelektualët të cilët një pjesë të krijimtarisë së tyre e kanë ndarë edhe për botimin e abetareve shqipe, poeti Agim Deva edhe në këtë segment ka qenë shumë aktiv duke botuar abetaren me titull:

- Abetare, 2008. Botimin e lejoi Ministria e Arsimit , Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës. Shtëpia botuese Dukagjini, Prishtinë.

Kritika letrare poetin Agim Deva e ka vlerësuar si një krijues të palodhur në fushën e tij duke e nderuar me dhjetëra mirënjohje, pena të arta, falenderime dhe çmime të ndryshme.

12. MIMOZA ÇANO- GJOKUTAJ

Magjné e fjalës së një didakti si te Mimoza Gjokutaj rrallë mund të takosh tek dikush tjetër në letërsinë shqipe sepse ajo është vlerësuar si një pedagoge, mësuese dhe studiuese e veçantë në fushën e didaktikës.

Mimoza Çano- Gjokutaj, lindi 14.04.1955. Ka përfunduar shkollën e mesme pedagogjike në Tiranë për të vazhduar studimet e larta në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër ndërkaq studimet e doktoratës i përfundoi në vitin 1992 në Universitetin e Tiranës. Rrugëtimin e saj si mësuese fillimisht e bëri SHK “Dajç” në Lezhë, pastaj mësuese e gjuhës dhe letërsisë, në shkollat e mesme në Zall, Dajt dhe Tiranë. Në periudhën 1985-2005 u angazhua si punonjëse shkencore pranë Institutit të Studimeve Pedagogjike në Tiranë ndërsa përgjatë periudhës 2005-2007 u angazhua si drejtoresh e Qendrës Kombëtare të

Trajnimeve dhe Kualifikimit për Arsimin, gjithashtu në Tiranë. Aktualisht është pedagoge, në Departamentin e gjuhës pranë Universitetit të Tiranës.

Krijimtaria profesionale e Mimoza Gjokutaj është shumë dimensionale duke u bërë autore e shumë teksteve shkollore, universitare dhe monografive të shoqëruara me shumë artikuj në revistat shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Punën e saj profesionale prof. Mimoza e ka orientuar shumë edhe në problemet e të lexuarit dhe të shkruarit fillestar, për nxënësit e klasave të para, ku është bashkëautore e shume abetareve me vite me radhe si:

- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë: SHBLSH, 2001.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2004.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2006.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2007.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiran, Morava, 2008.
- Abetare mbarëkombëtare, M. Gjokutaj, Sh. Rrokaj, I. Krasniqi & S. Kumnova, Pegi & Dukagjini, 2012.

13. SHEZAI RROKAJ

Profesor Shezaj Rrokaj konsiderohet njëri prej gjuhëtarëve më në zë në Shqipëri si një figurë e ndritur në fushën e letërsisë shqipe. Lindi në fshatin Kocul, më 10.05.1957 në Vlorë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e përfundoi në drejtimin e Gjuhëve të Huaja në shkollën “Asim Vokshi” në vitin 1976. Ka vazhduar edukimin universitar në Francë nga viti, 1980-1983, në Faculté des lettres, Bordeaux III, nga viti 1983-1984 ka studiuar në Jusieu, Universiteti Paris VII. Studimet e doktoratures i ka përfunduar në Sorbonne, Paris III, në vitin 1992. Puna shkencore dhe akademike e profesor Rrokaj e ka bërë emrin e tij shumë të rëndësishëm në Universitetin e Tiranës për të ushtruar detyra nga më të ndryshmet si: dekan, zëvendëskan, lektor, përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Shqipe, rektor dhe

zëvendësrektor në këtë universitet. Aktualisht punon si pedagog në Universitetin e Tiranës duke drejtuar dhe udhëhequr shumë veprimtari shkencore dhe projekte në shumë universitete tjera të Evropës. Lista e artikujve në revista shkencore është tejet e gjatë, duke përfshirë revistat shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kontributi i tij në botimin e abetareve ka qenë shumë profesional duke sjellë bashkëpunime me disa gjuhëtarë shqiptar ku njëra nga botimet e tyre (Abetarja e vitit 2012) ishte fituese e konkursit mbarëkombëtarë në vigjilje të shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptarë.

- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, SHBLSH, 2001.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2004.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2006.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2007.
- Abetare shkronjë pas shkronje, Mimoza Gjokutaj & Shezai Rrokaj, Tiranë, Morava, 2008.
- Abetare mbarëkombëtare, M.Gjokutaj, Sh.Rrokaj, I. Krasniqi & S, Kumnova, Pegi & Dukagjini, 2012.

III. STRUKTURA E ABETAREVE

Gjatë rrugëtimit të abetareve shqipe në Kosovë, shohim se ato ndryshojnë për nga struktura e ndërtimit. Që nga viti 1945-2012, struktura e abetareve ka ndryshuar në shumë aspekte, që është përcaktuar nga faktorë të ndryshëm, metodik, didaktik, kulturor, moshor etj. Kemi abetaret me paraabetare dhe abetaret pa paraabetare. Në vijim do t'i shohim se si është strukturuar ora mësimore në paraabetare dhe si është strukturuar ora në abetaret që punohet drejtpërdrejt me nësimin e tingujve/shkronjave.

1. Paraabetarja pjesë e programit të abetares nga viti 1945-2012

Paraabetarja është periudha hyrëse që i ndihmon nxënësit e klasës së parë për t'ju bërë ballë sfidave të ndryshme që mund t'i hasin nga dita e parë e shkollës. Në sistemin tonë edukativo-arsimor në Kosovë, paraabetarja është pjesë e programit të Abetares. Paraabetarja është periudha që e lidhë fëmijën parashkollor me shkollën dhe ju ndihmon nxënësve nismëtar për përshtatjen e tyre me jetën shkollore. Përmbajtja e paraabetares realizohet përmes lojës dhe veprimtarive argëtuese, duke mos krijuar ndarje strikte të jetës parashkollore me jetën në shkollë. Me punën që bëhet në paraabetare, mësuesit marrin një pasqyrë për paranjohuritë e nxënësve, gjendjen socio-emocionale, shkallën e zhvillimit të tyre, vështirësitë eventuale. Ndërsa, nxënësve ju ofron mundësi në realizimin e disa objektivave të rëndësishme të cilat ju ndihmojnë në punën e mëtejshme me Abetare. Gjatë punës në këtë pjesë, synohet të fitohen disa shprehje të domosdoshme për fëmijët e kësaj moshe, të tilla si:

- Zhvillimi i të folurit,
 - Pasurimi i fjalorit,
 - Përmirësimi dhe saktësimi i strukturave gjuhësore folëse të shqipes,
 - Zhvillimi i disa aftësive motorike të domosdoshme për procesin e lexim-shkrimit etj.
- (Gjokutat et.al.2012).

Rolin dhe vlerën e paraabetares, në historinë e këtij libri e ka rritë edhe më shumë pamundësia e vijimit në retrospektivë të fëmijëve në edukimin parashkollorë. Duke marrë pasqysh se edukimi parashkollor në Kosovë, tradicionalisht është realizuar në familje, paraabetarja ka qenë ajo pjesë e librit të abetares e cila është munduar ta zbuste mungesën e institucioneve parashkollore apo edhe të klasave përgatitore.

Gjatë këtij studimi kemi gjetur se, abetaret e para në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore nuk kanë Paraabetares. Këto janë abetaret e para dhe mbesin të fundit në kronologjinë e abetareve në Kosovë që nuk e kanë paraabetares brenda trungut të tyre ose paraabetares si libër të veçantë. Ato janë abetarja e vitit 1945 që është abetare për fëmijë dhe abetarja e vitit 1946 dhe 1948, e që janë abetare për të rritur.

Këto tri abetare fillojnë menjëherë me pjesën ku përpunohen tingujt/shkronjat. Puna për mësimin e tingujve/shkronjave dhe leximin e shkrimit, pa këtë pjesë i bënë këto abetare të ndryshme të vështira edhe për fillestarët. Duhet ditur se edhe “Edukimi dhe arsimit parashkollor deri në vitin 1954 nuk ishin në kuadër të sistemit të arsimit sepse mendohej se institucionet e edukimit parashkollor kanë më tepër karakter social se sa arsimor” (Shatri, 2006). Andaj, këto abetare mund t’i cilësojmë abetare të vështira për hapat e parë të përshtatjes dhe punën e mëtutjeshme me këta nxënës. Duke parë vlerën e edukimit parashkollor “më 25-26 maj 1948”, në Beograd, Komiteti Federativ i Arsimit dhe Shkencës mbajti një këshillim në të cilin, ndër të tjera tha: Duke marrë pasqysh rëndësinë e madhe të edukatës parashkollore, posaçërisht për realizimin e planit pesëvjeçar, si dhe faktin se vetëm 2% e fëmijëve janë përfshirë në institucionet parashkollore, shtohet nevoja e ngutshme për hapjen e planifikuar e masive të institucioneve parashkollore” (Kojçini, 2006). Këtë përfshirje kaq të vogël të fëmijëve në institucione parashkollore duke e lidhur dhe më format dhe metodat me të cilat janë hartuar abetaret si: formën komplekse dhe metodën globale të abetarja e vitit 1945, po ashtu formën grupore dhe metodën rrokjesor-silabike të abetarja e vitit 1946, mendojmë se këto abetare ka pasë vështirësi në përvetësimin e tingujve dhe shkronjave sepse ata janë në kontakt me të gjitha shkronjat ose i mësojnë në mënyrë grupore disa shkronja. Kurse të abetarja e vitit 1948, e hartuar me formën monografike e cila herë-herë shoqërohet dhe me formën grupore dhe metodat analitiko-sintetike, kanë një lehtësim në krahasim me dy abetaret paraprake sa i përket përvetësimin të tingujve/shkronjave dhe leximit e shkrimit. Sepse nxënësit i kanë mësuar

tingujt/shkronjat me formën monografike dhe në fillim vetëm shenjën grafike të madhe të shtypit, pastaj me vonë dy shenjat grafike të shtypit. Në disa raste me formën grupor nga dy shenja grafike të vogla të shtypit për shkronjat e mësuara paraprakisht. Ose dhe dy shenjat e shtypit në një orë dhe dy shenjat grafike të shkrimit në orën tjetër.

Pra, kjo përfshirje vetëm prej 2% e fëmijëve në institucione parashkollore, tregon se këto libra kanë pasur vështirësi për një plejadë fëmijësh që posa kanë dalë nga lufta. Por, një përfshirje të ulët kemi edhe në vitet në vijim të paraqitur më poshtë.

Tabela 3: Përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore

Nr.	Viti	Numri i fëmijëve
1	1955	70
2	1966	1.370
3	1971	2.2257
4	1981	6.023
5	1986	10.051
6	1996	8.076
7	2000	4.851
8	2001	5.224

Burimi: (Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës, 2000, f. 72)

Pas luftës së fundit në Kosovë, disa vite më vonë, pikërisht në vitin 2006, nga Kuvendi i Kosovës u miratua Ligji për Edukimin Parashkollor, Nr. 02/L52 i cili është edhe ligji i parë i edukimit parashkollor në Kosovën e pas viteve 1999. Në vitin 2011, me vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, miratohet Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KK). Edukimi parashkollor sipas Kornizës Kurrikulare e përfshin moshën 0-5 vjeç, ndërsa edukimi parafillor përfshin moshën 5-6 vjeç. Mirëpo, gjatë këtij hulumtimi kronologjik, paraabetaresh si periudhë përgatitore e gjejmë në këtë formë:

- Paraabetareshja, pjesë e Abetareshes,
- Paraabetareshja, libër i veçantë dhe

- Paraabetarja, pjesë e librit të Abetares dhe librit Abetare Pune.

Shikuar historikisht, paraabetarja ka luajtur një rol të veçantë në krijimin e gatishmërisë së fëmijëve për klasën e parë. Në të kaluarën, edukimi parashkollor, si periudhë e rëndësishme për përgatitjen e fëmijëve për klasë të parë, ka qenë e lidhur ngushtë me shumë faktorë, si: politik, ekonomik, me nivelin edukativo-arsimor të popullates, punësimi dhe arsimimi i gruas, etj.

2. Paraabetarja pjesë e Abetares

Një pjesë e abetareve shqipe në Kosovë e kanë brenda trungut të tyre paraabetaren si pjesë të parë të librit. Ato janë abetarja e vitit 1947, 1951, 1955, 1966, 1972, 1977 dhe 1982. Por, përmbajta e paraabetares, vëllimi dhe hapësira kohore e kësaj periudhe, nuk është e njejtë tek të gjitha abetaret. Në vijim do ta shohim më hollësisht se cili ishte qëllimi i kësaj periudhe në këto abetare.

Paraabetarja te abetarja me titull “ABETARE për klasën e parë të shkollave fillore” e vitit 1947, është pjesa hyrëse për në abetaren e mirëfilltë. Puna me këtë paraabetare përfshinë gjashtë faqe. Njësitë mësimore në paraabetare janë këto: “Drejt shkollës”, “Dita ime”, “Në shtëpi”, “Në fshat”, “Në kopësht” dhe “Në shkollë”. Këto përmbajtje janë vizatime që kanë për qëllim zhvillimin e shkathtësive për të folur, kërkojnë bashkëbisedim që i ndihmon mësuesit ta njoh fjalorin e fëmijëve, shqiptimin e tingujve dhe vetë nxënësit gradualisht ambientohen me shkollën. Abetarja është hartuar sipas formës komplekse dhe metodës globale të mësimit të lexim/shkrimit, por mësohen vetëm shenjat grafike të shtypit. Në këtë paraabetare nuk kemi elemente të veçanta të shkronjave, si vija formash e pozitash të ndryshme. Nxënësit ushtrohen për të shkruar duke i vizatuar objektet e mjediseve të ndryshme që gjenden në abetare, brenda të cilave ka elemente të shkronjave. Një shembull i punës se nxënësve për ushtrimin e dorës dhe muskujve të vegjël për të shkruar, me ndihmën e vizatimeve të caktuara është dhënë me poshtë. shih. figurën nr. 1.



Figura 1: Elementet e shkronjave, brenda objekteve të shtëpisë në paraabetare.

Paraabetarja në “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” e vitit 1951, ka njëmbëdhjetë faqe. Kjo pjesë dukshëm është më e gjatë se ajo e abetares së vitit 1947. Njësitë mësimore të kësaj pjese janë: “Loja dhe lodrat”, “Në shtëpi”, “Drejt shkollës”, “Në klasë”, “Dhoma dhe orientitë”, “Pemët dhe vjelja e tyre”, “Kafshët shtëpiake”, “Puna dhe veglat e punës”, “Mjetet e transportit”, vizatime skematike dhe elementet e shkronjave. Gjatë këtyre orëve nxënësit zhvillojnë shkathtësitë për të folur, ambientohen me shkollën, shokët/shoqet dhe mësuesën. Paraabetarja ju ofron nxënësve vazhdimisht mundësi ta përgatisin dorën për të shkruar, përmes vizatimeve skematike, por autorët në fund të periudhës japin elementet e shkronjave të dorës. Puna me elementet e shkronjave të dorës është bërë sepse nxënësit në këtë abetare do t’i mësojnë paralel shkronjat e shtypit dhe të dorës. Autorët bëjnë përpjekje t’i ndihmojnë nxënësit përmes këtyre ushtrimeve për tejkalimin e vështirësive që mund të kenë gjatë të shkruarit të shkronjave të shkrimit, duke pasur parasysh se shkrimi ka elemente të bukurshkrimit. Për elementet e shkronjave, shiko figurën nr. 2.



Figura 2: Elementet e shkronjave të dorës në paraabetare.

Paraabetarja në abetaren e vitit 1955, me titull "ABETARE për klasën e parë të shkollave fillore", ka një paraabetare që përfshinë trembëdhjetë faqe. Kjo paraabetare ka këto njësi mësimore si: "Dita ime", "Drejt shkollës", "Në oborrin e shkollës", "Në klasë", "Rregullat e sjelljes", "Në shtëpi", "Loja dhe lodrat", "Kafshët shtepiace", "Pemët", "Veglat e punës", "Mjetet e transportit", "Fëmijët punojnë", "Elementet e shkronjave". Faqja e fundit e kësaj periudhe ka elemente të shkronjave të shtypit dhe të shkrimit të shoqëruara me elemente të bukurshkrimit. Në Planin dhe programin mësimor për lëndët e mësimin të shkollave tetëvjeçare shqipe, të botuar në Kosovë në vitin 1954, jepen qëllimet e mësimin të bukurshkrimit si: a) nxënësit t'ushtrohen n'uniformitetin, bukurinë dhe lexueshmërinë e shkrimit të dorës pjerrtazi, b) që të zhvillojë te nxënësit kuptimin dhe ndjenjën e përpikënisë, rregullit dhe të të bukurit. (Plani dhe program, mësimor për lëndët e mësimin të shkollave tetëvjeçare shqipe, 1954). Kështu që, nxënësit në paraabetare përgatiten për të realizuar qëllimin e paraparë në Planin dhe Programin mësimor.

Paraabetarja në Abetaren e vitit 1966 (zhvillimi veçmas i germave të shtypit e të shkrimit) dhe Abetarja e vitit 1967 (zhvillimi paralel i germave të shtypit e të shkrimit). Janë abetaret e të njëjtit autor dhe kanë të njëjtë paraabetare. Dallimi ekziston se te abetarja e vitit 1966, paraabetarja përfshin 13 faqe, kurse te abetarja e vitit 1967 paraabetarja përfshin 14 faqe. Njësitë mësimore te këto paraabetare janë: "Fëmijët luajnë", "Dita ime", "Drejt shkollës", "Në klasë", "Pemët", "Perimet", "Profesionet e ndryshme", "Shpezët", "Kafshët shtepiace", "Kafshët e egra", "Mjetet e transportit", Përralla "Dhia e kecat" dhe sikurse te paraabetarja e vitit 1955 dhe të këto dy paraabetare kanë elementet e shkronjave të shtypit dhe të shkrimit.

Abetarja e vitit 1967, që kishte një faqe më shumë, i ka kushtuar rëndësi punëdores, si prerjes me gërshër, modelim me shkopinjë, me fleta me ngjitës dhe punës me gjethe. Përmbajtja e punës edukativo-arsimore te paraabetarja kryesisht i kushtohet përshtatjes të nxënësve me shkollën dhe klasën, njohjen e mësuesit me paranjohuritë e nxënësve, përgatitjen e tyre për të shkruar, mbajtjen e lapsit dhe fletores, zhvillimin e aftësive komunikuese, mësimi i disa shprehive për jetë dhe mirësjelljen, pasurimi i fjalorit etj. Te këto dy paraabetare është karakteristike se nxënësit pothuaj se në fund të çdo ore kanë detyrë të vizatojnë vizatime skematike që kanë kuptim dhe te nxënësit e nxitë më shumë

dëshirën për t'i bërë dhe kështu ushtrohen muskujt e vegjël të dorës për të shkruar. Për shembujt me vizatime skematike, shih figurën numër 3 dhe 4.




Figura 3: Vizatimi i mjeteve të higjienës.




Figura 4: Vizatimi i gjësendeve të ndryshme.

Paraabetarja në Abetaren e vitit 1972, kjo abetare është ribotuar në bazë të lejës së Pleqësisë së arsimit të Krahinës socialiste të Kosovës dhe sipas botimit të Shtëpisë botuese të Librit shkollor, Tiranë, 1971, me ndryshime fare të vogla. (Alaj, 1972 fq. 6). Paraabetarja e kësaj abetare, përfshinë 20 faqe. Janë paraqitur materiale shumë të bukura, siç janë figurat e ndryshme, skicat dhe vizatimet, fjalë me një, dy e tri rrokje, pastaj figura që kanë për qëllim shqiptimin dhe dëgjimin e tingujve, për zhvillimin e ligjëratës dhe për pasurimin e fjalorit të nxënësve. Është dhënë një përrallë e treguar me anë të figurave, me të cilën mësuesi/ja mund të bëjë një punë sistematike për zhvillimin e ligjëratës, për pasurimin e fjalorit për shqiptimin e plotë të fjalëve dhe sipas normave letrare. Pastaj gjenden figura shumë të përshtatshme për krijimin e fjalive të thjeshta dhe të zgjeruara, figura për analizën e fjalëve. Gjatë bisedës për bletën, aeroplanin, sharren, etj., me ndihmën e mësuesit mund

të imitojnë shumë mirë tingujt përkatës, si: u, z, zh, sh, ë, etj. Kjo është paraabetarja e parë që mirret konkretisht me nocionin për fjalinë, fjalën, rrokjen dhe tingullin/shkronjën.

Paraabetarja në abetaren e vitit 1977, në Planin dhe Programin unik të punës arsimore-educative në shkollën fillore të botuar në vitin 1977, përgatitja për lexim-shkrim, kalon nëpër tri periudha, periudha përgatitore-kjo periudhë zgjatë më së shumti një muaj dhe përfshinë: etapën adaptive, kontrolluese dhe etapën konstruktive didaktiko-metodike. Për etapën adaptive janë parapa tri ditë. Pastaj është etapa kontrolluese, ku shihet përvoja e nxënësve në lexim dhe shkrim, shprehitë jetësore, punuese, aftësitë psikofizike (të folurit, gjendja e organeve të të folurit, gjendja e shqisave, kujtesa, të mënduarit, aftësitë motorike etj). Etapa konstruktive, ushtrimet për shkrim me gjësende të ndryshme, formimi i koncepteve: gjallesë, objekt, fjalë dhe formimi i koncepteve për fjalinë, fjalën, tingullin, etj. Ndërsa më hollësisht, konkretizimi i punës përgatitore nëpër këto tri etapa jepet në planin orientues të gjuhës shqipe, të botuar në gazetën arsimore “Shkëndija” e vitit 1977, ku periudha përgatitore përshkruhet kështu: fillon me ditën e parë të shkollës-nxënësit priten në shkollë me program rasti të organizuar mirë. Dita e dytë, nxënësit bëjnë shëtitje të shkurtër në mjedisin e shkollës. Dita e tretë, nxënësit i njohim me objektin e shkollës dhe kështu përfundon etapa përshtatëse (adaptive). Pas tri ditëve fillon puna me tekstin e abetares, pra etapën kontrolluese me: “Moni, Nora me bubin shkojnë në shkollë” (ilustrimi i kopertines së abetares). “Tito dhe Pionerët”, “Gëzuar, gëzuar, po shkojmë në shkollë”, “Prej mëngjesit deri në shkollë”, “Klasa jonë”. “Kësulëkuqja” dhe në fund janë pesë tregime të ndryshme ilustrative. Nga këtu fillon etapa konstruktive didaktiko-metodike si: ushtrime shkrimi, ushtrime për emrin e foljen. Analizë e fjalëve të njohura. Imitimi i tingujve të ndryshëm. Ushtrime për vrojtimin e formave dhe të pozitave të objekteve. Formimi i koncepteve: gjallesë, send, figurë, fjalë. Autori ka shkuar nga e përgjithshmja te e veçanta, duke përdorur analizën gjatë formimit të këtyre nocioneve. Abetarja nuk ka elemente të shkronjave në periudhën përgatitore brenda faqeve në tekst, për të cilën kanë shkruar edhe gazetatat e kohës, artikuj që e vlerësojnë lart këtë abetare. “Fjala është për herrjen në rend të parë të elementeve të shkronjave me të cilat ngarkoheshin nxënësit pa nevojë. Në vend të tyre, efekte shumë më të larta mund të mbërrinim përmes vizatimeve, modelimeve e konstruktiveve të figurave të ndryshme me përmbajtje nga realiteti i afërt jetësor e shoqëror i fëmijëve” (Krasniqi, 1977 fq.11).

Paraabetarja në abetaren e vitit 1982, Kjo abetare “sipas vlerësimit të ekspertëve është një cilësi e re në krahasim me tekstet e njëjta të mëparshme” (Berisha & Iljazi 1982). Kjo paraabetare përfshin hapësirën prej 17 faqeve. Paraabetarja përmban këto njësi mësimore: ditë solemniteti dhe njohje, shoqërorizimi i nxënësve, bisedë e lirë rreth faqes së parë të abetares, ditë loje dhe bisedë, ditë kënge dhe bisede, bisedë për fotografinë e parë të abetares: shokun Tito, “Fëmijët dhe shkolla”, “Njohja me orenditë e klasës dhe vizatimi skematik i tyre”, “Mëngjesi i nxënësit”, ushtrime me muskujt e duarve, puna e nxënësve në kopësht, koncepti elementar (pa përkufizim) për fjalinë, fjalitë si pjesë përbërëse të mendimit, veçimi dhe dallimi i termave fjali, fjalë, veçimi i rrokjes, ideja e rrokjes, termi rrokje, ushtrime të të folurit me anë të përrallzës “Korbi e dhelpra”, ndërtimi i mendimit (sinteza e fjalës, fjalisë), ushtrime rreth ndarjes së fjalëve në rrokje, shqiptimi i drejtë i fjalëve dhe ndarja e tyre në rrokje e tinguj, ushtrime të të folurit me anë të përrallës “Dhia e kecat” (Batalli, 1982). Kjo abetare është botuar dhe një herë me disa ndryshime në vitin 1987, por ndryshimet nuk e përfshijnë paraabetaren, për të vazhduar botimi i saj deri në vitin 2000 (Nimonaj, 2014).

3. Paraabetarja, libër i veçantë

Nga paraabetarja e vitit 1947, (duke e perjashtuar abetaren e vitit 1948 që nuk kishte paraabetare), deri te abetarja e vitit 2003, të gjitha abetaret e kishin paraabetaren si pjesë të tyre. Prandaj, nga vitit 2003 fillon një epokë e re, ku kemi paraabetaren si libër të veçantë.

Qamil Batalli është autori i parë në Kosovë që e hartoi këtë paraabetare si libër të veçantë, që ju ndihmon nxënësit për sfidat në abetare. Paraabetarja e vitit 2003, ka këto njësi mësimore: “Nxënësit flasin për veten dhe të tjerët”, “Familja ime-punët dhe përgjegjësitë”, “Emërtojnë objekte, gjësende dhe frymor”, “Mëngjesi i nxënësit”, “Në klasë”, “Marushi dhe lulet e Arjetës”, “Pikat bëhen vijë”, “Për dhëmbë të bukur”, “Kafshët shtëpiake”, “Kafshët e malit”, “Me se udhëton njeriu”, “Dhia e kecat”, “Dallo ngjyrat”, “Për çfarë pune përdoren këto mjete”, “Vizato sipas modelit”, “Dhelpra dhe korbi, ç’bëjnë?” (Kur kemi një mendim, atë e quajmë fjali), “Ç’farë pune bëjnë fëmijët?” (çdo punë që bëjnë fëmijët e themi me një fjali), “Pjesët e fjalës” (fjala “top” ka një rrokje), “Të dallojmë

rrokjet”, “Vizato dhe ngjyros” (sa rrokje kanë këto fjalë, sa tinguj ka fjala topi), “Gjyshi e rrepa”, “Dallo tingujt” (gjej fjalë me tingujt l, ll, dhe dh), “Shtëpia vizatohet pjesë-pjesë”, “dallo tingujt r dhe rr”, “Dora mbahet lirshëm”, “Profesionet”, “Dy dhitë”, “Tingujt q dhe ç” (gjej fjalë të tjera me tingullin q dhe ç dhe ushtrro shqiptimin e tyre), “Pemët janë të shijshme, shqipto si duhet” (gjej fjalë të tjera me tingujt gj dhe xh, ushtrro shqiptimin e tyre), “Dora ushtrohet ngadalë”, “Kush i shpëtoi zogjët?”, “Ngjyra është e bukur”, “Emërto figurat”, “Njeriu ka krijuar çudira”, “Ne jemi shokë të mirë”. Sipas Planit dhe programit mësimor të hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë, 2003, për organizimin e përmbajtjeve programore nga Gjuha shqipe janë paraparë 259 orë në vit, 7 orë në javë. Nxënësit do t’i fitojnë këtë shkathtësi: të dëgjuarit dhe të folurit-70 orë, të lexuarit-85 orë, të shkruarit-94 orë, (në dispozicion-10 orë), (MASHT, 2003).

Paraabetarja e vitit 2008, ka pothuajse të njejtën mënyrë të përgatitjes së nxënësve në paraabetare sikurse te abetarja e vitit 2003. Kjo paraabetare fillon me: “Të njoftohemi, Unë quhem”, “Në oborrin e shkollës”, “Në klasë dhe në shkollë” (njofton nxënësit me klasen, shkollën, mjetet mësimore dhe hapësirat tjera etj), “Si të ulemi drejt gjatë mësimit” (Bisedë me nxënësit për mënyrën e drejtë si duhet ulur në bankë gjatë shkrimit dhe leximit), “Formojmë fjali”, “Ç’punë bëjmë brenda ditës?” (mëngjesi, mesdita, pasdita dhe mbrëmja), “Fëmijët e vitit” (diskutojnë për katër stinët), “Formojnë kuptimin për poziten në hapësirë”, bisedojnë rreth përrallëzës “Dhelpira dhe lejleku” dhe “Miu dhe luani”, “Formojnë kuptimin për rrokjen”, (formojnë dhe lexojnë fjalët, bashkojnë rrokjet dhe shqiptojnë drejt tingujt), “Dallojnë tingujt” (lexoni së bashku dhe shqiptoni drejt tingujt e shkronjave me ngjyrë të kuqe), “Ushtrojnë dorën dhe përgatiten për shkrim” (trego si duhet t’i mbajmë drejt mjetet e punës kur shkruajmë dhe kur lexojmë), “Ndihmoni lepurin të mbledhë të gjitha karrotat” (duke bërë rrugën sa më të shkurtër), “Të formojmë një kokë me perimet e kopshtit, ngjyros gjësendet e dhomës, vizatoni dhe ngjyrosin” (plotësoni vizatimin me elemente dhe objekte që mungojnë dhe më pas ngjyrosni), puna vazhdon me përrallëzën “Gjinkalla dhe milingona”, nxënësit kanë me e ngjyros vizatimin dhe me diskutu rreth ilustrimeve, rregullo këtë dhomë (vendosi gjërat e shtëpisë në pozita të ndryshme, si në të majtë, në të djathtë, mbi, në, para, pas), ushtrime me gërshërë (me pre dhe ngjitë), ta ndërtojmë një fshat (si dëshironi të rregullohet fshati juaj?), bëjnë elemente të shkronjave duke i lidhur me një

kuptim. Në shembullim poshtë kemi punën që kanë bërë nxënësit elemente të shkronjave, figura numër 5.




Figura 5: Ushtrime me elementet e shkronjave të paraabëtarja e vitit 2008.

4. Paraabëtarja, pjesë e librit të Abetares dhe librit Abetare Pune

Periodha e paraabetares të nxënësit e klasës së parë që mësojnë me abetaren mbarëkombëtare (Shqipëri-Kosovë), zë vend: në tekstin e Abetares-pjesa e parë dhe në Abetaren e Punës-pjesa e parë.

Paraabëtarja në tekstin e Abetares, përfshinë 12 faqet e para. Paraabëtarja fillon me mjetet e shkollës dhe lodrat e fëmijëve, “Drejt shkollës”, “Në shtëpi”, “Në qytet”, “Në mëngjes”, “Dita ime”, “Në fshat”, “Luaj”, “Kalendari i ditëlindjeve”, “Në garë”, përrallë “Mamadhia, Kecat dhe Ujku” dhe “Abetare”.

Gjatë punës me këtë tekst, nxënësit kryjnë veprime të ndryshme si: “Vizatim, imitim të zhurmave të natyrës dhe tingujve të ndryshëm, lojë në role, dramatizime **përrallash** dhe tregimesh të ndryshme, lojëra me pazëlla, me letra dhe shkronja, këngë të ndryshme, biseda për tema të ndryshme që lidhen me botën dhe aktivitetin e tyre jetësor, duke pasuruar fjalorin me fjalë dhe shprehje që i përkasin kësaj teme, gjëegjëza, vjersha, pyetje rrufe etj” (Gjokutaj, et al, 2012). Strukturë e faqes së Paraabetares në Abetare, ka për qëllim zhvillimin

e të folurit dhe pasurimin e fjalorit (ilustrimi në foto) njohja e tingujve/shkronjave, përmes mbishkrimit “Në shtëpi”, elemente shkrimi, vija vertikale, horizontale e të lakuara (që gjenden në çatinë dhe rrethojat e shtëpisë) dhe përmbajtja (fabula). Strukturën e kësaj faqeje në paraabetares, pjesë e abetares shikoje më poshtë në figurën numër 6.



Figura 6: Paraqitet struktura e Paraabetares në librin e Abetares.

Paraabetarja në Abetaren e Punës zë vend në tetëmbëdhjetë faqet e para të këtij libri. “Përmes temave të paraqitura në këto faqe, nxënësit artikulojnë saktë tingujt e shqipes, shkruajnë shkronjat e mëdha për çdo tingull, zhvillojnë të folurit për tema të caktuara, lexojnë fjalë globale të shoqëruara me foto përkatëse, plotësojnë në to shkronjën që mungon dhe vizatojnë apo ngjyrosin figura të ndryshme” (Gjokutaj, et al, 2012). Për periudhën përgatitore, program i planifikuar për Shqipëri merr rreth 32 orë mësimore 4 javë X 8 orë = 32 orë; në Kosovë 28 orë mësimore 4 javë x 7 = 28 orë.

Struktura e paraabetares te libri Abetarja e Punës, fillon me alfabetin, paraqitjen e tingullit, paraqitjen e shkronjës. Leximi dhe shkrimi i fjalëve globale, Shkronja e madhe e shtypit, elementet e shkronjave, elemente vizatimi dhe ngjyrosje. Në këtë mënyrë nxënësit njoftohen me të gjitha shkronjat e mëdha të shtypit. Për të gjitha këto aktivitete, shiko më poshtë figurën numër 7.




Figura 7: Struktura e një faqe të paraabetares në librin e Abetare Punës.

Paraabetarja e ka pasë dhe e ka rolin mbështetës për nxënësit fillestarë. Por, nëse ia shtojmë dhe faktin se në të kaluarë nuk ka pasë përfshirje të të gjithë fëmijëve në institucione parashkollore dhe se numri i këtyre institucioneve ka qenë fare i vogël dhe sot kemi akoma fëmijë që nuk janë pjesë e klasave përgatitore. Duke u mbështetur në faktin se, në shkollat tona në Kosovë, qëndrimi i fëmijëve nuk është tërë ditë, por disa orësh. Nxënësit në klasën e parë i kanë kryesisht 4 orë mësimore me nga 40 minuta, që nënkupton se këta minuta janë kohë pune e mësimi, që për fëmijën 6 vjeçarë është një vështirësi në vetvete.

Historikisht Paraabetarja ka ndryshuar në disa aspekte, si nga: kohëzgjatja, qëllimi, vëllimi, konkretizimi, aktivitetet, detyrat, ushtrimet për forcimin e muskujve. Si është lidhur përmbajtja e paraabetares me rendin e përpunimit të lexim/shkrimit, format dhe metodat e mësimi të tingullit/shkronjës në abetare etj.

Paraabetaret përgatitjen e fëmijëve për shkrim e kanë realizuar në mënyra të ndryshme. Një nga format e kësaj përgatitje ishte dhe puna me elemente të shkronjave. Abetarja e vitit 1951 ka elemente të shkronjave të shkrimit. Nga viti 1955 deri te viti 1967, abetarët kanë faqe të veçanta që ju kushtojnë rëndësi elementeve të shkronjave të shtypit dhe të shkrimit.

Duke filluar nga abetarja e vitit 1972 e deri te abetarja mbarëkombëtare, nxënësit, elementet e shkronjave i kanë në kuadër të vizatimeve, jo të veçuara si të tilla.

Njohja e nocionit fjali, fjalë, rrokje dhe tingull e gjejmë te abetarja e vitit 1972 e cila është e para që e ka trajtuar këtë çështje të njohjes dhe kanë vazhduar abetaret tjera deri te abetarja e fundit mbarëkombëtare.

Parabetarja e vitit 2003, 2008 dhe 2012, i kushton rëndësi të veçantë shqiptimit të tingujve, kryesisht atyre që vështirë shqiptohen nga kjo grupmoshë e fëmijëve, si dhe tingujve “q dhe ç” që në gjuhën shqipe janë më problem. Këto janë abetaret që periudhës së paraabetares i kushtojnë më shumë kohë dhe e begatojnë me aktivitete të ndryshme.

Kohëzgjatja e punës në paraabetares ndryshon, fillojnë me 6 faqe dhe ky numër gjithnjë shkon duke u rritur. Më vonë paraqitet paraabetarja si libër i veçantë dhe paraabetarja e shtirë në dy libra te Abetarja dhe libri Abetare Pune.

Paraabetarja historikisht në sistemin tonë edukativo-arsimor, ka kryer një funksion të rëndësishëm, karshi rrethanave politike, ekonomike e shoqërore nëpër të cilat ka kaluar populli ynë gjatë këtyre viteve.

5. Abetarja e mirëfilltë dhe struktura e orës mësimore

Abetarja është libri i parë shkollor që synon të formoj shkathtësi për të folur, lexuar dhe shkruar gjuhën shqipe në nivelin e përshtatshëm për moshën e nxënësit të klasës së parë. Abetarja e mirëfilltë është pjesa e dytë dhe më e rëndësishmja, që lidhet me përvetësimin e teknikës së lexim-shkrimit. Gjatë analizës së punës me abetaret shqipe në Kosovë, vijmë në përfundim se secila nga abetaret e trajtuara nga ana jonë, posedojnë një strukturë të orës mësimore përmes së cilës mund t’i qaset realizimit të rezultateve të planifikuara për secilën shkathtësi të nxënësit.

Abetarja e vitit 1945, abetarja e parë e quajtur “Këndimi im i parë”, posedon një strukturë të thjeshtë të orës mësimore, për nga ndërtimi dhe është e përbërë nga dy pjesë.

Hapi i parë, ora fillon me motivimin e nxënësve, ku ata mund të flasin për situatën e figurës së dhënë në libër, të bashkëbisedojnë për ato që shohin dhe ndjejnë. Hapi i dytë, vazhdohet me të lexuarit global vetëm me shkronja të mëdha të shtypit e cila është planifikuar deri tek faqja 25 sepse nga faqja 26, nxënësit lexojnë globalisht edhe me shkronja të vogla të shtypit. Kjo orë e përbërë vetëm nga dy hapa, në aspektin pedagogjik dhe didaktik të strukturimit të orës mësimore paraqet vështirësi për nxënësit e asaj kohe.

Abetarja e vitit 1946, Mësimi me këtë abetare për të rritur është planifikuar përmes katër hapave. Hapi i parë, fillimisht me njohjen e tre tingujve/shkronjave. Hapi i dytë, ku përmes këtyre tingujve/shkronjave krijohen rrokjet, hapi i tretë, me këta tinguj shkronja krijohen fjalë dhe hapi i katërt, ku me këto fjalë krijon fjali. Në orën e dytë me të njejtën strukturë të orës mësohen shenjat grafike të vogla të shtypit për këta tre tinguj/shkronjë të mësuar një orë më parë. Përmes këtyre planifikimeve, nxënësit fitojnë shkathtësinë e të lexuarit sintetik dhe të shkruarit me shkronja të mëdha dhe të vogla të shtypit shih fig. nr.8.




Figura 8: Mësimi i lexim shkrimit me metodën sintetike.

Abetarja e vitit 1947, e cila pothuajse ka pasur strukturë të njejtë sikurse abetarja e vitit 1945. Ora mësimore në abetare kishte këtë strukturë; hapi i parë, nxënësit bisedojnë për ilustrimin në abetare, hapi i dytë, nxënësit mësojnë të lexojnë globalisht deri në faqe 50 vetëm me tingujt/shkronjat e mëdha të shtypit, nga faqja 51 e tutje dhe me shkronjat e vogla të shtypit. Në këtë abetare nxënësit fitojnë këto shprehi: të lexuarit global, të folurit, të zhvilluarit e imagjinatës.

Abetarja e vitit 1948 dhe abetarja e vitit 1951, e kanë të njëjtë strukturën e orës mësimore, ora përbëhet nga tre hapa: hapi i parë, motivimi me bised që në vete ka fjalë që përmbajnë tingullin dhe shkronjën e cila do të përpunohet dhe njohja e nxënësve me tingullin dhe shkronjën e veçuar me katër shenjat grafike të saj. Hapi i dytë, nxënësit lexojnë fjalë, fjali dhe tekste me shkronja të shtypit dhe hapi i tretë, përfshinë punën me shenjat grafike të dorës. Në aspektin pedagogjik, ora mbështetet sado pak në parimin e gradualitetit.

Abetarja e vitit 1955, në këtë abetare, një tingull/shkronjë mësohet për dy orë mësimore kurse orët ndryshojnë për nga struktura e tyre. Ora e parë ka këtë struktur të përbërë nga dy hapa: hapi i I, motivimi ka të bëjë me bisedën e asaj se çka nxënësit shohin të vizatuar, njohjen e shkronjës së madhe të shtypit, hapi i II, nxënësit lexojnë fjalë, fjali me shkronjat e mësuara. Ndërsa ora e dytë, kalon nëpër tre hapa: hapi i I, motivues dhe ka për qëllim të zhvilloj aftësitë për të folur, hapi i II, njohja me tingullin/shkronjën me katër shenjat grafike dhe hapi i tretë, të lexuarit dhe shkruarit me shkronja të shkrimit. Për konkretizimin e orës së dytë, shih figurën numër 9.



Fig.9. Konkretizimi se si mësohen leximi dhe shkrimi.

Abetarja e vitit 1966, sjellë të tjera risi në planifikimin mësimor sepse në të, veçmas mësohen shkronjat e shtypit nga ato të shkrimit dhe si rezultat i kësaj edhe struktura e orës mësimore sjell ndryshime të reja.

Ora mësimore për mësimin e shkronjave të shtypit ka një strukturë të përbërë nga tre hapa. Në hapin e I, nxënësit flasin, krijojnë një ngjarje me figurat në libër dhe njohin dy shenjat grafike të shkronjës si dhe lexojnë nga një fjalë normale. Në hapin e II, nxënësit lexojnë tekst me shkronjat e shtypit ndërkaq në hapin e III, shkruajnë shkronjën që mungon në fjalëkryq, luajnë dhe ushtrojnë. Në këtë abetare qëndron e organizuar mirë edhe struktura e orës mësimore në të cilën përpunohen shenjat grafike të dorës sipas modelit: Hapi i I, njohja e shenjave grafike të dorës dhe përsëritja e shenjave grafike të shtypit. Hapi i II, të lexuarit dhe të shkruarit e fjalëve, fjalive dhe teksteve me shkronja të shkrimit. Hapi i III, për dallim nga të gjitha abetaret para saj ka të bëjë me zhvillimin e një bisede të lirë, për situatën e figurës së dhënë në libër dhe krijimi i një ngjarje me të.

Abetarja e vitit 1967, sjell ndryshime në strukturë sepse tingujt/shkronjat dhe leximi e shkrimi mësohen paralel për dy orë mësimore. Ora e parë është planifikuar për mësimin e shenjave grafike të shtypit, ndërkaq ora e dytë është planifikuar për mësimin e shenjave grafike të shkrimit. Edhe në këtë abetare, ora mësimore qëndron e organizuar në tre hapa ku në hapin e I, mësohen shenjat grafike të shtypit dhe leximi i fjalës normale të shoqëruar me fotografi, në hapin e II, nxënësit lexojnë tekstin me shkronja të shtypit, ndërkaq në hapin e III, mundësohet realizimi i bashkëbisedimit i cili ka qëllim të vë në pah zhvillimin e aftësive folëse e dëgjuese përmes ilustrimeve të paraqitura në abetare.

Ora e dytë, në hapin e I, njohja e shenjave grafike të dorës dhe përsëritja e atyre të shtypit, Hapi i II, zhvillimi i një bisede që brenda saj ka fjalë me tingullin/shkronjën që mësohet dhe hapi i III, të lexuarit dhe të shkruarit e tekstit me shkronja të dorës, Shih figuren. nr.10.



Fig.10. Mësimi i lexim shkrimit për dy orë.

Abetaret e vitit 1977 dhe 1982, ora mësimore te këto abetare ka këtë strukturë: Hapi i I, fillon me prezantimin e shkronjës, me dy shenjat grafike të shtypit, hapi i II, mundëson prezantimin e një teme bazë për të folurit e cili përmbanë fjalë që kanë tingullin/shkronjën që do ta përpunojnë. Hapi i III, synon të bëjë leximin e fjalëve dhe fjalive të bazuara në tekste me shkronja të shtypit, ndërkaq hapi i IV, planifikon të shkruarit e shenjës grafike të vogël dhe të madhe dhe fjalive me shkronja të shkrimit. Të njejtën strukturë e ka edhe abetarja pasardhëse e vitit 1982, duke e perjashtuar pjesën e parë ku mësohen dhjetë shkronja me të njejtët hapa, por vetëm shenjat grafike të shtypit.

Abetarja e vitit 2003, struktura e orës mësimore është krejtësisht ndryshe nga abetaret paraprake. Hapi i I, fillon me një qasje analitike nga një fjali e paraqitur në abetare, duke e ndarë atë në fjalë dhe pastaj fjalën në rrokje, duke arritur te tingulli/shkronja që do të mësohet. Në hapin e II, nxënësit bashkëbisedojnë në lidhje me figurën që është në abetare, që kryesisht lidhet me tekstin me shkronja të shtypit që do ta lexojnë, ndërkaq në hapin e III dhe të IV, nxënësit bëjnë punë me shenjat grafike të shkrimit dhe ushtrimet për të shkruar fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit.

Abetarja e vitit 2008, Te kjo abetare, ora mësimore realizohet duke kaluar nëper këta hapa: hapi I, organizohet përmes një bisede për ndonjë temë të caktuar nga autorët ose me përshkrimin e ndonjë ilustrimi apo duke ju përgjigjur pyetjes si (shiko dhe trego çka ka

vizatuar piktori?). Në kuadër të këtij hapi, fëmijëve ju mbetet detyrë të veçojnë një fjali që do ta analizojnë deri te tingulli.

Në hapin e II, nxënësit kanë për detyrë që fjalën e veçuar ta shohin me cilin tingull fillon ose cili është tingulli që përsëritet në rrokjet ose në fjalën e veçuar dhe ta rrethojnë atë duke u munduar të dallojnë fjalë të tjera që fillojnë ose kanë tingullin/shkronjën që mësojnë.

Në hapi i II, nxënësit mësojnë të shkruarit e katër shenjave grafike dhe së fundmi t'i ngjyrosin shkronjat. Në kuadër të kësaj skeme vërehet se kjo abetare ka një qasje deduktive, gjatë të mësuarit të lexim-shkrimit.

Abetarja e vitit 2012, e ka të organizuar orën mësimore sipas tre hapave të cilët duhet të ndiqen nëse dëshirohet të arrihen rezultatet e planifikuara në fillim të vitit shkollor.

Hapi i I në këtë abetare është shumë motivues sepse në të janë të planifikuara aktivitete të ndryshme të cilat i organizon mësuesi që korrespondojnë të lidhura kryesisht me tingullin/shkronjën që mësohen siç është punimi i tingullit, njohja e tingullit në mjedisin fonologjik, vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik. Hapi i II, ka të bëjë me grafikun e shkronjës, ku nxënësit janë të obliguar ta shkruajnë shkronjën, ta bëjnë dallimin grafik në mes të shkronjës së madhe të shtypit dhe të voglës së shtypit. Në këtë hap gjithashtu nxënësit kërkojnë shkronjën në tekst, e gjejnë dhe e qarkojnë atë. Ndërkaq hapi i III, ka të bëjë me dramatizimin, shkrimin e shkronjës dhe detyrat e shtëpisë.

Nga gjithë kjo që e elaboruam, mund të vijmë në përfundim se, autorët e abetareve shqipe kanë ndjekur traditë pedagogjike, gjuhësore dhe zhvillimet e shkencave tjera gjatë hartimit të abetareve. Kjo mund të shpjegohet se nga abetaret që kanë më pak mundësi, aktivitete dhe lojë gjatë mëimit të lexim-shkrimit, shkojnë deri te abetarja e fundit e cila e ka orën mësimore një botë me aktivitete e angazhime të dy anshme mësues-nxënës.

Abetaret e vitit 1945, 1946 dhe 1947, përbëjnë grupin e parë me një strukturë të orës ku nxënësi është më shumë objekt, puna në këto abetare është e vështirë për mësuesit dhe nxënësit.

Abetaret e vitit 1948 dhe 1951, posedojnë një strukturë pak më të organizuar mirëpo edhe këto bartin vështirësi për shkak se brenda një ore punohen katër shenjat grafike të tingullit/ shkronjës.

Abetaret e vitit 1955, 1966 dhe 1967, tingujt/shkronjat mësohen për dy orë, që kanë një strukturë të orës të përbërë nga tre hapa. Duke u mbështetur në nivelin e përgatitjeve të nxënësve të klasës së parë, këto mund të konsiderohen pak më të lehta se abetaret paraprake.

Ndërkaq, abetaret e vitit 1977, 1982, 2003 dhe 2008, gjatë një ore mësimore nxënësit mësojnë të gjitha shenjat grafike.

Abetaret e vitit 1977 dhe 1982, gjithashtu kanë të njëjtën strukturë të orës të përbërë nga tre hapa ndërsa abetaret e vitit 2003 dhe 2008, kanë një qasje analitike gjatë gjithë orës mësimore, ku nxënësi është subjekt aktiv sepse nga ai kërkohet të dëgjoj, të dallojë, të ngjis, të ngjyros, të prejë me gërshërë, të lidhë rrokjet, të rëndit fjalë dhe të formoj fjali.

Abetarja mbarkombëtare e vitit 2012 është e organizuar sipas modelit ku tingujt/shkronjat mësohen përmes punës me abetare dhe abetare pune, kështu që nxënësit, disa herë janë në kontakt me shkronjat. Në abetare një tingull/shkronja mësohet për pesë orë. Kështu që nga gjithë kjo po shohim se po kalojmë nga abetaret me struktur të thjesht të orës mësimore, në të cilën shkalla e vështirësis është më e lartë, te abetaret me strukturë më të ndërlikuar e të përbërë nga shumë hapa, kërkesa e detyra, duke bërë përpjekje t'u përshtatet aftësive kuptimore të nxënësve.

IV. METODAT E MËSIMIT TË LEXIMIT DHE SHKRIMIT NË ABETARET SHQIPE NË KOSOVË

Mësimi i gjuhës shqipe është një nga objektivat parësore në të gjithë arsimin e detyruar. Në klasën e parë të shkollës fillore, gjuha shqipe fillon të mësohet sistematikisht përmes të ushtruarit për lexim-shkrim fillestar. Kështu që, klasa e parë ka për detyrë t'i zhvillojë aftësitë për të lexuar dhe për të shkruar. Nxënësit duhet të fitojnë shprehinë e teknikës së të lexuarit dhe atë të të shkruarit, të lexojnë fjalë, të lidhin tingullin me shkronjën përkatëse, të dallojnë tekstin nga fjalia dhe fjala, të ndajnë tekstin në fjali dhe në fjalë, të bëjnë analizë dhe sintezë të fjalëve, të dallojnë tingujt dhe shkronjat e ngjashme, të dallojnë bashkëtingëlloret nga zanoret, të lexojnë saktë shkronjat dyshe të alfabetit, të lexojnë në mënyrë të kuptimshme, të shkruajnë shkronjat e shtypit dhe të shkrimit, të shkruajnë fjalë, fjali, të ndajnë fjalët në rrokje, të shkruajnë me të diktuar, të shkruajnë letra, kartolina të thjeshta duke kopjuar, të shkruajnë drejt dhe pa gabime. Abetarja është libër që i zhvillon aftësitë dëgjuese dhe folëse, po ashtu dhe njohuritë nga gjuha. Për ta rritur cilësinë në mësimin e lexim-shkrimit fillestar, rëndësi kanë metodat me ndihmën e të cilave shtjellohen tingujt/shkronjat. Nxënësit përmes metodave dhe formave fitojnë shkathtësitë dhe shprehitë e leximit dhe të shkrimit të drejtë dhe të natyrshëm. "Me metodat që zgjedhim e zbatojmë, mund të bëjmë që te nxënësit nismëtarë të shprushen e të ndizen flakë apo të nisin të zbehen a të fiken, interesimi për mësimin e tingujve e shkronjave dhe për leximin e shkrimit fillestar" (Krasniqi, 2002).

Në bazë të analizës së abetareve nga vitit 1945-2012, shohim se kemi zbatimin e shumë metodave për mësimin e leximit dhe shkrimit fillestar. Mund t'i cekim disa arsye mbi numrim dhe llojin e metodave në abetaret tona: a) struktura e gjuhës dhe e drejtshkrimit është faktori kryesor në përcaktimin e metodave, b) ndërlikueshmëria e procesit të leximit dhe shkrimit, c) mosha ku i dedikohet abetarja, kemi abetare për fëmijë 7, 6 dhe për të rritur, ç) përgatitja dhe paradituri e nxënësve nismëtarë, d) tradita dhe trashëgimia pedagogjike, dh) veçoritë socio-linguistike.

Nga e gjithë kjo mund të shohim se te abetaret shqipe në Kosovë, gjejmë këto metoda për mësimin e leximit dhe shkrimit fillestar si:

- a) Metodatat sintetike të mësimin të leximit dhe shkrimit,
- b) Metodatat analitike të mësimin të leximit dhe shkrimit,
- c) Metoda globale të mësimin të leximit dhe shkrimit dhe,
- d) Metoda analitike-sintetike të mësimin të leximit dhe shkrimit.

Por, e gjithë puna në abetaret tona është gërshetimi i këtyre metodave gjatë përvetësimit të tingujve/shkronjave dhe leximit e shkrimit.

1. Metodatat sintetike

Janë metodatat më të vjetra në historikun e mësimin të leximit dhe shkrimit fillestar. Metodatat sintetike janë një grup metodash, që mësimin e tingujve shkronjave dhe leximin e shkrimit fillestar e nisn nga elementet më të vogla të gjuhës drejt sintezës së tyre në tërësi më të plotë gjuhësore. Niset nga tingujt/shkronjat me bashkimin e tyre në rrokje, fjalë e fjali. Një metodë sintetike në sensin strikt të termit niset nga elementet e thjeshta, elemente abstrakte pak a shumë të izoluar nga përmbajtja (Mialaret, 1995).

Abetaret tona gjatë punës për mësimin e tingujve/shkronjave, leximit dhe shkrimit, janë të hartuara nga disa lloje të metodave sintetike.

1.1. Metoda e leximit rrokje për rrokje

Kjo metodë bën pjesë në grupin e metodave sintetike, që janë kryesisht metoda të vjetra dhe përdoren në disa variante. Sipas kësaj metode është hartuar abetarja e vitit 1946, në këtë abetare dominon varianti së pari mësohen tingujt /shkronjat e pastaj bëhet sinteza e tyre në rrokje, shih figurën numër, 11 dhe 12.




Fig.11. Shkronjat e medha të shtypit




Fig.12. Shkronjat e vogla të shtypit

1.2. Metoda e tingujve natyralë

Metoda e tingujve natyralë ndikon në krijimin e përfytyrimeve audiovizuale. Nocioni për tingullin bëhet përmes identifikimit dhe dallimit të tingujve natyralë të prodhuar në formë imitimi, për shembull, shushurima e ujit për tingullin “Sh”, fërflima e erës për tingullin “F”, zukatja e bletës për tingullin “Z”, fikja e qiririt për tingullin “P”, imitimi i ulërimës së ujqve për tingullin “U” (Brada, 2005).

Te abetarja e vitit 1955 dhe 1966 e kemi këtë metodë të mësimin, ku mësohet tingulli/shkronja “Ë”. Kurse te abetarja e vitit 1977, kemi përpunimin e tingullit/shkronjës “C”, shiko figurat numër. 13 dhe 14.



Fig.13. Dallimi i tingullit Ë



Fig.14. Dallimi i tingullit C

1.3. Metoda fonografike

Kur mësimi i shkronjave bëhet duke i vënë ato në lidhje me formën që kanë sendet a objektet në natyrë dhe me mjedisin e afërt jetësor që fëmija jeton. Kjo metodë e të mësuarit të tingujve, shkronjave quhet metoda fonografike. Këtë metodë e hasim te disa abetare, si te abetarja e vitit 1955 e Mehmet Gjevorit dhe Jusuf Shushkës dhe abetarja e Ramiz Hoxhës e vitit 1966. Po ashtu edhe te abetarja e vitit 2008 me autorët, Agim Deva dhe Islam Krasniqi. Ku të mësuarit e tingullit/shkronjes “O” është vënë në lidhje me formën e orës, pastaj shkronja “C” me formën e një gjevreku, që ka grimëcuar trumcaku dhe ia ka dhënë formën e shkronjes “C”. Këtë metodë e gjejmë edhe te abetarja mbarëkombëtare e vitit 2012, po ashtu te tingulli/shkronja “O” dhe “C”.

Për abetaren e vitit 1955 dhe 1966 shiko figurat numër 15 dhe 16.



Fig.15. Forma e shkronjës A



Fig.16. Forma e shkronjës F

1.4. Metoda fonetike

Metoda fonetike duhet të zbatohet për ushtrimet e shqiptimit të drejtë të disa tingujve, shqiptimi i të cilave, në rajonet e caktuara shqipfolëse, shmanget dukshëm. (Krasniqi, 2002). Kështu, nxënësit e përforcojnë përfytyrimin auditiv, vizual me atë motorik, për germën si simbol i tingullit që ushtrohet të shqiptohet. Metodën fonetike e gjejmë te abetarja e vitit 2003 e Qamil Batallit, në paraabetaren ka ushtrime për shqiptimin e normuar të tingujve: Q, Ç, Gj, Xh. Po ashtu edhe te abetarja e vitit 2008 kemi ushtrime për shqiptimin e po të njejtëve tinguj sikurse te abetarja paraprake. Te abetarja e vitit 2012, në abetare pune, kemi konkretizimin e shqiptimit për secilin tingull për 36 tingujt me radhe, shih figurën numër 17.



Fig.17. Konkretizimi i shqiptimit të tingujve në abetaren e vitit 2012.

Kështu që, shohim se një numër i abetareve në trungun e tyre kanë grupe të ndryshme të metodave sintetike, të cilat ju ndihmojnë nxënësve në bashkimin e tingujve/shkronjave, në shqiptimin e normuar të tingujve ose mund ta bëjnë mësimin shumë tërheqës dhe argëtues me metodën e tingujve natyralë, etj.

2. Metoda analitike

Metodat analitike janë një grup metodash të paraqitura për qëllim të evitimit të dobësive që kishin metodat sintetike. Metoda analitike ka një ecure të kundërt me metodën sintetike. Kjo metodë nisat nga një tregim, fjalia, fjala, rrokja e deri te tingulli si element përbërës i saj. Metodat analitike e begatuan teorinë dhe përparuan praktikën e mësimin të tingujve/shkronjave dhe të leximit, shkrimit fillestar. Kjo metodë nxit zhvillimin e proceseve intelektuale dhe të menduarit analitik të nxënësi. Abetaret tona në dimensionin metodik të tyre kanë disa metoda analitike si: metoda e fjalive normale, fjalës normale, e rrokjeve normale.

2.1. Metoda e fjalive normale

Metoda e fjalive normale nxirret nga një tregim ose përshkrim i vizatimit që është në abetare, ku veçohet fjalia normale dhe kjo shkruhet në tabelë. Mësuesi duhet ta lexojë fjalinë, e ndan atë në fjalë, rrokje e deri te tingulli/shkronja. Tregohet dhe ushtrohet shqiptimi i tingulli të ri.

Kjo metodë gjen vend edhe te abetarja e Qamil Batallit e vitit 2003 deri në vitin 2007. Kjo fjali normale këtu vjen apriori, duke u analizuar deri te tingulli/shkronja. Pastaj fillon leximi me tingullin, shkronjën e mësuar në një tekst të vogël.

Zbatimin e kësaj metode e gjejmë te abetarja e vitit 2008. Kjo abetare i është përmbajtur nga fillimi deri në fund kësaj metode, herë-herë është nxjerrë fjalia normale nga ndonjë tregim, poezi ose dhe ilustrimi që ishte në atë fletë. Shih figurën numër 18.




Figura 18: Metoda e fjalive normale.

Po ashtu, te abetarja e vitit 2012, kjo metodë zë vend të rëndësishëm nga fillimi deri te tingulli/shkronja "Y", d.m.th. vetëm të katër shkronjat e fundit që mësohen në këtë abetare si: "Z", "X", "Xh" dhe "Zh", nuk zbatohet kjo metodë. Karakteristikë e kësaj abetare është që një orë mësimore (ora e parë), zhvillimi i tingullit/shkronjës së re realizohet vetë përmes kësaj metode, e gjithë puna lidhet me analizën e kësaj fjalie.

2.2. Metoda e fjalës normale

Gjurmët e metodës së fjalëve normale hasen në veprën metodike të Komenskit: "Bota ndijore në fotografi"/Orbis sensualium pictus/. Por, e përpunuar teorikisht dhe e ngritur në nivel të metodës mësuesi gjerman Maksimilian Oto Kramer dhe Karllo Fogel, kah mesi i shekullit XIX. (Krasniqi, 2002). Kjo metodë nënkupton përshkrimin e ndonjë sendi, objekti, vizatimi që lidhet me rrethin jetësor të fëmijëve, d.m.th. zgjedhet fjala normale dhe shkruhet nën ose krahas fotografisë së përshkruar. Kjo fjalë duhet të jetë e shkurtër dhe të fillojë me shkronjën që mësohet brenda orës. Bëhet analiza e kësaj fjale drejt te tingulli,

veçohet tingulli i ri, mësohet shqiptimi model i tingullit. Këtë metodë e gjejmë në disa abetare, si te abetarja e vitit 1955, 1966, 2003, 2008 dhe 2012. Te abetarja e vitit 1955 dhe 1966, kjo metodë është përdorur në fillim të orës mësimore dhe tingulli/shkronja gjendet në fillim të fjalës, shih figurat numër, 19 dhe 20.



Figura 19: Abetarje e vitit 1955




Figura 20: Abetarja e vitit 1966

Kurse në tri abetaret e pasluftës së fundit në Kosovë, kjo metodë haset në fillim të orës së parë, në orën e dytë kjo metodë është te përsëritjet dhe ushtrimet për tingullin, shkronjën që është mësuar. Tingulli/shkronja gjendet në vende të ndryshme brenda fjalës e konkretizuar me fotografi. Te abetarja e vitit 2008 e ka ilustrimin dhe nën të e shkruan fjalën normale. Abetarja e vitit 2003 dhe 2012 e ka vizatimin, nën të fjalën dhe nën të prapë hapësirën për ta kopjuar atë fjalë. Shih figurat nr. 21 dhe 22.



Figura 21: Abetarja e vitit 2003




Figura 22: Abetarja e vitit 2008

2.3. Metoda e rrokjeve normale

Mësimin e leximit dhe shkrimit, me këtë metodë, e gjejmë te parabetarja dhe abetarja e vitit 2012. Te kjo abetare kemi vizatimin e një objekti ose sendi të njohur për fëmijën.

Përmes bisedës kërkohet të nxirret fjala që është emri i ilustrimit. Përfundi fotografisë është e shkruar vetëm rrokja e parë e fjalës së veçuar. Shih fotografinë numër 23.




Figura 23: Metoda e rrokjeve normale.

Por, brenda abetares ka edhe ushtrime të tjera me rrokje. Ku përfundi fotografisë mundet të jetë rrokja në pozita të ndryshme brenda fjalisë.

3. Metoda globale

Metoda “Shiko dhe lexo” (globale) lidhet me elemente të metodës globale, në të cilën, nxënësit, në mënyrë të pavarur, por dhe të orientuar, mund të lexojnë fjalë apo shprehje në mënyrë globale, të cilat diktohen nga përvoja e tyre, si: njohja dhe leximi i titujve të librave, i emisioneve, i reklamave, i etiketave dhe shumë materialeve të tjera autentike. (Gjokutaj, Rrokaj, Krasniqi, Pozhegu, 2012). Zbatimi i kësaj metode përkon me një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik-shoqëror. Këtë metodë e gjejmë te abetarja e vitit 2012, kryesisht te paraabetarja, ku testohen njohuritë dhe paradituritë e nxënësve për lexim dhe shkrim. E gjejmë dhe në abetare por, të kombinuar edhe me metoda tjera. Po ashtu edhe te abetarja e vitit 2008, ka zbatim kjo metodë, në paraabetare për të vazhduar edhe në abetare, kryesisht në disa orë të para. Nga kjo mund të nxjerrim se metoda globale gjen vend kryesisht në abetaret e pasluftës në Kosovë, ku mund të themi se kemi një lëvizje dhe përmirësim shoqëror dhe ekonomik. Zbatimi i kësaj metode lidhet edhe me parapërgatitje dhe përfshirje më të madhe të fëmijëve të moshës parashkollore në institucione edukativo-arsimore dhe klasa përgatitore.

4. Metoda analitike-sintetike

Procedimi metodik i punës me këtë metodë iu përshtatet veçanërisht gjuhëve me strukturë të theksuar morfologjike dhe me drejtshkrim të theksuar fonetik. Strukturë dhe drejtshkrim të kësaj natyre ka gjuha shqipe. Kjo metodë nis me analizën e tërësive më të plota gjuhësore, siç janë teksti, fjalia dhe fjala. Po ashtu vend të rëndësishëm zënë edhe elementet të sintezës së tingujve dhe shkronjave në fjalë-fjali. Te disa abetare kemi elemente të metodave, qoftë analitike qoftë sintetike, që janë kryesisht të zbehta.

Abetaret e pasluftës të botuara në Kosovë, janë hartuar me këtë metodë. Abetarja e parë, që e zbaton këtë metodë, në një procedim më korrekt të hapave të saj është abetarja e vitit 2003 e autorit Qamil Batallit. Metoda bazë e mësimi të tingujve/shkronjave në këtë abetare është metoda analitiko- sintetike. Në orën e parë mësimi fillon përmes kësaj metode, nga përshkrimi i ilustrimit të fjalës, nga fjalës të fjalës dhe nga fjalës të tingulli. Kurse në orën e dytë kemi zbatim të sintezës por, jo me të gjithë hapat e kësaj metode nga tingulli/shkronja të fjalës, nga fjalës të fjalës. Abetarja ka dhe ushtrime të ndryshme me rrokjet si: ndaje fjalën në rrokje dhe në tinguj, bashko rrokjet që formojnë fjalë, gjej rrokjen e parë, gjej rrokjen e dytë, rretho me ngjyrë të kuqe rrokjet e rreshtit me “në” dhe “rë”, në cilën rrokje dëgjohet tingulli “ë”? , lidh rrokjet duke lexuar, lidh rrokjen në tabelën që ka fjalën me këtë rrokje, lexo fjalët dhe trego nga sa rrokje kanë, lexo fjalitë, ndërsa fjalët ndaj në rrokje. Ky trend i punës me rrokje vazhdon deri te të mësuarit e shkronjës “Zh” që ka ushtrimin, lidh rrokjet. Të njëjtin procedim metodik e gjejmë edhe te abetarja e vitit 2008, ku në orën e dytë ka ushtrime me rrokje si: Plotëso rrokjet dhe me shkronjat e mësuara formo fjalë që kanë kuptim, duke ua ndërruar vendin rrokjeve formo fjalë që kanë kuptim, bashko rrokjet, gjej dhe lidh rrokjet me fjalët që kanë ato, rretho rrokjet në këto fjalë etj. Te abetarja e vitit 2012 kemi ushtrime të tilla me rrokje që vazhdojnë deri në fund të abetares, por janë më pak në numër se te abetaret paraprake.

Kemi metodën alfabetike, e cila gjen shtrirje të gjerë edhe në librin e punës, te abetarja e vitit 2012. Nxënësit njihen dhe shkruajnë të gjitha shkronjat kapitale të gjuhës shqipe. Ky është një hap shumë i rëndësishëm i cili bën që nxënësit të shqiptojnë dhe të shkruajnë të gjitha shkronjat e alfabetit të shqipes (kapitale), brenda periudhës së paraabetares. Kur nxënësve në abetare takohen me shkronja të reja, ata e kanë njohur atë që në periudhën e paraabetares.

Pjesa e dytë e abetares dallon për shtrirjen e gjerë të metodës analitike-sintetike. Kjo pjesë e libri dallon gjithashtu edhe për gjetje shumë të rëndësishme që i bëhet analizës së fjalisë dhe fjalës të cilat në mënyrë shumë didaktike analizohen në pjesë përbërëse, duke nxjerrë në pah kuptimin mbi fjalinë, fjalën, rrokjen, deri te shkronjat që përbëjnë rrokjen.

5. Format e mësimit të shkronjave në abetare

Format janë të lidhura ngusht me metodat e mësimit të shkronjave. Po, ku dallojnë metodat nga format e mësimit të shkronjave, për të gjithë ata që nuk janë pedagogë, gjuhëtarë, mësues etj., na jep një sqarim shumë të qartë profesor Islam Krasniqi, ku thotë “format e mësimit të shkronjave përcaktojnë numrin dhe rendin e mësimit të njëhershëm të shkronjave. Përderisa format e mësimit të shkronjave tregojnë sa dhe cilat shkronja do të mësohen brenda një ore, metodat përcaktojnë mënyrën dhe ecurinë metodike si do të mësohen ato”. (Krasniqi, 2002). Abetaret tona mundësojnë përpunimin e tingujve/shkronjave përmes tri formave:

1. Forma monografike e mësimit të tingujve/shkronjave,
2. Forma e mësimit grup të tingujve/shkronjave dhe,
3. Forma komplekse e mësimit të tingujve/shkronjave.

Nga forma e përpunimit të tingullit/shkronjës, që gjendet në abetare, varet cilësia dhe dinamika e të mësuarit të tyre, por edhe koha sa nxënësit do të punojnë për t’i përvetësuar.

5.1. Forma monografike

Metoda monografike është metodë më e vjetër e konceptimit e komponimit të abetares dhe e zhvillimit të lexim-shkrimit fillestar (Brada, 2005). Me të kuptojmë formën ku brenda një ore të mësimit, mësohen një, dy ose të gjitha shenjat grafike për tingullin dhe shkronjën përkatëse. Kjo formë ka gjetur zbatim më shumë në abetaret në Kosovë, ku shumica nga abetaret janë të haruara mbi këtë formë.

Me këtë formë është hartuar abetarja e vitit 1948. Te kjo abetare e gjejmë zbatimin e formës monografike me katër shenjat grafike. Pra, brenda një ore mësohen të gjitha shenjat grafike për tingullin.

a) Një shkronjë me të gjitha shenjat grafike, për një orë.

Dhe, ky procedim metodik fillon nga ora e parë e punës me tingujt/shkronjat. Abetarja nuk ka periudhë përgatitore, fillon drejt me mësimin e lexim/shkrimit. Ora e parë fillon me tingullin/shkronjen "O" dhe e dyta me "V". Shih. figurat 24 dhe 25.




Figura 24: Mësimi i katër shenjave grafike.




Figura 25: Mësimi i katër shenjave grafike.

grafike.

Abetarja e vitit 1951 ishte e hartuar sipas formës monografike, por vështirësinë e punës me katër shenjat grafike për një orë, e kishte ndarë në dy orë, për dallim nga abetarja paraprake. Në orën e parë mësoheshin dy shenjat grafike të shtypit edhe në orën e dytë dhe dy shenjat grafike të shkrimit, shih figurën 26.



Figura 26: Mësimi i një shkronje për dy orë.

Po ashtu edhe abetarja e vitit 1955, është e hartuar me formën monografike dhe për dy orë katër shenjat grafike, sikurse te abetarja paraprake.

Abetarja e vitit 1966 që ka zhvillimin veçmas të shkronjave të shtypit nga ato të shkrimit është e hartuar sipas metodës monografike, ku për një orë dy shenjat grafike të shtypit të tingullit, pasi të përfundohen të gjitha shkronjat e shtypit, fillon puna për shenjat grafike të shkrimit, prapë për një orë dy shenjat grafike të shkrimit.

Abetarja e vitit 1967, zhvillimi paralel i germave të shtypit e të dorës është e hartuar sipas metodës monografike për dy orë mësimore katër shenjat grafike të tingullit, natyrisht paraprijnë shenjat e shtypit, për të vazhduar me shenjat e dorës.

Abetarja e vitit 1972, prapë me metodën monografike, me tri shenjat grafike dhe me katër shenjat grafike për një orë mësimore.

Abetarja e vitit 1977, formën monografike e gjejmë të zbatuar në tri variante të saj.

- a) Në fillim të abetares një shkronjë me një shenjë grafike (gjegjësisht të madhen të shtypit),
- b) Pastaj një shkronjë me tri shenjat grafike (e madhja, e vogla e shtypit dhe e vogla e dorës), dhe
- c) Një shkronjë me katër shenjat grafike.

Abetarja e vitit 1982, kemi disa variante të formës monografike si:

- a) Një shkronjë me një shenjë grafike (shkronjën e madhe të shtypit) në një orë,
- b) Një shkronjë me dy shenjat grafike (shenjën e madhe dhe të vogël të shtypit) në një orë,
- c) Një shkronjë me tri shenjat grafike (e madhja, e vogla e shtypit dhe e vogla e shkrimit), në një orë dhe
- d) Një shkronjë me katër shenjat grafike (e madhja, e vogla e shtypit dhe e vogla e shkrimit), në një orë dhe në orën tjetër shenja grafike e madhja e shkrimit.

Abetarja e vitit 2003, në ato orë që shtjellimi i tingujve/shkronjave është bërë me formën monografike, kemi këto variante të kësaj forme.

- a) Një shkronjë me dy shenjat grafike (shenjën e madhe dhe të vogël të shtypit),

b) Një shkronjë me katër shenjat grafike të tingullit.

Abetarja e vitit 2008 kemi këtë shtjellim të tingujve/shkronjave me formën monografike si:

a) Një shkronjë me katër shenjat grafike të tingullit.

Abetarja e vitit 2012, kemi:

a) për një orë katër shenjat grafike dhe

b) për dy orë njëra pas tjetrës, katër shenjat grafike (në orën e parë dy shenjat e shtypit, pastaj në orën e dytë dy shenjat e shkrimit).

Arsyetimi pedagogjik mbi zbatimin e kësaj forme te abetaret tona qëndron se: kjo formë ju përshtatet më shumë nxënësve nismëtarë të shkollës fillore pa përgatitje, pa paradituri për tingujt/shkronjat. Nga ky konstatim na del edhe zhvillimi kronologjik, se si është zbatuar kjo formë dhe në cilat variante të saj dhe kush e përcakton. Nga këtu, abetaret sipas formës monografike, mund t'i ndajmë në katër grupe.

Grupin e parë, e përbën pjesë abetarja e vitit 1948, që mund ta quajmë abetare e vështirë sa i përket formës monografike të përpunimit të shkronjave, për një orë të gjitha shenjat grafike të shkronjës. Sepse ne e dime se cili ishte niveli arsimor i popullit tonë ato vite, pjesa dërmuese ishim analfabetë, pa kushte ekonomike e shoqërore, që të kenë ndonjë paranjohuri. “Në vitin 1948, në Kosovë konsiderohej se kishte rreth 130.000 analfabetë të moshës deri në 15 vjeç”. (Shatri, 2006).

Grupi i dytë, bëjnë pjesë abetarja e vitit 1951, 1955, 1966, 1967 dhe 1972, këto abetare janë për fëmijë. Sa i përket formës monografike, paraqesin një shkallë të lehtësisë për dallim nga abetarja paraprake sepse forma monografike është e paraprirë me periudhën përgatitore disa ditore. Pastaj forma monografike e përpunimit të shkronjave shtrihen nga 2 orë për katër shenjat grafike, me variacione të ndryshme brenda këtyre dy orëve, dy orë me nga dy shenjat grafike ose një orë me tri shenja grafike.

Grupi i tretë, abetaret e vitit 1977 dhe 1982, sa i përket formës së shtjellimit të shkronjave, mund të themi që janë përshtatur realitetit kohor, sa i përket nivelit të përgatitjes së

nxënësve dhe kanë gradualitet në ngritjen e vështirësisë sa i përket përvetësimit të shenjave grafike të tingullit, gjithmonë duke pasqyruar kontekstin tonë të zhvillimit. Përpunimi i shenjave grafike që fillon nga një, dy, tre deri të katër shenjat në një orë mësimi.

Grupi i katërt, bëjnë pjesë abetaret e pas luftës së fundit (1999). Abetarja e vitit 2003, 2008 dhe 2012. Zbatimin e metodës monografike me dy variantet e saj, si me dy shenjat grafike dhe me katër shenjat grafike për një orë, e arsyeton me pjesëmarrje më të madhe të fëmijëve në institucione parashkollore dhe që tashmë është në Kosovë.

5.2. Forma e mësimi grup të shkronjave

Kjo formë është më e re se forma monografike dhe i përgjigjet një shoqërie më të avancuar, që d.m.th. kur fëmijët kanë përgatitje më të lartë për shkollë. Fëmijët, përmes institucioneve parashkollore sot i njohin shkronjat, madje edhe mund të lexojnë. Me formën grupore kuptojmë “mësimin brenda orës së njejtë të dy a më shumë shkronjave me shumicën ose të gjitha shenjat grafike që kanë ato” (Krasniqi, 2002). Abetaret tona, që janë hartuar duke u mbështetur në këtë formë janë: abetarja e vitit 1946, 1948, 1951, 1977, 1982 dhe 2003.

Abetarja e vitit 1946 është komplet e hartuar mbi bazën e kësaj forme nga ora e parë deri te e fundit, ku mësohen të gjithë tingujt/shkronjat. Grupi përbëhej nga tre tinguj/shkronja në këtë abetare. Në orën e parë shenjat grafike të mëdha të shtypit dhe në orën e dytë shenjat grafike të vogla të shtypit.

Abetarja e vitit 1948, kemi vetëm dy raste të përdorimit të formës grupore, ku mësohen për një orë nga dy tinguj/shkronja me katër shenjat grafike.

Abetarja e viti 1951, ka vetëm një rast të formës grupore, ku mësohen për një orë dy tinguj me katër shenjat grafike. Mehmet Gjevori që është bashkautor, ka dëshiruar t'i largojë rastet me formën grupore, por një ka mbetur sepse këto janë abetare të hartuara ekskluzivisht me formën monografike.

Abetarja e vitit 1977 e Mehmedali Hoxhës, nga këtu fillojnë shkëndijëzat e para të kësaj forme në abetaret, në Kosovë. Kjo është në nivelin shoqërues ose plotësues në raste të formës monografike që është kryesorja në këtë abetare. Por, si është përdorur kjo formë e shohim në vijim:

- a) Në variantin e parë, për një orë katër shenjat grafike të vogla të shtypit, për shkronjat e mësuara më parë.
- b) Në variantin e dytë, dy shenjat e vogla grafike të shkrimit, për shkronjat e mësuara më parë.
- c) Në variantin e tretë, katër shenjat grafike të vogla të dorës, për shkronjat e mësuara më parë dhe,
- d) Në variantin e katërt, nga pesë shenjat e mëdha të dorës për shkronjat e mësuara më parë.

Abetarja e vitit 1982 e Qamil Batallit është hartuar sipas formës monografike, herë herë e shoqëruar edhe me formën grupore. Duke pasur parasysh që abetarja paraprahe u kritikua shumë për formën grupore, në abetaren pasardhëse kemi vetëm disa raste, në dy variante të zbatimit të kësaj forme:

- a) Në variantin e parë, për një orë dy shenjat grafike të vogla të shtypit për shkronjat e mësuara më parë,
- b) Në variantin e dytë, nga dy shenjat grafike të mëdha të shkrimit për nga dy shkronja të mësuara më parë.

Abetarja e vitit 2003 e Qamil Batallit, kemi vetëm dy raste të kësaj forme me një variant:

- a) Në variantin e parë, katër shenjat grafike të një shkronje dhe dy shenjat grafike të shkrimit, të njëjës nga dy shkronjat e mësuara më parë, vetëm me shenjat grafike të shtypit.

Kurse të abetaret e vitit 2012, kjo formë gjen zbatim në abetare pune, ku përpunohen dy tinguj/shkronja vetëm me shenjat e mëdha të shtypit.

Shikuar në përgjithësi, mund të vijmë në përfundim se forma grupore e abetareve shqipe në Kosovë nuk është forma bazë mbi të cilën janë mësuar dhe mësohen

tingujt/shkronjat, por atë e gjejmë herë pas herë, si formë shoqëruese ose si formë me mundësinë e saj për ta ndihmuar dhe shpejtuar formën monografike për përvetësimin e ndonjë shenje grafike të disa shkronjave, që janë mësuar më parë, mirëpo ato shenja nuk janë përpunuar.

6. Forma komplekse

Për dallim nga format tjera sipas të cilave mësimi i leximit dhe shkrimit fillestar nis me formimin e nocionit për tingullin e shkronjën, për fjalën e fjalinë sipas formës komplekse, shkronjat nuk mësohen një nga një dhe as sipas grupeve”, por në kontakt të përhershëm me të gjitha shkronjat dhe duke i shfrytëzuar ato gjatë aktiviteteve të përditshme (Krasniqi, 2002). Gjatë analizës së abetareve tona shohim se një numër më i vogël i abetareve shqipe janë hartuar sipas kësaj forme.

Abetarja e parë “Këndimi im i parë” i vitit 1945 dhe abetarja e vitit 1947, për klasën e parë të shkollave fillore, janë abetare të hartuara vetëm nga forma komplekse, nga fillimi deri në fund. Por, mësimi është vetëm me shenjat grafike të shtypit. Në këto dy abetare nuk kemi ndonjë model të shkronjave të shkrimit.

Abetarja e vitit 2008 dhe kjo e fundit 2012, në trungun e tyre kanë edhe formën komplekse të përpunimit të shkronjave, por te këto abetare, nxënësit punojnë edhe me shenjat grafike të shtypit.

Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se abetaret në Kosovë janë hartuar kryesisht sipas formës monografike. Disa abetare e kanë këtë formë bazë për përpunimin e tingullit/shkronjës. Në disa abetare, forma monografike shoqërohet me formën grupore. Por, të dy abetaret e fundit, forma monografike ndihmohet dhe nga forma grupore dhe komplekse. Mirëpo kemi abetaren e vitit 1945 dhe 1947, që është ekskluzivisht e hartuar sipas formës komplekse dhe abetaren e vitit 1946 vetëm me formën grupore.

V. ONOMASTIKA E ABETAREVE SHQIPE NË KOSOVË

Sot, mund të marrim informacione të ndryshme për onomastikën në libra, fjalorë, revista, simpoziume shkencore, që ofrojnë të dhëna, për të gjitha grupet e emrave, për patronime, mikrotoponime, antroponime, orionime, hidronime, të dhëna të toponimisë së lashtë dhe të toponimisë shqiptare në Ballkan si në: në Mal të Zi, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë Lindore, Çamëri dhe shumë vendbanime e qytete të tjera shqiptare. Këto hulumtime kanë për qëllim shpjegimin e historisë së gjuhës shqipe dhe historisë së popullit shqiptar. Kështu që, onomastika prej kohës ka qenë gur themel e lëndë e parë me rëndësi parësore në të gjitha hulumtimet e shqyrtimet historiko-gjuhësore rreth iliro-shqiptarëve, së pari nga albanologët e huaj, pastaj dhe nga studiuesit shqiptarë (Shkurtaç, 2015). Duke pasur parasysh se historia e popullit shqiptar është histori e përpjekjeve për ndërtimin e identitetit kulturor, gjuhësor, etnik dhe kombëtar, prandaj është e kuptueshme se dhe onomastika në përgjithësi dhe antroponimet në veçanti, kanë qenë pjesë e asaj vlere dhe bartëse e rëndësishme e kësaj historie (Baliu, 2008).

Pra, ky studim përfshinë antroponimet e abetareve shqipe në Kosovë nga viti 1945–2012. Popujt e kombet dallojnë jo vetëm nga historia, gjuha dhe kultura e tyre, por edhe nga emrat. Emri i një njeriu na kujton në të shumtën e rasteve një komb apo popull. Ndryshimet e mëdha sociale-ekonomike, ideo-politike e kulturore nga vitit 1945 e tutje, kanë sjellë shumë risi dhe filozofi të ndryshme në qasjen ndaj emrave të njerëzve, emrave familjar, emrave të vendeve dhe emrave të tjerë në përgjithësi. Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar, në një masë dhe në kohë të ndryshme edhe te emrat në abetare. Pra, si çdo dukuri tjetër shoqëror edhe emrat janë tregues të një niveli arsimor, të zhvillimit shoqëror, kulturor dhe të mendimit njerëzor, nga një periudhë në periudhën tjetër. Gjatë hulumtimit të abetareve, ne do të fokusohemi te emrat e njerëzve, të cilët i përbëjnë disa grupe si: emra nga një fjalë shqipe, emra ilirë, emra të vjetër katolikë shqiptarë, emra sllav, emrat oriental, antroponimet e dala nga emra të vendeve, emra trajta të dala vetëm nga pjesa e parë e emrit, emra, trajta të dala nga pjesa fundore e emrit, emra shkurtime, cungime të ndryshme, emrat që shprehin dëshira, oronimet, hidronimet, patronimet, emrat e vendbanimeve etj.

Përveç këtyre emrave vetanak (personal), të theksuar më lart, abetaret kanë një gamë të gjërë emrash të tillë si: emrat familjarë (patronime), emrat e vendeve (toponimet), të cilat i gjejmë si: emra të vendeve të banuara (qytet, fshat, lagje etj), etnonimet ose emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore, pastaj kemi hidronime apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, përrenj etj.), oronimet apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj.

Nga ky hulumtim shohim se antroponimia në abetare është mjaft e larmishme për nga burimi, po ashtu mjaft heterogjene për nga kronologjia, ku gjejmë se antroponimet parreshtur shprehin motive dhe identifikohen me çaste të ndryshme historike të popullit shqiptar dhe ndikimeve fetare. Duke pasur parasysh se emrat vetanak, më shume se çdo kategori tjetër fjalësh dhe emrash, pësojnë ndryshime, në varësi me rrethanat shoqërore, kulturore e politike të vendit. Shqiptarët edhe pse me tri fe të ndryshme, prej shekujsh kanë krijuar një fond të pasur e të larmishëm emrash kombëtar, qoftë fetarë, tashmë të përvetësuar fonetikisht sipas ligjeve të shqipes (Musatafa, 2012).

Hulumtimet për antroponimet ose emrat vetanak të njerëzve, përhapja gjeografike dhe mënyra e formimit të tyre, paraqesin interes për gjuhësinë dhe për disiplina të tjera shkencore si: arkeologjinë, historinë, etnografinë, gjeografinë, gjeologjinë dhe folklorin (Shkurtaç, 2015), këto studime i shërbejnë edhe historisë së arsimit shqip. Studimet onomastike në abetare ose në cilindo libër shkollor, na japin një pasqyrë kronologjike të zhvillimeve arsimore në periudha të ndryshme, të cilat ndryshime kanë ndërhyrë (interferuar) dhe te emrat në abetare, të cilët emra kanë bartur dhe një qëllim të edukatës dhe arsimit.

1. Emrat e krijuar nga një fjalë e shqipes

Historia e popullit tonë edhe pas viteve 1945 e tutje, prapë është histori e përpjekjeve për ndërtimin e identitetit kulturor, gjuhësor, etnik dhe kombëtar. Prandaj, gjatë këtij hulumtimi onomastik e në veçanti të antroponimeve në abetare, gjejmë që fondi i emrave të njerëzve nga një fjalë e shqipes në abetare është i ndryshëm, si: nga porositë që bartin, po ashtu edhe nga numri i cili rritej ose binte.

Emrat në abetaret prej vitit 1945-2012, bartin porosi të ndryshme dhe tregojnë gjendjen shoqërore dhe shpirtërore të kohës. Te disa abetare të para e kemi praninë e emrit “Bashkim”. Këtë e dëshmojmë dhe me pjesë tekstuale që synojnë të arrijnë dashurinë vëllazërore mes serbëve dhe shqiptarëve si: “Ramë Bardhi e mori Stevon e vogël e i tha: Biri im, rri te na. Qe, ky është djali im, Agimi. Ky do të jetë vëllau yt i vërtetë, Kjo është shtëpia jote e re”. Ndërsa në tregimin tjetër thuhet, “Në festën e madhe të 7 Korrikut edhe popujt tanë, në Kosovë e Metohi, shqiptarë, serb e malazez, marrin pjesë të gjithë sëbashku sepse ajo asht dita ma e madhe, dita që i nxorri në dritë dhe u siguroi popujve tanë vllaznim dhe bashkim” (Gjevori, at al.,1948). Këto praktika, kanë ndikuar dhe te emrat në abetare, në të cilët shihet qartë se përcjellin porosinë e bashkimit. Deri në vitin 1966 pjesa dërmuese e teksteve që përdorej në Jugosllavinë e dytë ishin të përkthyer nga gjuha serbokroate” (Buletini,1998). Nga viti 1966, e kemi të pranishëm në abetare emrin Shpetim (që në mënyrë jo të drejtpërdrejt flet për një dëshirë të shqiptarëve dhe një zhvillim të vogël politik të kohës). Zhvillimet politike shihen edhe te abetaret e fundit, ku prishja e marrëdhënieve shqiptaro-serbe, ndikon dhe shtimin e emrave nga fjalë shqipe në abetare. Te abetaret në vijim shohim se emrat kanë karakter kombëtar, janë të lidhur me rrethana dhe ngjarje historike, që tregojnë qëndresë, luftë e krenari kombëtare, këto janë abetaret e Qamil Batallit që fillojnë nga vitit 1982-2007 dhe kanë këta emra: Krenari, Lirim, Lirie, Çlirimtare, Durimi, Hekurani, Çelikani, etj.

Emrat nga një fjalë shqipe në abetare janë nga burime të ndryshme, si emrat e përgjithshëm: dituri, fitim, gazmend, jeta, etj, emrat e krijuar nga folje si për shembull, agoj, duroj, emra që dalin nga trupat qiellorë si: Hëna, Dielli, Ylli, emra nga fjalë të përbëra ose të përngjitura si: Fatmir, Fatjeta, Fatlume etj., pastaj ka emra të burimit popullor, emra të nxjerrë kryesisht nga leksiku i sferës së florës dhe faunës dhe nga leksiku abstrakt, emra kalendarikë, si: Vera, Pranvera, etj. Sipas autorëve, Hasani (1990, 2006 & 2010), Elezi (2015) dhe Murati (2015), kemi mbledhur të gjithë emrat nga një fjalë e shqipes në abetaret tona. Për përfaqësimin e emrave nga një fjalë e shqipes në abetaret tona mund të shohim në tabelat nr. 3 dhe 4.

Tabla 3

Emra të krijuar nga një fjalë e shqipes

Nr.	Abetare 1945	Abetare 1946	Abetare 1947	Abetare 1948	Abetare 1951	Abetare 1955	Abetare 1966
1	Luani	Dita	Ylberi	Dita	Lena	Mani	Luani
2	Ylberi	Afërdita	Ylli	Ylli	Petriti	Luani	Luljeta
3	Ylli	Fatoni	Vera	Drita	Vera	Lulja	Jetoni
4	Vera	Fatmiri	Lulja	Agimi	Fatoni	Jeta	Dritoni
5	Flutura	Liria	Agimi	Bardhi	Fatmiri	Burimi	Fatmiri
6	Lulja	Lumnija	Fatoni	Fatmiri	Agimi	Besa	Agroni
7	Drita	Sokoli	Bashkimi	Besa	Bujari	Fatoni	Zana
8	Shega		Lena	Zana	Drita	Fatmiri	Shpendi
9	Petriti		Kujtimi	Vesa	Burbuqja	Vjollca	Vera
10	Agimi		Petriti	Shpendi	Shqipja	Agimi	Bekimi
11	Bujari		Shpresa		Ylberi	Zana	Ylli
12	Fatoni		Afrimi		Kujtimi	Shpendi	Petriti
13	Bardhi		Zana		Bardhi	Vera	Arsimi
14	Fatmirja		Shpendi		Bashkimi	Bardhi	Fatoni
15	Luli		Gazmendi			Afrimi	Merita
16	Bashkimi		Bardhi			Drita	Astriti
17	Shqipja		Fatosi				Afrimi
18	Petriti		Drita				Elita
19	Dita		Luani				Lumnija
20			Bujari				Jeta
21							Dija
22							Bujari
23							Blerimi
24							Besniku
25							Sokoli
26							Fatosi
27							Fatmirja

28							Agimi
29							Bardhi
30							Shpëtimi
31							Shqipja
32							Besimi
33							Gazmendi
34							Fatmirja
35							Hana
Gjithsej	19	7	20	10	14	16	35

Tabela 4

Emra të krijuar nga një fjalë e shqipes

Nr.	Abetare 1967	Abetare 1977	Abetare 1982	Abetare 2003	Abetare 2008	Abetare 2012
1	Luani	Rina	Miri	Urta	Arta	Iliri
2	Luljeta	Mira	Mira	Urimi	Lulevere	Bora
3	Jetoni	Marena	Mirani	Rina	Donjeta	Era
4	Dritoni	Lule	Rinori	Burimi	Loriku	Rinori
5	Fatmiri	Luli	Merita	Roni	Pranvera	Rina
6	Agroni	Luani	Rina	Miri	Petriti	Miri
7	Zana	Bekimi	Liria	Mirana	Liria	Luli
8	Shpendi	Bleta	Luani	Ëndrra	Rrita	Lira
9	Vera	Mira	Lulja	Rinori	Miri	Laura
10	Bekimi	Urimi	Lirimi	Learti	Rinori	Pranvera
11	Ylli	Petriti	Lulmali	Liria	Luani	Mira
12	Petriti	Suta	Lira	Albini	Urtina	Urimi
13	Arsimi	Shpresa	Liraku	Alba	Urata	Blerina
14	Fatoni	Astritit	Krenari	Miraku	Laura	Hëna
15	Merita	Petriti	Hartina	Krenari	Murlani	Shpresa
16	Astriti	Shpëtimi	Hekurani	Hekurani	Lumnia	Shota
17	Afrimi	Vetoni	Petriti	Liraku	Mirani	Fatmiri

18	Elita	Vera	Premtina	Hënora	Kroni	Fitorja
19	Lumnija	Vullneti	Jehona	Herakja	Blerina	Flora
20	Jeta	Fatmiri	Jeta	Puhia	Fatoni	Shpëtimi
21	Dija	Fatosi	Jetoni	Premtimja	Flutura	Besimi
22	Bujari	Selvija	Drita	Petriti	Liridona	Valoni
23	Blerimi	Flutura	Dritani	Arta	Edona	Liridona
24	Besniki	Ylberi	Blerimi	Ermira	Arditi	Arditi
25	Sokoli	Ylli	Blerina	Mirani	Sokoli	Eranda
26	Fatosi	Yllka	Blerta	Jehona	Henori	Bardhi
27	Fatmirja	Visari	Bujari	Arjeta	Heroina	Dhurata
28	Agimi	Guri	Flora	Jetoni	Shpendi	Dorina
29	Bardhi	Vjollca	Florini	Ejona	Ylbetina	Jetmiri
30	Shpëtimi	Zamirja	Samirja	Drita	Ylberi	Bashkimi
31	Besimi	Zana	Sokoli	Dritani	Rina	Njomza
32	Gazmendi	Drita	Çelikani	Flora	Vesa	Zamiri
33	Shqipja	Xhevahiri	Çlirimtarja	Fatoni	Zana	Marta
34		Borëbardha	Çetina	Fatmirja	Zamira	Besniku
35			Filloreta	Blerimi	Hana	Buqja
36			Yllka	Bujari	Bardhi	Redoni
37			Ylberi	Alba	Valoni	Linda
38			Yllnora	Bleta	Pëllumbi	
39			Ylli	Abetarja	Njomza	
40			Ylberina	Zana	Valmira	
41			Agimi	Zamiri	Viona	
42			Roni	Cuca		
43			Rrita	Sokoli		
44			Shega	Çeltina		
45			Mirashi	Ylberi		
46			Zana	Ylli		
47			Valoni	Ylberina		
48			Vala	Yllnori		

49		Visari	Gëzimi			
50		Vetoni	Gëzimja			
51		Vegimi	Agimi			
52		Qershorja	Shega			
53		Burbuqja	Mirashi			
54		Dhurimi	Shpetimi			
55		Njomza	Shpresa			
56		Gjeraqina	Rrushja			
57		Dukagjini	Valoni			
58		Thesari	Vala			
59		Jetoni	Visari			
60		Gonxhe	Vesa			
61		Lirika	Vetoni			
62			Gazmori			
63			Lulzimi			
64			Gazmendi			
65			Vegimi			
66			Zamira			
67			Qershorja			
68			Burbuqja			
69			Bardhi			
70			Borëbardha			
71			Njomza			
72			Gjereqina			
73			Thesari			
74			Arlindi			
75			Agimja			
Gjithsej	33	34	61	75	41	37

Përqindja e emrave nga një fjalë shqipe në këto abetare, fillon nga 14% e shkon deri 70.7%. Abetarja e vitit 1945 ka 29% të emrave nga një fjalë shqipe, kjo është abetare që e ka sjellë nga Shqipëria në Kosovë Mehmet Gjevari është botuar në shtypshkronjën “Luarasi

Prizren-Tiranë” (Nimonaj, 2014). Kurse abetarja e vitit 1947, ka një numër prej 37% të emrave nga një fjalë e shqipes, kjo është abetare për fëmijë. Abetaret e tjera të botuara në Kosovë si ajo e vitit 1946 dhe 1948, që janë abetare për të rritur. Te abetaret për të rritur në përgjithësi ka një numër më të vogël të emrave nga fjalë shqipe sepse ato kanë edhe shumë emra të tjerë oriental dhe sllav. Pastaj, ngjarjet që ndodhën në vitin 1948, pas paraqitjes së Byrosë Informative dhe pas prishjes së marrëdhënieve të mira midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, shënuan një kthesë tjetër negative në zhvillimin e arsimit shqip në Kosovë. Këto ndikime politike kanë reflektuar edhe te abetarja e vitit 1951 e cila ka 18% të emrave nga fjalë shqipe. “Mbas Plenumit të Brioneve, të mbajtur më 1966, u bënë disa ndryshime pozitive në jetën politike dhe shoqërore, sidomos në fushën e arsimit në gjuhën shqipe. (Shema, 2000). Pas vitit 1966, shqiptarët në Kosovë fituan të drejta më të medha kombëtare, gjë që u shpreh edhe në fushën e botimit të librit dhe të teksteve mësimore. (Buletini,1998). Këtë frymë pozitive e shohim dhe te përqindja e emrave nga një fjalë e shqipes te abetaret e viteve, 1966, 1967, 1977. Abetaret kanë edhe ndërlidhje me një fazë tjetër të zhvillimit të arsimit dhe të shkollave në gjuhën shqipe (1981-1990), në kohën kur ndodhën shumë ngjarje politike dhe shoqërore, si dhe çrregullime serioze në lëmin e arsimit, me ashpërsimin e marrëdhënieve brendakombëtar. Kemi abetaret e Qamil Batallit nga viti 1982-2000, kjo abetare është botuar trembëdhjetë herë (Nimonaj, 2014) dhe ka një përqindje më të lartë të emrave nga fjalë shqipe. Pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-serbe, abetaret e Qamil Batallit janë abetaret që për u përket emrave nga një fjalë e shqipes kanë shumë dhe ndihet fryma kombëtare. Kurse abetarja me më shumë emra nga fjalë shqipe, pas lirisë në Kosovë është abetarja e Qamil Batallit e vitit 2003 me 70.75%, të këtyre emrave. Kurse dy abetaret, ajo e parafundit e vitit 2008 dhe abetarja e fundit mbarëkombëtare Kosovë-Shqipëri kanë 42% emra nga fjalë shqipe, kjo përqindje është më e vogël se te abetarja e vitit 2003 sepse kanë edhe emra tjerë ndërkombëtarë, si: Xhimi, Xheki, Zhaneta, Xhejm dhe emra të krijuar nga shkurimi i emrave ose emra të dalë nga pjesa e parë apo fundore e emrit. Për përqindjen e këtyre emrave shiko tabelën:

Tabela 6

Përqindja e emrave nga një fjalë shqipe në abetare

Abetaret	Përqindja
Abetare 1945	29%
Abetare1946	18%
Abetare 1947	37%
Abetare 1948	15%
Abetare 1951	18%
Abetare1966	36%
Abetare 1967	35%
Abetare 1977	40%
Abetare 1982	58%
Abetare 2003	70.75%
Abetare 2008	42%
Abetare 2012	42%

1.1. Frekuenca e emrave nga fjalë shqipe në abetare

Gjatë kësaj analize, kemi marrë të gjithë emrat nga një fjalë shqipe, në të gjitha abetaret nga viti 1945-2012, i kemi përpunuar me SPSS, na ka dalë se cilët janë emrat më frekuent, që janë përsëritur disa herë në abetare si:

1. Emrin: “Bardh” e gjejmë në nëntë abetare, është emri me denduri më të lartë,
2. Emrat: “Agimi, Fatoni, Ylberi, Zana, Petriti, dhe Drita” i gjejmë në shtatë abetare,
3. Emrat: “Luani, Fatmiri, Liria, Ylli dhe Rina” i gjejmë në gjashtë abetare,
4. Emrat: “Bujari, Sokoli dhe Vera” i gjejmë në pesë abetare,
5. Emrat: “Njomza, Rinori, Miri, Shpendi, Jetoni, Shpetimi, Lulja, Vtoni” i gjejmë në katër abetare.
6. Emrat tjerë janë përsërit nga, tri, dy dhe një herë.

Shpegimi i kuptimit të këtyre emrave që më së shpeshti janë përdorur në abetare, si përshebull: Emri “Bardh”, kjo është forma mashkullore, ky emër vjen nga mbiemri i gjuhës shqipe “e bardhë, i bardhë”. Emri “Agim”, emër mashkullor me prejardhje nga folja agoj, e cila kupton kohën kur nis të zbardhë dita në mëngjes. Emri Faton është i formuar nga emri i

përgjithshëm fat. Emri “Ylber”, është emër i përgjithshëm i gjuhës shqipe ylber, që përdoret edhe si emër vetanak. Emri “Zanë”, është emër femëror me prejardhje nga emri i një hyjnie të natyrës në mitologjinë shqiptare, që dëshmohet që tek ilirët dhe vjen deri në kohët bashkëkohore. Emri “Petrit”, nënkupton një njëri trim, të fuqishëm, të shkathët e guximtar. Emri “Dritë”, emër femëror me prejardhje nga emri i përgjithshëm dritë. Emri “Luan”, ka kuptimin e njeriut trim, guximtar. Emri “Fatmir”, është me prejardhje nga mbiemri fatmir. Ka kuptimin që ka fat të mire, që i ecën shumë fati, që është me fat. Emri “Lirie”, vjen nga emri i përgjithshëm në gjuhën shqipe liri. Emri “Yll”, emër mashkullor me prejardhje nga emri i përgjithshëm yll. Emri “Rina”, emër femëror me prejardhje nga emri i përgjithshëm rini, por edhe formë e shkurtuar e emrit Katarinë. Emri “Bujar”, emër mashkullor që vjen nga emri i përgjithshëm i gjuhës shqipe bujar. Emri “Sokol” është emër i gjinisë mashkullore, figurativisht ka kuptimin e një djali trim, shtathedhur e i zoti. Emri “Verë”, në shqip është emri i një stine (Zoto, 2016).

Gjatë kësaj analize gjetëm se 75 emra i gjejmë vetëm nga njëherë në një abetare. Nga të gjithë këta emra ,22 janë të abetares së Qamil Batallit të vitit 2003. Këtë mund ta arsyetojmë kështu:

- a) se kjo është abetare e hartuar pas lufte, ku shihet një tendecë për përfshirjen sa më shumë të emrave shqiptar dhe nga një fjalë shqipe.
- b) se abetareja e Qamil Batallit e vitit 2003 është botimi i fundit i këtij autori që është ribotuar deri në vitin 2007.

1.2. Emrat ilirë në abetaret shqipe në Kosovë

Emrat kanë lidhje me kombin dhe vendin përkatës, dhe janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë, historike, gjuhësore të çdo populli. “Emrat ilirë nuk janë të shumtë. Arsyeya është e lidhur me një pragmatikë historike të mirënjohur: nuk kemi dëshmi të shkruara prej asaj gjuhe”. (Shkurtaj, 2015). “Ndjenjat atdhetare filluan të ndikojnë në aktin e emërtimit që nga Rilindja Kombëtare e këtej. Me forcimin e ndërgjegjes kombëtare, filloi shtrirja gjithnjë e më e gjerë e emrave me burim vendës, si kundërveprim i vetëdijshëm ndaj emrave me burim të huaj” (Ibrahimi, 2012). Nga fondi i përgjithshëm i emrave në abetare,

një pjesë e tyre janë me burim vendës-ilirë dhe shqiptar. Nga analiza për emrat ilirë në abetaret tona, na del se te abetareja e vitit 1945 kemi pesë emra ilirë, për të pësuar rënie te abetarja e vitit 1946 dhe 1947, me nga dy emra. Në abetarën për të rritur të vitit 1948, botuar në shtypshkronjën “Dituria” në Beograd (Nimonaj-Hoti, 2014), nuk ka emra ilirë. Kurse abetarja e vitit 1951, ka tre emra ilirë. Nga vitit 1955 e tutje numri i emrave ilirë fillon të ngritet, në vitin 1955 kemi gjashtë emra, në vitin 1966 pesë emra, në vitin 1967 dhe 1977, kemi gjashtë emra. Abetaret e Qamil Batallit, shquhen për frymën kombëtare meqë janë dy abetaret me më shumë emra ilirë në historinë e abetareve shqipe në Kosovë. Abetarja e vitit 1982 i ka nëntë emra ilirë, kurse ajo e vitit 2003 i ka katërbëdhjetë emra. Për të pasuar me abetaret e vitit 2008 me tetë dhe 2012 nëntë emra ilirë. Në abetaret tona, kemi këta emra ilirë, shiko tabelën nr. 7 dhe 8.

Tabela 7

Emrat Ilir në abetare

Nr.	Abetare 1945	Abetare 1946	Abetare 1947	Abetare 1951	Abetare 1955	Abetare 1966
1	Teuta	Titi	Tefta	Ana	Loni	Teuta
2	Agroni	Tefta	Bardhyli	Bardhyli	Ana	Agroni
3	Pirroja			Tefta	Tefta	Mentori
4	Tefta				Fata	Genci
5	Shqipja				Bardhyli	Shqipja
6					Leka	
Gjithsej	5	2	2	3	6	5

Table 8

Emrat Ilir në abetare

Nr.	Abetare 1967	Abetare 1977	Abetare 1982	Abetare 2003	Abetare 2008	Abetare 2012
1	Teuta	Ana	Ana	Ana	Olti	Ana
2	Agroni	Artani	Moni	Olta	Platori	Eni
3	Mentori	Brikena	Teuta	Artani	Etriti	Teuta

4	Genci	Beni	Artani	Entela	Anila	Artani
5	Shqipja	Teuta	Entela	Artoni	Gentiana	Titi
6	Ana	Bardhyli	Genci	Dardani	Redoni	Dardani
7			Agroni	Blenda	Dardani	Genti
8			Bardhyli	Genti	Teuta	Redon
9			Anduena	Genta		
10				Gentiana		
11				Gentiani		
12				Bardhyli		
13				Anduena		
14				Teuta		
Gjithsej	6	6	9	14	8	8

Emrat ilirë më të frekuentuar në abetare janë emrat “Teuta” dhe “Ana”, që janë përsëritur në shtatë abetare. Pason emri “Bardhyl” në gjashtë abetare, pastaj emri “Tefta” në pesë abetare, emri “Agron”, “Genc” dhe “Arton” që gjenden në katër abetare. Prejardhja e këtyre emrave si emri “Teuta” është emri i një mbretëreshë ilire, gruas së Agronit, sundimtare e fisit të ardianëve. Ana, emër femëror, i trashëguar në gjuhën shqipe nga ilirishtja. Bardhyl, emër mashkullor me prejardhje nga emri i mbretit të dytë ilir. Agron, emër i mbretit ilir të ardianëve, i shoqi i Teutës. Emri Genc aktualisht shfaqet nga emri Gent me prejardhje nga emri ilir Gentius, sikurse quhej mbreti i fundit ilir të ardianët (Zoto,2016).

1.3. Emra të vjetër katolikë në abetaret shqipe në Kosovë

Në grupin e emrave në abetare, një vend e zënë emrat e nomenklaturës kishtarë. Këtë fond të emrave e përbëjnë disa emra si, Pali, Deda, Gjoni, Gjini, Gjergji, Kola, Toma, Marku, Mikel dhe Gjoka. Emrat e vjetër katolikë kryesisht i gjejmë në të gjitha abetare. Emri “Gjergj” ka frekuencë më të lartë, ky ndikim është edhe për shkak të figurës sonë kombëtare, Gjergj Kastriotit, pastaj vjen emri Gjon e të tjerët me radhë. Prejardhja e emrit “Gjergj”, “Gjon” dhe “Pal” është kjo: emri “Gjergj” emër mashkullor, një nga emrat vetanakë më të moçëm në gjuhën shqipe, me prejardhje nga emri latin me përdorim ndërkombëtar Georgius. Emri “

Gjon”, emër mashkullor, një nga emrat vetanak më të moçëm në gjuhën shqipe, me prejardhje nga shkurtimi latin Jon. Emri “Pal”, një nga emrat më të vjetër të shqipës, me prejardhje nga latinishtja paullus që do të thotë “i vogël” ose dhe “ i ri” (Zoto,2016). Në tabelën nr. 9 dhe 10 i kemi emrat e vjetër katolikë në abetare.

Tabela 9

Emrat e vjetër katolikë në abetare

Nr.	Abetare 1945	Abetare 1956	Abetare 1947	Abetare 1948	Abetare 1951	Abetare 1955
1	Pali	Gjoni	Kola	Gjergji	Gjergji	Kola
2	Deda	Gjergji		Toma		Pali
3	Gjoni	Kola				Marku
4.	Gjini					Gjergji
5.	Gjergji					
6.	Kola					
Gjithsej	6	3	1	2	1	4

Tabela 10

Emrat e vjetër katolikë në abetare

Nr.	Abetare 1966	Abetare 1967	Abetare 1977	Abetare 2003	Abetare 2008	Abetare 2012
1	Toma	Toma	Gjergji	Gjergji	Gjoni	Gjini
2	Mikeli	Mikeli			Pali	Gjoni
3	Gjoni	Gjoni				Gjola
4	Pali	Pali				Gjergji
5	Gjergji	Gjergji				
Gjithsej	5	5	1	1	2	4

2. Emrat sllav

Mënyra e depërtimit dhe përhapjes së emrave, fjalëve të një gjuhe në gjuhën tjetër janë produkt i kontakteve të popujve me gjuhë të ndryshme. Kosova në vitin 1999 ka dalur nga lufta e fundit dhe nga ajo kohë kemi vetëm tri abetaret e fundit të botuara në liri, numri më i madh i abetareve është botuar në kohën kur, shqiptaret, serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, jetonin në një bashkësi të quajtur Jugosllavi. Sistemi i arsimit në Kosovë ishte pjesë integrale e sistemit arsimor jugosllav. Një nga parimet themelore të këtij sistemi ishte “edukimi në frymën e patriotizmit socialist jugosllav. (Koliqi, 2004). Zhvillimi i arsimit sikurse zhvillimi i përgjithshëm në Kosovë, në periudhën 1945-1952, u shoqërua me një politikë diskriminuese e cila e pengoi zhvillimin e arsimit e të shkollës shqipe në përgjithësi. Në këtë interval kohor nuk u kultivua sa duhet historia dhe kultura kombëtare. “Për këtë arsye, pas vitit 1948 u ndaluan simbolet kombëtare, ndërsa nga plan-programet mësimore u hoqën të gjitha përmbajtjet kombëtare, duke shkuar aq larg sa mohohej dhe prejardhja e popullit shqiptar”. (Kojçini, 2006). Këto zhvillime politike kanë ndikuar shihet qartë në përmbajtje dhe emrat e njerëzve në abetare. Nga ky studim na del se te abetarja e vitit 1945 e botuar në Shqipëri nuk kemi emra sllav. Kurse te Abetarja e vitit 1946 është botuar në Kosovë dhe shihet një tendencë e përfshirjes së këtyre emrave sepse në tekste kemi këta emra: Boro, Pashiq, Tito, Drazhë, Pave, Lenin, që d.m.th. se ka gjashtë emra. Nëse i krahasojme me emrat shqiptarë, kemi shtatë emra nga fjalë shqipe dhe dy emra ilirë, që gjithsej bëjnë nëntë emra. Te Abetarja e vitit 1947, kemi tre emra të tillë. Shihet se te abetaret që janë kryesisht për të rritur e gjithë përmbajtja ka frymë politike po ashtu dhe në emra të njerëzve ka ndikim motivi politik. Abetarja e vitit 1948 është libri me numrin më të madh të emrave sllav, me katërbëdhjetë emra të tillë. Te kjo abetare, sa i përket emrave shqip ka më pak në krahasim me emrat sllav, kjo abetare nuk ka asnjë emër ilir dhe vetëm dhjetë nga fjalë shqipe. Këto marrëdhënie në mes shqiptarëve dhe serbëve kanë sjellë si rezultat në disa abetare përfshirjen e herë-herë mos përfshirjen e emrave sllav. Te abetarja e vitit 1950, 1955, 1966 dhe 1967, figuron vetëm emri i Josip Broz Titos. Për të vazhduar kështu deri te abetaret e Qamil Batallit, ku kemi emrin e Titos dhe Boros, si heronj. Shih tabelen numër 11.

Tabela 11

Emrat sllav në abetare

Nr.	Abetare 1946	Abetare 1947	Abetare 1948	Abetare 1982
1	Boro	Jovo	Jovo	Boro
2	Pashiq	Josip	Savo	Tito
3	Tito	Stevo	Vejso	
4	Drazhë		Sava	
5	Pave		Moja	
6	Lenin		Stepan	
7			Franjo	
8			Stevo	
9			Jezhek	
10			Josip	
11			Millutin	
12			Dositej	
13			Boro	
14			Koça	
15			Memo	
16				
Gjithsej	6	3	15	2

3. Emrat Oriental

Gjatë këtij humumtimi, ne mund të shohin ndikimin e gjuhëve orientale në emrat e abetareve. Emrat oriental paraqesin një tërësi të përbërë nga tri gjuhë të tre popujve orientalë, të Lindjes (turk, arab, persian). Në tekstet tona shkollore kemi emra të trashëguar dhe nga kultura orientale. Këtë e dëshmon dhe numër i të këtyre emrave në abetare. "Orientalizmat janë përhapur dhe përmes arsimimit të shtresës popullore në mejtepe dhe medrese, ku brumoseshin me një fond të ri leksikologjik në gjuhën turke, arabe

dhe persiane”. (Metaj, 2009). Edukimi dhe arsimimi në medrese, mejtepe, teqe dhe xhami, i ka bërë orientalizmat pjesë e ligjërit të përditshëm, por dhe letrarë. Po ashtu dhe bartjen e emrave të njerëzve nga këto gjuhë, tek ne dhe emërtimin e femijëve me emra oriental, ka një shtrirje në popullatën tonë.

Nga hulumtimi i abetareve mund të vijmë në përfundim se emrat oriental kanë pas ndikim më të madh te abetaret e para, kryesisht një ndikim më të theksuar e gjejmë te abetarja e vitit 1948, 1951 dhe 1955. Në anën tjetër kemi abetaret e Qamil Batallit të vitit 1982 dhe 2003, po ashtu edhe abetarja e vitit 2012, nuk kanë shtrirje emrat e tillë. Kurse te abetaret tjera kemi një numër të emrave oriental. Shih. tabelën me numër 8 dhe tabelën me numër 12.

Tabela 12

Emrat oriental në abetare

Nr.	Abetare 1945	Abetare 1946	Abetare 1947	Abetare 1948	Abetare 1951
1	Rexhepi	Ramizi	Njaziu	Isai	Nushi
2	Zejneli	Ymeri	Zejneli	Samiu	Naime
3	Njaziu		Ganiu	Osmani	Milaimi
4	Isaki		Avdyli	Musai	Nuri
5	Xhemilja		Xhemili	Rasimi	Kameri
6	Veliu		Veliu	Zija	Kemali
7				Tajar	Tahiri
8				Bajram	Talati
9				Dalipi	Omeri
10				Kamberi	Taipi
11				Ymeri	Veliu
12				Qamili	Ganiu
13				Qemaili	Zehraja
14				Qerimi	Zija
15				Ganimetja	Ramizi
16				Abdullahi	Samiu

17				Murati	Sanija
18				Ramizi	Dauti
19					Qerimi
20					Rrahimja
21					Njazi
22					Zymeri
Gjithsej	6	2	6	18	22

Tabela 13

Emrat oriental në abetare

Nr.	Abetare 1955	Abetare 1966	Abetare 1967	Abetare 1977	Abetare 2008
1	Naimi	Naime	Naime	Aliu	Ganimetja
2	Emini	Emine	Emine		Naimi
3	Alija	Dauti	Dauti		Xhevdet
4	Taipi	Ymeri	Ymeri		Xhemile
5	Halili	Ganiu	Ganiu		
6	Halimja	Xhaviti	Xhaviti		
7	Kemaili	Aliu	Aliu		
8	Hakiu	Emini	Emini		
9	Veliu	Kemaili	Kemaili		
10	Sadiki	Jakupi	Jakupi		
11	Selimi	Qazimi	Qazimi		
12	Sanija				
13	Zeneli				
14	Ramizi				
15	Qemali				
16	Rrahimi				
17	Rrahmani				
18	Ymeri				
19	Ylfetja				

21	Sherifi				
22	Xhemilja				
23	Xhaferi				
24	Xhaviti				
25	Duraki				
Gjithsej	25	11	11	1	4

Prejardhjen e disa prej këtyre emrave oriental e shpjegojmë duke u mbështetur te fjalorët e orientalizmave, te disa autorëve tone. Në abetaret tona i kemi gjetur këta emra që kanë këtë shpjegim si: “Naim-i emër vetanak. Në onomastiken tonë, Naime-ja të jetuarit me të gjitha të mirat, gjendje e lumtur; një pjesë e parajsës myslimane. Emri Hasan, Imam Hasani, i biri i Aliut dhe Fatimes, nipi i Profetit Muhamed a.s. Emri Sadik, i drejtë, i saktë, njeri që mban besën e dhënë, besnik, bestar, shtyllak” (Dizdari, 2005). “Emri Veli, arabisht mik, ndihmës”. Emri Xhafer, arabisht Xha’far “lumi vogël, përroskë”. Emri Halime, arabisht “E butë”. Emri Xhemile, arabisht. “bukurije”, Emri Taip,-i (arabisht. Tajjib “i mirë i përshtatshëm)” (Metaj, 2009).

Nga prania e emrave oriental në abetare, nxjerrim përqindjen e këtyre emrave nga viti 1945-2012. Duke filluar nga abetarja e vitit 1945 me 9% e deri te abetarja e vitit 1951 me 29 %, të emrave në abetare janë oriental. Për më shumë, shih tabelën numër 14.

Tabela 14

Përqindja e emrave oriental në abetare

Abetaret	Përqindja
Abetare 1945	9%
Abetare 1946	5.2%
Abetare 1947	10%
Abetare 1948	27%
Abetare 1951	29%
Abetare 1955	22%
Abetare 1966	11%
Abetare 1967	11%

Abetare 1977	1.1%
Abetare 1982	0%
Abetare 2003	0%
Abetare 2008	3,70%
Abetare 2012	0%

4. Emra të dalë nga ndonjë emër tjetër

4.1. Antroponimet e dala nga emra të vendeve

Një ndër karakteristikat e antroponimeve në Kosovë është se kemi shumë njerëz që janë emërtuar me emra të qytetesh, fshatrash, ujërave, maleve që gjenden në Shqipëri. Kjo ndarje e tokave shqiptare ka mbjellë dashuri dhe më të madhe në mes shqiptarëve dhe ka ngritur motivin për emërtim të fëmijëve me emra gjeografik që gjenden jashtë kufijve. Kjo shihet edhe në abetaret tona si:

- Në abetaren e vitit 1966, kemi këta emra: Çajupi ,Valbona, Migjeni,
- Në abetaren e vitit 1967, kemi këta emra: Çajupi, Valbona, Migjeni,
- Në abetaren e vitit 1977, kemi këta emra: Sharri, Drini, Tomori,
- Në abetaren e vitit 1982, kemi këta emra: Tomori, Çajupi,
- Në abetaren e vitit 2003, kemi këta emra: Tomori, Joni, Çajupi, Valbona, Erina trajta femërore e emrit Erind është një fshat, vendbanim i vjetër, në rrethin e Gjirokastrës. (Zoto, 2016), Aulona, Vlora e lashtë quhej Aulona,
- Në abetaren e vitit 2008, kemi këta emra: Driloni, Rozafa, Lura,
- Në abetaren e vitit 2012, kemi këta emra: Drini, Holta, Kledi (Zoto, 2016).

Emri Çajupi, emër mashkullor me prejardhje nga emri i një maje të malit të Lunxherisë në rrethin e Gjirokastrës. Valbona, emër femëror me prejardhje nga emri i një lumi me ujëra të kthjellët në alpet e Shqipërisë Veriore, dega më e madhe e lumit Drin, Drini, emër mashkullor me prejardhje nga emri ilir i lumit më të madh të Shqipërisë, Holta (është emër fshati dhe lumi në rrethin e Gramshit),

Kledi (emër mashkullor që formohet nga emri Cledo, sikurse quhej Ohri gjatë shekujve të parë të sundimit romak (Zoto, 2016).

Rëndësia pedagogjike e këtyre emrave qëndron në karakterin kombëtar, duke ndikuar në njohjen e këtyre vendeve, ujërave, maleve të Shqipërisë dhe nxitjen e atdhedashurisë. Me përpjekje për të prekur sferën intelektuale, emotive dhe edukative të nxënësve. Qëllimi (intenca) e këtyre emrave është dhe motivimi për një njohje më të thellë, nxitjen e hulumtimit për t'i njohur më shumë në mënyrë të pavarur, tani, apo në një shkallë më të larta të shkollimit. Këta emra ndikojnë në edukimin kombëtar, krijimin e ndjenjës së përkatësisë, dashurisë për bukuritë e vendit dhe ngritur kështu vetëdijen kombëtare.

4.2. Emra, trajta të dala vetëm nga pjesa e parë e emrit

Në abetare ka dhe emra, trajta të dalur vetëm nga pjesa e parë e emrit. Emra të përveçëm, trajta të dala nga pjesa e parë e emrit i gjejmë në shumicën e abetareve. Emrat, Luli dhe Lili nga viti 1945-1977, e gjejmë të pranishëm në të gjitha abetaret, kurse emrin Ani e gjejmë prej vitit 1982 deri 2012.

- Abetarja e vitit 1945: Lili nga Liljana, Luli nga Lulzim, Eli nga Elizabeta ose Eliona, Mina nga Minaza, Hila nga Hilara.
- Abetarja e vitit 1947: Lili nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim, Roza nga Rozafa.
- Abetarja e vitit 1948: Lili nga Liljana.
- Abetarja e vitit 1951: Lili nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim.
- Abetarja e vitit 1955: Lilë nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim, Çeli nga Çelin, Mara nga Marashe.
- Abetarja e vitit 1966: Lili nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim.
- Abetarja e vitit 1967: Lili nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim, Leon nga Leonatishi, Tana nga Tanusha.
- Abetarja e vitit 1977: Keli nga Kelsian, Lili nga Liljana, Luli nga Luljeta dhe Lulzim, Leon nga Leonat, Tana nga Tanusha.
- Abetarja e vitit 1982: Ani nga Anili (emër ilir) Alma nga Almarina (emër vendi), Zani nga Zanushi (fjalë shqipe), Fito nga Fitoni (fjalë shqipe), Keli nga Kelsian.

- Abetarja e vitit 2003: Ani nga Anili (emër ilir), Ana është trajta e dal nga fjala shqipe Anadet ose Anamal.
- Abetarja e vitit 2008: Ani nga Anili (emër ilir).
- Abetarja e vitit 2012: Ani nga Anil ose Anid, Albi nga Albin, Dasara nga Dasareta, Edlira nga Edliriana, Ori nga emri Orik, Rei nga emri Reis, Keli nga emri Kelian. (Zoto, 2016)

4.3. Emra, trajta të dala nga pjesa fundore e emrit

Këta emra vetanake në abetare, pavarësisht nga origjina e tyre apo përkatësia fetare, vijnë nga shkurtimi i trajtave pa ndonjë ndërrim tjetër tingullor.

- Abetarja e vitit 1945: Miti nga Hamiti, Meti nga Mehmeti, Neli nga Zeneli, Limi nga Selimi, Sifi nga Josifi, Leta nga Violeta,
- Abetarja e vitit 1947: Meti nga Muhameti,
- Abetarja e vitit 1966: Miti nga Hamiti, Meti nga Mehmeti, Neli nga Zeneli, Limi nga Selimi, Sifi nga Josifi, Leta nga Violeta, Toni nga Jetoni,
- Abetarja e vitit 1967: Toni nga Jetoni,
- Abetarja e vitit 2008: Dona nga Dodona, Rita nga Margarita,
- Abetarja e vitit 2012: Linda nga Majlinda, Ola emri Driola, Rita nga Margarita dhe Merita, Tina nga Valentina, Kristina, Tiku nga Adriatiku, Gimi nga Agimi.

4.4. Emra me shkurtime cunime të ndryshme në abetare.

Këta emra janë fituar nga cunime dhe ndërrime të ndryshme tingullore të tipit të gjuhës fëmijërore. Në të gjitha abetaret nuk ka numër të madh të cunimeve të tilla, kryesisht është pëndorur emri Ceni dhe Cani. Mirëpo, marrë në përgjithësi, nuk janë shumë emrat e tillë në abetaret tona në Kosovë.

- Abetarja e vitit 1945: Ceni nga Hysen,
- Abetarja e vitit 1946: Ceni nga Hysen, Dini nga Abedini, Titi nga Petriti,
- Abetarja e vitit 1948: Ceni nga Hysen,
- Abetarja e vitit 1951: Ceni nga Hysen, Cani nga Hasani, Sula nga Sulejman, Lena nga Maddalena dhe Helena,

- Abetarja e vitit 1955: Ceni nga Hysen,
- Abetarja e vitit 1966: Ceni nga Hysen, Cani nga Hasani,
- Abetarja e vitit 1967: Ceni nga Hysen, Cani nga Hasani,
- Abetaret e viteve 1977, 1982 dhe 2003: Ceni nga Hysen,
- Abetareja e vitit 2008: Lora nga Laura, Lola nga Dolores,
- Abetarja e vitit 2012, Kledi forma e re e emerit Cledo, sikurse quhej Ohri gjatë shekujve të parë të sundimit romak, Roni dhe Rona nga Rovena (Zoto,2016)

5. Emra të dalë nga toponime

5.1. Emra të dalë nga Oronimet

Oronimet apo emrat e maleve, fushave, kodrave, i gjejmë vetëm te abetarja për të rritur e vitit 1946: Malet e Mirditës, Dibrës, Lumës, Krasniqës.

Abetarja e vitit 1948, kemi këta emra që flasin për fushat pjellore që janë hambar si, Vojvodina (Banat, Baçka, Baranja) e Srem, Senverija e Maçva, Posavina, Podravina e Megjumurja, po ashtu edhe fusha e Kosovës dhe e Metohisë.

5.2. Emra të dalë nga Hidronimet

Hidronimet apo emra të ujrave në përgjithësi, nuk kemi shumë në abetaret tona.

Abetarja e vitit 1946: Drini i Bardhë, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit dhe Bistrica e Prizrenit.

Abetarja e vitit 1948: “thuhet se fusha e Kosmetit përshkohet prej një seri lumenjsh që janë: Drini i Bardhë i cili buron prej malit të Zhlebit. Në të derdhen këta lumej: Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit dhe Bistrica e Prizrenit, Bistrica e Istokut, Ereniku, Deviqi. Të tanë këta lumej, lagin fushën e Metohisë, kurse fusha e Kosovës përshkohet prej lumit Sitnica, Shtimja, që buron prej kënetave Sazlije. Në Sitnicë derdhen lumej ma të vegjël sikurse Shtimja, Drenica, Janjeva, Graçanka dhe Llapi” (Gjevori&Veliu&Kostari&Paçarizi, 1948) si dhe Neretva, Danubi, Drava, Morava, Vardari, Liqeni i Shkodrës.

Abetarja e vitit 2008: e kemi lumin Shkumbini.

Emrat në abetaret kanë ndikim edukativ

5.3. Emra të dalë nga Patronimet

Patronimet apo emrat familjar në përgjithësi nuk ka shumë në abetare, ato kryesisht i gjejmë te pjesa e tretë e librit që ka të bëjë me përforsimin e leximit dhe shkrimit.

Te abetarja e vitit 1945, janë këto patronime si: Gjika, Keçi, Ndroqi, Kuqi, Marashi. Abetarja e vitit 1946, i ka këta mbiemra familjar: Mihajloviçin, Agushi, Deva, Hoxha, Sadiku, Vukeniroviç, Curri, Noli, Zogu, Kryeziu, Qemajlit.

Te abetarja e vitit 1947 kemi këto patronime: Bardhi, Dardani.

Abetarja e vitit 1948: Bardhi, Popoviç, Llakiçeviq, Milani, Obradoviç, Terbeshi, Kastrati, Gorani, Osmani, Sadiku, Vukmiroviç.

Abetarja e vitit 1977: Hajdini.

Abetarja e vitit 1982: Ramizi.

Abetarja e vitit 2003: Urti dhe Blini.

Kurse abetaret e këtyre viteve nuk kanë si: 1951, 1955, 1966 ,1967, 2008 dhe 2012.

5.4. Emra të dalë nga Toponimet

Toponimet apo emrat e vende, duke qenë se kemi një fond emrash të tillë në abetare, gjatë analizës së tyre i kemi ndarë në dy grupe në: oikonimet apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, fshatra, lagje etj.), dhe etnonimet, emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore.

5.5. Emra të dalë nga emrat e vendbanimeve

Emrat e vendbanimeve (oikonimet), janë emra që gjenden pothuajse në të gjitha abetaret përveç te abetarja e vitit 2003. Por, nuk janë të shumtë në numër. Te abetaret e këtyre viteve 1966, 1967, 1977 nuk kemi emra vendesh. Te abetarja e vitit 1948 kemi më së shumti oikonime, që përfshijnë emra të vendeve nga territori i ish-Jugosllavisë.

- Abetarja e vitit 1945 i gjejmë këto vendbanime si: Tirana, Durrësi,
- Abetarja e vitit 1946: Peja, Drenica, Prishtina, Gjakova, Kruja, Lezha,
- Abetarja e vitit 1947: Peja, Prizren, Shamac, Koshutnjak, Nikshiq, Titograd,

- Abetarja e vitit 1948: Prizreni, Gllgovci, Krushë e Madhe, Kumrovec, Pishçe, Janjeva, Sllatina, Prishtina, Gjakova, Ferizai, Gilani, Trepça, Kllanjaçka, Rezhevinë, Shumadi, Kragujevci, Bella Cërkva, Birçe, Bellopavliq, Kelmendi, Landovica, Magjer, Zagorje, Zveçan, Novoberda (Artana), Gollesh, Pejë, Shkup, Cetinë, Lubjanë, Has, Opojë, Dragash, Ajvali, Brezne,
- Abetarja e vitit 1951: Drenovc, Rrenc, Rugovë, Pejë, Zhuri, Xërxë,
- Abetarja e vitit 1955: Zhuri, Prishtina,
- Abetarja e vitit 1982: Landovic, Dukagjini,
- Abetarja e vitit 2008: Peja, Pogradeci, Skënderaj, Ersekë, Cerralevë, Negroc, Cerovikë, Drenoc, Sharr, Shkabë, Prishtinë, Puka, Presheva, Kosova, Prizreni, Brezovica, Bardhoshi, Vlora, Gjakova, Tetova, Theranda,
- Abetarja e vitit 2012: Gjlani, Gjirokastra, Gjakova, Vlora, Presheva, Tetova, Prishtina, Tirana.

5.6. Emra të dalë nga Etnonimet

Etnonimet (apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore), në abetare janë:

- Abetarja e vitit 1946: Jugosllavia, Shqipria, Bashkimi Sovjetik, Kosmeti, Kosova e Metohija, Serbia, Vojvodina, Bosnje Hercegovina,
- Abetarja e vitit 1947: Jugosllavia, Mali i Zi,
- Abetarja e vitit 1948: Gjermanët, Shqiptarët, Malazezet, Serbët, Rusë, Sovjetikët, Kroatet, Maxharët. Disa nga shtetet dhe nëndarjet administrative si, Jugosllavia, Shqipria, Bashkimi Sovjetik, Kosmeti, Kosova e Metohija, Serbia, Vojvodina, Bosnje, Hercegovina, Sllovenia, Kroacia, Novi Sad, Zagrebi, Lubjana, Beogradi, Berlini, Gjermania, Krahina e Kosmetit.
- Abetarja e vitit 1951: Jugosllavia, Shqiptar, Serbë, Malazezë,
- Abetarja e vitit 1955: Shqiptar, Serbë, Malazez, Jugosllav,
- Abetarja e vitit 2012: Austria, Vjena.

Në abetaret e viteve, 1966, 1967, 1977, 1982, 2003 dhe 2008 nuk kemi emra të shteteve as të kombeve, etj.

5.7. Emra të dalë nga emrat përkëdhelës

Emrat përkëdhelës nuk zënë shumë vend në abetaret tona, kemi pak emra të tillë si:

- Abetarja e vitit 1977 dhe 1982: Emrit Ermal i shtohet pjesa fundore ush dhe bëhet nga Ermal në Eramalush.
- Abetarja e vitit 2003: Emrit Gjin i shtohet pjesa fundore ush dhe bëhet Gjinush.
- Abetarja e vitit 2008: Emri Mic bëhet Micaku.

5.8. Emra që shprehin dëshirë

Emrat që shprehin dëshirë, janë emrat më të shumtë në numër nëpër abetare. Këta emra kanë për qëllim krahasimin e fëmijëve me të bukurën, me të fortën, me të bardhën, me krenarinë, me forcën, me guximin, me mençurinë, etj. Janë emra që synojnë një orientim pozitiv të fëmijëve dhe motivim që ata të sillen, të bëhen si emrat e tyre. Te këta emra qëndron motivi i dëshirës, ku me anë të emrit të zgjedhur, dëshirohet që fëmija dhe jeta e tij, të jetë e gëzuar, e lumtur, e lirë, e shëndetshme, e gjatë, e begatë etj. Si për shembull emrat: Fatmiri-ka kuptimin fat të mirë, që i ecë shumë fati, që është më fat. Fatosi, kuptimin e një trimi të fortë, një kreshniku. Petriti, nënkupton një njeri trim, të fuqishëm, të shkathët e guximtar. Pëllumb, emri i një shpendi, që mbahet si simbol i butësisë, i pastërtisë, i bukurisë dhe i paqes. Sokoli, djalë shtathedhur, trim e i zoti. Gazmendi, që vjen nga një emër i përgjithshëm, me kuptimin e një gëzimi të madh, të një hareje. Gjeraqinë, që figurativisht, ka kuptimin “Sokoleshë, e shpejtë dhe e shkathët”. Hekurani, emër me prejardhje nga emri i përgjithshëm hekur, me kuptimin i “i fortë si hekur”. Krenari, nga mbiemri i shqipes krenar, i cili ka kuptimin “që e çmon dhe e nderon vetveten, që kënaqet me arritjet e tij. Urta vjen nga urtia (dituri, dije). Visari, në gjuhën shqipe emri visar ka kuptimin e thesarit. Vegimi i cili ka kuptimin “ëndërrim”, por dhe zbardhëllim, agim i ditës. Xhevahiri ka kuptimin e gurit të çmuar, diamant, brilant, në gjuhën shqipe figurativisht, ka kuptimin njeri shumë i mirë, i dashur, i sjellshëm, zemërmirë” (Zoto, 2016). Emrin Shota e gjejmë në abetare dhe ky emër vjen nga emri i heroines Shotë Galica. Emrat që shprehin dëshirë i kemi në të gjitha abetaret, si:

- Abetarja e vitit 1945: Agimi, Bujari, Bashkimi, Drita, Dita, Flutura, Fatmiri, Fatmirja, Fatoni, Luani, Lulja, Petriti, Shega, Vera, Ylli, Ylberi.

- Abetarja e vitit 1946: Drita, Fatmiri, Fatoni, Sokol, Sofia.
- Abetarja e vitit 1947: Agim, Bujari, Bashkimi, Drita, Gazmendi, Luani, Lulja, Petriti, Shpend, Vera, Ylli, Ylberi, Zana.
- Abetarja e vitit 1948: Agimi, Bardhi, Besa, Dita, Drita, Fatmiri, Gazmendi, Vesa, Ylli, Zana.
- Abetarja e vitit 1951: Agimi, Bujari, Burbuqja, Bardhi, Bashkimi, Drita, Fatoni, Fatmiri, Kujtimi, Petriti, Shqipja, Vera, Ylberi.
- Abetarja e vitit 1955: Afrimi, Agimi, Bardhi, Burimi, Besa, Drita, Fatoni, Fatmiri, Jeta, Luani, Lulja, Mani, Shpendi, Vera, Vjollca, Zana.
- Abetarja e vitit 1966: Astriti, Afrimi, Agimi, Agroni, Arsimi, Bardhi, Bekimi, Bujari, Blerimi, Besniku, Besimi, Dritoni, Dijs, Elita, Fatosi, Fatmirja, Fatoni, Fatmiri, Gazmend, Jetoni, Jeta, Luani, Luljeta, Lumnija, Merita, Petriti, Sokoli, Shpëtimi, Shqipja, Shpendi, Vera, Ylli, Zana.
- Abetarja e vitit 1967: Agroni, Arsimi, Afrimi, Astriti, Agimi, Bardhi, Bekimi, Bujari, Blerimi, Besniku, Besim, Dritoni, Dijs, Elita, Fatmiri, Fatoni, Fatosi, Fatmirja, Gazmend, Jetoni, Jeta, Luani, Luljeta, Lumnija, Merita, Petriti, Sokoli, Shpendi, Shpëtimi, Shqipe Vera, Ylli, Zana.
- Abetarja e vitit 1977: Astriti, Bekim, Blerta, Drita, Fatmir, Fatos, Flutura, Lulja, Guri, Luani, Mirja, Petriti, Urimi, Selvija, Shpresa, Shpetim, Vera, Vullneti, Visari, Vjollca, Xhevahiri, Ylberi, Ylli, Yllka, Zana.
- Abetarja e vitit 1982: Agimi, Bujari, Blerimi, Blerina, Blerta, Burbuqja, Çelikani, Çlirimtarja, Drita, Dritani, Dukagjini, Dhurimi, Flora, Florini, Gonxhe, Gjeraqina, Hekurani, Jehona, Jeta, Jetoni, Krenari, Liria, Luani, Lule, Lirimi, Lulmali, Lira, Liraki, Miri, Mira, Mirani, Mirashi, Merita, Njomza, Petriti, Premtina, Qershorja, Rroni, Rrita, Samirja, Sokoli, Shega, Thesari, Vala, Visari, Vetoni, Vegimi, Zana.
- Abetarja e vitit 2003: Arlindi, Arjeta, Agimi, Agimja, Berbuqe, Bardhi, Burimi, Blerimi, Bujari, Bleta, Drita, Dritani, Ermira, Ejona, Ëndrra, Fatoni, Fatmirja, Gëzimi, Gëzimja, Gazmendi, Gazmori, Gjeraqina, Hekuran, Hënoren, Jehona, Jetoni, Krenari, Lulzimi, Liria, Miri, Mirana, Miraku, Mirani, Njomza, Qershorja, Puhia, Premtime, Petrit, Rrushja, Sokoli, Shega, Shpetimi, Shpresa, Thesari, Urta, Urimi, Valoni, Vala, Visari, Vesa, Vetoni, Vegimi, Ylberi, Ylli, Ylberina, Yllnori, Zana, Zamiri, Zamira.

- Abetarja e vitit 2008: Ardit, Blerina, Bardhi, Donjeta, Edona, Fatoni, Flutura, Heroina, Hanë, Kroni, Lulevera, Liria, Luani, Lumnia, Liridona, Murlani, Mirani, Miri, Njomza, Pranvera, Petriti, Pëllumbi, Rrita, Sokoli, Shendi, Urtina, Urata, Valoni, Valmira Vesa, Ylber, Zana, Zamira, Manjolla, Jasemin.
- Abetarja e vitit 2012: Bora, Blerina, Bardhi, Besniku, Buqja, Bashkimi, Besimi, Dhurata, Fatmiri, Fitorja, Hëna, Jetmiri, Luli, Miri, Mira, Pranvera, Shpresa, Shota, Shpëtimi, Urimi, Valoni, Zamiri.

Të gjithë këta emra kanë kuptim të qartë. Emrat kryesisht rrjedhin nga flora (emra drurësh, bimësh, lulesh etj), nga fauna (emra kafshësh, shpendësh, etj), emra konkretë (emra sendesh), emra abstraktë dhe emrat që krijohen përshtetë me bashkimin e foljes “do”, me emrin “jetë”- Donjetë, emrin “Urim” ka prejardhje nga emri përgjithshëm i gjuhës shqipe urim, që vjen nga folja uroj etj.

Përmes studimit të emrave mund të njihet realiteti shoqëror, politik, gjendja arsimore në shkollat tona, ndikimi ideologjikë e shumë çka tjetër në të kaluarën dhe sot. Gjatë hulumtimit gjejmë se emrat në abetare janë përcaktuar nga disa faktorë si: gjuha shqipe, ndjenja kombëtare, prejardhja (përcjellja e emrave ilirë), besimi fetar (emrat krishter dhe oriental për besimtarët islam), nderimi për Shqipërinë (emrat e qyteteve, fshtrave, lumenjve, detrave etj,) ndikimi politik (emrat sllav, nga abetarja e vitit 1946-1999, gjejmë emra sllav, në çdo abetare të këtyre viteve është i pranishëm emri i Josip Broz Titos, si dhe në disa abetare emri i heroit Boro Vukmirovic), viti i botimit, politikat arsimore të kohës, kujt i dedikohet abetarja, (për të rritur, apo fëmijëve) moda dhe zhvillimet shoqërore (emrat ndërkombëtar, figurat e ekranit etj).

Në bazë të këtij hulumtimi, abetaret i ndajmë në tri periudha, si:

-Përiudha e parë e cila përfshin abetaren e parë të vitit 1945 e cila është sjellë nga Shqipëria në Kosovë. Abetarja ka frymë kombëtare. Në abetare kemi këto lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe, emra ilirë, emra katolikë dhe emra oriental.

-Përiudha e dytë, i përfshinë abetaret e botuara në ish Jugosllavi, nga viti 1946-1999. Dhe pse janë abetaret e të njejtës periudhë, kanë lloje të ndryshme të emrave. Këta emra lidhën edhe me ndryshimet politike dhe shoqërore të kohës. Në bazë të llojit të emrave, abetaret e kësaj periudhe i ndajmë në katër grupe si:

Grupi i parë, përfshin abetaret e vitit 1946, 1947 dhe 1948. Abetaret e vitit 1946 dhe 1947 janë abetare për të rritur. Emërues i përbashkët i këtyre tri abetareve është se janë në ndikimin e politikës jugosllave. Abetaret karakterizohen me rënie të emrave shqip dhe rritje të emrave sllav dhe vendbanimeve nga Jugosllavia e atëhershme.

Grupi i dytë, i përfshinë abetaret e vitit 1951, 1955. Për dallim nga grupi paraprake, te këto abetare shihet tendenca për ngritje të emrave nga fjalë shqipe edhe emrave oriental. Në këto abetare kemi këto lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe, emra ilirë, emra katolikë dhe emra oriental. Emra sllav në këto abetare nuk ka.

Grupi i tretë, këtë etapë e përbëjnë abetarja 1966, 1967 dhe 1977. Abetarja e vitit 1966 dhe 1967 i kanë emrat e njëjtë sepse abetaret janë të njëjta për kah përmbajtja, autori i njejtë por, dallojnë vetëm nga rendi i perpunimit të leximit dhe shkrimit. E përbashkëta e tri abetareve është se kanë dukshëm rritje të emrave nga fjalë shqipe për dallim nga abetaret paraprake dhe emrat ilirë, bie numri i emrave të oriental dhe emra sllav nuk ka.

Grupi i katër, përfshin abetaret nga viti 1982 deri 1999, këto vite janë të autorit Qamil Batalli. Këto abetare karakterizohen vetëm me dy lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe dhe emra ilirë. Nuk ka emra sllav as oriental.

Përiudha e tretë, përfshin abetaret nga viti 2000-2012 të botuara në liri. Kemi abetaren e vitit 2003, abetaren e vitit 2008 dhe Abetaren mbarëkombëtare të vitit 2012. Te këto abetare ndihet fryma e lirisë. Abetaret kanë emra shqip, por edhe të huaj, ndërkombëtarë, të ndikuar nga letërsia, arti, radio-televizioni, kinematografia, sporti, moda etj. Po ashtu shihet tendenca për edukimin gjeografik të fëmijëve sepse kemi emra të vendbanimeve nga të gjitha trojet etnike shqiptare dhe pak të vendeve evropiane.

Abetaret shqipe në Kosovë, janë një pasqyrë e shkollës dhe jetës së ne shqiptarëve. Janë tekste që ndihmuan arsimin e popullit tonë. Emrat në abetare, prejardhja dhe historia e tyre, janë të lidhura ngushtë me historinë e popullit, me gjuhën dhe kulturën material e shpirtërore. Përmes hulumtimit të emrave zbardhet e shkuara e arsimit tonë, po ashtu dhe llojet e emrave në abetare në të kaluarën dhe sot.

VI. ANALIZA DIALEKTORE E ABETAREVE

Në çdo vend, gjuha paraqitet me degëzime sipas krahinave, në mënyrë që edhe pse e kuptojnë njëri-tjetrin, folësit e njëjës krahinë dallohen nga ata të një tjetër. Kështu që dhe shkrimet në gjuhën shqipe i gjejmë në dy dialekte, rast i tillë kemi te abetaret e botuara në Shqipëri ku kemi abetare toskërisht dhe gegërisht. Në gjuhën shqipe pra, dallojmë dy degë të mëdha që u përgjigjen dy ndarjeve të etnikumit shqiptar në baza territoriale: gegërishtja ose dega e trojeve shqiptare që shtrihen në Shqipërinë Veriore ose në Gegëri dhe toskërishtja ose dega e trojeve shqiptare që shtrihen në Shqipërinë Jugore ose në Toskëri. Gegërishtja dhe toskërishtja janë dy variante të së njëjtës gjuhë kombëtare: të shqipes, ashtu si dhe bartësit e tyre shqiptarët janë pjesë përbërëse të së njëjtës etni, e të njëjtit komb: kombit shqiptar (Shkurtaç, 2010).

“Nga pikëpamja gjuhësore, dialekti nuk ka dallime nga gjuha: secili dialekt i shqipes i marrë në vetvete, qoftë gegërisht, qoftë toskërisht, mund të quhet gjuhë shqipe. Vetë gjuha letrare kombëtare nuk është tjetër veçse një dialekt që është përkrahur dhe është ngritur në përdorim nga i gjithë kombi, nga e gjithë bashkësia shoqërore përkatëse” (Gjinari&Shkurtaç, 2003).

Kemi disa përkufizime për dialektin si:

“Dialekti është gjuha e një krahine, rajoni apo qyteti në krahasim me gjuhën e përbashkët të mbarë kombit”. “Dialekti është një copë a pjesë tërësore e saj, një sistem komunikimi i kryer dhe i pavarur, ndonëse ka një numër më të kufizuar folësish. Vetë gjuha letrare kombëtare nuk është tjetër veçse një dialekt që është përkrahur dhe është ngritur në përdorim nga i gjithë kombi, nga e gjithë bashkësia shoqërore përkatëse” (Gjinari&Shkurtaç, 2003).

“Dialekti është një variant i një gjuhe i cili shërben si mjet komunikimi për një kolektiv pak a shumë të vogël njerëzish, përfaqësuesit e të cilit kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta në një territor të caktuar” (Gjinari, 2010).

“Variant i gjuhës i cili përdoret nga një grup njerëzish që banojnë në një truall pak a shumë të kufizuar ose që i takon një shtrese shoqërore të caktuar” (FGJSH, 2006).

Në shkrimet e gjuhës tonë shqipe, në shumë qartë i gjejmë dy dialektet “është e vërtetë se kur flitet tek shkrimi i shqipes, që në dokumentet e para të saj, ligjërimi shqip del i koinezuar, kryesisht në fytyrë të një dialekti: gegërisht ose toskërisht, shtrirja e të cilëve si atëherë edhe sot, del pothuajse me kufij të qartë gjeografik: gegërishtja në Gegëri, d.m.th. në Veriun e Shqipërisë dhe toskërishtja në Toskëri, d.m.th. në Jug të Shqipërisë” (Veselaj, 2015).

Një shtysë të fortë këtyre proceseve pozitive të zgjidhjes së drejtë të drejtshkrimit, thuhet të stabilizimit të gjuhës letrare shqipe i dhanë vendimet e Konsultës Shkencore të Prishtinës (1968), si rezultat i zhvillimit kulturor të shqiptarëve dhe i përpjekjeve të vetëdijshme të punonjësve të kulturës, të arsimit dhe të shkencës. “Veçoria e afrimit a e konvergencës së dialekteve shkrimore të shqipes, që i përshkonte gjithë përpjekjet në fushën e krijimit të një gjuhe letrare e të përbashkët shqipe në Kongresin e drejtshkrimit që zhvilloi punimet në nëntor 1972 në Tiranë. Që nga këto dy ngjarje me rëndësi të dorës së parë në kulturën shqiptare (1968, 1972), gjuha e njësuar letrare shqipe ka zënë e po përvetësohet dhe po zbatohet nga të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë të bëjnë me gjuhën: në shkolla-fillore e të mesme, në Universitetin e Prishtinës, në institucionet botuese e në organet të tjera të shtypit (Ajeti, 1980).

Gjatë analizës së abetareve në Kosovë, shohim se nga abetarja e vitit 1945, duke përfshirë edhe abetaret e Ramiz Hoxhës me të cilat kanë mësuar nxënësit deri në vitin 1970, janë hartuar në dialektin gegë. Kurse nga Abetarja e vitit 1972, abetare kjo e cila u ribotua në bazë të lejes së “Pleqësisë së Arsimit të Krahinës Socialiste të Kosovës” dhe sipas botimit të Shtëpisë botuese të Librit Shkollor, Tiranë, 1972, me ndryshime fare të vogla (Alaj, 1972). Po ashtu, te revista “Shkëndija” përmenden librat e botuar dhe që janë lejuar të përdoren në shkolla për vitin shkollor 1972-1973, për klasën e parë përveç librave të tjerë, kemi tri abetare, a) Ramiz Hoxha Abetare-Metoda e zhvillimit paralel të shkronjave të shtypit dhe të

shkrimit, b) Abetare-Metoda e zhvillimit veçmas të shkronjave të shtypit dhe shkrimit, 3) Kolë Xhumari, G. Bardhia, A. Lakuriqi Abetare (Zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të shkrimit). Për dy abetaret e para janë ribotim, kurse abetarja e tretë është botim i ri i vitit 1972. (Nimonaj, 2014). Të dy abetaret e Ramiz Hoxhes janë shkruar me dialektin gegë kurse Abetarja e vitit 1972 është ribotim i abetares në Shqipëri. Që do të thotë të gjitha abetaret e botuara para Kongresit drejtshkrimor, janë në dialektin gegërisht deri te abetarja e Mehmedali Hoxhës e vitit 1977, që është shkruar sipas rregullave të Kongresit të drejtshkrimit. “Deri në vitin 1968, përveç ribotimeve të veprave të shkrimtarëve të jugut, në Kosovë nuk botohej asgjë në dialektin e toskërishtes. Në Konsultën e përfaqësuesve të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, e cila u mbajt në Prishtinë më 1968, u miratua kërkesa që gjuha e njësuar letrare kombëtare të përdoret edhe në Kosovë” (Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1980).

Gjuha në librin e Abetares mund të jetë një hapësirë që ngjallë interes për gjuhëtarët, pedagogët dhe mësimdhënësit në shkollat tona. Gjatë studimit të Abetareve, ne shohim se gjuha është shumë e pasur, me fjalë të bukura dialektore dhe krahinore, me fjalë të vjetra. Pikërisht këto fjalë nga dialekti gegë me të cilin janë hartuar abetaret tona para Kongresit Drejtshkrimor janë objekt i studimit.

1. Analizë fonologjike në abetaret deri në vitin 1972

Në gjuhën e sotme letrare shqipe tingujt (qofshin zanore, qofshin bashkëtingëllore), mund të pësojnë ndryshime gjatë përdorimit të tyre në të folur, përkatësisht, kur ata ndodhen në pozicione të ndryshme të fjalës ose të fjalisë. Pra, në aktin e të folurit, tingujt nuk përdoren të veçuar, por të bashkuar në një fjalë, prandaj edhe ndikojnë në njëri-tjetrin dhe kështu pësojnë edhe ndryshime që quhen **ndryshime fonetike**. (Ibrahimi...).

Këto ndryshime më të theksuara janë në gjuhën e folur (dialektet), që bën të dallohen dukshëm nga gjuha letrare, ngase gjatë ligjërimit, tingujt në rrokje të patheksuara, u shtrohen një reduktim sasiar, por edhe cilësor. Në këtë mënyrë zhvillohen procese dhe fenomene të ndryshme fonetike, që për gjuhësinë vërtetimi i tyre është me interes të veçantë.

1.1. Metafonia

Metafonia (greq. meta="pas", tjetër dhe phone "tingull"), quhet alternimi ose kalimi i zanores **a>e** të disa fjalëve dhe në rastin tonë kalimi i **a>ë**.

Bani>bëri, kambet>këmbët, asht>është, nana>nëna, ban>bën, hangër> hëngër, bahet>bëhet, bante>bëhet, gja>gjë, njana>njëra, gja>gjë, za>zë, dhambi>dhëmbi, andrra>ëndrra, gjana>gjëra, (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Asht>është, njani>njëri, dame>dëme, bani>bëri, land>lëndë, randa>rënda, njajtë>njëjtë, baj>bëj, gja>gjë, gjana>gjëra, (Gjevori, Kolgeci, Riza & Shpendi 1946).

Kamët>këmbët, nana>nëna, baj>bëj, za>zë, mramja>mbrëmja, dham>dhëmb, dhamin>dhëmbin, zani>zëri, gja>gjë, baj>bëj, dham>dhemb, bani>bëri, asht>është, hangren>hëngrën, njani>njëri, bahen>bëhen, ma>më, njana>njëra, banë>bëri, nana>nëna, bante>bënte, ama>ëma (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Nanën>nënë, landë>lëndë, ban>bën, asht>është, nxanë>nxënë, bajmë>bëjmë, (Gjevori, Veliu, Kostari & Paçarizi, 1948).

Kama>këmba, bahet>bëhet, nandë>nëntë, landë>lëndë, bani>bëni, nxanës>nxënës, ban>bën (Gjevori, Kostari, 1951).

Ba>bë, za>zë, kamba>këmba, banë>bënë, asht>është, bajnë>bëjnë, dhambët>dhëmbët, njani>njëri, hangra>hëngra, dhambë>dhëmbë, njana>njëra, ban>bën, e hanë>e hënë, (Gjevori, Shushka,1955).

Bajnë>bëjnë, asht>është, kamba>këmba, rand>rënd, kanda>kënda, damton>dëmton, ma>më, hangri>hëngri, damshëm>dëmshëm, bajnë>bëjnë, gja>gjë, (Hoxha, 1966).

1.2. Rënia e tingujve

Një veçori tjetër që hasim në abetare është edhe rënia e tingujve në fjalë. Ai haset dendur, si rezultat i mosshqiptimit të disa zanoreve nëpër rrokje të ndryshme të fjalës. Rënia bëhet në pozicione të ndryshme:

Në ballë të fjalës (Afereza): Gimi (<Agim), Dita (<Afërdita),

Në trup të fjalës (sinkopë): shpi (<shtëpi), shllung (<shtëllungë),

Në fund të fjalës (apokopë): erdh (<erdhi), pat (<pati), fjet (<fjeti).

Afereza

Fenomeni i aferezës është proces më i shpeshtë se sa ai i sinkopës dhe apokopës. Shembuj afereze hasim te emrat e përveçëm në formë hipokoristike me prejardhje orientale. P.sh.: Miti (<Hamiti), Meti (<Mehmeti), Neli (<Zeneli), Limi (<Selimi), Sifi (<Josifi), Leta (<Violeta) (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Meti (<Muhameti), pështue (<Shpëtue) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Maron (<mbaron) (Gjevori, Kostari, 1951).

Miti (<Hamiti), Meti (<Mehmeti), Neli (<Zeneli), Limi (< Selimi), Sifi (<Josifi), Leta (<Violeta), Toni (<Jetoni) (Hoxha, 1966).

Toni (<Jetoni) (Hoxha, 1967).

Dona (<Dodona), Rita (<Margarita) (Deva & Krasniqi, 2008).

Linda (<Majlinda), Ola (<Driola), Rita (<Margarita dhe Merita), Tina (<Valentina, Kristina), Tiku (<Adriatiku), Gimi (<Agimi), (Rrokaj, Gjokutaj, Krasniqi & Pozhegu).

Sinkopa

Sinkopa është rënia e tingujve në trup të fjalëve. Fenomeni i sinkopës është pak më i rrallë, megjithatë edhe kjo dukuri vërehet në abetare në disa raste:

Fëmijët (<fëmijët), vlla (<vëlla), shtëngata (shtrëngata), gjarpri (<gjarprin),uku (<ujku), (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Vllaznuen (<vëllazëruan), Shqipnis (<Shqipërisë), tradhtue (<tradhtuar), (Gjevori, Kolgeci, Riza & Shpendi, 1946).

Fëmi (<fëmijë), uku (<ujku), njerzvet (<njerëzve), vlla (<vëlla), emnin (<emrin), shpijat (<shtëpitë), dhimje (<dhimbje), msue (mësuar), gzue (<gëzuar), msojmë (<mësojmë), mësusi (<mësuesi), dhent (<dhënët), nxansit (<nxënësit) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Blue (<bluar), shkruie (<shkruare,) (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Amla (<ëmblla), antarët (<anëtarët), gjysë (<gjysmë), uku (<ujku), (Gjevori, Kostari, 1951).

Vlla (< vëlla), puntuer (<punëtor), kcy (<kërcye), hidhshin (<hidheshin), dliirë (<dëllirë), kënaqsis (<kënaqësisë), plotsu (<plotësuar), ejten (<enjten), msuesin (<mësuesin), argtue (<argëtue), grunë (<gruan), kcy (<kërcy), fëmijët (<fëmijët), hidhshin (<hidheshin), knaqsis (<kënaqësisë), plotsue (<plotësuar), lulojnë (<lulëzojnë) (Gjevori, Shushka,1955).

Përmirsue (<përmirësoi), friguem (<frikësuam), tregue (<treguar), udhtar (<udhëtar), shokt (<shokët), udhtar (<udhëtar), shokt (<shokët) (Hoxha, 1966).

Apokopa

Apokopa apo dukuria e rënies së tingujve në fund të fjalës është e përhapur në fjalë e shprehje të ndryshme. Në fund të fjalës mund të bie një zanore, një bashkëtingëllore apo edhe një grup tingujsh. Si më karakteristike është rënia e **e-së** fundore. Kjo është karakteristike e gjuhës shqipe, si për kah ruajtja e saj (sidomos tek folësit toskë), ashtu edhe kah rënia apo reduktimi i theksuar (karakteristike e gegëve) i këtij tingulli. Në dialektet e gjuhës shqipe në toskërishte ka /ë/ në serinë e zanoreve të theksuara e cila pothuajse i mungon gegërishtes, në shqipen letrare praktikohet që zanoret hundore të gegërishtes /a/ dhe /e/, në të shumtën e rasteve, jo vetëm në gjuhën e shkrimit, por edhe në atë të shqiptimit të zëvendësohen me barasvlerën /ë/. Rënia e **ë-së** sidomos në pozicionin fundor, duke shkaktuar kështu zgjatjen e zanores së fundit që ndodhet para saj, në abetare

kemi dhe raste të rënies së /ë/, në rrokje nistore të hapur, që fillon me bashkëtingëlloret sonate **l, m, n**.

Un (<unë), ban (banë), një (<një), nalt (<naltë), ban (banë), nat(<natë), gjith (<gjithë), shum (<shumë), kët (<këtë), zogjt (<zogjët), asht (<është), asni (<asnjë),lye (<lyer), (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Shum (shumë), asht (<ashtë), shkruar (<shkruan), lexue (<lexuan), një (<një), sigurue (<siguruar), shkatrrue (<shkatërruar), syt (< sytëi), fillu (< fillue), asht (<është), kët (<këtë), ret (< retë), ndonji (<ndonjë) (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Një (<një), yjt (<yjet), nxuer (<nxori), asht (<është), shum (<shumë), fjalt (<fjaltë), rroft (rrënoftë), djat (<djalë), gjith (<gjithë), kurr (<kurrë), mjer (<mjerë), dhem (<dhemb), zogjt (<zogjtë), kët (<këtë), femijt (<fëmijët), hudh (<hedhë) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Shum (<shumë), un (<unë), drith (<drithë), fëmi (<fëmijë), asht (është) (Gjevori, Velu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Shum (<shumë), dhent (<dhentë) (Gjevori, Kostari, 1951).

Pin (<pinë), qoj (<qojë), një (<një), shum (<shumë), ndi (<ndie), kcy (<kërcy), djat (<djalë), grunë (<gruan), luej (<luajë), mundue (<munduar), mbulue (<mbuluar), fillue (<filluar), livdue (<livduan), ndi (<ndier), gjithni (<gjithnjë), pushue (<pushuar), djat (<djalë), shkruar (<shkruan), asgjesue (<asgjësuar), fëmij (<fëmijë) (Gjevori, Shushka, 1955).

Shum (<shumë), një (<një), kët (<këtë), sëmu (<sëmur), fëmij (<fëmijë), hetue (<hetuan), sëmu (<sëmur), mij (<mijë), at (<atë), zogjt (<zogjtë) (Hoxha, 1966).

1.3.Kalimi i tingullit /ë/ në /a/

Kalimin e tingullit /ë/ në /a/ e gjejmë në abetaret tona, për shkak se është dukur e dialektit gegë me të cilin janë shkruar edhe abetaret deri në vitin 1972. Në disa abetare e

gjejmë më shumë këtë dukuri si te ato të viteve 1947, 1955, dhe 1966. Për një pasqyrim më të saktë të këtij kalimi të tingujve shohim në vijim:

Bante (<bënte), kanga (<kënga), ban (<bën), hangri (<hëngri), za (<zë), gja (<gjë), kambet (<këmbët), asht (<është), nana (<nëna), langu (<lëngu), bahesh (<bëshesh), gja (<gjë), bahet (<bëhet), dhambi (<dhëmbi), (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Asht (<është), njani (<njëri), dame (<dëme), ba (<bë), bani (<bëri), nanavet (<nënave), landë lëndë, randa (<rënda), bajnë (bëjnë), najtë <njëjtë), gja (<gjë), gjana (<gjëra), ashte (<është) (Gjevori, Kolgeci, Riza & Shpendi 1946).

Lâ-lë, kamët-këmbët, baj-bëj, za-zë, nanën-nënë, bani-bëri, ashtë-është, banë-bënë, bante-bënte, kanga-kënga, ma-më, ba-bë, ma kadalë-më ngadalë, ba (<bëj), kambet (<këmbët), tana (<tëra), gja (<gjë), bajnë (<bëjnë), landën (<lëndën), bahen (<bëhen), bajnë (bëjnë), ma (<më), njanën (<njëren), gjana (<gjëra), (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Nanën (<nënë), ban (<bën), landë (<lëndë), asht (<është), nxanë (<nxënë) (Gjevori, Veliu, Kostari & Paçarizi, 1948).

Landët (<lëndët), nxanës (<nxënës), ban (<bën), bahet (<bëhet), kama (<këmbla), amla (<ëmbla), bajnë (<bëjnë), (Gjevori, Kostari, 1951)

Ba (<bë), za (<zë), kambë (<këmbë), asht (<është), bajnë (<bëjnë), dhambët (<dhëmbët), gja (<gjë), bajmë (<bëjmë), bani (<bëni), shkamb (<shkëmb), hanë (<hënë), nxansave (<nxënësve), bajmë (<bëjmë), hangrën (<hëngrën), njizani (<njëzëri), njani (<njëri), kandshme (<këndshme), njana (<njëra) (Gjevori, Shushka, 1955).

Nana (<nëna), randë (<rëndë), bamë (<bërë), asht (<është), nxanës (<nxënës), bajshin (<bëjshin), damton (<dëmton), bani (<bëri), ba (<bë), zani (<zëri), kamba (<këmbla), randë (<rëndë), kangë (<këngë), ma (<më), damshme (<dëmshme), hangri (<hëngri), gja (<gjë) (Hoxha, 1966).

1.4. Kalimi i bashkëtingëllores /h/ në /f/

Në dialektin e Gegërishtes /h/ në pozitë të caktuar këmbëhet në /f/. Në bazë të analizës që ua kemi bërë abetareve, shohim se nuk ka shumë shembuj të kësaj dukurie dialektike, përveç në tri abetare, si ajo e vitit 1945, 1947 dhe 1955. Në këto tri abetare i gjejmë këto fjalë si:

Njef (<njeh), prefin (<prehin) (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Nifte (<njihte), njef (<njeh), ftofun (<ftohur), ngrofta (<ngrohta), shofim (<shohim) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Shifni (<shihni), njofin (<njohin), panjoftun (<panjohur) (Gjevori, Shushka, 1955).

1.5. Rotacizmi

Rotacizmi (nga fjala greke rhotë që është emri i tingullit **r**). Prania në dialektin e veriut e fonemës /n/ në grupin e fjalëve që në dialektin jugor dalin me fonemën /r/ për shkak të dukurisë së rotacizmit (Beci, 2002). Toskërishtja ka si karakteristikë rotacizmin /rëra/, kurse gegërishtja e ka ruajtur bashkëtingëllore /n/ ndërmjet zanoreve /rana/. Në Abetaret tona e takojmë mjaft shpesh këtë dukuri, sidomos te abetarja e vitit 1966. Rotacizmin e abetareve në Kosovë e gjejmë te këto fjalë:

Dashni (<dashuri), bani (<bëri), anmikut (<armikut), plagosun (< plagosur), njana (<njëra), emnat (<emrat), drapënin (<draprin), njeni (<njëri), vuni (<vuri), (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Tana (<tëra), anmiku (<armiku)-jo vetm mes zanoreve, robnue (<robërua), burgosun (<burgosur), shtypun (<shtypur), mundësinat (<mundësirat) nxuni (<nxuri), lidhun (<lidhur), kapun (<kapur), prishuna (< prishura), gjana (< gjëra) (Gjevori, Kolgeci, Riza & Shpendi 1946).

Penin (<perin), anmiqt (<armiqtë), vene (<vëre), dashtuni (<dashuri), anmik (<armik), vuni (<vuri), zuni (<zuri), pasunin (<pasurin), shinat (< shirat), bani (<bëri), sëmundë (<sëmurë), unshëm (<uritur) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Zuni-zuri (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Lumtun (<lumtur), vuni (<vuri), anmiku (<armiku) (Gjevori, Kostari, 1951).

Lene (<lere), dhelpëna (<dhelpëra), njani (<njëri), dashtun (<dashur), emnin (<emrin), lakna (<lakra), zuni (<zuri), dashtun (<dashur), vene (<vëre), anmiqt (<armiqtë), bane (<bëre), idhnimi (<hidhërimi), grunë (<grurë) lakna (<lakra), zene (<zëre), drapni (<drapri), vuni (<vuri) (Gjevori, Shushka,1955).

Lene (<lere), lumtunon (<lumturon), zunë (<zure), mushkëni (<mushkëri), dhelpna (<dhelpna), dimni (<dimri), dashuni (<dashuri), njenën (<njërën) lumtunon (<lumturon), djersitun (<djersitur), emnin (<emrin), tyne (<tyre), ujna (<ujëra), rijtë (<rinjtë), sëmuni (<sëmurë), sëmunit (<sëmurit), trimninë (<trimërinë), turpnue (<turpërua), prishun (<prishur), djersitun (<djersitur), papjekuna (<papjekura), dashtuni (<dashuri), tyne (<tyre), sëmuni (<sëmurën), dhelpna (<dhelpna), dimni (<dimri), ujna (<ujra), njianni (<njzëri), bani (<bëri), korrunave (<korrurave), lakna (<lakra), emni (<emri), vene (<vëre), anmiqt (<armiqt) (Hoxha, 1966).

1.6. Alternimi i bashkëtingëlloreve /mb>m, nd>n, ng>k/

Gegërishtja nuk ka në inventarin e vetë grupet e bashkëtingëlloreve/ mb, nd, ng,/ në vend të tyre pjesë më të madhe të të folmeve kanë mbetur përkatësisht /m,n, /. Alternimin e bashkëtingëlloreve mb.>m, nd>n dhe ng>k nuk është se e gjejmë shume tek abetaret tona, kjo dukuri gjendet ekskluzivisht vetëm ne tri abetaret e para në Kosovë. Alternimin e bashkëtingëlloreve për këto tri abetare e kemi si vijon:

Mërrijtën (<mbërritën), (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Maruen (<mbaruan), math (<mbath,) mprojtë-mbrojte, (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Kamët (<kambët), mushem (<mbushem), mlodhi (<mblodhi), dhem (<dhemb), mlidheshin (<mlidheshin), mulue (<mbuluar), mledhë (<mbledhë), mrenda (<brenda), kamën (<këmbën). Kemi raste ku bashkëtingëlloret /ng/-zavendsohen me /k/, kadal (<gadalë), ndigjoj (<dëgjoj) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

1.7. Asimilimi i grupeve të zanoreve / ue, ye, ie/

Gegërishtja i asimilon grupet e zanoreve/ ue, ye, ie/, toskërishtja i ruan ato.p.sh. bluejbluja, fyell-fyll, diell-dill. Toskërishtja ka togunzanor /ua/, ndërsa te gegërishtja kemi togunzanor /ue/, (shpesh të monoftonguar në /u/) p.sh. Grue - Gru - Grua. Toskërishtja ka togzanor ose diftongun /ua/ - kurse gegërishtja në përgjithësi ka /u/ disa të folme kanë /ue/.

Gjatë analizës së abetareve, ne kemi gjetur një numër të madh të asimilimeve të tilla, ku më së shumti fjalë janë gjetur në abetare me asimilimin e grupeve të zanoreve sidomos te abetarja e vitit 1947. Të gjitha fjalët që janë paraqitur me dukurinë e tillë të asimilimit i gjejmë të paraqitura nga njëra abetare tek tjetra, si me poshtë:

Mue (<mua), luen (<luan), luejnë (<luajnë), gëzuem (<gëzuan), luen (<luan), çuen (<çuan), perqafuen (<përqaftuan), helmue (<helmuar), due (<duam), shkruie (<shkruar), shkuen (<shkuan), duen (<duan), qerue (<qëruar), kerkue (<kërkuar), vrapuen (<vrapiuar), friksuen (<frikësuar), due (<dua), duer (<duar), vuejnë (<vuajnë), luftuen (<luftuan), biseduen (<biseduan), shkuen (<shkuan), mesue (<mësuar), luejtë (<luajt), huej (<huaj), paguej (<paguaj), shkuen (<shkuan), due (<dua), ruejtë (<ruajt), gëzue (<gëzuar), luejt (<luajt), shkuen (<shkuan) (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Duem (<duam), shkruie (<shkruar), këndue (<kënduar), filluen (<filluan), mësuën (<mësuar), maruem (<maruar), shkretue (<shkretuar), bashkuem (<bashkuar), çmue (<çmuar), grues (<gruas), muerën (<morën), filluen (<filluan), pushkatue (<pushkatuar), internue (<internuar), luftue (<luftuan), fitue (<fituan), shfrytëzue (<shfrytëzuar), sundue (<sunduan), robnie (<robëruar), organizuen (<organizuar), tërbuem (<tërbuam), çue

(<çuar), vllaznuen (<vëllaznuan), duert (<duart), trashigje (<trashëgje), shkatruem (<shkatërruam), naltësue (<lartësuar), zhvillue (<zhvilluar), sigurie (<siguruar), bashkuem (<bashkuam), kaluem (<kaluam), duersh (<duarsh), ruen (<ruan), pranue (<pranuar), interesuem (<interesuam), tradhtue (<tradhtuar), tregue (<treguar), fillue (<filluar), filluen (<filluan), grues (<gruas). (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Vizitue (<vizituam), luente (<luante), shkuen (<shkuan), duen (<duan), largue (<larguar), livrue (<livruar), çue (<çuar), fillue (<filluar), muer (<muar), mue (<mua), çue (<çuar), duem (<duam), msue (<mësuar), gzue (<gëzuar), afrue (<afruar), shkatrrue (<shkartuar), çuen (<çuan), duen (<duan), këndue (<kënduan), luftuen (<luftuan), duruen (<duruan), afrue (<afruan), shkuen (<shkuan), luejnë (<luajnë), detyruen (<detyruan), ruej (<ruaj), due (<dua), mue (<mua), pushtuem (<pushtuam), punuem (<punuam), qortue (<qortuam), idhnue (<hidhëruam), mësue (<mësuar), vetmume (<vetmuar), punuen (<punuan), duesh (<duash), punue (<punuar), afruen (<afruan), filluen (<filluan), luejtë (<luajtën), kallxue (<treguan), ndihmuen (<ndihmuan), afruen (<afruan), prue (<sjellën), shkruem (<shkruam), këndue (<kënduar), çue (<zgjuar), luejshin (<luajshin), gjelbërue (<gjelbëruar), duelën (<dolën), gëzuan (<gëzuan), shkuen (<shkuan), shkatrruen (<shkatërruan), ndertue (<ndërtuar), rindertue (<rindërtuar), plotësue (<plotësuar), zbukurue (<zbukuruar), shkue (<shkuar), luente (<luante), gzue (<gëzuar), çuen (<çuan), duem (<duam), këndue (<kënduar), luftuen (<luftuan), duruen (<duruan), afrue (<afruan), due (<dua), pushtuem (<pushtuam), punuem (<punuam), qortue (<qortuar), mësue (<mësuar), duen (<duan), vetmueme (<vetmuar), punuen (<punuan), filluen (<filluan), luejtë (<luajte), ndihumen (<ndihmuan), ruejt (<ruajt), due (<dua), gjelbërue (<gjelbëruar), gëzuan (<gëzuan), shkuen (<shkuan), shkatrruen (<shkatërruan), ndertue (<ndërtuar), plotësue (<plotësuar), zbukurue (<zbukuruar), shkue (<shkuan), Luen (<luan), luente (<luante), lieuen (<liruan), luftuen (<luftuan), fituem (<fituam), mue (<mua), shkuen (<shkuan), duen (<duan), bluen (<bluan), bombarduen (<bombarduan), shkuen (<shkuan), gjuejtë (<gjuajte), dërguen (<dërguan), tepruen (<tepruan), shkruen (<shkruan), luejshin (<luajshin), luftuen (<luftuan), zaptuen (<zaptuan), fituen (<fituan), liruen (<liruan) (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Muer (<mori), luen (<luan), fituem (<fituam), ngarkuen (<ngarkuan), bluejm (<bluajmë), ruen (<ruan), festuen (<festuan), filluen (<filluan), zemrue (<zemëruar), shkuen (<shkuan), luejtë (<luajt), luejmë (<luajmë), mësue (<mësuar), punue (<punuar), ngarkuen (<ngarkuan), dorzuen (<dorëzuan), duen (<duan) (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Luen (<luan), mue (<mua), punue (<punuar), vluem (<vluam), luejm (<luajmë), kaluen (<kaluan), duert (<duart), ruen (<ruan), duem (<duam), ngarkuen (<ngarkuan), çuen (<çuan), luej (<luajt), due (<dua), takuen (<takuan), rrëzuen (<rrëzuan), punuen (<punuan), ndihmuen (<ndihmuan), shkruiej (<shkruaj), gëzuan (<gëzuan), vizituen (<vizituan), tuej (<tuaj), kaluen (<kaluan), grumbulluen (<grumbulluan), filluen (<filluan), luejmë (<luajmë), shkuem (<shkuam), shoqnuen (<shoqëruan), qëndruen (<qëndruan), pushuen (<pushuan), turpnueme (<turpëruar), gëzue (<gëzuar), duert (<duart), mue (<mua), rrethuen (<rrethuan), çuen (<çuan), ndegjuem (<ndegjuam), shëmtueme (<shëmtuar), dëshpruem (<dëshpëruar), due (<dua), duert (<duart), shkuen (<shkuan), duejt (<duajt), pushuen (<pushuan), gëzuem (<gëzuar), muer (<mori), grues (<gruas), gatuej (<gatuaj), luejm (<luajmë) (Gjevori, Kostari, 1951).

Luen (<luan), dueni (< duani), luejt (<luajt), ruen (<ruan), rueni (<ruani), duer (<duar), duel (<doli), duen (<duan), treguen (<treguan), gjuejtë (<gjuajt), shpëtuen (<shpëtuan), due (<dua), gëzuem (<gëzuar), ndertuen (< ndërtuan), luftuen (<luftuan), ruen (<ruan), caktuem (<caktuam), luejnë (<luajnë), ndërtuen (<ndërtuan) kërkue (<kërkuan), luftuen (<luftuan), ruen (<ruan), caktuem (<caktuam), ruejmë (<ruajmë), thueju (<thuaj), paftuem (<paftuar), caktueme (<caktuara), duelen (<dolën), gjuejtë (<gjuajtën), friguem (friguam) (Gjevori, Shushka,1955).

Luejnë (<luajnë), dueni (duani), punue (<punuar), ruen (<ruan), duel (<doli), ruen (<ruan), duer (<duar), muer (<mori), duen (<duan), ndihmuen (<ndihmuan), pakësue (<paksuan), përmirësue (<përmirësuan), gjuejt (<gjuajt), friguem (<friguar), due (<dua), premtue (<premtuar), zgjuen (<zgjuan), kalue (<kaluar), fillue (<filluar), rrëxue (<rrëxuar), tregue (<treguan), shpetue (<shpëtuan), punue (<punuan), luej (<luaj), hetue (<hetuar), ndërtuen (<ndërtuan), kërkue (<kërkuar), luftuen (<luftuan), pastrue (<pastruar), caktue (<caktuar), deshirue (<dëshiruar), vrapuen (<vrapuan), thueju (<thuaju) (Hoxha, 1966).

1.8. Mbaresat: /shin/, /ue/, /vet/, /uem/ dhe /er/

Gjatë analizës dialektore të Abetareve, ne kemi gjetur se disa fjalët në tekste kanë këto mbaresa: /shin/, /ue/, /vet/, /uem/, /er/. Numri i fjalëve me këto mbaresa nuk është i madh, do t'i shohim për secilën abetare si vijon:

Mbaresa: /shin/

Dhimseshin, rrifeshin, (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Vujshin, rrëshqitshin, luejshin (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Mësojshin, ndihmojshin, udhtojshin(Hoxha, 1966).

Mbaresa: /ue/

Tue, puntuer, due, mue, shkruue, këndue, kërkue(Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Shkruue, këndue, lexue, shkruue, mësuue, shkretuue, shkatruue, pushkatue, internue, fitue, çmue, shfrytëzue, sundue, robnuue, tue, çue, trashigue, fillue, naltësue, zhvillue, sigurie, tradhtue, tregue, pranue, (Gjevori, Kolgeci, Riza & Shpendi 1946).

Shkatruue, pështue, ndëgjue, ndihmue(Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Tue, blue, dorzue, organizue, lexue, shkruue, bashkue, plague, lirue, regjistruue (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Mue, tue, vënuue, mësuue, çue (Gjevori, Kostari, 1951).

Kalue, due, mue, tue, mendue, mbulue, fillue, bashkue, shkue, shkruue, ndihmue, plotësue, pastrue, ndëgjue, mashtruu, vizitue, fillue, kujtue, prapue, zgjue, grumbullue, argëtue, pushue (Gjevori, Shushka,1955).

Tue, punue, ngarkue, pendue, çue, rrëxue, mjeshtuue, pezmatue, paksue, përmirësue, due, premtue, kalue, fillue, mësuue, tue, lexue, tregue, kërkue, ndihmue, pastrue,turpnue, caktue, recitue, fitue, shpëtue, tmerrue (Hoxha, 1966).

Mbaresa: /vet/

Krahavet, rrugëvet, pemëvet, tradhtarvet, pantollonvet, shokëvet, krahëvet, barbarizmavet (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Popujvet, shkollavet, nenavet, barbarizmavet, përfaqësuesvet, tokavet, kafshëvet, shpendëvet, (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Popujvet, mjeshtërvet, shpijavet, shokëvet, puntorëvet, ndertesavet, tjervet, flutravet, përfaqësuesvet, tokavet, kafshëvet, shpendevet, pvet, rrugëve, fluturavet (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Senevet, rijvet (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Ditëvet (Gjevori, Kostari, 1951)

Prindervet (Gjevori, Shushka,1955).

Nxanësavet, lepujvet, shokëvet, pionerëvet, punëtorëvet, prindërvet, detyravet, udhëtarëvet, popujvet, syvet, puplavet, popujvet (Hoxha, 1966).

Mbaresa: /uem/

Friguem (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Bashkuem, vllaznuem, internuem, unjisuem, mësuem, maruem, shkatruem, duem, kaluem (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Shkatruem, mësuem, vllaznuem, kaluem, bashkuem, internuem, duem, punuem, pushuem (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Fituem, (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Shkatrueme, shkruem, ndegjuem, deshpruem, vluem, duem (Gjevori, Shushka,1955).

Ndihmuem (Hoxha, 1966).

Mbaresa: /er/

Puntuer(Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

Muer, hanger, puntuer(Gjevori, Gjino & Kostari, 1947).

Puntuer, muer(Gjevori,Shushka,1955).

1.9. Ndryshim i kuptimit

Hofin (<hedhshin prej qefit), vojti të bluente në mulli (<shkoi të bluante), Dajak (<shkop, thupër), mrrini (<arriti), mas (<pas), Sahat (<Orë), math (<madh), kamën teme(<këmbën time), çilnia (<hapeni), gjaja e gjallë (<kafshët), rrokën pushkët (<kapën pushkët), menxi ecte (me vështirësi ecte) (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Tana (<të gjitha), math (<madh), mbasi (<pas), mdëhaja (<mëdhaja), kundra (<kundër), kurrniherë (<asnjëherë), t'onë (<e gjithë), naltë (<lartë), njajtë-njëjtë, zhgatrrue

(<shkatrrue), të ndahern dyzash (<të ndahen në dyshe) (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Hofin (<hedhshin prej qefit), Milici (<polici), vojti (<shkoi), sahati (<ora), baxhës (<banjo), nxuerr (<nxorri), mixha (<axha), llom (<baltë), kismet (<kismet, ndajf. tur. fat, përdoret për të uruar në të ardhmen (kësmet po ja filloi), pvetën (<pyetën), sa kishte mërrijtë (<sa kishte arritur), zhaba (<bretkosa), xhapini (<zhapini), të tana (<të gjitha), grindavecet metën pa gja (<grindavecet mbetën pa asgjë), gërvishti qenin në turi (<gërvishti qenin në fytyrë), kështu mujti me pështue (<kështu arriti me shpëtuar), u-tutshin (<u frikësuan), Fatosi i em (<Fatosi im), shkollës s'onë (<shkollës tonë), me ju dekë (<me ju vdekë), da (<ndarë), qi (<që), mas (<pas), katundin (<fshatin), do të jecin (<do të mbesin), shtëpija e eme (<shtëpia ime), janë prindët e mi qi m'duen me kimet (<kimet, em. turq. Rëndësi, vlerë), nuk dijt kurrgja (<nuk diti asgjë), pod (<dysHEME), ap fjalën (<jap fjalën), muellën shum kompira (<mbloodhën shumë patate), mos u tut prej ujës (<mos u frikëso nga uria), prrue i fellë (<përruan i thellë), musafiri-mysafiri, ka prue (<ka sjellë), një sahan (<një pijat), as ke mërdhi në borë (<a nuk ke pas të ftohët në borë), mësuesin tem (<mësuesin tim), kqyr (<shikon), ma sëmrami shef (<së fundi sheh), me një herë nget te ato (<menjëherë vrapon te at), e çuen në shpin e vet (<e drguan në shtëpinë e vet), një ujk i unshëm (<një ujk i uritur), dhimtës (<dhembjes), na do të bijshim ujë (<na do të sjellnim ujë), fjalët tueja (<fjalët tua), t'amlë (<të ëmbla), m'ep (<më jep), vnojë (<vendos), pece (<pecet), epë<jep), dugaja (<shitore), voli (<vjeli), u-banë gadi (<u bënë gati), mulue (<mbuluar), tesha të trasha (<rroba të trasha), vnuen kryet (<vnunë kokën), muerën me vedi (<morën me veti), duaje shokun e vetvedin (<duaje shokun e vetveten), duaje e ndihmoi te vorfnit (<duaje dhe ndihmoi te varfëritë). (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Në sovën e nejës (<në dhomën e nejës), tue blue (<tu e bluar), mbasi (<pasi), e muer (<e mori), sod (<sot), pëveti (<pyeti), po hecte me vrap (<po ecte me vrap); kundra (<kundër); miq të pandamë (<miq te pandarë), zaptuan (<uzurpuan), shdukesh (<zhdukesh), mbasi po udhëtojmë bashkë (<pasi po udhëtojmë bashkë), do të na gjejë belaja (do të na zë sherri), djali i zdathun (<djali i zbathur); me i mprojtë (<me i mbrojtë); shrrregullon (<çrregullon), shlirimtar (<çlirimtar), qershuer të vitit (<qershor të vitit), muej (<muaj), para se të diste (<para se të vdiste) (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

Hini (<hyri), muer (<mori), ama mue (<më jep mua), t'ama (<të ëmbra), Llani maron mure (<Llani mbaron mure), punëtorët i apin (<punëtorët i japin), nanë pruna plot vo (<nënë solla plot ve), veni votë (<vëri vetë), epu pulave (<jepi pulave), vili mollat (<vjeli mollët), vikatën macet e vocrra (<mjaullin macet e vogla), e prunë (<e sjellën), ata muerën (<ata morën), zene (<zëre), Ramizi u çpall (<Ramizi u shpall), katunarët (<fshatarët), tambël (<qumësht), drapni (<drapri), nandë sulmuesa (<nëntë sulmues), epma mue (<jepma mua), njih Njazi (<numëro Njazi), njizet-njëzet, ja vënoi flamurit (<ja vë flamurit), i jati Kujtimit (<i ati Kujtimit), kemi me çue (<kemi për t'i dërguar), mbërrijtën (<arritën), mos e çilni (<mos e hapni), çilni derën (<hapeni derën), çukati uku në derë (<trokiti ujku në derë), don të na hajsh (<donë për të na ngrenë), i duen fort (<i duan fort), lloç (<baltë), hecte (<ecte) (Gjevori, Kostari, 1951).

Man (<mbanë), tuti (<frikësoi), tamli (<qumështi), massi (<pasi), vojten në fabrikë (<shkuan në fabrikë), po i vnoj librat (<po o vendosi librat), fustanin tem (<fustanin tim), qevren (<lloj shamie), bonjat prej qiellit (<ngjyrat prej qiellit), nxemë (<nxehtë), dashin e majmë (<dashin e shëndosh), uja (<uria), mbas (<pas), vumë (<vendosem), menzi (<me vështirësi), muejmë (<mundemi), mb'anë tjetër (<anën tjetër), cofuna (<ngordhura), kryet (<kokën), fluturoi tue thanë me vedi (<fluturoj duke thënë me veti), tem (<tim), tanë (<gjithë), vu mbi tavolinë (<vendos mbi tavolinë), njofish (<njohësh), dit'ni (<dituri),mbuell (<mbolli), nxuni (<zuri), kaherë (<që moti), çue (<zgjuar), shpejto djalë sa hora (nxito djalë shumë shpejtë), sod (<sot) (Gjevori, Shushka,1955).

Tuti (<frikësoi), odë (<dhomë), tambël (<qumësht), duelën (<dolën), soset (<hargjohet), ua kanda mjaltin (<ju pëlqen mjalti), mueren (<morën), nalti (<larti), kryet (<kokën), shtektarë-shtegtarë, cofin (<ngordhin), konop (<litar), simbas (<sipas), tanë (<gjithë), të na zhblijë (<të na hajë), kryemjen (<kryerjen), katunde (fshatra), mbajnë ndysi (<mbajnë papastërti), mëshehë (<fshehë) (Hoxha, 1966).

2. Vështrime etnolinguistike

1.1. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse,

Në traditën tonë popullore ne kemi shumë fjalë përkëdhelëse dhe urime nga me të ndryshmet, në varësi nga mosha, gjinia, për pjesë të ndryshme të kohës, për raste të ndryshme, etj. Në abetare kemi gjetur disa urime të cilat i kemi ndarë në ato që bëjnë nënat për të vegjlit e tyre dhe urimet që shkojnë për të gjithë:

Urimet e nënave janë:

“Na, të pastë nana!”, “Ska si nëna me!”, “Ska me motrën time!”, “Flij, o shpirti i nanës, fli, flij se nana të ka xhan!”, “T’i mu bafsh plak i katundit!”, “Do t’rrisë nana me vo pule!”, “Natën e mirë, pra ju la me shëndet!”, “Ditë e dliirë!”.

Urime të tjera që kanë të bëjnë me festat, individët, pjesët e ditës, me fillimet e mbara dhe urimet për t’u bërë sipas disa figurave model në abetare, kemi nënvizuar këto:

“Rrnoft pra shoku ynë i madh Tito!”, “Rrnoft Marshalli i Jugosllavis , JosipBroz Tito!”, “Rrnoft armata e jonë trime!”, “Ska me mësuesen time!”, “Me fat një maji!”, “Na pruftë lumturi!”, “Gëzuar një Maji!”, “Me fat ditëlindja, Dhorkë!”, “Si nuse me tel! Ditë e dliirë!”, “Dite e mirë!”, “Paç rrugë të mbarë!” “Rrënoftë flamuri!”, “Puna e mbarë!”, “Rrnoft armata jonë trime!”, “Rrnofshin shpëtimtarët tanë!”.

Përdorimi i mallkimeve: “Uç gomar, uç he plaq”, “Ah armik i mallkuem, sa shumë ne ke shkatrruem”, “U shfarofshin armiqtë e mallkuar!”.

Përdorimi i ngushëllimeve: Ulu në karrige dhe mos u frikëso!

Përdorimi i fyerjeve (sharjeve), “zene qenin e qenit zini anmiqt”, “katilat”, “rrugaçi”, “sakat”, “Vete budall je”, “I pa pastër”, “Nëna i pështyu në fytyrë e i quajti qenë”, “qorra”, “Klasë zhurmëtare”, “sa e shëmtuar”, “tradhtarë”, “bishat e egra fashiste”, “grabitësi”, “grindavec”, “budallic”, “invalid”, “zaptuesit”, “gomaric”.

1.2. Pasqyrimi i fjalëve të urta

Fjalët e urta janë thesar me rëndësi të madhe gjuhësore dhe pedagogjike. Fjalët e urta që ne i gjejmë në abetaret tona kanë të bëjnë me punën, me të mirën apo mirësinë, bujarinë, mikëpritjen etj. Në abetare shohim se autorët i kanë kushtuar mjaft rëndësi punës si burim i jetesës, mirëqenies, begatisë dhe prosperitetit si: “Në daç lup, në daç jep, po s’punove kush s’të jep”, “Kush punon gëzon”, Punën e sotme mos e lër për nesër”, “Punë, punë, natë e ditë që të shohim pakëz dritë”, “Gurë, gurë bëhet mur, pikë, pik mbushet pushi”, “Kush punon-fiton”, “Pika-pika rritet lumi, gurë-gurë bëhet muri”.

Përveç punës i gjejmë edhe vrytytet e tjera morale, si e vërteta, dashuria për dijen, për lirinë, etj si: “Thueni gjithmonë të vërtetën”, “Rrena i ka këmbët e shkurta”, “Bashkimi banë fuqi”, “Dija nuk falet ajo fitohet tu punuar”, “Pastërtia asht gjysma e shëndetit”, “Libri është çelës i diturisë”, “Miku njihet që është mik në të keqe e në rrezik”, “Më mirë është të dish se të kesh”, “Kush punon, përparon”, “Dituria është drita e jetës”, “Kush i ndihmon shokun, ndihmon veten”, “Më mirë të vdesësh i lirë se të rrosh në zinxhirë”.

VII. ABETARET DHE EDUKIMI MORAL

Historikisht, në çdo formacion shoqëror u ka kushtuar rëndësi edukimit moral si terësi apo arritjes së disa vlerave morale në veçanti. Çdo rend shoqëror ka pasur moralin e tij, çdo komb, çdo epokë, çdo klasë, madje çdo individ ka një moral të veçantë, thënë ndryshe është zotërues i një sistemi vlerash të lidhura me atë që quhet moral. Nuk mund të mendohet që jeta sociale mund të funksionojë normalisht pa pasur vlerat morale. Morali, pra ka karakter historik i cili gradualisht gjatë shekujve ka evoluar duke u përparuar dhe pasuruar me cilësi të reja.

Pedagogu i madh zviceran, Johan Henrik Pestaloci, i kushton rëndësi të madhe kësaj komponente të edukimit. Ku edukimi moral e përbën thelbin e sistemit pedagogjik të Pestalocit. Ideali i edukatës sipas Pestalocit ishte arritja e “njerzishmërisë së vërtetë, është edukimi i njeriut si bir i familjes së madhe njerëzore, si vëlla i njerëzve të tjerë. Kjo arrihet nëpërmjet aftësive (forcave) të lindura të njeriut. Ato forca janë koka (mendja), zemra dhe dora. Vlerat themelore të moralit sipas tij, përkohë me dashurinë aktive të njeriut ndaj njerëzve të tjerë, në mirësinë, besnikërinë dhe në bindjen e tij. Ai kërkonte që fëmijët të formohen si personalitete të moralshme. Edukimi moral fillon në familje, për të vijuar pastaj në shkollë. Në këtë vështrim, sipas Pestalocit, rëndësi ka shembulli pozitiv, në radhë të parë i nënës dhe i edukatorit (Koliqi, 1998).

Kemi Herbartin me idenë e mirësisë, idenë e drejtësisë dhe idenë e së drejtës. Ideja e mirësisë ka të bëjë me harmoni midis vullnetit të individit dhe vullnetit të njerëzve të tjerë e cila shprehet përmes ndihmës që individit u ofron të tjerëve. Ideja e drejtësisë sipas Herbartit ka të bëjë me gjykimin moral të konflikteve midis dy ose më shumë vullneteve dhe ideja e së drejtës, Herbarti për individët që mbështesin harmoninë e vullnetit parashikon shpërblimin, ndërsa për ata që e rrënojnë, parashikon ndëshkimin, (Koliqi, 1998).

Edukimi moral sipas Kantit është të mësuarit e rregullave morale fëmijës, jo nëpërmjet forcës dhe frikës, por duke u mbështetur në të kuptuarit prej fëmijës, në shpjegimin dhe gjithpërfshirjen ndaj tij. Vetëm në rast se fëmijës i është siguruar një edukim i tillë, fëmija do të mund të tregojë, shfaqë (performojë) sjellje të moralshme dhe të ndërgjegjshme e do të konsiderohet i edukuar.

Teoritë e Kohlbergut për zhvillimin moral, duke studiuar arsyetimin moral të të rriturve dhe të vegjëlve, duke u vënë përpara dilema morale apo situata hipotetike, në të cilat njerëzit duhet të marrin vendime dhe të japin arsytet. Duke u bazuar në këto arsytetime, ai krijoi një seri të fazave të arsytimit moral apo gjykimeve rreth së mirës e të keqes. E ndau zhvillimin moral në tri nivele: 1. Parakonvencional, ku gjykimi bazohet vetëm në nevojat dhe perceptimet e vetë personit; 2. Konvencional, ku merren parasysh ligji dhe pritshmëritë e shoqërisë dhe 3. Paskonvencional, ku gjykimi bazohet në parime abstrakte dhe më vetjake të së drejtës, të cilat nuk përcaktohen domosdoshmërisht nga ligjet e shoqërisë (Anita Woolfolk, 2011).

Zhan Pijazhe duke trajtuar zhvillimin moral të individit, flet për tri faza: faza objektive e cila përfshin moshën deri më shtatëvjeçare, faza konceptuale që përfshinë moshën 7-10 vjeçare dhe faza autonome e formimit moral që përfshin moshën mbi 10 vjeçare.

Morali, si pjesë e vetëdijes shoqërore, zhvillohet dhe ndryshon në raport me ndryshimet ekonomiko-shoqërore, pasi që moral të përjetshëm nuk ka. Morali është një sistem i njohurive që u shërben fëmijëve si busullë orientuese për t'u treguar njerëzve se cili është drejtimi i duhur që duhet të ndjekin gjatë veprimeve të tyre (Mazreku, 2015).

Formimi moral i brezave të rinj është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar, në varësi të disa faktorëve, duke filluar nga familja e për të vazhduar me shkollën si vatër e organizuar e edukimit e cila pasuron më tej edukimin moral të brezave të rinj. Faktorët brenda institucioneve edukativo-arsimore si: edukatorët, mësuesit, drejtorët, punëtorët e shërbimit psiko-pedagogjik, mjeku, koordinatori i cilësisë e deri te punëtorët e mirëmbajtjes, kanë ndikimin e tyre edukativ. Roli dhe ndikimi i punonjësve të arsimit dhe sidomos i mësuesëve në zhvillimin moral të fëmijëve e të rinjve është tepër i madh. Ndërsa nga faktorët tjerë me rëndësi janë edhe tekstet mësimore me përmbajtjet e tyre. Në programet mësimore të

shkollave janë përfshirë mësimet që transmetojnë vlera kulturore dhe morale tek fëmijët. Por, edukimi moral nuk arrihet vetëm me një lëndë ose disa kapituj që flasin për të, por kjo komponentë duhet të ketë përfshirje ndërlëndore. Shkolla ndikon në edukimin moral dhe me mjedisin përreth, pastërtia e shkollës, aktivitetet e nxënësve brenda dhe jashtë kurikulare, krijimit të bibliotekave, këndeve të leximit, ekskursioneve me vlerave kombëtare dhe shpirtërore, si dhe projekteve që transmetojnë kulturë e njerëzitet (humanizëm), etj. Edukimi moral nuk mund të mendohet i ndarë nga zhvillimi mendor, shpirtëror dhe psiko-motorik. Jeta jonë morale ndërtohet nga mbledhja e të gjitha këtyre elementeve: ndjenjë, njohuri, sjellje.

Një ndër etapat e formimit moral është njohja e rregullave dhe parimeve të cilat do të ndihmojnë mbikëqyrjen e sjelljeve të mira dhe të këqia.

Etapa e dytë, formimi i bindjeve dhe qëndrimeve edukative, njohuritë që faktorët ua adresojnë fëmijëve duhet të jenë edukative, bindëse, tërheqëse dhe përvetësuese. Për të ushqyer ndjenjën e moralit dhe ndërgjegjes tek nxënësit.

Etapa e tretë, formimi i shkathtësive dhe shprehive morale, që tregojnë moralin e vërtetë.

Si proces kompleks, edukimi moral përfshinë tri aspekte të rëndësishme: aspektin intelektual ose kognitiv, aspektin emocional dhe aspektin konativ ose i vullnetit.

Edukimi moral arrihet përmes aktivitetit të organizuar sistematik e pedagogjik në të gjitha shkallët e shkollimit po ashtu dhe në të gjitha fazat e zhvillimit të individit me qëllim përvetësimin e vlerave pozitive.

Përmes përmbajtjeve në tekste, në rastin tonë në abetare, njësitë mësimore kanë për qëllim realizimin e tri etapave të edukimit moral të cekura më lart. Në bazë të analizës së abetareve, shohim se bëhet përpjekje për krijimin e këtyre cilësive pozitive të moralit: Atdhedashuria, dashuria për punë, humanizmi, edukimin në frymën familjare, bujaria, besa. Në abetare jepen shembuj që tregojnë, burra, gra, fëmijë me karakter dhe vullnet të fortë. Kryesisht personazhe që pasqyrojnë vullnet për punë, vendosshmëri për kryerjen e detyrave, këmbëngulje, seriozitet, disiplinë, nismë (iniciativë), nder, dinjitet, bashkëndjenjë (solidaritet), drejtësi, liri, barazi, etj. Gjatë këtyre viteve nga viti 1945-2012, vendi jonë ka pasur shumë ndryshime, shoqërore, ekonomike, politike andaj shohim dhe një ndryshim

në cilësi e edukimit moral. Abetaret e para japin shumë tablo të shembujve pozitiv ndonjë herë edhe negativ, pothuajse çdo mësim ka porosinë dhe ndikimin e tij, qofshin dhe ato parullat e porosit politik, që fatmirësisht shkojnë duke u zbehë me vonë.

Të gjitha ndikimet morale nëpër abetaret tona të analizuara nga vitit 1945-2012 i kemi ndarë në edukimin:

1. Edukimi për jetë në familje,
2. Edukimi kombëtar,
3. Edukimi për punë,
4. Edukimi për dashurin ndaj shkollës,
5. Edukimi njerëzor (human),
6. Edukimi ndërkombëtar

Në abetare po ashtu nxënësit kanë marrë njohuri mbi kategoritë kryesore të moralit si e mira e keqja përmes përmbajtjeve që kanë bartur këto informacione tek fëmijët duke formuar etapën e parë:

1. Njohja e moralit dhe teorisë së tij.

Po ashtu theksohet edhe vlera dhe rëndësia që kanë disa veti morale për formimin e personaliteteve të moralshme të fëmijëve, si duke mbajtur premtimin, si dhe bujaria si veti morale që e karakterizon popullin tonë:

1. Premtimi dhe
2. Bujaria.

Mjetet e edukimit moral janë instrumentet dhe mënyra kryesore për realizimin e qëllimit dhe detyrave të edukimit moral, i gjejmë në përmbajtjet e teksteve, poezive dhe përrallave, përmes të cilave synohet të realizohen objektivat. Kryesish gjejmë te mjetet e orientimit, nxitjes dhe pengimit si:

1. Këshilla,
2. Modeli,
3. Gara dhe
4. Dënimi.

Në përmbajtjen e abetareve shohim se, përveç edukimit të qëllimshëm dhe përmirësues, kemi edhe disa raste të edukimit represiv.

1. Edukimi për jetë në familje

Familja si qeliza themelore e shoqërisë, ka ndikim të madh në edukimin e anëtarëve më të rinj që janë përsëritës të familjes dhe kombit. Në përgjithësi, edukimi familjar zë vendin qendror dhe është themeli mbi të cilin do të hedhen edhe ndikimet e faktorëve tjerë edukativ.

Nga puna me abetare vlen të nënvizohet ndikimi i faktorëve edukativ që u pasqyruan nga një abetare tek tjetra si: nëna, babai, motra, vëllai, gjyshërit, etj. Krahas theksimit të këtyre faktorëve, shprehet edhe unifikimi i ndikimeve edukative nga faktorët. Pastaj, këta faktorë paraqiten si modele pozitive, pune, suksesi, takti e kulture pedagogjike. Strukturat e familjeve që paraqiten zakonisht janë familje të plota dhe të harmonishme. Ndërsa motivet e jetës familjare janë paraqitur si dashuria dhe kujdesi i prindërve për fëmijët dhe po ashtu i fëmijëve për prindërit, dashuria dhe kujdesi i ndërsjellë (reciprok) mes vëllezërve dhe motrave.

Motivin e dashurisë në familje, e gjejmë tek të gjitha tekstet që flasin për familjen në përgjithësi apo për njërin faktor edukativ brenda familjes. Poezitë, tregimet i referohen dashurisë për njeri-tjetrin, si ta kultivojmë këtë emocion në familje, si ta shprehim me vepra dhe punë, si të krijojmë lidhje të fuqishme mes motrave dhe vëllezërve apo fëmijëve në përgjithësi, për ta dokumentuar këtë ne kemi shkëputura vargje dhe fjali nga tekstet:

Dashurin e motrës për vëllain e kemi gjetur në poezinë “Leta e Petriti” dhe tregimi “Vera ka një vëlla” shih më poshtë:

Leta e Petriti

Leta ka ni vlla të vogël. Ai e ka
emnin Petrit. Leta e do fort e luen me të.

Nina, nana o mor' bir,
Flij se gjumi të ban mirë
Nana po të mban në gj

Flij o shpirti i nanës, flij.
Nana dorën nuk ta dan,
Flij se nana të ka xhan.
Nina, nina o mor' bir,
Flij se gjumi të ban mirë (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

“Vera ka një vlla të vogël. Ai e ka emnin Petrit. Vera e don fort Petritin” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Dashuria për prindërit është shumë e theksuar në abetare, shembull të tillë kemi te abetarja e vitit 1947, ku tetë mësimet e para flasin për familjen kryesish nënën, ka dhe dy poezi “Nana” dhe “Sa e dua nanën”.

Prindët

Se atje gjej prindët e mi,
Që i due me shpirtin t'im (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

“Shkuen dhe e rrokën në qafët nanën dhe e puthën. Ata e dojshin me shpirtit nanën e tyne” (Gjevori, Kostari&Raça, 1945). “Nana ime asht ma e mira e tana nanavet” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947). “Bardhyli u ndihmon prindëvet me dëshirë dhe asht i gëzuem” (Gjevori, Shushka,1955).

Naim Frashëri ka thënë:

Duaje mamën e atën,
Që t'japin uratën
Ata vuenjë për ty
Të kanë dritë në sy (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Shtëpija e eme

Atje në shtëpi,
Dikush po na pret,
Janë prindët e mi,
Qi m'duen me kimet (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Zemra e babës

Për ju dit' e natë

Lodhet e punon

Lodhet baba i ngratë

Lum kush e nderon.

Në abetaren e vitit 1955, te poezia “Çka due” shprehet dashuria për diellin, ajrin, lulet, punën, mësuesin shkollën. Vargjet e paraqitura me poshtë na dokumentojnë se dashuria e kultivuar në familje, bartet edhe për shokët dhe gjithë njerëzit tjerë:

Çka due

Due nanë e babë në votër,

Due vllaun me gjithë motër,

Due shokët pionerë,

Due t'gjithë njerëzit tjerë (Gjevori, Shushka,1955).

Heroizmin dhe qëndresën e nënave tona e kemi në disa abetare, sidomos ato të parat që flasin se si gruaja ka luftuar krah për krah me burrin për çlirimin e vendit dhe ka qenë po aq e zonja dhe trimëreshë sa dhe vetë gjinia mashkullore.

Gjatë luftës kundra pushtuesit, gratë derdhën edhe gjakun e tyre për me fitue lirinë. “Ato luftuen krah për krah me shokët e tyre partizan dhe nuk u trembën prej plumbavet t’anmikut kurrë një herë” (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Në abetaren e vitit 1982, “Nëna Qëndresë” tregon sakrificën dhe qëndresën qe bënë një nënë për t’i mbrojtur djemtë e saj.

2. Edukimi kombëtar

Të formuarit e personaliteteve me identitet dhe dinjitet shqiptar ka qenë bosht i shoqërisë dhe shkollës sonë, përkundër rrethanave politike, ekonomike e shoqërore. Historikisht, të gjithë intelektualët shqiptarë nga e kaluara më e largët e duke arritur deri te

rilindësit të cilët vendosën vëmendjen dhe përqendrimin (fokusin) në preokupimin madhor dhe të përbashkët që e kishin: Atdheun, Kombin, Gjuhën shqipe dhe Diturinë. Të gjithë rilindësit i përkulen atdheut dhe shtojnë me forcë edukimin kombëtar (Koliqi, 2012).

Edhe sot, edukimi kombëtar është nevojë e cila duhet të fillojë që në familje e pastaj në shkollë, duke mbjellë dhe rritur dashurin për atdheun, vendlindjen dhe popullin të cilit i takon. E gjithë kjo dashuri mund të kultivohet duke ua bërë të ditur fëmijëve faktet për të kaluarën e lavdishme historike, të arriturat kulturore, artistike, njohjen e figurave emblematike dhe të rëndësishme të historisë, bukuritë dhe pasuritë e atdheut. Gjatë analizës së abetareve, gjejmë poezi, tregime, thënie, fjali që flasin për atdheun, qytetin, misionet ndaj atdheut, flamurin, heronjtë, figurat e rëndësishme historike etj.

Duke filluar nga abetarja e parë e vitit 1945 e deri te abetarja e vitit 2012, kanë poezi, tregime për atdheun me intenzitet të ndryshëm prej të cilave kemi veçuar disa fjali dhe poezi si në vijim:

“Duhet ta duem fort vendin t’onë”. “Ne do të rindërtojmë vendin t’onë”, “Jugosllavia është një prej shteteve që ka një pasuri të madhe nëntoksore”, Kosova e Metohija (Kosmeti), mësim ku e përshkruan Kosovën shtrirjen e saj gjeografike, lumenjtë fushat, xehet etj (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

“Partizanet liruen Pejën” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

“Dueje dhe mbroje vendin tand!” (Hoxha, 1966).

“Fëmijët nderuan Landovicën heroike” (Batalli,1982),

“Malet tona me plot minerale” (Deva&Krasniqi, 2008).

Kemi veçuar dhe tri poezi si:

Pioneri puntuer

Jam pioner jam pioner

Dijta tanksat t’i hedh n’erë

Dijta, dijta te luftoi

Lirinë time ta fitoj

Ne dijmë të punojmë

Shqipërinë ta rindërtojmë (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Vendlindja ime

Vendlindjen time e due për jetë,

Në te i mbusha plot shtatë vjet.

Kjo poezi me tutje shpreh dashurinë për djepin, malet, kopshtin, shtëpinë, fushën, tufën e barinë, lumin fushën që lulëzon (Hoxha, 1966).

Qytet hero

Prishtinë, qytet hero!

Për hir të trimave na trego (Hoxha, 1977).

Gjuha shqipe dhe flamuri, për gjuhën si taban themelori i identitetit, i dinjitetit shqiptar dhe flamurin si simbol kombëtar, nuk ka shumë vargje apo fjali për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar për to. Një porosi për gjuhën shqipe është te abetarja e vitit 1946.

“Mësoni me shkruie e me këndue mirë gjuhën shqipe”, abetarja është për të rriturit që ishin analfabetë, ndërsa poezia e parë për flamurin kuq e zi, e gjejmë ne vitit 2008, d.m.th abetaren e pas luftës (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Flamuri

Ngjyrë të kuqe ka flamuri,

Me shqiponjën me dy krerë,

Na jep emrin më të bukur,

Jam shqiptar me besë e nder (Deva & Krasniqi, 2008)

Njohja e figurave të rëndësishme historike dhe letrare, duke dhënë shembuj të mirë trimërie, dashurie për atdhe për ata që i kënduan, e mbrojtën dhe luftuan për të, deri te figura e shenjtëreshës sonë, nënë Terezës, kemi disa raste. Figura si: Skenderbeu, Naim Frashërit i gjejmë te abetarja e vitit 1945, që është botuar në Shqipëri. Pastaj për Bajram Currin dhe Ismajl Qemajlin, përmbajtjet mësimore janë te abetarja e parë shqipe e botuar në Kosovë në vitin 1946.

Pas këtyre viteve në abetare nuk gjejmë figura kombëtare përveç atyre përmbajtjeve që flasin për vëllaznim-bashkim mes popujve në ish-Jugosllavi, për Titon, si figurë qendrore të cilën e kanë çdo abetare deri te abetaret e vitit 1999.

“Naim Frashëri ka punue shumë për Shqipninë. Ai ka shkruar shumë vjersha të bukura. Ne i duem shumë ata që punojnë për Shqipninë, prandaj nuk i harrojmë kurrë”, “Skënderbeu ka qenë një mbret i Shqipnisë. Ai ka bërë gjithë ato lufta kundër anëtarëve dhe gjithë fitimet, sa ai ishte shumë trim dhe i mençur. Prandaj ne e kujtojmë gjithë emrin e Skenderbeut” (Gjevari, Kostari&Raça, 1945).

“Boro e Ramizi-heroj të popullit”, “Bajram Curri, Shpella e Dragobis”, “Skenderbeu tregon bukur trimërin e tij dhe nderin që ja bëri Shqipërisë”, “Ismail Qemajli”, “Figura e Enver Hoxhës, ku paraqitet si biri më i mirë i popullit shqiptar. Ai i vendosun që, kurriherë nuk iu përulë zgjedhës s’anmikut, por i ndeji besnik deri në fund popullit të vet” (Gjevari, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

Tito

Shoku Tito shpresa jonë,

Ti je diell i vendit tonë (Hoxha,1977)

Nga vitet 1846 e deri te abetarja e vitit 2007, shohim një boshllëk, sa i përket edukimit kombëtar për shkak të rrethanave politike. Pas dy abetareve të para të viteve 1945 dhe 1946, abetaret e vitit 2008 dhe 2012 kanë përmbajtje për Skenderbeun dhe nënë Terezën.

Në abetaren e vitit 2008 kemi tregimin, Porosia e fundit e Skënderbeut ishte: “Qëndroni gjithnjë të bashkuar...!” Kurse në abetaren e vitit 2012 tregimin për “Nënë Terezën e njeh e gjithë bota. Ajo kishte zemër të madhe. Gjithë jetën e saj, Nënë Tereza ua kushtoi njerëzve të varfër. Ajo ndihmonte fëmijët e vuajtur. Porosia e saj është: “Të jemi shpirtmirë, ta duam njëri-tjetrin, ta ndihmojmë njëriun që kemi pranë”.

Edukimi kombëtar është mëse i nevojshëm dhe domosdoshmëri, nuk guxon të zbehet ky ndikim nëpër librat tonë. Ne duhet të përgatisim njerëz që e duan, punojnë, nderojnë dhe e ruajnë atdheun kombin.

3. Edukimi për punën

Puna është një prej komponentëve edukative që vlerësohet për ndikimin e gjithmbarshëm edukativ dhe formues të brazave të rinj. Edukata e punës është një faktor i pazëvendësueshëm për formimin e moralit dhe lartësimin e gjithanshëm të personalitetit. Nëpërmjet punës edukohen tiparet më të bukura njerëzore duke shndërruar individin në qenie aktive të vetëdijshme përmes së cilës ne mund t'i realizojmë qëllimet tona, "Pestaloci, Makarenko, apo Harry T. Fultzi kanë vërtetuar se me punë të organizuar mirë, janë riedukuar fëmijët dhe të rinj me zbrazëtira të mëdha në formimin e tyre ose me formim të shtrembër, duke i kthyer në qytetar të dobishëm për shoqërinë" (Musa Kraja, pedagogjia, 2009, Tiranë).

Nikolla Potkonjak ka thënë nuk ka punë pa edukatë, as edukatë pa punë. Sidomos autoret e abetareve të para i kanë kushtuar shumë rendësi vetëdijesimit të fëmijëve për vlerën e punës. Duke mbjelle dashuri për këtë vlerë të quajtur punë e cila ndikon në zhvillimin social, fizik dhe psikik të fëmijës. Po ashtu dhe krijimin e vetive pozitive të karakterit si: qëndrueshmërinë, durimin, përpikërinë, qëndrimin e drejtë ndaj punës, mjeteve dhe produkteve të punës po ashtu qëndrimin e drejt ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

Abetaret kanë tekste dhe poezi që japin njohuri mbi disa profesione si dhe shembuj e modele të figurave punëtore dhe si duhet të punojmë pa pushim.

Ndikime edukative mbi rendësinë e shfrytëzimit racional të kohës gjejmë:

Ora

Porsi ora të punojmë,

Tik, tak, tik, tak,

Kohen s' duhet kot ta çojmë,

Tik, tak, tik, tak (Gjevori, Kostari & Raça, 1945).

"Mira nuk e kalon kohën kot", "Kohën mos e kalo kot" (Xhumari, Bardhi & Lakuriqi, 1972),

"Ata çohen herët ja nisin punës" (Gjevori, Shushka, 1955).

Zhvillimi i vetëdijes dhe ndërgjegjes së të riut për domosdonë dhe rëndësinë e punës për njeriun dhe shoqërinë e gjejmë kështu: "Daja Kola ban opinga-ngrihet herët në mëngjes

vete në dyqan; aty punon gjithë ditën, që të mbajtë shtëpinë e të ushqejë fëmijën. Po nuk punove, s'ke të hash, s'ke të vishesh, s'ke as shëndet, as gëzim" (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

"Pa punë nuk jetohet Rinija e Jugosllavis i është përveshë punës për me shfrytëzu këto pasuri dhe me i përdorë për rindërtimi e vendit të vetë" (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

"Kush nuk punon nuk ha", "Mos prito, por puno" (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

"Në daç lyp, në daç lep, po s'punove, kush s'të jep", "Kush punon- fiton" (Gjevori, Shushka,1955). "Njeriu duhet të punojë" (Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

Pionerët

Përpara pionerë të ri

Përpara ju o fëmi,

Punoni e vraponi

Të mirën ta fitoni (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Formimi i disiplinës së vetëdijshme, se puna duhet të kryhet me kohë dhe me cilësi pa detyrim, por nga vetëdija për rëndësin që ka ajo:

Mëmgjezi

Krejt puntorët që me natë

Kan lanë shtratin e janë çue

Kush me kazëm kush me shatë,

Punës tash ja kanë fillue (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Shembullin e fëmijëve punëtor, duke i njohur me natyrën e punës dhe duke i bërë ata pjesë e këtij procesi e gjejmë: "Qefseri qëndis e nana qep". "Por edhe fëmijët kanë fillue t'i punojnë e zbukurojnë kopshtijt e shkollave" (Gjevori, Shushka,1955).

"Shpendi asht nxanës i mirë. Kohën e lirë e kalon në punishte", "Të rijtë tanë janë puntorë të mirë. Ata punojnë krah për krah me puntorët. Na i duem të rijtë puntorë". (Hoxha, 1966).

“Rinia punon mirë”, “Tomorri bëri supë”, “Vesa lahet, krihet e vishet vetë”, “Jeta ujit lulet”, “Pas mësimit fëmijët shkuan në kopshtin e shkollës”, “Fëmijët i mblodhën gjethet”, “(Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

“Jehona ka jakë. Ajo e punoi me makinë”, “Saksit e Samires. -Une kujdesem për këto saksi, i ujis e i pastroi”, “Njomza e qepi pullën me kujdes” (Batalli, 1982).

Shembuj kur puna përjetohet si kënaqësi, ushtrohet me dëshirë dhe i sjell individit gëzim dhe krenari për rezultatet e arritura: “Tana e pa Palin tue punue. Puno, Pali im! Puna na lumtunon”, “Ademi e Dauti e duen punën. Ata dali me kohë në punë. Puna i lumturo”, “Kush punon gëzon” (Hoxha, 1966).

“Yllka shkoi në punë vullnetare. Puna të bën mirë” “(Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972), “Premtina punon pa përtuar, Puna të kalit”, “Çelikani e çlirimtarja krenohen për babain punëtor”, (Batalli, 1982).

Siç po shihet, te abetaret me të vonshme pak vihat theksi te puna, kemi abetaren e vitit 2008, ku gjejmë një fjali që nuk ka ndikimin e duhur ndaj punës si: “Jemi lodhur nga puna”.

4. Edukimi për dashuri ndaj shkollës

Te abetaret ndihet fryma e mbjelljes së dashurisë për librin dhe shkollën. Lirisht mund të themi duke e nënvizuar se këtë predikim e gjejmë nga një abetare tek tjetra. Kemi tregime vargje dhe porosi që fuqizojnë vlerën e dijes, librave, abetares, mësuesit/es, shkollës, duke i vënë në radhën e faktorëve më të rëndësishëm të përvetësimit të njohurive në përgjithësi si dhe leximit e shkrimit në veçanti.

Përmendet vlera e shkollës si institucion edukativo-arsimor, duke paraqitur librin si burim i fuqishëm i arsimit, për shembull te poezia e më poshtme, te strofa e parë, si dhe edukimi me vlera të larta njerëzore të ngjyrosura me dashuri për familjarët, mësuesin dhe rrethin më të gjerë:

Sa e due shkollën

Të due fort moj shkolla ime,

Se ti mue më jep mësim:
Si me shkruie e me këndue,
Babë e nanë si t'i due,

Si t'i due vlla e motër
Gjith sa jemi në një votër:
Mësuesin t'em si m'e nderue
Dhe me shokët mirë me shkue (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Msojtore

Msojtore e dashur,
Qi neve na bashkon,
Këndimin dhe shkrimin,
Ti neve na i mëson. (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Çka due

Due lojnat e mësimet,
Due punën dhe argëtimet,
Due mësuesin e librat e mij,
Due shkollën që m'ep dit'ni. (Gjevori, Shushka, 1955).

Shkolla

Prind e msus ti nderojmë,
Fjalt e tyne ti ndëgjojmë.

Punët e mëdha kryhen së bashku (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Po ashtu shihet se në abetare kemi përmbajtje që mbështeten në parimin e aktivitetit të vetëdijshëm. Ku nxënësit i përshkruhet vlera dhe rëndësisë së shkollës, duke nxitur motivimin, dëshirën, interesin për të qenë pjesë e saj, për shkak të vetëdijesimit të fëmijëve për përfitimet që vinë nga shkolla, këtë e dokumentojmë me disa poezi dhe pjesë nga tekstet të ndryshme si në vijim:

Shkolla ime

O, sa me qef që shkoj,
Unë në shkollën time,
Mësuesin e ndigjoj,
Kur me jep mësim, (Gjevori, Gjino & Kostari 1947).

Abetaren e mbarova

E due fort, pra, abetaren,
Pse ma dha mu' krejt të mbarën.
E due shkollën dhe mësimin:
Numrat shkrimin dhe leximin(Gjevori,Shushka,1955).

Rruga jonë

Ne në mësim
Jemi të parë,
Rruga e dijes
Na bën krenarë. (Batalli, 1982)

Puna na rritë
Na falë bukuri,
Shkolla na qenka
Plot dashuri (Batalli, 2000)

Naim Frashëri ka thënë; Ai që nuk mëson, Jetën të zezë e shkon (Gjevori, Kostari&Raça, 1945). “Dijmë me lexue gjithëka. Nuk jemi ma të verbët. Sa kënaqësi e madhe asht kjo! Me të vërtetë e ndiejmë vedin sikur fillojmë një jetë të re, plot drit, fat dhe mundësi...”, “Ne nuk duam analfabetizmin dhe mbrapambetjen, sikur ka qenë në Jugosllavin e vjetër. Ne duam shkolla kultur”, “Ne të gjithë duhet të zgjanojmë rrethin e ditunis s’on. Secili duhet të shkoi sa ma shpesh nëpër kurse për me zgjanue ditunin e vet. Po ashtu, secili, duhet të lexojë sa ma shum gazeta të përditëshme, revista dhe sidomos libra. Kush lexon ma shumë ka me qenë ma i zoti me rregullue punët e veta dhe kështu ka me u-ba ma i vlefshëm për popullin e vet (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

“Na do t’bahem nxanës t’mirë, do të mësojmë me dëshirë” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).
“Shkolla asht vendi ku nxajmë lexim, shkrim e shum sende të vlefshëme. Në kohën e Jugosllavisë së përparshëme, shqiptarëve nuk u lejohesh me nxanë shqip. Prandaj, shumica e shqiptarëve sot nuk dijnë me lexue e shkruet. Sot pushteti i ri i Titos ka çelë shum shkolla shqipe e kurse për të rritun” (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

“Jemi puntorë të vegjël”-është poezi qe flet për shkollën dhe dëshirat se çka dëshirojnë të bëhen fëmijët në të ardhmen duke qene puntor ne shkollë (Gjevori, Shushka,1955).

“Për çka s’kam dijtë, kam pyete të tjerët. Po ma së shumti kam mësue tue lexue libra”, (Hoxha, 1966).

“Libri është çelësi i diturisë”, “Dituria është drita e jetës” (Hoxha, 1977).

Poezia për Abetare, thot: “Dora ime u mësua, mendja ime u ndriçua...”(Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

5. Edukimi human

Hartuesit e abetareve i kanë kushtuar mjaft rëndësi krijimit të aftësive për të kuptuar këndvështrimin e tjetrit, pra, se çka mendon tjetri, si ndihet ai duke bërë përpjekje për nxitjen e sjelljeve pozitive, pakësimin e paragjytimeve edhe zgjidhjen e konflikteve.

Kujdesi për nxënësit dhe ndihma që duhet dhënë atyre që të mësojnë të jenë të kujdesshëm ndaj të tjerëve është kthyer në temë qendrore për shumë specialistë të arsimit. Për shembull, Nel Noddignis, bënë thirrje që e gjithë kurrikula të organizohet rreth “temave të përkujdesjes”. Disa nga temat që duhet të trajtohen janë: “Kujdesi për veten”, “Kujdesi për familjen dhe miqtë” dhe “Kujdesi për të tjerët dhe për botën” (Anita, Woolfoil, 2011).

Në abetare, kujdesi dhe sjellja njerëzore kultivohet ndaj fëmijëve, të rriturve, partizanëve, të sëmurëve, invalidëve, të moshuarve, mësuesëve dhe kafshëve etj. Ia vlen t'i cekim disa shembuj duke filluar nga abetarja e pare: "Nëna i tha Drites, buka nuk hudhet. Në qoftë se ti nuk mund ta hash ma, bane thërrime dhe hudhja zogjëvet". "Petriti e Deda janë pionerë. Me pak para që kishin të dy, shkuen dhe blenë një kokërr portokalli dhe ja dhanë partizanit" (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

"Njerzit i ndihmojnë njani tjetrit". "Shoku Tito kujdesohet për krejt popullin puntuer, po ashtu edhe për jetimat prindët e të cilëve ranë dëshmorë në luftën katër vjeçare Nacional-Clirimtare". "Mos i ban tjetrit çka s'ta don zemra me ta ba aj ty" (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

"Nana qau për partizanët e vramë". "Pionerët e duen Titon. Ai kujdeseohet për ata dhe i don fort". "Stevo ka metë pa prind. Partizanet e çuen në një katund shqiptar. Ram Bardhi i tha: Rri te na. Qe, ky asht biri im, Agimi. Ky do të jetë vëllau i yt i vërtetë. Kjo asht shpija jote e re". "Shokët e Bashkimit kanë da qi çdo ditë, mas mësimit, të shkojnë ma i u ndihmue mjeshtërvet në ndërtimin e shijavet në katundin e tyre". "Të lutem, më fal mixha Xhemil, se pa hiri e theva xhamin". "Ndihma që fëmijët i japin gjyeshes së vetmueme, duke i punuar vetë tokën". "Ndihma, se si vëllau i Shpendit hoqi rrypin prej shoke dhe kështu mujtën me e shpëtue Shpendin prej ujit". Eshte pyetja në fund kush nga vëllezrti ka punue me mire. Kështu fëmijët mund të gjykojnë për sjelljen dhe veprimin me te mirë te tre vëllezërve. "Kujdes rueje pasunin e shkollës". "Duej e ndihmo të vorfnit" (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

"Zajmi ra në vijë. Aj e zuni vajzën në ujë. Sa zemër mirë a Zajmi", (Gjevori, Veliu, Kostari&Paçarizi, 1948).

"Tue kalue nëpër katundin tonë, nana e Bujarit u tha: -Djali i juej ka me ju dekë rrugës. E leni te na. Do ta ruej dhe do të kujdesem për të si për djalin tim. As tjerët nuk i mbuullen mollat vetëm për vehte. Mbullën tjerët, hangra unë; tash mbjell unë, të hanë të tjerët". "Tali kur kthehet prej shkolle gjithmonë i ndihmon nanës së vet". "Kalaveshi rrushit- është tregim qe rrëfen se si një kalavesh rrushi është bartur nga vajza te vëllau dhe nga vëllau te babai dhe babai te nëna dhe nëna prap ua ndau fëmijëve" (Gjevori, Shushka, 1955).

“Merita ndihmoi invalidin qe u rrëzua e ju thye kukëza. Ajo shkoi në shtëpi e mori një shkop ja sjelli dhe invalidi u ngrit” Mësuesja i tha mirë ke bo. Nderoni dhe ndihmoni invalidët. “Aliu tue ec pa binarët e hekurudhës të prishun. Ali hoqi shaminë e pionerëvet. Dha shenje me dorë tue bërtite: -Binarëte prishun! Maqinisti e kuptoi rrezikun dhe e ndali trenin. Aliu shpëtoi jetën e shum udhëtarevet”(Hoxha, 1966).

“Çimi e çon motën e vogël në çerdhe me karrocë dhe pastaj shkon në shkollë” (Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

“Dimrit Drini shkon në mal. Takon drerin e bukur ei lë bar, Dreri vrapon pas Drinit”. “Xhaferi kishte thyer xhamin, klasa mblodhi para dhe për ta blere xhamin”, “ Kush ndihmon shokun-ndihmon vete. Miku njihet që është mik në të keqe e në rrezik!” (Hoxha,1977)”.

“Leci e pa mikun e tij të sëmure Cenin”, “ Rota e traktorit ra në gropë. Fëmijët dhe burrat e ndihmuan traktoristin” (Batalli, 1982).

“Mësuesi dhe fëmijët u ndihmuan vreshtarëve”(Batalli, 2000).

“Do t’i mbushim hambarët e do t’i ndihmojmë të uriturit, brohoriti gëzueshëm” (Deva&Krasniqi, 2008).

Genci dhe zogjtë

Ishte ngrisë e madhe.

Zogjtë kërkonin ushqim.

Gencit i erdhi keq. Ai u hodhica grimca buke (Xhumari, Bardhi &Lakuriqi, 1972).

Prindërit e mi

Sot këtu në klasë,

Si n’ çerdhe të nxehtë,

Më është bërë mësuesja,

Prindi im i tretë. (Deva & Krasniqi, 2008)

Besa –Besë

Besa –besë,
Besën ta kam dhenë,
Do ta dua mësuesen
Si ta kisha nënë.

Shkolla më thërret

Udhë e mbarë, o bir'i im!
Vene mendjen në mësim;
Dueja shkollën, more bir,
Edhe bahu nxanës i mire (Gjevori, Shushka,1955).

6. Edukimi ndërkombëtar

Nga abetaret e para e deri te periudha e prishjes së marrëdhënieve në mes të shqiptareve dhe serbëve, shohim se abetaret proklamojnë barazi ndërmjet popujve, qëndrim pozitiv ndaj popujve të ish-Jugosllavisë, bashkëpunim, respekt, ndihmë, miqësi dhe vëllazërim e bashkim. “Detyrë e parë e UNESCO-s në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, ishte përgatitja e programeve të mirëkuptimit ndërkombëtar dhe të edukimit për paqen, në këtë kuadër, u ndërmor pastrimi i teksteve shkollore nga çdo lloj racizmi apo qëndrimi fyes ndaj popujve e kombeve të tjerë. (Mialaret, 1997).

Tregimet më përfaqësuese i gjejmë te abetarja e vitit 1946, si: Rinija e Jugosllavisë ka qenë ajo që filloi e para me mbjell farën e Barazisë dhe të vllazrisë ndërmjet popujve të Jugosllavisë. Në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë i gjithë pushteti buron prej popullit dhe i takon atij. Të gjithë shtetasit e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë janë të njajhtë para logjit, me të drejta të barabarta, pa dallim kombësisje, race, besimi e grade kulturore. Na jemi për bashkim të punëtorit dhe të katundarit. Ne duem që puntoret dhe katundaret të jenë të lidhun ngushtë të kapu ndore për dore. Mos lejoni qi të ngrihet muri në mes të katundarit dhe juve! Populli Shqiptar ka me qenë popull me të drejta të

barabarta dhe se kanë me iu dhanë të tana mundësit për me e zhvillue kulturën e vet, me pas shkollat e veta, me përparue ne bujqësin e tij. Në Jugosllavin e re kanë me iu dhanë popullit Shqiptar të tana ato që mundet me ba populli për popullin. Populli shqiptar ka me qenen nji lloj në se ndodhet mbrenda kufive shqiptar ose Jugosllave. Në këshillat popullore zgjidhen njerëzit ma të mirë, ma të drejtë dhe ma të ndershëm. Ata këshilltarë, që punojnë kundra interesave të popullit, rrëxohen me njo herë prej vetë popullit.

Të gjithë popujt e Jugosllavisë i kanë dhanë dorën njani tjetrit. Tue u bashkue në luftë e në paqe ka lindë vllaznimi dhe janë zhdukë të gjitha shkaqet e dasis dhe të grindjes që anmiqet e jashtëm dhe të mbrendshëm të popullit kishin sht ne mes të tyre (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi 1946).

7. Njohja e moralit

Njohja morale nënkupton arsimin moral, përvetësimin e nocioneve e të kategorive morale, njohjen e normave të qëndrimeve morale, të rregullave e të parimeve morale në përgjithësi njohjen e sistemit të vlerave. Njohja e moralit është etapa e parë e formimit moral, që ka për qëllim t'ua bëjë të ditur fëmijëve se çka quajmë sjellje apo veprim të moralshëm, apo të pamoralshme ose të mirë dhe të keq. Njeriu nuk mund të ketë veprime të moralshme dhe të jetë personalitet i moralshëm nëse nuk i dallon të mirën nga e keqja nëse nuk e di se çka është moral e çka jomoral. Njohja e moralit është shumë e rëndësishme për procesin e formimit moral, por nuk e zëvendëson dhe arrin plotësisht formimin moral të fëmijëve pa u realizuar edhe hallkat tjera shumë të rëndësishme të këtij procesi. Abetaret kanë shembuj që përshkruajnë veprime të moralshme dhe të pa moralshme, që përmes modeleve nga jeta të bëhet njohja e kategorive morale.

Tekstet përfshijnë përmbajtje që flasin për kategoritë jomorale siç janë:

- a) përçarjen,
- b) armiqësinë,
- c) grindjen,
- d) gënjeshtren dhe
- e) mburrjen si cilësi negative të njeriut.

Por, pa lënë anash edhe cilësitë pozitive si:

- a) ndihmën ndaj tjetrit,
- b) puna,
- c) drejtësia,
- d) përdorimin e frazave sociale dhe
- e) sinqeritetin etj.

“Posa e shkelën fashistat vendin t’anë u munduen, me propagandën e tyre të ndytë, me mbjellë përçamje dhe me shti grindje ndërmjett popujve t’on”. “Okupatori dhe shërbëtoret e tij kanë dashtë që popujt e Jugosllavisë të vriten e t’anmiqsohen ndërmjet vedi” (Gjevori, Kolgeci, Riza&Shpendi, 1946).

“Kur këto u përlejshin pulat e tjera e hangrën të tanë drithin. Grindavecet metën pa gjë”. “Kola zu ta, drejtëngucte qenin. Qeni u çue për një herë, i kërcei dhe e kafshoi e ja shkeu tirqit. Mirë ja bani Kolës, qi nuk e la qenin në punë të vet” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

“I biri i Rrahimit nuk rrin rrugëve kur del prej mësimi. Ai disa herë rrin e i ndihmon babës së vet”, “Dhelpna u kënaq me fatkeqsin e ujkut, qe ra në grop. Vërtet budall je! Dhe prej kënaqësis gjithnji kërcente rreth gropës si dudalle. Por diqysh gaboi, i rrëshqiti këmba e ra edhe ajo në grop”. “Ra ujku ndër dele! Por Rrahmani i rrejti. Herën tjetër rrenacakut nuk i besuan ma. Ujku i preu delet”. “Shikon të gjithë! Une jam gjeli ma i fortë! Ende pa mbarue, skyfteri fluturou prej së nalti, e kapi lëvduesin dhe e çoi në çerdh të vet”, “Rrena i ka kambët e shkurta”, (Gjevori, Shushka,1955).

“Rrahimi nuk mundi me e ngrit qerren. Disa burra i ndihmuen. Rrahimi i falënderoi”. “Ajo pastrohet e krihet vetë. Fustanet i ven në varëse. Nanës i ndihmon në punë. Pastron këpucët e veta e të prindëvet”, (Hoxha, 1966).

Picimuli

Fjalë të ndyta kurrë nuk flas,
 Rrenën fort e kam meras!
 Me rrugaçë fare s’rrij,
 Fort i zgjedhi shokt e mij (Hoxha, 1966).

Fëmijë hani këto qershia! Selvija i mori të gjitha për veti. Në fund të ilustrimit shkruan/Tregoni si është drejtësia? (Hoxha, 1977), Mirashi bëri shaka me Shegën. Ai i kërkoi falje (Batalli, 1982).

8. Premtimet

Te edukimi moral ka rëndësi shumë edhe konsekuenca në mes fjalëve dhe veprimeve, ku për shembull te mësimi “Premtimi i Gazmendit”, ka pasur për qëllim me nxjerrë rëndësinë e premtimit dhe mbajtjes së tij. Nëse ne premtojmë dhe nuk e mbajmë premtimin nuk mund të flasim për vlera morale.

Tregon se si Gazmenti ka premtu se nuk do t’i bëjë më disa veprime qe janë jo të mira si: nuk kam me pështye në rrugë, Kurr nuk kam me i qit letrat e lëvoret në pod. Nuk ka m me i prishë gardhet dhe nuk kam me i shkruie në muret e shtëpijave të ndërtesave. Me gjithkand kam me fol si duhet. Kam me qenë mprojtës i zogjve. Kam me ruejtë pasurin e të tjerëve, siç dëshiroj që edhe të tjerët të ruejnë temën. Kam me o dashtë prindët dhe vllaznit, të tanë popullin puntuer (Gjevori, Gjino&Kostari, 1947).

Tregimi, Fjala e majtun e pionerit, në mbledhjen e pionervet, Drita qau. I dha fjalën shokëve të vet se kurr nuk ka me e idhnue ma shoqen mësuese. Për herë ka me i mësue mësimet. Drita e vogël u ba nxënësja dhe pionierja ma e mirë.

9. Bujaria

Bujaria si virtyt moral, i njohur si tipar karakteristik i popullit tonë, që është përcjellë dhe kultivuar brez pas brezi. Të qenit bujar, do të thotë që njeriu të jetë dorëdhënës, zemërgjerë dhe fisnik. Këto i bënë pa paragjykime, me ndershmëri. Bujaria është virtyt i njeriut zemërbardhë. (Kraja, 2009). Abetaret kanë shumë shembuj të mirëseardhjes, mikëpritjes, ndihmës, e deri te figura me e përsosur morale e njeriut te Nënë Tereza.

Si shembuj të tillë kemi: “Kur i pa, u-ngrit në kambë dhe u duel përpara tue bërtite: Erdhën! Erdhën!” (Gjevori, Kostari&Raça, 1945).

Mësimi “Stani i Qamilit”, ku priten dhe ushqehen partizanët. Dashunija vllaznore-ku Stevon shqiptarët e kanë mbajtur dhe rritur në shtëpin e tyre. Jovo i shkruan letër nënës, ku Jovo ka qenderuar një kohë te gjatë në shtëpinë e Bujarit ku është mirëpritur si biri i tyre. Tregimi “Gjyja e vetmueme” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Besa

Jemi vllazën, jemi shokë

Që të tanë.

Njani tjetrit neve besën

i kemi dhanë.

Do ta duem njani tjetrin

Sikur vlla,

Do t’ndihmojmë shoqi shoqin

Sa s’ka ma! (Gjevori, Shushka, 1955)

10. Morali

1. Mjetet e edukimit moral

Mjetet e edukimit moral janë instrumentet dhe mënyra kryesore për realizimin e qëllimit dhe detyrave të edukimit moral, i gjejmë në përmbajtjet e teksteve, poezive dhe përrallave, përmes të cilave synohet të realizohen objektivat. Kryesisht janë përdorur këto metoda, si:

Këshilla,

Modeli,

Gara dhe

Dënimi.

Në përmbajtjen e abetareve shohim se, përveç edukimit të qëllimshëm dhe përmirësues, kemi edhe disa raste të edukimit represiv.

1.1. Këshilla

Këshilla është mjet i edukimit moral e cila gjenë zbatim në komunikim në mes të njerëzve që janë personazhe në përmbajtje e poezive dhe teksteve në abetare. Qëllimi i këtij mjete është që t'i këshillojë nxënësit se si duhet të sillen e të veprojnë rrethana të ndryshme që janë në përputhje me normat sociale dhe ligjore. Këshillat janë me ndikime të ndryshme, si edukim shëndetësor, edukim moral etj.

Laj duert!

Para e mbas buke

Laj duert, Zana,

Mos e ban vehten

Te qortojë nana (Gjevori, Shushka,1955).

“Atë qi njana nuk mujt me e ba vetëm, e banë të trija bashkë krejt lehtë” (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

Vlera e unitetit, unifikimit potencohet në këto vargje si:

Thuprat e thyera

Shtatë veta qenë,

Kur ishin të ndarë

Kurrë s'ishin të parë.

E kur u bashkuan

Shtatë trima u bënë. (Hoxha,1977)

Ne e pastërtia

Ne jemi të pastër.

Në klasë nuk kemi mbeturina.

Pastërtia është shëndet (Batalli, 2000)

“Tito foli me pionerët si babë. I këshilloi ata, u foli për detyrët e rej. Ata i dhanë fjalën se do të punojnë si i mëson ai”, (Gjevori, Gjino&Kostari 1947).

1.2. Modeli

Modeli është mjet i edukimit moral, mjaft i fuqishëm i cili ndikon drejtpërdrejt dhe pa u imponuar, duke u tërhequr dhe nxitur njëkohësisht sipas tij.

Shkenca e psikologjisë thotë se duke filluar nga mosha 6 gjer në 10 vjeç mbi zhvillimin social dhe personalitetin e fëmijës, përveç familjes ndikojnë edhe faktorët e tjerë të shumët, si: shkolla, klubet, shtypi që ushtrojnë ndikimin e tyre. (Pettijohn, 1996). Identifikimi me personat tjerë fillon qysh në moshën katër ose pesë vjeçe, arrijnë ta kapërcejnë egocentrizmin e tyre dhe fillojnë të identifikohen me prindërit ose ndikimet tjera dhe fillojnë të imitojnë mënyrat karakteristike të të sjellurit.

Abetaret kanë shembuj të shumtë të edukimit moral: “Nxënës i mirë”, “Jeta po mëson”, “Luli qep vetë”, “Babai i Vegimit”, “Ne e pastërtia”, “Në zyrën e babait”, “Xaja”, “Gjergji”, e shumë tekste të tjera.

Në vijim do t’i paraqesim modelet pozitive si: “Xaja punon në xeheroren e Trepçes. Xaja ma parë ka qenë analfabet, por sod ka nxanë me lexue” (Gjevori, Velju, Kostari&Paçarizi, 1948).

Gjergji ka qenë nxënës shkolle. Kur filloi lufta kundër fashizmit, menjëherë ai doli në mal. Në luftë është plagosur gjashtë herë. Tash Gjergji mbaroi shkollën ushtarake e po shërben në Armatën Jugosllave (Gjevori, Velju, Kostari&Paçarizi, 1948).

Nxënës i mirë Xaja i don librat. Ato i ruen me kujdes. Ka orar të caktuem pune. Lexon e mëson me andje. I don nxënësit e klasës e të tjerët. U ndihmon në kryemjen e detyravit, (Hoxha, 1966).

Jeta po mëson

- Jeta, eja në oborr të luajmë,

- Jo, Bujar, nuk kam kohë të luaj: tani po mësojë. Ti eja mëso me mua, pastaj luajmë.
- Shumë mirë, Jeta tani po vij (Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

Luli qep vetë

Lulit i kishte rënë kopsa e palltos.

Ai mori ta qep vetë (Xhumari, Bardhi&Lakuriqi, 1972).

Babai i Vegimit

Si u bëtët vrapues i dalluar? – e pyetën shokët e Vegimit.

- Vetëm me ushtrime mund të bëheni si unë, - ua priti babai i Vegimit, (Batalli, 1982).

Në zyrën e babait

Dorina kishte pare nje babë ndryshe, që shkruante ne kompjuter, rregullonte disa shkresa në dosje. Herë pas here përgjigjej në telefon. Dorina kur u kthye në shtëpi i tha mamit: -O ma sa shumë punë ka babi ne zyrë! -A do të bëhem edhe unë një ditë si babi? (Rrokaj, Gjokutj, Krasniqi&Pozhegu, 2012).

Kemi edhe disa modele jo të mira, që mbetet në dorën e mësuesit/es që të nxjerr pororsinë pozitive nga to si:

Loja në rrugë

“Rrezaku nisi të luejë me arra rrugëve. Mësimet i la mbasdore. Mësuesi i njoftoi prindët e Rrezakut. I ati e zbuloi të vërtetën. Rrezaku ka zanë miqësi me rrugaçë” (Hoxha, 1966).

Lulla në shkollë

“Vullneti shpeshherë niset pa vullnet në shkollë. Kur niset Vullneti në shkollë, shtëpinë e kaplon tollovia” (Hoxha, 1977).

“Baba i Yllit pin duhan me llullë. Ai e këshillon Yllin të mos pijë duhan. Duani e damton trupin e njeriut”(Hoxha, 1966).

1.3. Gara

Gara si mjet edukativ e kemi hasur te abetarja e vitit 1966.

“Nxnësit e nji klase bajshin gara”. “Ata mësojshin e luftojshin kundër njishave”.“ Garat treguen sukses të mirë” (Hoxha, 1966). Autori dëshiron të ngjallë garën si mjet për arritjen e rezultateve më të mira në shkollë.

1.4. Denimi

Denimi, si mjet edukativ nuk gjendet shpesh nëpër abetare, pasi që dhe sot nuk rekomandohet shumë. E gjejmë te abetarja e vitit 1966 ku thuhet: Nexhati dhe Xhavitit tue luejt me top në klasë e thyen xhamin. Mësuesi i caktoi të ulen në bankën afër xhamit të thyer. Ata dridheshin nga të ftohtit. Nji ditë e lutën mësuesin që t’ua ndërrojë vendi, (Hoxha, 1966). Ndëshkimi mund të sjellë efekte anësore negative. Ai mund të shërbejë si model për veprime agresive dhe mund të nxisë reagime emocionale negative te nxënësit (Woolfolk, 2011).

2. Llojet e edukimit

Në abetare kemi ndikim të qëllimshëm dhe ndikim përmirësues, por kemi hasur edhe një rast të edukimit represiv te abetarja e vitit 1972. Edukata represive si lloj i edukatës manifestohet me qëndrime, me kërkesa dhe sjellje të ashpra ndaj fëmijëve. Kemi dy raste në njërin ku bëhet përpjekje të arrihet edukimi përmes frikës dhe rasti i dy, ku paraqitet një prind syçelë (vigjilent) dhe me kulturë pedagogjike që e lufton frikën e paarsyeshme si:

Rasti i parë:

Kur isha e vogël, më flisnin:

“Fli tani, Zamira, mbylli sytë shpejtë, se të ha gogoli”, (Xhumari, Bardhi & Lakuriqi, 1972).

Agimi i frikësuar

Agimi doli natën. Diçka ra e tringçlloi. Agimi u frikësua.

-Nënë gogoli! -bërtiti Agimi.

-Jo, Agim, askund nuk ka gogol. Mos u frikëso kot! (Batalli, 1982)

Për të përmbushur nevojat e brezave të rinj për edukim moral është e rëndësishme që të rivlerësohen dhe rishikohen programet mësimore. Në ditët e sotme është mëse e domosdoshme që të shtohet komponenta edukative në çdo libër dhe të realizohet brenda çdo ore mësimore pa marrë parasysh lëndën, se cila do ta ketë për objektiv edhe realizimin e edukimit. Sot duhet të rishikohen programet, sistemet shkollore dhe librat duke marrë parasysh se nevoja kërkon që t'u jepet zgjidhje problemeve të shumta shoqërore që po dalin sot në shoqërinë tonë si dhe të kuptohet rëndësia e edukimit moral.

PËRFUNDIMI

Ky punim është bërë si një përpjekje për të shtjelluar dhe analizuar zhvillimin e abetareve shqipe në Kosovë në harkun kohor prej 67 viteve. Gjatë analizës etnolinguistike dhe pedagogjike të abetareve në Kosovë, do t'i përcjellim ndryshimet që kanë pasur abetaret nga vitit 1945 deri më sot. Ndryshimet janë dialektore, onomastike, në aspektin metodik pra, të metodave dhe formave për mësimin e leximit dhe shkrimit, ndryshime edhe në strukturën e abetareve, në procedimin didaktik të orës mësimore dhe në ndikimet edukative, etj, etj.

Çështjet e studimit në këtë punim i kemi konceptuar në disa njësi. Studimi përfshin njohjen jetës dhe veprimtarisë së autorëve të abetareve shqipe që janë përdorur në Kosovë nga vitit 1945 e deri te abetarja mbarëkombëtare. Përveç njohjes së tyre si hartues të abetareve, ne shohim se ata ishin edhe mësues për fëmijë dhe të rritur, pikërisht me abetaret e hartuara nga ata, kjo vlen për autorët e abetareve të para. Ata i shërbyen mbijetesës së arsimit shqip në Kosovë dhe me punën e tyre si redaktor, kryeredaktor, inspektor të arsimit. Abetaret tona kanë filluar me autorë nga Shqipëria dhe për fat të mirë përfundon me abetaren unike me autorë nga Shqipëria dhe Kosova.

Gjatë këtij pasqyrimi kronologjik të abetareve, kemi gjetur se struktura ka pësuar disa ndryshime të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me zhvillimin e shoqërisë, me zhvillimin e metodikës si disiplinë, me përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore e klasa përgatitore dhe me zhvillimin e shkencave të tjera. Ku shohim se zhvillimi i psikologjisë vë në pah më shumë elemente të mësimin të diferencuar dhe shkathtësinë e shkrimit duke e përshtatur me zhvillimin proksimo-distal të fëmijëve.

Pra, sa i përket strukturës kemi abetare e paparaabetare, pastaj paraabetarja si pjesë e abetares, paraabetarja si libër i veçantë dhe paraabetare të integruar brenda abetares dhe

librit abetare pune. Paraabetarja e ka pas dhe e ka rolin mbështetës për nxënësit fillestarë. Historikisht, paraabetarja ka ndryshuar si nga: kohëzgjatja, qëllimi, vëllimi, konkretizimi, aktivitetet, detyrat, ushtrimet, etj.

Kurse abetarja e mirëfilltë ku punoheshin tingujt/shkronjat dhe mësohej leximi dhe shkrimi, shohim se kanë procedim didaktik të ndryshëm të orës mësimore. Kemi abetare që e vënë nxënësin në pozitën e objektit dhe subjektit gjatë punës me këtë libër. Abetaret kanë pasur ora mësimore që fillon dhe mbaron me një hap d.m.th, njëjtë pa një gradualitet në rritjen e vështirësisë ose ore mësimore që përbëhen nga dy, tre ose deri katër hapa, kemi orë mësimore me qasje analitike, po ashtu dhe strukturë të orës mësimore ku nxënësve ju ofrohet mësimnxënie ndërvepruese me librin dhe mësuesin përmes aktiviteteve që kërkon abetarja.

Arritja e rezultateve të caktuara për mësimin e leximit dhe shkrimin, varet edhe nga aspekti metodik me të cilin janë hartuar abetaret. Metodatat e hartimit të abetareve janë: Metodatat sintetike, metodatat analitike, metoda globale dhe metoda analitike-sintetike të mësimin të leximit dhe shkrimin.

Me metodën sintetike rrokje për rrokje është hartuar abetarja për të rritur e vitit 1946, metodën e tingujve natyral e gjejmë te këto abetare: e vitit 1955, 1966 dhe 1977, metoda fonografiken te abetaret e këtyre viteve 1966, 1955, 2008, metodën fonetike te abetaret 2003, 2008 dhe 2012.

Pastaj kemi abetaret që janë hartuar me metodën analitike si: metodën e fjalëve normale abetarja e vitit 2003, 2007 dhe 2008, metodën e fjalës normale abetaret e viteve 1955, 1966, 2003, 2008 dhe 2012, metodën e rrokjeve normale e gjejmë te abetarja e vitit, 2012.

Grupi tjetër i metodave janë metoda globale me të cilën janë hartuar abetarja e vitit 2008 dhe 2012. Kurse me metodën analitike-sintetike, gjejmë se është hartuar abetarja e vitit 2003, 2008 dhe 2012.

Kemi arritur të nxjerrim përfundime edhe për format e mësimin të shkronjave në të gjitha abetaret. Të gjitha abetaret janë hartuar duke u mbështetë në këto tri forma, si: Forma monografike, grupore dhe komplekse e mësimin të tingujve/shkronjave.

Sipas formës monografike i kanë mësuar tingujt/shkronjat nxënësit që kanë mësuar me këto abetares, me abetaret e viteve 1948, 1951, 1955, 1966, 1972, 1977, 1982, 2003, 2008 dhe 2012.

Me formën grupore janë hartuar këto abetare: abetarja e vitit 1946, 1948, 1951,1977, 1982 2003 dhe 2012. Dhe formën komplekse janë hartuar këto abetare: Abetarja e vitit 1945, 1947 dhe abetaret e fundit në Kosovë ajo e vitit 2008 dhe 2012.

Këto forma i gjejmë të kombinuara, dy ose tri format te një abetare, por kemi edhe abetare të hartuara ekskluzivisht vetëm nga një formë si abetarja e parë e vitit 1945 dhe abetarja e vitit 1947 të cilat për rrethanat kohore dhe niveli i përgatitjes së nxënësve janë shumë të vështira.

Një çështje tjetër mjaft e rëndësishme në studimin etnolinguistik të abetareve është edhe onomastika. Gjatë studimit kemi gjetur të dhëna të rëndësishme që lidhen me ndryshimet e shumta politike në Kosovë të cilat kanë reflektuar drejtpërdrejt në sistemin arsimor edhe te onomastika e librave të botuar gjatë viteve 1945-1999. Në bazë të kësaj analize abetaret i ndajmë në tri periudha si:

Periudha e parë e cila përfshin abetaren e parë të vitit 1945 e cila është sjellë nga Shqipëria në Kosovë. Abetarja ka frymë kombëtare. Në abetare kemi këto lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe, emra ilirë, emra katolikë dhe emra oriental.

Periudha e dytë i përfshinë abetaret e botuara në ish-jugosllavi, nga viti 1946-1999. Dhe pse janë abetaret e të njëjtës periudhë, kanë lloje të ndryshme të emrave. Këta emra lidhën edhe me ndryshimet politike dhe shoqërore të kohës. Në bazë të llojit të emrave, abetaret e kësaj periudhe i ndajmë në katër grupe si:

Grupi i parë, përfshin abetaret e vitit 1946, 1947 dhe 1948. Abetaret e vitit 1946 dhe 1947 janë abetare për të rritur. Emërues i përbashkët i këtyre tri abetareve është se janë në ndikimin e politikës jugosllave. Abetaret karakterizohen me rënie të emrave shqip dhe rritje të emrave sllav dhe vendbanimeve nga Jugosllavia e atëhershme.

]

Grupi i dytë, i përfshin abetaret e vitit 1951, 1955. Për dallim nga grupi paraprak te këto abetare shihet tendenca për ngritje të emrave nga fjalë shqipe edhe emrave oriental. Në këto abetare kemi këto lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe, emra ilirë, emra katolikë dhe emra oriental. Emra sllav në këto abetare nuk ka.

Grupi i tretë, këtë etapë e përbëjnë abetarja 1966, 1967 dhe 1977. Abetarja e vitit 1966 dhe 1967 i kanë emrat e njëjtë sepse abetaret janë të njëjta për kah përmbajtja, autori i njëjtë por, dallojnë vetëm nga rendi i përpunimit të leximit dhe shkrimit. E përbashkëta e tri abetareve është se kanë dukshëm rritje të emrave nga fjalë shqipe për dallim nga abetaret paraprake dhe emrat Ilirë, bie numri i emrave të oriental dhe emra sllav nuk ka.

Grupi i katëtr, përfshinë abetaret nga viti 1982 deri 1999, këto vite janë të autorit Qamil Batallit. Këto abetare karakterizohen vetëm me dy lloje të emrave si: emra nga fjalë shqipe dhe emra ilirë. Nuk ka emra sllav as oriental.

Periodha e tretë, përfshin abetaret nga viti 2000-2012 të botuara në liri. Kemi abetaren e vitit 2003, abetaren e vitit 2008 dhe Abetaren mbarëkombëtare të vitit 2012. Te këto abetare ndihet fryma e lirisë. Abetaret kanë emra shqip, por edhe të huaj, ndërkombëtarë, të ndikuar nga letërsia, arti, radio-televizioni, kinematografia, sporti, moda, etj. Po ashtu shihet tendenca për edukimin gjeografik të fëmijëve sepse kemi emra të vendbanimeve nga të gjitha trojet shqiptare dhe disa të vendeve evropiane.

Çështje tjetër me rëndësi për njohjen sa më të shumanshme të abetareve është edhe analiza dialektore e tyre. Nga kjo analizë dalin përfundime se të gjitha abetaret në Kosovë deri në vitin 1972 janë të hartuar me dialektin gegë. Ku nga vitit 1977 e tutje abetaret hartohen me gjuhë standarde sipas Kongresit të Drejtshkrimit Shqip.

Gjatë analizës mund të përfundojmë se kemi gjetur alternim të zanoreve në të gjitha abetaret nga vitit 1945-1966 pa përjashtime. Pastaj, rënia e tingujve si: Aferezë në abetaret e këtyre viteve, 1945, 1947, 1966 , 1967, 2008 dhe 2012. Sinkopë kemi te këto abetare: Abetaret e viteve 1945, 1946, 1947, 1948, 1951, 1955 dhe 1966. Kurse apokopa si dukuri e rënies së tingujve në fund të fjalës e gjejmë te këto abetaret e këtyre viteve: 1945, 1946,

1947, 1948, 1951, 1955 dhe 1966. Po ashtu, në të gjitha abetaret deri në vitin 1966 kemi kalim të tingujve/shkronjave nga /ë/n /a/, kurse kalim të bashkëtingëllores /h/në/f/ kemi te këto abetare si ajo e vitit 1945, 1947 dhe 1955.

Dhe rotacizmin e kemi gjetur shpesh në të gjitha abetaret deri ne vitit 1966, e cila abetare këtë dukuri e ka më të shprehur se të tjerat. Abetaret kanë asimilim të bashkëtingëlloreve dhe asimilim të grupit të zanorëve po ashtu edhe fjalë me mbaresa si: /shin/, /ue/, /vet/, /uem/, /er/, etj.

Këto abetare përveç komponentes arsimore, kanë ndikim shumë të madh edhe në edukimin moral. Ndikime të tilla gjejmë sa i përket edukimit familjar, edukimit kombëtar, edukimit për punë, dashurisë për dije, edukimin ndërkombëtar, si dhe formimin e shume cilësive morale. Por, për edukimin moral mund të vijmë në përfundim se është shumë më e theksuar në abetaret e para dhe intenziteti i kësaj komponente vjen duke u zbeh gradualisht në abetaret më të vonë. Mendojmë se është mjaft shqetësues fakti i një rënie të tillë sepse librat kanë qëllimin arsimor dhe edukativ dhe nuk duhet lënë pas komponenta edukative.

Zhvillimi i përgjithshëm social, politik, ekonomik dhe ai arsimor në periudhën pas viteve 1945 e deri në vitin 1999 u bë në rrethana specifike në krahasim me rajonet e tjera të ish-Jugosllavisë. Abetarja shqipe në Kosovë është pasqyrë e shkollës dhe jetës tonë. Është libri i parë për të gjithë nxënësit dhe ndihmoi arsimin e popullit edhe në kushtet më të pa përshtatshme. Historikisht, abetaret janë libra që kanë evoluar gjithnjë për të mirë sa i përket aspektit gjuhësor, metodik, dialektikor, onaomastik dhe didaktik.

CONCLUSION

This paper is an attempt to elaborate and analyze the development of Albanian ABC-Books in Kosovo over a period of 67 years. During the ethnolinguistics and pedagogy analysis of ABC-Books in Kosovo, we will follow the changes that ABC-Books have had since 1945 and until today. The changes are dialectical, onomastic, in the methodical aspect i.e. methods and forms for teaching reading and writing, changes also in the structure of the ABC-Books, in the didactic processing of the lesson and in the educational influences etc.

The researched subjects in this paper are conceived in several units. The study includes an introduction to the life and work of Albanian ABC-Books authors used in Kosovo from 1945 to the nationwide ABC-Book. In addition to recognizing them as designers of ABC-Books we find that they were also teachers for children and adults, precisely with the ABC-Books they designed, this applies to the authors of the first ABC-Books. They served the survival of Albanian education in Kosovo and with their work as editor, editor-in-chief and inspector of education. Our ABC-Books started with authors from Albania and fortunately it ended with a unique ABC-Book with an author from Albania and Kosovo.

During this chronological overview of the ABC-Books we found that the structure has undergone some changes that are directly related to the development of society, the development of methodology as a discipline, the inclusion of children in preschools institutions and preparatory classes and the development of other sciences, where we see that the development of psychology highlights the elements of differentiated learning and literacy by adapting it to children's proximo-distal development.

So in terms of structure we have ABC-Books without Pre ABC-Books, then the Pre ABC-Book as a part of an ABC-Book, the Pre ABC-Book as a special book, and the Pre ABC-Book integrated within ABC-Book and the ABC-Book workbook. The Pre ABC-Book has had and has a supporting role for elementary students. Historically, the Pre ABC-Book has changed as: in length, purpose, volume, concretization, activities, tasks, exercises, etc. Whereas the genuine ABC-Book where the sounds/letters were worked and the reading and writing were taught, we find that they have different didactic processing of the lessons. We have Pre

ABC-Books that put the student in the object and subject position while working with this book. ABC-Books have had classes that start and end with one step i.e. without a gradual increase in difficulty, or classes consisting of two, three or up to four steps, we have lessons with analytical approaches, as well as class structure where students are offered an interactive learning with the book and with the teacher through the activities that the ABC-Books requires.

The achievement of certain results for reading and writing also depends on the methodological aspect with which the ABC-Books are designed. Design methods of ABC-Books are: Synthetic methods, analytical methods, global methods and analytical-synthetic methods of learning to read and write.

With the synthetic method syllable for syllable the ABC-Book of the year 1946 was designed, the method of natural sounds is found in the following ABC-Books: those of the year 1955, 1966 and 1977, the phonographic method of the ABC-Book of 1966, 1955, 2008, the phonetic method of ABC-Books of 2003, 2008 and 2012. Then there are the ABC-Books that were compiled by the analytical method like: the normal word method the ABC-Book of 2003, 2007 and 2008, the normal word method the ABC-Books of 1955, 1966, 2003, 2008 and 2012, the method of normal syllables we find in the ABC-Book of the year 2012. Whereas with the analytical-synthetic method, we find that the ABC-Books of the years 2003, 2008 and 2012 were designed.

We have also come to conclusions about the forms of learning letters in all ABC-Books. All ABC-Books are designed based on these three forms such as: Monographic, group and complex forms of learning sounds/letters.

According to the monograph form, the students learned the sounds/letters with these ABC-Books, respectively with the ABC-Books of 1948, 1951, 1955, 1966, 1972, 1977, 1982, 2003, 2008 and 2012. The following ABC-Books were designed in group forms: ABC-Books of the year 1946, 1948, 1951, 1977, 1982, 2003 and 2012. And the following are of complex forms: ABC-Book of 1945, 1947 and the last ABC-Books in Kosovo of 2008 and 2012. These forms are combined, two or the three forms of an ABC-Book, but we also have ABC-Books

designed exclusively from only one form, such as the first ABC-Book of 1945 and the ABC-Book of 1947 which were very difficult at the time and the level of preparation of students.

Another very important subject in the ethnolinguistic study of ABC-Books is also onomastics. During the study we found important data related to the numerous political changes in Kosovo that have directly reflected in the education system even on onomastics of ABC-Books published during 1945-1999. On the basis of this analysis we divide primers into three periods such as:

The first period that includes the first abc-book of the year 1945 brought from Albania to Kosovo. This book has a national spirit. In the abc-book we have types of names such as: names from Albanian words, Illyrian names, catholic names and oriental names.

The second period included the abc-books published in former Yugoslavia from 1946-1999. Even though these abc- books are of the same period, they differ in names. These names are connected with political and social changes of the time. Based on the type of the names, the abc-books of this period are divided in four groups:

The first group includes the abc-books of the year 1946, 1947 and 1948. The abcbooks of the year 1946 and 1947 are abc-books for adults. These abc-books are nominated together because they were under the influence of the Yugoslavian policy. The abc-books are characterized with the fall of the Albanian names and the growth of the slavic names and places from the former Yugoslavia.

The second group includes the abc-books of 1951 and 1955. Unlike the previous groups, these abc-books show tendency for the rise of the names from the Albanian language and oriental names. In these abc-books we have names such as: names from Albanian words, Illyrian names, catholic names and oriental names. There are no Slavic names in these abc-books.

The third group is composed by the abc-books of 1966, 1967 and 1977. The abcbooks of 1966 and 1967 have the same names because they are the similar regarding content, and it

is the same author, but they distinguish only from the order of reading and writing. The common things of these abc-books are the rise of names from Albanian words and the Illyrian names. The number of oriental names falls and there are no Slavic names.

The fourth group includes the abc-books from 1982 until 1999. These are the years of the author Qamil Batalli. These abc- books are characterized by only two types of names such as: names from Albanian words and Illyrian names. There are no oriental or Slavic names.

The third period includes the abc-books from the year 2000-2001 published in freedom. We have the abc-book of the year 2003, the abc-book of 2008 and the nationwide abc-book of 2012. The spirit of freedom is felt at these abc- books. They have Albanian names but also foreign international names influenced by the literature, art, radio-television, cinematography, sports, fashion etc. Also, we see the tendency for geographical education for children because there are names of places from all of the Albanian lands and some from European places.

Another important subject for the wider recognition of ABC-Books is their dialectical analysis. From this analysis, it is concluded that all ABC-Books in Kosovo until 1972 are designed with the Gheg dialect. Whereas from the ABC-Book of 1972 by authors Kole Xhumari, Gani Bardhi and Anton Lakuriqi it is in the Tosk dialect. From 1977 onwards the ABC-Books are drafted in standard languages according to the Albanian Spelling Congress.

During the analysis we can conclude that we have found vowel alternation in all ABC-Books from 1945 to 1966 with no exceptions. Then a drop of sounds such as: Apheresis in the ABC-Books of the years 1945, 1947, 1966, 1967, 2008 and 2012. We have syncop ABC-Books such as: ABC-Books of 1945, 1946, 1947, 1948, 1951, 1955 and 1966. Whereas the apocope as a phenomenon of the dropping of sounds at the end of the word we find it in the ABC-Books of the years 1945, 1946, 1947, 1948, 1951, 1955 and 1966. Also in all ABC-Books until 1966 we have the passage of sounds/letters from /ë/ in /a/, and the passage of consonants /h/ in /f/ we have these in the ABC-Books like the one of 1945, 1947 and 1955.

And we have often found rotacism in all the ABC-Books until 1966, which ABC-Book has this phenomenon more pronounced than others. ABC-Books have assimilation of consonants and vowel assimilation as well as endings such as: /shin/, /ue/, /vet/, /uem/, /er/, etc.

These ABC-Books, in addition to the educational component, have a great impact on moral education as well. We find such effects in terms of family education, national education, job education, and love of knowledge, international education and the formation of many moral qualities. But for moral education we can conclude that it is much more pronounced in the first ABC-Books, and the intensity of this component gradually diminishes in the later ABC-Books. We think it is quite disturbing that such a decline is because books have an educational purpose and educational components should not be left out.

The overall social, political, economic, and educational development in the period after 1945 and until 1999 was made in specific circumstances compared to other regions of the former Yugoslavia. Albanian ABC-Book in Kosovo is a mirror of our school and life. It is the first book for all students and helped educate the people even in the most inappropriate conditions. Historically, ABC-Books are books that have always evolved for the better in terms of linguistic, methodical, dialectical, onomastic and didactic.

BIBLIOGRAFIA

- Alaj, S. (1972). Abetarja e re . Shkëndija, nr. 14-15, f. 20
- Batalli, Q. (1982). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (1983). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (1985). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (1986). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (1987). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (1990). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (2003). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (2004). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q. (2005). Abetare. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Batalli, Q & Hasan, H. (1990). Si ta pagëzojmë fëmijën. Prishtinë: Zëri i rinis.
- Baliu, B. (2008). Onomastika e Kosovës. Prishtinë.
- Batalli, Q. (1982). Plani i shkoqitur orientues, Shëndija, nr.18, fq, 8
- Berisha, B., Iljazi, I. (1982). Tekste gjithnjë më shumë, Shkëndija, nr. 16, p.5
- Buletini Arsimit i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës. (1982). Plani dhe programi unik i punës arsimore – edukative në shkollën fillore. Prishtinë.
- Buletini Arsimit i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës. (1977). Plani dhe programi i korigjuar i punës arsimore – edukative në shkollën fillore. Prishtinë.
- Buletini Arsimit i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës. (1954). Plani dhe programi mësimorë për landët e mësimi të shkollave tetëvjeçare shqipe. Prishtinë
- Bevapi, K. (1996). Meditim pedagogjik mbi abetaret shqipe. Tiranë: Onufri.
- Brada, R. (2005). Pedagogjia. Tiranë.
- C. Martler, C.N. Charles, (2005). Introduction to educational research. United States of America, Pearson.
- Deva, A., & Krasniqi, I. (2008). Abetare. Prishtinë: Dukagjini.
- Deva, Z. A. (2003). Edukimi i parashkollorit në familje. Prishtinë.

- Domi, M. (1976). Mbi jehonën e botimit të abetarit shqip dhe të veprimtarisë së Naum Veqilharxhit në shtypin romun të kohës. Studime filologjike. Akademia e shkencave e RPSSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Vitit XXX (XIII).nr.4. fq. 126.
- Dizdari,T.(2005). Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe (rreth 4500 fjalë me prejardhje nga gjuhët turke, arabe dhe perse), Tiranë: Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC).
- Elezi, M. (2015). Fjalor me emra njerëzish-31 000 emra iliro- shqiptarë.Tiranë: Fishta.
- Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes.(1970). Nish.
- Fjalor i gjuhës shqipe. (1954). Tiranë.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe.(1981). Prishtinë: “Rilindja”.
- Grup autorësh. Pedagogët e mëdhenj. Tiranë
- Gjinari, J. (1988). Dialektologji shqiptare. Tiranë: “SHBLU”.
- Gjinari, J. (1989). Dialektet e gjuhës shqipe. Tiranë.
- Gjinari, J & Shkurtaj, Gj. (2003). Dialektologjia. Tiranë: “SHBLU”.
- Gjevori, M., & Shpendi, R., & Kolgeci, S., & Riza, I. (1945). Abetare për të rritur.Tiranë.
- Gjevori, M., & Gjino, J., & Kostari, S.(1947). Abetare për klasën e parë të shkollës fillore. Jugoshtampa: Beligrad.
- Gjevori, M.,& Kostari ,S., & Veliu, Sh., & Paçarizi, T.(1948). Abetare për të rritur.Biligrad: Ditunia.
- Gjevori, M., &Kostari, S.(1951). Abetare për klasën e parë të shkollës Fillore. Prishtinë: Mustafa Bakija.
- Gjevori, M., & Kostari, S., & Shushka, I. (1955). Abetare për klasën e parë të shkollës fillore.Prishtinë. Mustafa Bakija.
- Gjokutaj, M., & Rrokaj, Sh., & Krasniqi, I., & Pozhegu, S. (2012). "Abetare". Shqipëri dhe Kosovë: Dukagjini dhe Pegi.
- Gjokutaj, M., & Rrokaj, Sh., & Krasniqi, I., & Pozhegu, S. (2012). Libri i mësuesit. Shqipëri dhe Kosovë: Dukagjini dhe Pegi.
- Gjevori, M. (2005). Prindërit- edukatorët e parë të fëmijëve. Prishtinë.
- Hasani, H. (1990). Si ta pagëzojmë fëmijën.Prishtinë: Zëri i Rinisë.
- Hasani, H. (2006). 5555 Emra shqip për fëmijë. Prishtinë:Faik Konica.
- Hasani, H. (2010). 6500 Emra shqip për fëmijë. Prishtinë:Faik Konica.

- Hoxha, R. (1966). Abetare për klasen e parë të shkollës fillore (Zhvillimi veçmas i germave të shtypit e të dorës). Prishtinë: Enti i Botimeve Shkollore i Republikës socialiste të Serbis.
- Hoxha, R. (1967). Abetare për klasen e parë të shkollës fillore (Zhvillimi paralel i germave të shtypit e të dorës). Prishtinë:Enti i Botimeve Shkollore i Republikës socialiste të Serbis.
- Hoxha, M. (1977). Abetare. Prishtinë: Enti i Botimeve Shkollore i Republikës socialiste të Serbis.
- Hyseni. H. (1998). Tekstet e nxënësve shqiptar në Kosovë ndërmjet dhunës dhe aspiratave kombëtare, Buletini, 1-2, 33-77.
- Hyseni, H., Salihaj, J., Popovci, D., Shatri, B & Bylekbashi.(2002). Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës. Prishtinë.
- Hyseni, H.,Salihaj, J &Shatri, B (2000).Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës. Prishtinë.
- Hasani, H. (2003). Leksikoni ishkrimtarëve shqiptarë 1501-2001.Prishtinë: Faik Konica.
- Hancock, D., & Algozzine, B. (2017) . Si të bësh studim rasti, Udhëzues praktik për hulumtuesit fillestarë. Columbia University, New York and London.
- Ibrahimi, M.(2012).Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, Shkup.
- Ibrahimi, M. Dukuritë fonetike . Ligjërat. (jo e publikuar).
- Ibrahimi, M..(2018). Sociolinguistika. UNT, Shkup.
- Krasniqi.I. (1978). Abetarja mbështetet në shumë metoda,Shkëndija, nr. 3-4, p.11
- Iljazi,I. (1982). Respekti ndaj mësueses së parë i pazëvendësueshëm,Shkëndija, nr.1-2. 5 janar , fq. 9
- Instituti i Shkencave. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. (1976). Tiranë.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës Fjalor i shqipes së sotme. (2002). Tiranë: “Toena”.
- Juniku,N.(1994). Kaptina nga Psikologjia. Shkup: Asdreni.
- Koliqi, H. (2004). Sistemi i arsimit ne Kosovë. Prishtinë:Libri shkollor.
- Koliqi, H. (1989). Vepra dhe idetë pedagogjike të Naum Veqilharxhit.”BULETINI” i Fakultetit Filozofik. Prishtinë.
- Koliqi, H. (2002). Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Koliqi, H. (1997). Historia e pedagogjisë botërore I. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Kojqini, S. (2006). Zhvillimi i arsimit në Kosovë 1945-1952. Prishtinë.
- Kraja, M.(2009). Pedagogjia. Tiranë.
- Kryeziu, B. (2011). Metodik e gjuhës amtare. Gjilan.
- Kambo, E. (2005). Arsimi në shqipëri (1945-1960). Tiranë.

- Lleshi, Q. (1987). Normalja e Gjakovës. Themelimi dhe brezi i saj i parë (1946 – 1948).
- Martler, C., & Charles, C.N. (2005). Introduction to educational research. United States of America: Pearson.
- Metaj, I. (2009). Orientalizmat shtrirja leksiko-semantike në gjuhën shqipe. Prishtinë: Drenusha.
- Murati, Q. (2015) Shqiptarët dhe shqipja në një botë emrash të përveçëm. Instituti ablanologjik: Prishtinë.
- M. Gjokutaj, Probleme të mësimi të abetares, Prishtinë, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, 2001.
- MASHT, Plan dhe programi mësimor 1, Prishtinë, Ministria e arsimit e shkencës dhe teknologjise, 2003
- MASHT (2003). Plani dhe programi mësimor . Prishtinë.
- Mialaret, G. (1997). Pedagogjia e përgjithshme. Prishtinë
- Memushaj, R. (2011). Shqipja standarde. Tiranë: Toena.
- Mulaku, R. (2005). Hulumtime dialektologjike dhe onomastike. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Nimonaj, V. (2014). Abetaret shqipe në Kosovë 1945-2012. Prishtinë: Libri shkollor.
- Osmani, Shefik dhe Kazazi Njazi (2000). Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike. Tiranë: Idomeno.
- Osmani, T. (1999). Udhë e shkronjave, Shkodër
- Plani dhe program, mësimor për lëndët e mësimi të shkollave tetëvjeçare shqipe, Prishtinë: Mustafa Bakija, 1954.
- Raka, F. (2004). Historia e shqipes letrare. Prishtinë.
- Ramaj, A. (1985). Bibliografia e librit shkollor në Kosovë 1945-1985. Prishtinë: Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës.
- Sulaj, A. (2012). Shkrime dhe hulumtime gjuhësore. Tiranë.
- Syla, Xhevat (2016). Agim Deva I letërsis për fëmijë. Prishtinë.
- Sokoli, L. (2010). Metodat e kërkimit në shkencat sociale. Prishtinë.
- Shimlesha, P. (1983). Pedagogjia. Prishtinë
- Shkurtaj, Gj. (2015). Onomastikë dhe etnolingistikë. Tiranë: Dea.
- Skurti, A. (2001). Mendime rreth abetares të sotme shqipe, Tiranë: Udhë e shkronjave.
- Shatri, B. (2006). Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX sfida, dëshmi , fakte I, Prishtinë: Libri shkollor.
- Shema, I. (2000). Çështje të arsimit kombëtar shqiptar. Libri shkollor: Prishtinë.

Shuteriqi, Dh. (1976). Mbi Veqilharxhin - Fakte dhe hipoteza. Studime filologjike. Akademia e shkencave e RPSSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. Vitit XXX (XIII).nr.4. fq. 134.

Ukaj, K.S. (2006) Zhvillimi i arsimit në Kosovë 1945-1952. Prishtinë.

Veselaj, N. (2015). Drejt standartizimit të gjuhës shqipe. Prishtinë: Era.

Vula, E. (2016). Hulumtimi në veprim. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,

Veselaj, N. (2014). Rreth formësimit të emërimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe. Prishtinë.

Woolfolk, A. (2011). Psikologji e edukimit. Tiranë: Qendra për arsim Demokratik.

Zoto, V. (2016). Fjalor emrash. Tiranë: Dasar.